monumentet



DO NOT COPY

58/2019

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Monumentet

DO NOT COPY

DO NOT COPY

MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS

"GANI STRAZIMIRI"

TIRANË

DO NOT COPY

Monumentet

KY NUMËR I KUSHTOHET PROF. DR. PIRRO THOMOS

ME RASTIN E 80 VJETORIT TË LINDJES

58/2019

Redaksia

Prof. Dr.	Pirro THOMO	Kryeredaktor
MSc.	Arta DOLLANI	Anëtar
Dr.	Edlira ÇAUSHI	Anëtar
MSc.	Marsela PLYKU	Anëtar
Dr.	Elio HOBDARI	Anëtar
Prof. Dr.	Florian NEPRAVISHTA	Anëtar
MSc.	Mimoza ZERECI	Anëtar
MSc.	Joli MITROJORGJI	Anëtar
MSc.	Anduela ARBANA	Sekretare

ISSN 0253-1607

Copyright: Instituti i Monumenteve të Kulturës

Botim i Institutit të Monumenteve të Kulturës

Tiranë, 2019

Në kopertinë: Kisha e manastirit të Shën Kollit, Mesopotam, Sarandë.

SHTËPIA BOTUESE

GRAPHIC LINE-01
Tel.: 04 2246163, info@graphicline01.com

DO NOT COPY

PASQYRA E LËNDËS

ARTIKUJ

Faqe

Prof. Dr. Ali MUKA
Shënime për një Koleg 11

Mimoza ZERECI
Pirro Thomo. Aktiviteti shkencor 2000-2019 17

Mimoza ZERECI
Pasqyrë Bibliografike 1967 – 2019 e Prof. Dr. Pirro Thomo 29

Prof. Dr. Aleksandër MEKSI
Prof. Dr. Pirro THOMO
Ing. Rest. Zaim LILA
Ing. Rest. Alfred ÇOMA
Ndërhyrjet konsoliduese dhe restauruese në Kishën e Manastirit të Shën Kollit, Mesopotam 33

Prof. Dr. Emin RIZA
Studimet e banesës popullore shqiptare dhe e ardhmja e tyre ……..... 71

Prof. Dr. Apollon BAÇE
Anatomia e mbishkrimit të Medaurëve …….....…….... 93

Prof. Dr. Valter SHTYLLA
Kulla e Sahatit e qytetit të Ohrit …….. 117

Andi REMBECI
Zhvillimi arkitekturor dhe urbanistik në Korçë gjatë shek. XV-XIX ……..….... 121

Joannis SARIJANNIDIS
Duke dekodifikuar estetikën dhe sistemin metrik të piktorit të madh Onufër nga Elbasani. Shembulli i ikonës së lëvizshme të shenjtorëve të barabartë me Apostujt, Konstandinit dhe Helenës 145

DO NOT COPY

Era XHAFERAJ
Skënder BUSHI
Renald META
Rrënojat e kishës së Shën Gjergjit në fshatin Mërtish (Lushnjë). Raport paraprak.. 155

Arbela KISI
Skulptura dekorative në eksonarteksin e Kishës së Shën Marisë, Apoloni 165

Dritan ÇOKU
Kulla e Sahatit në Kalanë e Elbasanit ……...…….181

Dr. Federica POMPEJANO
Çatitë tradicionale në Gjirokastër, Shqipëri Teknika e ndërtimit dhe çështje të konservimit 195

Gentian VOKOPOLA
Restaurimi i fragmenteve të dëmtuara të pikturës murale në kishën e "Shën e Premtes" në Valsh, Elbasan ……..... 211
Rudina PAPAVASILI

Kisha e Shën Mëhillit, Vithkuq, Korçë. Metodologjia e dokumentimit dhe strategjia e ndërhyrjeve ……..……... 233

Prof. Dr. Pirro THOMO
Recencë për librin "Arkitektura në Iliri" me autor Apollon Baçe 249

DO NOT COPY

TABLE OF CONTENTS

ARTICLES

Page

Prof. Dr. Ali MUKA
Notes on a Colleague ……..…….... 11

Mimoza ZERECI
PIRRO THOMO. Scientific activity 2000-2019 17
Mimoza ZERECI
Bibliographical overview of Prof. Dr. PIRRO THOMO (1967 – 2019) 29

Prof. Dr. Aleksandër MEKSI
Prof. Dr. Pirro THOMO
Ing. Rest. Zaim LILA
Ing. Rest. Alfred ÇOMA
Conservation and Restoration Interventions in the Catholicon of the Monastery of St. Nicholas at Mesopotam 33

Prof. Dr. Emin RIZA
Studies on the Albanian Vernacular Dwelling and its Future ……..... 71

Prof. Dr. Apollon BAÇE
The anatomy of the inscription of Medauroi ……..... 93

Prof. Dr. Valter SHTYLLA

Clock Tower of the city of Ohrid ……..... 117

Andi REMBECI
Architectural and urban development in Korça during the XV-XIX century 121

Joannis SARIJANNIDIS
Decoding the aesthetics and metric system of the great painter Onufër from Elbasan. The example of the moving icon of the saints, equal to the Apostles Constantine and Helen 145

DO NOT COPY

Era XHAFERAJ
Skënder BUSHI
Renald META
The ruins of the Church of St. George in the village Mërtish (Lushnje).
A Preliminary Report 155

Arbela KISI
Decorative sculptures in the exonarthex of the church of St. Mary (Apoloni) .. 165

Dritan ÇOKU
The clock tower in the Castle of Elbasan 181
Dr. Federica POMPEJANO
Traditional Timber Roofs in Gjirokastra, Albania. Building technique and
conservation issues 195
Gentian VOKOPOLA
Restoration of damaged fragments of mural paintings in the Church of "Saint
Paraskevi" in Valsh, Elbasan 211

Rudina PAPAVASILI
The church of Saint Michael, Vithkuq, Korça. Documentation methodology and
interventions strategy 233

Prof. Dr. Pirro THOMO
Review of the book "Architecture in Illyria" authored by Apollon Baçe 249

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Prof. Dr. Ali MUKA

SHËNIME PËR NJË KOLEG*

Ftesa

Kur gjeta mbi tavolinën e punës në Institut ftesën për të marrë pjesë në promovimin e librit të kolegut dhe mikut tim Pirro Thomo, sinqerisht pata shumë emocione. Spontanisht mendja ime u kthye fluturim në vite të cilat i kujtoj më një notë keqardhjeje dhe boshësie të dhimbshme.

E kam thuajse përditë përpara syve të mi dhe ky është këndi i punës i kolegut tim. Qysh nga prilli i vitit 1991. Pirroja ynë nuk është ulur më për të punuar aty...

Këndi i punës dhe koha

Në zyrën ku vazhdoj të punoj sot me kolegë të tjerë ndodhen ende tavolina karrigia dhe dollapi që formojnë këndin e punës së Pirros. Madje brenda në dollap janë ende të paprekura materiale të tij në një kohë që çelësi, ta dini, ndodhej "i heshtur" në sirtarin tim. Tani besoj e kuptoni më mirë se ç 'ndodhi me mua kur më ra ftesa në dorë. Pasi lexova përmbajtjen e saj, sytë më vanë te këndi i punës i Pirros...

Po të përpiqeshim të llogarisnin sado shpejt e shpejt kohën e "shfrytëzimit" nga Pirroja të "njësive" që e formojnë atë kënd, me siguri edhe unë, edhe kolegët e tjerë të zyrës do të "gaboheshim", për të mos thënë, do të "nxitoheshim''. Mjafton të kujtoj se ekzistenca e pajisjeve në fjalë në përdorim të kolegut tonë të nderuar nuk lidhet, fjala vjen, me riorganizimin e ish-IF (Instituti i Folklorit), sot IKP (Instituti i Kulturës Popullore), por shkon shumë më tutje në kohë, ndoshta dy dekada më tej. Them dy, pasi Pirroja, që nga gjysma e parë e vitit 1991, është vendosur në Selanik të Greqisë fqinje.

Kam bindjen se fillimisht ai nuk gjeti atje ku vajti "fushë me lule" (siç e përfytyrojnë jo pak prej nesh botën tej kufijve tanë). Përkundrazi, e them përsëri me bindje, ai ka arritur t'i bëjë vend vetes falë vullnetit, këmbënguljes dhe karakterit të tij si njeri, por dhe personalitetit të formuar si studiues, tipare këto me domethënie gjithsesi universale e të mirëpritura në ambiente të kulturuara të botës së qytetëruar apo, më saktë, të asaj pjese të botës, që di e çmon vlerat e njeriut të përgatitur...

Shoku dhe miku

Duke kujtuar vitet e njohjes dhe të punës së përbashkët, më erdhi ndër mend një thënie e urtë e popullit: "Shokë mbaj shumë, po miq mbaj pak, se nuk i mban dot"... Kur ma pat thënë një i moshuar këtë shprehje për herë të parë, të them të drejtën, u zura disi ngushtë. Sikur nuk po e kuptoja thelbin logjik të saj. Dhe duke e përmbajtur një lloj shqetësimi të brendshëm, i them të moshuarit në fjalë: "Po pse, ç 'ndryshim ka shoku, nga miku sipas mendjes tënde"? E shoqërova këtë pyetje më një humor të lehtë, për të mos krijuar ndonjë keqkuptim me plakun e nderuar.

DO NOT COPY

Përgjigjja e tij qe vërtet e thekur, pasi me duket se nuk do të ishte e mjaftueshme të thoja e mençur. “Shok mund të kesh shumë, tha plaku. Mund të zësh edhe për ditë. Mund të qeshësh e të bësh edhe shaka me ta, qofshin këto të çdo lloji. E megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme për ta quajtur ndonjërin prej tyre mik. Këtë s’e nxora unë. Edhe mua ma ka mësuar jeta”, theksoi plaku...

“Miqtë, për të cilët po të flas janë ajo pjesë e vogël e shokëve a e shoqërisë që ke, me të cilët ndan gëzimet e vogla e gëzimet e mëdha të jetës, hidhërimet e vogla e hidhërimet e mëdha të saj. Ata, vazhdoi plaku, bëhen si të thuash, pjesë e jetës tënde, po edhe ti bëhesh pjesë e jetës së tyre. E të tillë shokë unë quaj miq, vazhdoi plaku. Ata veçohen nga të tjerët. Ata as nuk i gjen më shumicë kudo e kurdo, por as edhe i mban dot më shumicë...”

Mbresë

E hapa parantezën e mësipërme jo rastësisht. Shpresoj të kem mirëkuptim edhe me Pirron, se nuk kemi qenë thjesht “shokë”, në kuptimet që e shkrova më lart. Unë nuk do ta teproja, po të ndalesha këtu qoftë dhe në ndonjë moment nga marrëdhëniet tona shoqërore.

Në fund të viteve ’60, në kohën kur po punoja në Hidrocentralin e Vaut të Dejës, më vjen transferimi për mësimdhënës në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë. U paraqita në zyrën e kuadrit, për të marrë emërimin për katedrën ku më kishin caktuar. Ndodhem përpara një të “papriture” vërtet të paimagjinuar nga unë. Kujtova se bëhej fjalë për Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, prandaj dhe me një notë naiviteti të lexueshëm qartë, shtrova pyetjen: ‘Shoqja Pandora, më duket se më keni ngatërruar. Unë jam inxhinier. Nuk e kuptoj çfarë lënde do të jap atje ku keni menduar të më caktoni ju”. Ajo ma kuptoi shqetësimin dhe me njerëzillëk më shpjegoi se ç’ ishte pak a shumë ai Institut. Hutimi im filloi të bëhej më i ndjeshëm, kur papritur ajo shtoi: “Atje ke Pirro Thomon, nëse e njeh. Është në sektorin e Historisë së Artit dhe të Arkitekturës. Janë pak njerëz në këtë sektor, prandaj nga pedagogët që të kanë njohur si student, u mendua të shkosh dhe ti”.

I harrova të gjitha hollësitë, detajet, shpjegimet. Emri i Pirros ishte “barka e shpëtimit” për sqarim e vendim. Ne njiheshim me Pirron që 10-11 vjet më parë, kur punonim si gjeometra zbatimi në ish-ndërmarrjen e ndërtimit “21 Dhjetori” në Tiranë.

Kujtoj që kur u takova me Pirron dhe ia bëra të njohur problemin, ai, bashkë me gëzimin që do të punonim së bashku, më rezervoi një pritje të ngrohtë. Theksoj se Pirroja kishte vite që merrej me këtë punë. Ishte emëruar aty fill pasi kishte mbaruar fakultetin si inxhinier ndërtimi, në fillim të viteve ’60. Pasi më bëri të njohur në vija të përgjithshme natyrën e punës dhe vuri re shqetësimin tim, u përpoq të më mbante afër dhe të më tregonte që kjo punë ishte e bukur, kërkonte vullnet, përkushtim e dashuri dhe, bashkë me to, edhe horizont kulturor e shkencor, që arriheshin vetëm me punë.

Këtu e kështu nisën midis nesh ato marrëdhënie të pazhurmshme e të tilla mbetën në vite, pa njohur errësim, por, e shumta, ndonjë “pushim të imponuar”, që nuk varej e as kushtëzohej nga ne, nga njëri e nga tjetri. Vitet bënë punën e tyre. Ne tani nuk punojmë më së bashku. Prandaj, natyrshëm unë marr guximin t’ju pyes: A nuk e kam të drejtën morale, pra, të drejtën njerëzore që të kem emocione?

Janë emocione gëzimi e kënaqësie për Pirron tonë, i cili ka mbi 7 vjet që qëndron sa larg, aq

DO NOT COPY

edhe afër, madje midis nesh... Dhe kjo e fundit, jo vetëm me emër, por edhe me mendje, me angazhime, me kontribute e me botime në dobi të kulturës dhe të shkencës shqiptare, e cila, për hir të së vërtetës, e rriti dhe e formoi edhe Pirron si studiues tanimë të afirmuar.

Libri

Librin që po promovojmë sot, vetëm sa e kam shfletuar. Natyrisht në mënyrë të vëmendshme, të përqendruar e dashamirëse. Pra, siç shihet, ende nuk e kam lexuar, në kuptimin që i japin kësaj fjale studiuesit. Gjithsesi ky mbetet një "borxh" që do të "lahet" shpejt e ndoshta do të shoqërohet edhe me ndonjë recension...

Këtu nuk do të ndalem gjatë për librin. pasi atë besoj se do ta bëjnë specialistë të Institutit të Monumenteve. Megjithatë, mund të them se libri në fjalë, jo vetëm ka një strukturë të menduar, por ka edhe një ndarje në kapituj me interes shkencor. Ata kapituj të orientojnë nga e veçanta tek e përgjithshmja, nga njohja me objekte konkrete, tek vështrimi i kompletuar tipologjik, gjymtyrë pa të cilën vepra do të ishte vërtet e mangët.

Këtu nuk po ndalem as në ilustrimet e goditura, apo në bibliografinë e pasur deri për pjesë të tjera të të quajturit aparat ndihmës të veprës. Veçse një gjë dua ta theksoj qartë dhe shkurt: Veprën e përshkon një mendim shkencor e profesional i paqortueshëm, madje i integruar në kërkesat e sotme të shkencës së historisë së arkitekturës.

Dhe kjo, jo thjesht e vetëm se është kontribut më vlerë për arkitekturën tonë e historinë e saj, se është shkruar në gjuhën tonë amtare, se ka material të gjurmuar, të fiksuar e të dokumentuar në trojet tona, por edhe sepse është zëri i një studiuesi të këtyre trojeve, që ka ditur t'i vërë gjërat në vendin e vet e të thotë për to atë që duhet thënë, saktë e pa mëdyshje. Po ashtu, nuk do të ishte as e drejtë, në kuptimin formal, e as logjike në vështrim profesional, që të na shkonte qoftë edhe kalimthi mendja se ky libër erdhi "papritur", se ky libër "na ra nga qielli". Në këtë vepër, si edhe në të tjera të Pirros, mishërohet një punë e saktë, e lodhshme, e shtrirë në vite. Dhe kam arsye dhe argumente, që më japin të drejtën për të menduar e për të pohuar kështu.

Studiues i formuar në vite

Në shikimin e parë të duket sikur mund ta ezaurosh ashtu shpejt e shpejt, po në fakt nuk është kështu. Madje mund të shtrohet natyrshëm pyetja: Ç' thonë e ç' dëshmojnë vitet e punës e të angazhimit të Pirros si gjurmues dhe si studiues?

I bindur që po marr përsipër një punë jo aq të lehtë sa mund të duket, po përpiqem me ndjenjën e përgjegjësisë qytetare të kolegut që t'i përgjigjem pyetjes përmes ndriçimit të disa momenteve kryesore, sipas gjykimit tim, në veprimtarinë e Pirros.

Së pari: Pirroja është njohës i mirë e i përkushtuar i punës në terren, një gjurmues i kujdesshëm dhe i apasionuar. Ejani në skicotekën dhe në fototekën e IKP-së, dhe do të shihni se materialin e mbledhur nga ai e karakterizon jo vetëm sasia, jo vetëm "gjeografia" e shtrirjes, por dhe cilësia e mirë në raport me kushtet, me mundësitë dhe me rrethanat. Kjo "gjeografi" e këto hulumtime, të shoqëruara edhe me material grafik dhe fotografik, nuk kanë lënë jashtë vëmendjes as Kosovën, në përgjithësi dhe Rrafshin e Dukagjinit, në veçanti. Ndiqni qoftë edhe listën e "Monumenteve të Kulturës", të fushave e të gjinive të ndryshme të

DO NOT COPY

shpallura tek ne në vite dhe do të konstatoni se, nga një anë, Pirroja është autor ose bashkautor në zbulimin dhe dokumentimin e tyre dhe, nga ana tjetër, do ta ndjeni se "gjeografia" e hulumtimeve të këtij autori vjen e bëhet gjithnjë e më e pasur. Por ka dhe një anë tjetër, njerëzore do ta quaja, të punës gjurmuese të Pirros në terren.

Atë mund ta përmblidhja me pak fjalë: mirëkuptim e angazhim me kolegët pjesëmarrës, shfrytëzimin maksimal i kohës dhe drejtim e organizim i forcave ndihmëse pjesëmarrëse në gjurmim, i them këto pasi i kam përjetuar dhe nga afër, si pjesëmarrës në disa ekspedita gjurmuese e studimore. Kujtoj, fjala vjen, që edhe ekspedita ime e parë u krye më pjesëmarrjen e Pirros...

Kujtoj gjithashtu, ekspedita të kryera se bashku më Pirron dhe me pjesëmarrje të studentëve të degës së arkitekturës të Universitetit të Tiranës. Pirroja dinte t'u krijonte atyre ambient të ngrohtë qëndrimi e pune, një bilanc të të cilave mund të quaja lidhjet miqësore që ai krijoi në vite më ta.

Së dyti. Pirroja nuk ka qenë i angazhuar e nuk ka punuar vetëm për ndërtimet e kultit, për çka flet qartë vepra që kemi në dorë. (Kujtoj kalimthi që kjo vepër është paraprirë nga botimi i një numri të konsiderueshëm artikujsh shkencor në revistën "Monumentet'). Ai shfaqet po kaq i angazhuar, në mos më shumë, fjala vjen, në fushën e arkitekturës popullore. Madje, jo vetëm të asaj fshatare, por edhe të asaj qytetare.

Shfletoni sado shpejt bibliografinë e punimeve të tij shkencore dhe nuk do të ndjeni nevojën e dikujt tjetër që t'ju bindë. Ndaluni te monografitë "Banesa fshatare e Shqipërisë Veriore", apo "Korça, urbanistika dhe arkitektura", njihuni me vëllimin e parë të korpusit "Vendbanimet dhe ndërtimet fshatare shqiptare" dhe do të bindeni se informacionet, analizat, interpretimet e përfundimet i kanë qëndruar e do t'i qëndrojnë kohës. Kujtoj, fjala vjen, se klasifikimi tipologjik i banesës fshatare shqiptare mbetet ende ai që ka bërë Pirro Thomo.

Veçse, nuk mund të lihet pa përmendur një sfond tjetër me peshë jo pak të ndjeshme, që shoqëron gjurmimet dhe studimet e tij në fushën e arkitekturës popullore. Kushdo që e kalon nëpër duar punën e tij në këtë fushë, do të ndjejë se pranë inxhinierit të ndërtimit, qëndron, madje me nivel cilësor, historiani i arkitekturës. Dhe, pranë këtij të fundit, ju do të ndjeni praninë e etnologut "të terrenit", por edhe "të kabinetit".

Prandaj Pirron mund ta quash pa asnjë hezitim jo vetëm historian arkitekture por edhe etnolog.

Së treti, Pirron e bënë rrethanat e jetës dhe të punës edhe një restaurator të mirëfilltë, të formuar në punë e sipër. "Pagëzimin" si i tillë e mori në qytetin e Korçës. Gjeni rastin të shkoni në atë qytet dhe do t'ju "flasin " për këto banesat dhe të gjitha kategoritë e tjera ndërtimore me vlera historiko-arkitektonike të restauruara nën drejtimin e tij. Me këtë rast mund të pohoj se, po të bëhej historiku i Ateliesë së Monumenteve dhe i punëve të kryera prej saj në atë qytet, do të konstatonit që, pa emrin, punën dhe angazhimin e tij, ajo vështirë ta shfaqte fizionominë që mori ndër vite.

Se katërti, shfletoni qoftë dhe kalimthi, dokumentacionet e punës së këshillave shkencore të Institutit të Historisë, të Institutit të Monumenteve të Kulturës apo të Institutit të Kulturës Popullore. Shfletoni po ashtu edhe dokumentacionet e punës së redaksive të botimeve të tilla, si: "Studime Historike", "Monumentet" apo "Kultura Popullore" dhe do të bindeni se

DO NOT COPY

edhe aty, si anëtar permanent (në të dy rastet), ka vendin e vet emri, mendimi dhe gjykimi i Pirros.
Së pesti, shenjat e një studiuesi të formuar, thotë shpesh një miku im i vjetër, duken qysh tek respekti që ai shfaq ndaj kolegëve e ndaj mendimit shkencor të tyre, sidomos ndaj atij të publikuar. Korrektesa në këtë vështrim, e them me bindje, është një tipar tjetër i tij. "Armik" i heshtjes dhe "mik" i evidentimit të qartë të asaj që e ka thënë tjetri. Pirroja mbetet njëherazi injorues ndaj atyre që s'e kanë për gjë për të mos thënë e kanë sëmundje, plagjiaturën. Tregojnë kulturë e njëherazi njohuri të gjera citimet relativisht të shumta në botimet e tij, por, mbi të gjitha, ato dëshmojnë respekt ndaj kolegut, pavarësisht nivelit të punës që ka publikuar. Kësaj i duhet shtuar njohja dhe përdorimi i disa gjuhëve evropiane.

Vështrim kolegu
Duke mos u zgjatur: Në angazhime a kontribute të Pirros në fusha e në drejtime të ndryshme, nuk mundem, brenda këtij diskutimi modest, të mos them pak fjalë për Pirron si koleg e mik, si njeri dhe si studiues. Kjo ka arsyen e vet. E ndjej për obligim moral, nga raportet që kanë karakterizuar marrëdhëniet tona.
Të gjitha këto (kolegu, njeriu dhe studiuesi) nuk mund të mos merren se bashku e as të mos shihen në harmoni me njeri-tjetrin, sepse të tillë janë në të vërtetë. Pirron e karakterizojnë tiparet e një njeriu sa të edukuar, aq edhe të heshtur në qëndrim, e karakterizojnë tiparet e një kolegu sa të matur, aq edhe të pranishëm në gjykim. Dhe, së fundi, por jo e fundit, atë e karakterizojnë tiparet e një studiuesi sa të saktë, aq edhe racional në veprim. Janë të gjitha këto veti themelore, që na e prezantojnë Pirron tonë me një personalitet të formuar shkencor, por "të vetin", "të pa zhurmshëm" apo më saktë, disi diskret.

Mesazhe të veprës
Në mbyllje të këtij kumtimi dua të them se vepra që promovojmë sot këtu, përcjell, e pakta, tre mesazhe.
Të gjithë e dimë se, ashtu si Pirroja, na janë larguar shumë intelektualë të vjetër e të formuar (edhe nga fushat tona), por edhe të rinj e të përkushtuar (edhe të këtyre fushave). Dhimbja në kuptimin fisnik të fjalës, është e përmasave të mëdha, por, në fund të fundit, ky është realiteti. Libri që kemi në dorë duket si një dritë shprese e besimi, si një dritë optimizmi në "tunelin" me pak dritë, të cilit, në prani të pamjaftueshme të kësaj të fundit, vështirë t'i "matet" gjatësia...
Dhe jo vetëm kaq. Pirroja është nismëtar dhe njëherazi organizator i disa simpoziumeve dhe ekspozitave në shtetin fqinj (Greqi), ku janë pasqyruar dhe kanë gjetur jehonë, rezultatet e punës studimore e restauruese në Shqipëri. Po ashtu ai vazhdon të jetë projektues dhe drejtues i punimeve restauruese në disa prej monumenteve tona mesjetare (kisha a manastire), që trashëgojmë nga e kaluara.
Pra, libri i Pirros dhe në tërësi aktiviteti i tij, i pasqyruar shumë shkurt më lart, bën pjesë në ato sinjale ogurmirë që duket sikur u thonë të gjithë bijve të kësaj toke "Mos e harroni nënën"! Kjo nënë duket se e ka të vështirë ta mbajë gjallë e jo më ta rrisë e ta konsolidojë më tej bijën e saj, shkencën shqiptare, pa mendimin, veprimin e kontributin tuaj!". Më thoni,

DO NOT COPY

a nuk më jepet e drejta të pyes, cilën zemër të brumosur me ndjenjën fisnike dhe humane të patriotizmit jo zhurmues nuk e prek, nuk e ngacmon apo nuk e vë në lëvizje për mirë ky mesazh? Përgjigjen, le t'ia lemë kohës...

Historia, kjo nënë e kujtesës njerëzore, veç të tjerash, ka mbajtur mjaft të gjalla monumente të trashëgimisë kulturore, si dëshmi të pakontestueshme nga një anë, të individualitetit të popujve tanë dhe, nga ana tjetër të bashkëjetesës se tyre, për mjaft prej tyre, duke i vlerësuar si pasaporta autentike vlerash të nivelit të zhvillimit kulturor. Jemi angazhuar t'i mbrojmë, t'i studiojmë dhe t'i restaurojmë, dhe këtë e bëjmë pasi ato janë një testament vërtet i vlertë edukimi, por edhe vlerësimi e respekti reciprok që ndikojnë dhe duhet të ndikojnë gjithmonë e më shumë, në vlerësimin realist të marrëdhënieve reciproke të nevojshme dhe të domosdoshëm për popujt.

Sepse të duket sikur ato flasin e thonë më zë të lartë: kemi nevojë për njeri-tjetrin, kemi nevojë për mirëkuptimin dhe për dashuri njerëzore.

Dhe vetiu prej këtu rrjedh mesazhi i dytë që na përcjell libri i Pirros. Ai sikur u thotë studiuesve a politikanëve qofshin se Zoti na ka vënë pranë e pranë të bashkëjetojmë e jo të grindemi, se Zoti, kjo ide universale e të mirës na i ka bërë fort të qarta ç'është përkohshmëria e ç 'është përjetësia.

Në këto kuptime, Pirroja dhe të gjithë ata të nderuar (individë a institucione) që janë marrë me realizimin e këtij botimi, sikur "flasin" e "bëjnë thirrje" për mirëkuptim e për angazhim të përbashkët në ndriçimin dhe publikimin e vlerave pa paragjykime. Qoftë kështu!

Kam "frikën" dashamirëse se shumëkush nga ju që e njihni, nuk e di se Pirroja ynë këtë vit mbush trezet (gjashtëdhjetë) vjeç, siç thonë shkodranët. E thashë kështu, disi shkodrançe, sepse më duket sikur i jap më të zvogëluara vitet, nga ç 'janë ata në të vërtetë... Kam një "propozim": Gjeni mundësitë, ju lutem dhe shikojini me vëmendje të gjitha tiparet e fytyrës së tij, madje tërë figurën. Dhe do të shikoni që në të është më e dukshme "streha e freskisë", sesa "kalaja" e viteve të moshës...

Dhe bashkë me këtë "portretizim fizik", vjen një mesazh, në formën e një thirrjeje prej miku e kolegu:

Pirro i dashur! Ma merr mendja që ti i do njerëzit që të rrethojnë atje ku punon e jeton, sepse me siguri të duan edhe ata. Veçse, kam një porosi 'të vogël', një kërkesë 'të vogël' apo dëshirë te madhe: Mos u shkëput nga trualli mëmë! Ai prej nga ti siç e dëshmove me këtë libër, të presin edhe miqtë e tu etnologë. Edhe për punën (Mos harro! Tavolina, dollapi dhe karrigia janë aty), edhe për të pirë kafe gjithë lezet, apo.... raki Përmeti, gjithë humor e kënaqësi. Dhe duke i marrë të gjitha së bashku. Mos harro kurrë mesazhin e heroit të papërsëritshmin të mitologjisë greke, mesazhin që simbolizon ANTEU...

Prandaj, të presim të na gëzosh e të na tubosh në angazhime të reja, në promovime të reja!

Si thoni, a kam të drejtë?...

* Ky diskutim është mbajtur në promovimin e librit Kishat Pasbizantine në Shqipërinë e Jugut të autorit Pirro Thomo. Aktiviteti u zhvillua më 51 mars 1999, në sallën e Muzeut Historik Kombëtar

** Kujtoj që shqyrtimi i librit në këndvështrime të ndryshme u bë në atë takim nga parafolës të tjerë të përgatitur posaçërisht.

DO NOT COPY

Mimoza ZERECI

PIRRO THOMO. AKTIVITETI SHKENCOR (2000-2019)

DO NOT COPY

Periudha nga 60-vjetori në 80-vjetorin e e Prof. Dr. Pirro Thomo do të karakterizohej nga shfaqja e të njëjtit pasion, përkushtim dhe të njëjtës përkujdesje për mbrojtjen dhe propagandimin e vlerave të kulturës sonë kombëtare: Ai në këto 20 vjet shquhet për një veprimtari në disa fusha:

1. Propagandues i vlerave të kulturës sonë kombëtare.

Në sa e sa simpoziume e konferenca ndërkombëtare e kombëtare i ka bërë të njohura opinionit shkencor të huaj e vendas pasuritë e trashëgimisë kulturore që ruhen, mbrohen dhe restaurohen në Shqipëri. Mjafton t'i hedhësh një sy bibliografisë së Pirro Thomos për të kuptuar gjerësinë dhe larminë e tematikës së lëvruar prej tij. Në Mineapolis të USA bëri të njohura *Karakteristikat e arkitekturës pasbizantine në Shqipëri*, në Melburn të Australisë opinioni shkencor u njoh me *Pikturën e shpellave eremitë të Prespës*, tema e referuar në Stamboll të Turqisë bënte fjalë për *Tipologjinë e ndërtimeve prej druri*; *Një mënyrë veçantë e fortifikimit të banesës: banesat me kullë në Shqipëri, kishat e Voskopojës, Probleme të rijetëzimit të ansambleve historike, shembulli pazarit të Korçës, Veprimtaria e piktorëve mesjetarë në hapësirën ballkanikë* etj., janë temat e referuara në simpoziume të ndryshme në Selanik, kumtesat mbi *Vlerësimin dhe vënien në mbrojtje të Qendrës Historike të qytetit të Korçës* dhe *Tiparet e reja të arkitekturës fshatare gjatë gjysmës së dytë të shek. XXIX-fillimit të shek. XX* u referuan në simpoziumet e Verias, për *Kishën e manastirit të Çatistës* u fol në konferencën shkencore në qytetin e Dramës, mbi *Trashëgiminë arkitektonike dhe artistike të monumenteve në rajonin e Gjirokastrës* u referua në Follorinë, kumtesa për *Voskopojën dhe lidhjet e saj me botën e jashtme* u mbajt në Monemvasia të Peloponezit, *Shpërndarja kohore dhe territoriale e arkitekturës pasbizantine në Shqipëri, Aspekte të njësisë dhe ndryshueshmërisë në trashëgiminë ndërtimore të vendeve fqinje* ishin kumtesat e mbajtura në aktivitetet shkencore në Tiranë. Nuk kanë munguar dhe kumtesat që lidhen me përvojën personale restauruese, si *A mundim t'i rrisim jetën elementeve prej druri*, apo *Mbi ruajtjen e autenticitetit gjatë ndërhyrjeve restauruese, restaurimi i varrit të Hortaxit në Rotondën e Selanikut*, në Selanik, apo *Vështirësitë teknike në procesin e restaurimit të trashëgimisë ndërtimore* dhe *Për një interpretim më të drejtë të nocioneve "monument i kategorisë së dytë" dhe "rrjetëzim" i monumenteve* në Tiranë.

2. Veprimtari organizative.

Në mjaft nga aktivitetet shkencore të mësipërmet është ndjerë dhe kontributi i Prof. Dr. Pirro Thomos, si anëtar i bordeve organizative apo shkencore të tyre. Nga më të rëndësishmet

mund të përmendim:
Congres International, *Interventions architecturales dans les Centres Historiques de Villes*, Veroia-Grèce, 2-3 tetor 1995, Congrès International: *Architecture Balkanique Traditionelle*, Thessalonique 7-10 Nov. 1997), International Conference and Exhibition on *the Restauration and Rehabilitation of Historic Buildings and Towns*, Thessaloniki 1999
Congres International *Architecture Vernaculiaire des Balcans*, Veroia, Grèce, 12-15 Oct. 2000, Simpoziumi Ndërkombëtar: *2000 Vjet Art dhe Kulturë Kishtare në Shqipëri*, Tiranë, 16-18 nëntor 2000, Simpoziumi: *Ndërhyrje të përmbajtura dhe mbrojtja e ndërtesave historike*, Selanik, 2000, Konferenca ndërkombëtare shkencore: *50 Vjet Studim dhe Restaurim i Trashëgimisë kulturore Shqiptare*, Tiranë 22-23 tetor 2015

3. Veprimtaria botuese.
Përveç kumtesave të mbajtura në konferenca e simpoziume shkencore, që në pjesën më të madhe të tyre janë botuar në aktet e këtyre aktiviteteve, Pirro Thomo ka botuar dhe një numër të konsiderueshëm artikujsh në periodikët e ndryshëm shkencorë. Shumë prej tyre pasqyrojnë punimet e restaurimit në monumente të rëndësishme, si për ndërhyrjet restauruese në kishën e Leusës pranë Përmetit, Amfiteatrin e Durrësit, kishën e Zervatit të Gjirokastrës, kishën e Labovës së Kryqit, apo përmbledhësin për ndërhyrjet konservuese dhe restauruese në monumentet e Kishës Ortodokse. Si rezultat i iniciativës dhe përkujdesjes së tij kemi sot veprën fondamentale Historia e Arkitekturës në Shqipëri dhe rifillimin e botimit të revistës prestigjioze "Monumentet", vepra madhore e Institutit të Monumenteve të Kulturës.

4. Në fushën e mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve.
Si rezultat i studimeve dhe propozimeve të tij u vunë në mbrojtje Qendrat Historike të qytetit të Korçës, Pogradecit, fshati i vjetër i Himarës dhe Ansambli historiko-arkitektonik i pazarit të Bilishtit (Korçë).
Të shumta janë gjithashtu projektet, udhëzimet, udhëheqjet dhe konsultimet për ndërhyrjet konsoliduese e restauruese. Si shembuj mund të përmendim projektet për objekte të rëndësishme të manastireve të Ivironit, Stavronikitës dhe Pantelejmonit në Malin e Shenjtë, (Greqi) banesa dhe ansamble urbanistiko-arkitektonike në qytetin e Selanikut etj.; projektet dhe drejtimin e punimeve të restaurimit për kishën e Leusës, manastirin e Shën Gjergjit të Demës, manastirin e Kakomesë, manastirin e Zvërnecit, kishën e Zervatit, të Bodrishtës, Amfiteatrin e Durrësit etj.; udhëheqjen e punimeve në kalatë e Durrësit e të Peqinit, ansamblet e lagjeve Kala e Goricë si dhe të kishës së Shën Mëhillit të qytetit të Beratit, drejtimin e ndërhyrjeve në kishën e Labovës së Kryqit, Pëshkëpisë së Sipërme, etj.; bashkëpunime për realizimin e punimeve të restaurimit të kishës së Ristozit të Mborjes, kishës së Shën Kollit të Mesopotamit, konsultime për hartimin e projekteve të Restaurimit dhe rikualifikimit urban i fshatrave Dhërmi e Vuno, si dhe për Pazarin e Gjirokastrës. Falë përgatitjes profesionale të formuar nga një përvojë shumëvjeçare mori përsipër modifikimin e projektit të konsolidimit dhe restaurimit të kishës së Shën Pandelejmonit në Selanik, monument në mbrojtje të UNESCO-s. Si rezultat, restaurimi i realizuar sipas këtij modifikimi u vlerësua nga Organizata Europa Nostra si restaurimi më i mirë i vitit 2000.

DO NOT COPY

Gjatë viteve 2000-2009 udhëhoqi Bërthamën e Restaurimit, të ngritur pranë Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Me iniciativën dhe mbështetjen e Kryepeshkopit të Tiranës, Durrësit dhe të Gjithë Shqipërisë, Fortlumturisë së tij Anastasit, kjo bërthamë projektoi dhe restauroi një numër të konsiderueshëm kishash monument kulture, të cilat janë pasqyruar në përmbledhësin Restaurimi i Monumenteve të Kishës Orthodhokse në Shqipëri.

5. Në fushën e trajnimeve dhe mësimdhënies.

Transmetimi i përvojës teorike e praktike në fushën e mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve është konsideruar si një detyrim nga Pirro Thomo. Kështu ai mban një cikël leksionesh në Trajnimin Kombëtar "Analizë Strukturore dhe Përforcuese si dhe Teknika të Muraturave në Ndërtesat Historike", organizuar nga Instituti i Monumenteve, si dhe në kampet rajonale të restaurimit, organizuar nga Organizata Cultural Heritage Without Borders – Albania.

Këtë vit u mbyll dhe viti i tretë i Masterit Profesional në Restaurimin e Monumenteve të Kulturës, pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, në të cilin kurs Pirro Thomo jep lëndën e Vlerësimit dhe Restaurimit, si dhe lëndën e Konsolidimit të Monumenteve të Kulturës, duke udhëhequr njëkohësisht dhe një numër të konsiderueshëm diplomash në këtë fushë.

Në këtë përvjetor të 80-të, i urojmë Jetë të Gjatë, Shëndet e sa më shumë Krijimtari, Profesorit të Nderuar Pirro THOMO!

Suksese më tej në të gjitha angazhimet e Tij, që sigurisht do të vijojnë e do të dallohen nga përkushtimi, dashuria dhe profesionalizmi i lartë, si gjithmonë në pararojë për evidentimin, mbrojtjen dhe restaurimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore të Shqipërisë!

DO NOT COPY



1. Ekspeditë për në manastiin e Athalit, Himarë



2. Gjatë dokumentimit në manastirin e Dhuvjanit

DO NOT COPY




3. Marrje kampionesh në kishën e Manastirit të Zvërnecit



4. Dokumentim gjurmësh të vjetra në kupolën e kishës së Labovës së Kryqit

DO NOT COPY



5. Diskutim me kolegë në kishën e Zervatit



6. Diskutim me kolegë në kishën Labovës së Kryqit

DO NOT COPY



7. Diskutim me kolegë në kishën e Mesopotamit



8. Diskutim me kolegë në kishën e Mborjes

DO NOT COPY



9. Diskutim me kolegë në kishën e Leshnicës



10. Leksion i hapur me studentët e Masterit Pofesional në kishën e Labovës së Kryqit

DO NOT COPY



11. Leksion i hapur me studentët e Masterit Pofesional në kishën e Peshkëpisë së Sipërme



12. Leksion në kursin e trainimit në IMK

DO NOT COPY



13. Gjatë promovimit të tekstit të Historisë së Arkitekturës në Shqipëri studentët e Masterit Pofesional në kishën e Peshkëpisë së Sipërme



14. Leksion në Shkollën Verore për Kulturën Bizantine, viti II

DO NOT COPY



15. Në Konferencën Shqipëria 60 vjet në UNESCO



16. Në veprimtaritë e Akdemisë së Shkencave

DO NOT COPY



17. Dhënia e diplomave për Masterin Profesional në Restaurim



18. Pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare për 50 vjetorin e IMK

DO NOT COPY

Mimoza ZERECI

Pasqyrë Bibliografike 1967 – 2019 e Prof. Dr. PIRRO THOMO

THOMO, P., "Arkitektura e Kishës së Ristozit në Mborje të Korçës", *Studime Historike,* Tiranë, 1967, 2.

THOMO, P., "Kalaja e Skënderbeut në Kepin e Rodonit", *Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike*, Tiranë, 1969, vëll. I.

THOMO, P., "Banesa popullore e tipit kullë në Mat dhe në Mirditë", *Etnografia Shqiptare*, Tiranë, 1972, 4.

THOMO, P., "Mbi dy monumente të arkitekturës sonë mesjetare në shek. XI-XIV", *Studime Historike,* Tiranë, 1972, 4.

THOMO, P., "Banesa e fortifikuar në Malësinë e Gjakovës", *Studime Historike,* Tiranë, 1973, 3.

THOMO, P., "Arkitektura e banesës fshatare shqiptare", *Studime Historike,* Tiranë, 1974, 3. "L'architecture rurale Albanaise, ses types et leur diffusion", *Studia Albanica*, Tirana, 1974.

THOMO, P., "Arkitektura e banesës fshatare në Has", *Studime Historike,* Tiranë, 1975, 1.

THOMO, P., "Arkitektura e banesave fshatare në Shqipërinë e Veriut gjatë shek. XIX", *Monumentet*, Tiranë, 1976.

THOMO, P., "Banesat me "qoshk" në Shqipërinë e Veriut", *Etnografia Shqiptare*, Tiranë, 1976, VIII.

THOMO, P., "Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës (gjatë shekullit XIX - fillimi i shekullit XX)", *Monumente Historike në vendin tonë,* Tiranë, 1978.

THOMO, P., "Kulla e Shqipërisë së Veriut si banesë fshatare dhe procesi i formimit të tyre", "Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike", Tiranë, 1977.

THOMO, P., "Restaurimi i shtëpisë së Vangjush Mio-s", *Monumentet*, Tiranë, 1979, 18.

DO NOT COPY

THOMO, P. *Arkitektura fshatare e Shqipërisë Veriore*. Tiranë, 1981.

THOMO, P., "Banesat e hapura në qytetin e Korçës dhe disa probleme të restaurimit të tyre", *Monumentet*, Tiranë, 1982, 1(23).

THOMO, P., "Banesa me kullë në Shqipëri", *Etnografia Shqiptare*, Tiranë, 1982, 12.

THOMO, P., RIZA, E., "Kritere dhe metoda për gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve popullore në RPSH", *Monumentet*, Tiranë, 1983, 1, (25).

THOMO, P., "Vështrim historiko – arkitektonik mbi pazarin e Korçës", *Etnografia Shqiptare*, Tiranë, 1983, 13.

THOMO, P., "Vështrim urbanistiko – arkitektonik mbi lagjen e vjetër të Pogradecit", *Vepra të mjeshtërve tanë*, Tiranë, 1983.

THOMO, P., "Tiparet urbanistike dhe arkitektonike të fshatit Dardhë – Korçë", *Etnografia Shqiptare*, Tiranë, 1985, 14.

THOMO, P., "Les nouveaux traits architecturals et constructifs des marches des villes balkaniques durant 19 ème - 20 ème sciècles. Le marché de Korça", kumtesë e mbajtur në: *7 ème Congres International d'études du Sud-Est Europeen,* Thessalonique, 29 août-4 septembre 1994.

THOMO, P., "The characteristics of Post-byzantine architecture in Albania and its incorporation into the Post-byzantine architecture of the Balkans", kumtesë e mbajtur në: International Conference, *An Unknown Territory: The Art and Architecture of Albania in a Balkan Context*, University of Minnesota, Minneapolis, April 14-17, 1994.

THOMO, P., "Αξιοποίηση και προστασία του Ιστορικού Κέντρου της Κορυτσάς" (La mise en valeur et la protection du Centre Historique de la ville de Korçë), kumtesë e mbajtur në: Congres International, *Interventions architecturales dans les Centres Historiques de Villes*, Veroia-Grèce, 2-3 tetor 1995.

THOMO, P., "Byzantine Monuments on Great Prespa", *Byzantine Macedonia, Art, Architecture, Music and Hagiography,* Melburne 2001, Papers from the Melbourne Conference, July 1995, p. 97-106.

THOMO, P., "Les constructions en bois en Albanie", kumtesë e mbajtur në: Table ronde organisé par l'Institut Francais d'Etudes Anatolienne et l'Université Technique d'Istambul, Istanbul, 19-20 Avril 1996, *La Maison Ottomane, origine, typologie, aires de diffusion.*

THOMO, P., «Μπορούμε να παρατείνουμε τη ζωη τον ξύλινων στοιχείν», Μνημείο&Περιβάλλον, 4, 1997, σ. 115-122, (Thomos, P., "Can we make timber elements last longer?", Monument & Environment, 4, 1997).

DO NOT COPY

THOMO, P., "Η Μοσχόπολη και οι σχέσεις της με τοω έξω κόσμο" (Moschopolis and its relations with the world at large), kumtesë e mbajtur në: ΙΑ' Συμπόσιο ιστορίας και τέχνις, *Επικοινωνίες και ματαφορές στην προβιομηχανική περίοδο,* Κάστρο Μονεμβασιάς 23-26 ιουλίου 1998, (11th Symposium of History and Art, *Communication and Transport in the Pre-industrial Era*, Monemvasia, Castro 23-26 July 1998).

THOMO, P. *Kishat Pasbizantine në Shqipërinë e Jugut*. Tiranë, 1998.

THOMO, P., «Οι εκκλησίες της Μοσχόπολης (Αρχιτεκτονική ανασκόπηση)», (The Churches of Moshopolis: an Architectural Review), *Διεθνές Συμπόσιο, Μοσχόπολις,* Θεσσαλονίκη 31 Οκτ.-1Νοεμβ. 1996, σ. 45-64, Θεσσαλινίκη 1999.

THOMO, P., «Ένας ξεχωρστός τρόπος οχύπωσης υης κατοικίας – Ηκατοιχία με πύργο στην Αλβανία» (Thomo P., Une manière particulière de fortification de la maison: L'habitation a "kulla" en Albanie), *Βαλκανική παραδοσιακή αρχιτεκτονική. Πρακτικά διεθνούς συνεδρίου, Θεσσαλονίκη, 7-10 Νοεμ. 1997(Architecture Balkanique Traditionelle. Actes du Congrès International, Thessalonique 7-10 Nov. 1997)*, pp. 129-143, Thessaloniki 1999.

THOMO, P., Kallamata K., "Προβλήματα αναβίωσης ιστορικώω συνόλων. Η περίπτοση της αγοράς (παζαριού) Κορυτσάς " (Probleme të rijetëzimit të ansamblemeve historike. Rasti i pazarit të Korçës), kumtesë e mbajtur në: *International Conference and Exhibition on the Restauration and Rehabilitation of Historic Buildings and Towns*, Thessaloniki 1999.

THOMO, P., "Τα Νέα Γνωρίσματα της Αγροτικής Αρχιτεκτονικής κατά το β' ήμισυ του 19ου αι.- αρχές 20ου αι. στην Αλβανία" (Caracteristique nouvelles dans architecture rurale pendant la seconde moitié du 19 ème sciècle-début du 20 ème sciècle en Albanie), kumtesë e mbajtur në: Congres International d'Architecture Vernaculiaire des Balcans, Veroia, Grèce, 12-15 Oct. 2000.

THOMO, P., «Αποκατάσταση του τάφου του Χορτάτζη στη Ροτόντα Θεσσαλονίκης», *Ήπιες επεμβάσεις κι προστασία ιστορικών κατασκευών.* Πρακτικά1ου Εθνικού Συναδρίου 23-25 Νοεμβρίου 2000, Θεσσαλονίκη, (Thomos, P., Restoration of the Tomb of Hortatzi, Rotonda-Thessaloniki, *Appropriate Interventions for the Safeguarding of Monuments and Historical Buildings.* Proceedings of the 1st National Congress 23-25 November 2000, Thessaloniki), pp. 543-552, Θεσσαλονίκη, 2001.

THOMO, P., Κομάτας Δ., «Το καθολικό της μονής Τσιάτιστας και ο μιτροπολίτης Νευροκόπου Δανιήλ», *Η Δράμα και η περιοχή της.Ιστορία και πολιτισμός,* Γ' Επιστημονικής Συνάντιση, Δράμα 21-24 Μαϊου 1998, σ. 177-188, Δράμα 2002.

THOMO, P., "Αρχιτεκτονική τεκμηρίωση του ναού της Κοιμήσεως της Θεοτόκου στο Ζερβάτι του Αργυποκάστρου", *Μνημείο&Περιβάλλον,* σ. 123-146, Θεσσαλονίκη 2002, (Thomo P., "Architectural Documentation of the Church of Dormition in Zervati, Argyrokastro", *Monument&Environment*).

DO NOT COPY

THOMO, P., "Shpërndarja kohore dhe territoriale e arkitekturës pasbizantine në Shqipëri", *2000 vjet Art dhe Kulturë Kishtare në Shqipëri,* Aktet e Simpoziumit Ndërkombëtar, Tiranë, 16-18 nëntor 2003, f. 171-178.

THOMO, P., MUKA, A., RIZA, E. *Vendbanime dhe banesa fshatare, I*. Tiranë, 2004.

THOMO, P., "Konsolidimi dhe restaurimi i kishës "Fjetja e Shën Marisë" në Zervat të Gjirokastrës", *Monumentet,* f. 17-65, Tiranë, 51/2009-2010.

THOMO, P. *Korça, Urbanistika dhe Arkitektura*. Tiranë, 1988, bot. i dytë 2012.

THOMO, P., SARIGIANNIDIS, I., GAVRA, E. G., "The Ecclesiastical Architecture - Art in the greater region of Gjirokaster. Promotion of the local history through the educational institutions of the archdiocese", kumtesë e mbajtur në: International Conference Education across Borders, Florina, 5-7 October 2012.

THOMO, P., "Aspekte të njësisë dhe ndryshueshmërisë në trashëgiminë ndërtimore të vendeve fqinje", *Albanohellenica,* 5, 2013, f. 269-286.

THOMO, P., «Η δραστηριότητα των μεσαιωνικών ζωγράφων στον βαλκανικό χώρο» (Activities of Medieval Painters in the Balkans Region), kumtesë e mbajtur në: Διεθνές Συμπόσιο, *Πολιτισμός & Χώρος στα Βαλκάνια, 17ος-20ος αιώνας, Θεσσαλονίκη 21-22 Νοεμβ. 2014* (International Symposium, ***Culture and Space in the Balkans (17th-20th centuries)***, Thessaloniki 21-22.11.2014).

THOMO, P., "Vështirësitë teknike në procesin e restaurimit të trashëgimisë ndërtimore", kumtesë e mbajtur në takimin me temë: *Rijetëzimi i Trashëgimisë Kulturore, potenciale dhe sfida*, Tiranë 22 tetor 2014.

THOMO, P., "Manastiret e krahinave të Gjirokastrës", *Monumentet*, Tiranë, 2015, 53.

THOMO, Pirro., "Për një interpretim më të drejtë të nocioneve "monument i kategorisë së dytë" dhe "rijetëzim i monumenteve", *Monumentet*, 2015, 54/2, fq. 45 mbajtur në konferencën shkencore "*50 Vjet Studim dhe Restaurim i Trashëgimisë Kulturore Shqiptare"*, mbajtur në Tiranë, 22-23 tetor 2015, me rastin e 50 vjetorit të krijimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës.

THOMO, Pirro., MEKSI, A., "Sistemi konstruktiv i Kishës së Shën Marisë në Labovë të Kryqit – Gjirokastër", *Monumentet*, 2017, 56, fq. 11-18.

THOMO, Pirro., ÇOMA, A., "Kisha e lindjes së Shën Marisë në Labovë të Kryqit – Gjirokastër. Punimet e restaurimit, *Monumentet*, 2018, 57, fq. 19-48.

DO NOT COPY

Prof. Dr. Aleksandër MEKSI
Prof. Dr. Pirro THOMO
Ing. Rest. Zaim LILA
Ing. Rest. Alfred ÇOMA

DO NOT COPY

NDËRHYRJET KONSOLIDUESE DHE RESTAURUESE NË KISHËN E MANASTIRIT TË SHËN KOLLIT, MESOPOTAM[1]

Një vështrim i përmbledhur historiko-arkitektonik i monumentit.

Manastiri i Shën Kollit ngrihet jashtë fshatit Mesopotam, pranë Sarandës, mbi një kodër të ulët, ndërmjet dy lumenjve. Manastiri i përket tipit të manastireve të fortifikuar. Ka formë drejtkëndëshi me përmasa 80x120, muret e të cilit ngrihen rreth 1-3 m nga toka, ndërsa në anën perëndimore ruhet një mur i lartë, pjesë e një kulle, që ka shërbyer edhe si kambanore (Fig. 1).



Fig. 1. Pamje e përgjithshme e Manastirit


Kisha e Manastirit ngrihej në qendër të kompleksit të manastirit. Ajo ka një zgjidhje planimetrike dhe vëllimore unikale. Në plan ka formë katrore me përmasa 20.2 x 11.5 m dhe përbëhet nga naosi, ambienti i altarit dhe narteksi, të cilat ndahen nga njëra-tjetra me anë të dy arkadave (Fig. 2). Naosi përmban në qendër një pilastër masiv, të lidhur me muret perimetrale me harqe, që krijojnë katër



Fig. 2. Planimetria e Kishës

bërthama të mbuluara me kupola. Në anën lindore del apsida katërfaqëshe, nga jashtë. Por, gërmimet arkeologjike të kryera nga viti 1966 deri në vitin

1 Ndërhyrjet u kryen sipas projektit të hartuar nga Ark. Rest. Gentian Stratobërdha, Ark. Odhise Zoto, Ing. Zaim Lila i IMK dhe konsulent Prof. Dr. Aleksandër Meksi. Punimet u realizuan nga firma "AD-STAR" gjatë vitit 2019



DO NOT COPY

Fig. 3.1, 3.2. Rikonstruksioni hipotetik i fazës së parë të monumentit

1973 zbuluan se në fazën fillestare Kisha ishte me dy apsida[2] (Fig. 3.1, 3.2). Gërmimet zbuluan gjithashtu ekzistencën e një portiku, që e rrethonte kishën në tri anë. Gjurmët e pilastrave dhe të mbulesës me qemer cilindrik ruhen ende në gjendjen e sotme të monumentit. Në dyshemenë e pjesës veriore të portikut u zbuluan dy panele mozaiku[3] me përmasa 94.5x100 cm dhe 95x100 cm (të cilat ndodhen sot në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë) (Fig. 4.1, 4.2).

Kompozimi planimetrik i brendshëm është pasqyruar dhe në kompozimin vëllimor të jashtëm. Vëllimi i naosit kurorëzohet nga katër kupola të ngritura mbi tambure, nga të cilat, çifti lindor i kupolave është më i lartë nga ai perëndimori. Blloku qendror i lartë i naosit zbret në anën lindore dhe perëndimore të ambientit të altarit dhe të narthekstit, të mbuluara me nga tri çati dyujëse secila (Fig. 5). Monumenti dallohet edhe nga trajtimi i pasur dekorativ i pamjeve të jashtme. Pjesa e poshtme është ndërtuar me blloqe gurësh të latuar, disa prej të cilëve përmbajnë reliefë të gdhendur me motive të shumëllojshme (Fig. 6.1, 6.2). Përdorim të gjerë kanë tullat, qoftë si material ndërtimor, duke na dhënë shpesh muratura të tipit *kluasonazhë*, qoftë për të krijuar dekoracione të shumëllojshme, si korniza në formë dhëmbësharre dhe friza me motive në formë kurrizpeshku, zigzage etj. Fasadat gjallërohen nga dritare të mëdha trilobëshe, të ndara me kolonçina guri dhe të kornizuara me harqe tullash, ndërsa timpanet janë zbukuruar gjithashtu me motive tullash (Fig. 7).

Është e kuptueshme që me këtë kompozim planimetrik e vëllimor të veçantë, si dhe me këtë trajtim të pasur arkitektonik e dekorativ, monumenti të tërheqë vëmendjen e studiuesve të ndryshëm, të cilët kanë dhënë dhe datime të ndryshme[4].

Fazat historike të ndërtimit.

Këtu nuk do të bëjmë një analizë të hollësishme



Fig. 4.1, 4.2. Mozaikët e zbuluar në galerinë e Kishës

DO NOT COPY

2 Meksi, A., "Arkitektura e Kishës së Mesopotamit", *Monumentet* 3,1972, 47-75, fig. 1-32, tab. I-XI; "Të dhëna të reja për Kishën e Mesopotamit", *Monumentet* 10,1975, 151-154, fig.1-2, Tab.I-III; *Shën Kolli Mesopotam, Sarandë*, Tiranë, 2017, fq 63-113

3 Meksi, A., Shën Kolli…, fq. 141-143

4 Meksi, A., *Shën Kolli…*, fq. 41-47



Fig. 5. Pamja jugore e Kishës

të fazave ndërtimore të monumentit, por do të interesohemi për ndërhyrjet, rindërtimet dhe përforcimet të bëra në kohë, si pasojë e dëmtimeve, e deri të shkatërrimeve të pjesëve të ndryshme të ndërtesës.

Studimet e hollësishme të monumentit kanë konstatuar dy ndërhyrjet e konsiderueshme në ndërtesë; një në vitin 1793 dhe ndërhyrja e dytë në vitin 1845[5] (Fig. 8.1, 8.2, 8.3, 8.4). Ndërhyrja e vitit 1793, u bë për arsye se i gjithë muri lindor dhe një pjesë e murit verior, si dhe një pjesë e kupolave lindore ishin shkatërruar. Ndërhyrja konsistonte në rindërtimin e mureve dhe kupolave të rrëzuara, si dhe u morën masa përforcimi për sigurimin e qëndrueshmërisë. Kështu, u zgjeruan seksionet e pilastrit qendror dhe të pilastrave në muret veriore e jugore, si dhe u ndërtuan një kontrafort në murin jugor dhe një kolonë në mesin e arkadës së narteksit. Duket qartë se si i





Fig. 6.1, 6.2. Reliefë në pjesën e poshtme të muraturës

gjithë ky sistem përforcimi kishte si qëllim kryesor


5 Meksi, A., *Vep. Cit.*, fq. 125, 126

DO NOT COPY




Fig. 7. Fragment nga dekoracioni keramoplastik i Kishës

anulimin e shtytjeve horizontale të harqeve, që lidhnin pilastrin qendror me muret perimetrale. Ndërhyrja e vitit 1845 u krye si pasojë e rrëzimit të një pjese të murit verior dhe një pjese të sistemit të kurbëzuar, kupolës verilindore dhe harqeve mbajtëse të saj. Ndërhyrja konsistoi në rindërtimin




e pjesëve të rrëzuara.



Gjendja e monumentit para ndërhyrjes konsoliduese dhe restauruese të vitit 2018.

Gjatë viteve 2007 e në vazhdim janë kryer punime restaurimi në Kishë, të ndara në dy faza. Pa hyrë në analizën e punimeve të realizuara, dokumentacioni i të cilave gjendet në arkivin e



Gjendja para 1793



Gjendja në 1793

DO NOT COPY




Fig. 81-8.4. Fazat e rindërtimeve në ndërtesë

Institutit të Monumenteve të Kulturës, do të vëmë në dukje ato ndërhyrje prishjeje dhe përforcuese, për të pasur mundësinë e vendosjes së një radhe pune për plotësimin e ndërhyrjeve për rivendosjen e qëndrueshmërisë së objektit dhe rritjen e aftësisë mbajtëse të tij, të dëmtuar gjatë kalimit të viteve.

Ndër punimet e prishjes, më kryesoret ishin prishja e kontrafortit në murin jugor dhe e pilastrit ndërmjet arkadës ndarëse të naosit me narteksin (Fig. 9).

Janë pikërisht këto ndër elementet e sistemit përforcues të ndërmarrë në vitin 1793, të vendosura në akset gjatësore e tërthore që kryqëzohen në qendrën e pilastrit qendror, për të shmangur dëmtimet që mund të shkaktoheshin nga shtytjet horizontale të sistemit të kurbëzuar, harqeve dhe



kupolave në këto drejtime. Për të zëvendësuar punën

Fig. 9. Prishja e pilastrit në murin jugor

që këto elemente kishin bërë deri në ditët tona, u tentua të ndërmerreshin dhe disa masa përforcuese. Ndër to, ndërhyrja më e plotë është vendosja në kuotën 4.80 e një unaze prej dy shufrash hekuri që shtrëngon perimetralisht të gjithë ndërtesën. Për sa i përket shiritave shtrënguese të vendosura përreth katër tambureve të kupolave dhe rreth tambureve të kupolave lindore, për vetë materialin e përdorur prej rrobe, ndonëse të përforcuar, ato nuk mund të luanin asnjë rol (Fig. 10.1, 10.2).

E papërfunduar kishte mbetur vendosja e një brezi prej profilesh metalike në vend të brezave të kalbur të drurit në muraturë, në kuotën 2.80 (Fig. 11). Përveç tirandit metalik me profil U UPN 80 në arkadën naos-narteks (Fig. 12), kishin mbetur pa u vendosur tirandat metalike të sistemeve të tjera të kurbëzuara, të cilat do të zëvendësonin funksionin e elementeve të vitit 1793, që u prishën.

Ndërhyrjet konsoliduese.

Në themel të projektit të restaurimit, sigurisht me përditësimet e nevojshme dhe përdorimin e materialeve të reja, u vu ideja restauruese e paraqitur si në disertacionin në kërkim të gradës shkencore Kandidat i Shkencave[6], ashtu dhe në monografinë për këtë monument[7]. Atë ide e patëm diskutuar dhe në vitin 2006 në "Forumin e hapur për Mesopotamin e Rusanj" në Sarandë e Mesopotam.

6 Meksi, A., *Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Shën Kollit Mesopotam-Sarandë*, Disertacion, Tiranë 1977

7 Meksi, A., *Shën Kolli Mesopotam*,179-188

DO NOT COPY





Fig. 10.1, 10.2. Shirita prej bezeje të përforcuar rreth tambureve

Si rezultat i prishjeve dhe rikonstruksioneve ndër vite, mungesës së pakujdesjeve dhe mirëmbajtjeve të vazhdueshme dhe, së fundi prishja e përforcimeve të vitit 1793, pa ndërmarrë masa të plota që do të zëvendësonin funksionin konstruktiv të tyre, e kishin shpënë monumentin në një gjendje kritike. Çarje të shumta në të gjitha strukturat statike, mure, harqe, kupola, dalja jashtë funksionit të elementeve



Fig. 11. Ndërprerja e profilit metalik që zëvendëson brezat e drurit

konstruktive etj. do ta çonin monumentin në një degradim të plotë. Në të tilla rrethana, në radhën e ndërhyrjeve dhe restaurimeve, primare ishin ato të karakterit konsolidues (Fig. 13.1-13.6).



Fig. 12. Tiranda profil U në arkadën naos-narteks

Punime puntelimi. Vrojtimet e kujdesshme të objektit, të mundësuara tashmë nga pastrimi i brendësisë dhe ngritja e skelerisë, e bënë më të qartë gjendjen reale të konstruksionit mbajtës të monumentit. Në sistemin e kurbëzuar të mbulesës me kupola u konstatuan çarje të shumta, si të karakterit kapilar, ashtu dhe të një madhësie të konsiderueshme (Fig. 13.7, 13.8, 13.9). Fotografimi me dron dhe inspektimi në vend i çatisë konstatuan degradimin e mbulesës me tjegulla. Kjo gjendje presupozonte kryerjen e ndërhyrjeve më sistemin e mbulesës. Për të shmangur dëmtimet e mëtejshme gjatë kryerjes së punimeve, u punteluan strukturat konstruktive, e në mënyrë të veçantë, sistemi i mbulesës së kurbëzuar (Fig. 14).

Rindërtimi i elementeve të prishur. Rindërtimi i kontrafortit në anën jugore dhe i pilastrit në brendësi ishte një kërkesë e projektit, i cili do të rikthente ekuilibrin statik të konstruksionit, të lëkundur nga prishja e tyre, pa u shoqëruar me masa të plota konsoliduese. Nga ana tjetër, rindërtimi i këtyre elementeve do të rikthente kujtesën historike,

DO NOT COPY


e cila dëshmon për një masë të rëndësishme dhe mbase të vetme të mundshme përforcimi të objektit tepër të dëmtuar. Dhe kjo masë rezultoi tepër e suksesshme, për deri sa e ruajti monumentin që nga viti 1793 e deri në ditët tona. Gjatë prishjes së kontrafortit ishin zbuluar elemente që dëshmonin për formulimin fillestar të fasadës jugore, si dhe një fragment afresku, të cilat, duke i konsideruar si dëshmi të rëndësishme historike, u lanë në dukje (Fig. 15.1, 15.2).

Plotësime murature u bënë gjithashtu edhe në pilastrin e arkadës naos-narteks dhe në pilastrin qendror (Fig. 16.1, 16.2).

Ndërhyrjet lokale. Me ndërhyrje lokale do të kuptojmë fugatimet, qepjet e të çarave dhe injektimet.









DO NOT COPY






Fig. 13.1-13.6. Çarje në strukturat konstruktive




Fig. 13.7-13.9. Çarje në kupolat





Në gjendjen aktuale ndërtesa paraqiste zona të shumta ku llaçi ishte dekompozuar, duke shkaktuar dhe rënien e fragmenteve të dekoracionit qeramoplastik. Njëkohësisht konstatoheshin dhe një numër i konsiderueshëm çarjesh, që shkonin nga ato të karakterit kapilar e deri në çarjet me madhësi të konsiderueshme. Janë pikërisht këto ndërhyrje

DO NOT COPY



Fig. 14. Puntelimi i kupolave

të para që do ristrukturonin elementet konstruktive dhe do t'u rikthenin atyre funksionimin statik.

Fugatimi sipas rastit, i thellë apo sipërfaqësor, me llaç të freskët dhe me përbërje dhe granulometri të përafërt me atë ekzistues dhe i aplikuar paksa më i thelluar se sipërfaqja e jashtme e gurëve dhe tullave, ka sjellë një qëndrueshmëri të muraturës dhe ka shmangur rënien e mëtejshme të tullave të dekoracionit. Fugatimi ka mbyllur njëkohësisht dhe çarjet e karakterit kapilar. Për sa i përket çarjeve të madhësive të konsiderueshme, ato u eliminuan me rindërtimet e pjesshme të dy anëve të dëmtuara të muraturës, ose siç njihet, me metodën shqep-qep.

Fugatimet dhe qepjet do të konsolidonin kryesisht pjesën sipërfaqësore të muraturës, pa mundur të depërtojnë në thellësinë e saj. Për ta bërë sa më të plotë konsolidimin e muraturës u krye procesi i injektimit. Përgatitja e lëndës së injektimit mori





Fig. 15.1, 15.2. Rindërtimi i kontrafortit në murin jugor, duke lënë në dukje elementet e zbuluara

DO NOT COPY

parasysh rezistencën dhe përbërjen e llaçit të muraturës, në mënyrë që materiali i vjetër dhe ai i ri të ishin kompatibël, d.m.th. të bashkëpunonin dhe



Fig. 16.1, 16.2. Rindërtime në pilastrin e arkadës naos-narteks dhe në pilastrin qendror

të lidheshin ndërmjet tyre. Receta e përshtatshme do të eliminonte krijimin e bërthamave rigjide të palidhura me llaçin ekzistues, gjë që do të krijonte efekte negative për qëndrueshmërinë e muraturës. Injektimi u krye me pompa injektimi, me presion të kontrolluar, duke zgjedhur presion deri në 1 atm., duke pasur parasysh tipin dhe gjendjen e muraturës. Lënda e injektimit depërtonte në thellësi të muraturës nëpërmjet tubave të llastikut, të futura në muraturë, që krijonin një rrjet kuadratik 50x50 cm (Fig. 17).



Fig. 17. Proces nga injektimi i muraturave

Vendosja e tirandave dhe brezave metalike. Mungesa e tirandave për thithjen e shtytjeve horizontale të sistemeve të kurbëzuar, si dhe dalja jashtë funksionit të brezave prej druri të muraturës, ishin disa nga shkaqet e dëmtimeve dhe shkatërrimeve gjatë shekujve të mëparshëm. Rivendosja e elementeve konstruktive tradicionale ishte e pamundur, prandaj u kalua në zëvendësimin e tyre me elemente metalike.

Zëvendësimi i brezave të kalbur të muraturës me profile metalike U UPN 80 filloi të përdorej që në ndërhyrjet e vitit 2009, në kuotën 2.80. Por kjo përpjekje nuk arriti të realizohej tërësisht në gjithë perimetrin e muraturës (shih Fig. 11). Duke e vlerësuar këtë masë si tepër efikase, brezi metalik

DO NOT COPY




Fig. 18. Sistemi i brezave në muraturë dhe i tirandave në kuotën 2.80




Fig. 19.1

DO NOT COPY




Fig. 19.1-19.3. Sistemi i brezave në muraturë dhe i tirandave në kuotën 4.80



Fig. 19.4-19.7. Përgatitja dhe vendosja e profileve metalike në kuotën 4.80







DO NOT COPY

u plotësua edhe në pjesët e mangëta, duke kaluar gjatë gjithë perimetrit të ndërtesës. Plotësimi i brezit në këtë kuotë u bë me profile dopio T IPE 160. Madje ky brez u lidh dhe me tirandat gjatësore të së njëjtës kuotë në brendësi të ndërtesës, me tirandën U UPN 80 të arkadës që ndan naosin me narteksin dhe me tirandën φ 22 të harkadës naos-ambient të altarit, duke krijuar në këtë mënyrë një sistem të mbyllur, jo vetëm perimetral, por dhe në planin horizontal (Fig. 18).

Një brez i dytë metalik, që zëvendëson brezat e kalbura të drurit u vendos në kuotën 4.80. Ky brez u realizua me profile metalike dopio T IPE 160. Me të njëjtën logjikë si për brezin e poshtëm, edhe ky brez u lidh me tirandat e brendshme, që thithnin shtytjet horizontale të sistemit të kurbëzuar. Është ky një koncept tradicional i sistemit konstruktiv të kishave, ku brezat e drurit të muraturës dhe tirandat e harqeve dhe qemerëve ishin të lidhura me njëra-tjetrën, duke krijuar një rrjet horizontal që punonte si një i tërë (Fig. 19.1- 19.7).

Në rastin tonë, tirandat munguese të elementeve të kurbëzuara prej druri (Fig. 20) u zëvendësuan me tiranda metalike inoksidabël φ 22. Mbas vendosjes, ato u tensionuan me anë të muftave në masën e gjysmës së kufirit të rrjedhshmërisë, për të përballuar luhatjet nga deformimet e shkaktuara nga ndryshimet e temperaturës.



Fig. 20. Dalja jashtë funksionit të tirandit të ark-adës naos-ambienti i altarit

Ndërhyrjet në sistemin e mbulesës. Në studimet apo raportet e punimeve të mëparshme nuk gjetëm ndonjë të dhënë mbi sistemin e mbulesës. Duke përfituar nga një pjesë skele e mbetur në objekt, u bë e mundur marrja e disa kampioneve për llojet e tjegullave të mbulesës. Ndër to, me interes të veçantë ishte konstatimi i tjegullave të fazës fillestare të ndërtesës. Kjo e dhënë mbase ishte e pamjaftueshme për të hedhur propozimin për rikonstruksionin e mbulesës, por shërbeu si një indicie për të ndërmarrë fotografimin me dron të objektit. Fotot e marra, si dhe fillimi i punimeve për konsolidimin e strukturës, verifikuan supozimin se pjesa origjinale perëndimore e monumentit kishte ruajtur të paprekur dhe mbulesën me tjegulla të saj, ndërsa pjesa lindore e rindërtuar nga ndërhyrjet e mëvonshme ishte e mbuluar me tjegulla gjithfarësh (Fig. 21.1-21.4).

Gjendja jo e mirë statike e kupolave, ku konstatohen një sërë çarjesh në pjesën e brendshme, e bënte të nevojshme konsolidimin e tyre. Zhveshja nga mbulesa e tjegullave dhe pastrimi i mbushjeve nën to na zbuloi një gjendje akoma më problematike të konstruksionit të kupolave, nga ajo e konstatuar në brendësi. U konstatua gjithashtu se llaçi për fiksimin e tjegullave ishte krejtësisht i degraduar (Fig. 22.1-22.4). Me gjithë shumëllojshmërinë e tjegullave të përdorura, ato u hoqën dhe u magazinuan me kujdes, në mënyrë të veçantë tjegullat e fazës fillestare, për të pasur mundësinë e ripërdorimit të atyre që ishin ende në gjendje të shëndoshë (Fig. 23).

Konsolidimi primar i konstruksionit të kupolave u krye me fugatime të thella dhe me qepje sipas mënyrës shqep-qep. Faza përfundimtare e konsolidimit u realizua me fibra karboni, të vendosura sipas meridianëve dhe paraleleve. Vetitë tekniko-mekanike të fibrave janë: Moduli i elasticitetit rreth 170.000 Mpa; Rezistenca në tërheqje rreth 700 Mpa; Gjerësia e fibrës 100 mm dhe trashësia 5 mm.

Meqenëse tensioni që do të ushtronin fibrat e

BOTIMOR



Gjetja e tjegullave origjinale dhe vendet e gjetjeve





Fig. 21.1-21.4. Konstatimi i ekzistencës së tjegullave origjinale para dhe gjatë punimeve

karbonit në konstruksionin e kupolës ishte tepër i lartë dhe materiali i ndërtimit të saj mund të konsiderohek i brishtë, pra mund të pësonte dëmtime, sipas rekomandimeve, fibrat e karbonit u aplikuan mbi breza llaçi special dhe me rezistencë të lartë. Në këtë mënyrë, efekti tërheqës i fibrave do të transmetohej në konstruksionin e kupolës nëpërmjet këtyre brezave të llaçit. Gjithashtu, moduli i lartë i elasticitetit të fibrave garantoi rigjiditetin e nevojshëm që ato mund të ofronin. Për fiksim të fibrave të karbonit u përdorën rezina polimere epokside, të tregtuara së bashku me fibrat nga firma të certifikuara (Fig. 24.1-24.3).

Mbi sipërfaqen e kupolave u shtrua një shtresë llaçi horasan 12 cm, e cila do të siguronte hidro dhe

DO NOT COPY









Fig. 22.1-22.4. Gjendja e konstruksionit të mbulesës së kurbëzuar mbas heqjes së tjegullave

termoizolimin dhe, çfarë është më kryesorja, do të lejonte respirimin e konstruksionit të brendshëm. Është kjo një metodë ndërtimi tepër e zakonshme e aplikuar më monumentet bizantine, por e përdorur edhe në monumentet tona, siç ishte rasti i paraqitur gjatë restaurimit të kishës së Shën Marisë në Kosinë të Përmetit[8] (Fig. 25.1, 25.2).



Fig. 23. Magazinimi i tjegullave të hequra.

Mbi shtresën e horasanit u vendosën tjegullat. Tjegullat e përdorura ishin dy llojesh. Në pjesët ku ishte ruajtur mbulesa me tjegulla origjinale u vendosën tjegulla të prodhuara në mënyrë artizanale me të njëjtat forma dhe përmasa si ato origjinalet, ndërsa në pjesët e rindërtuara u vendosën tjegulla, gjithashtu të tipit bizantin, por me forma dhe përmasa të ndryshme me ato origjinalet, për të dalluar ndryshimin ndërmjet fazave të ndryshme

8 Meksi, A., "Restaurimi i kishës së Kosinës në Përmet", *Restaurimi 1985*, Tiranë, 1986, 2, fq. 11-14

DO NOT COPY

ndërtimore (Fig. 26)

Ndonëse me masat e ndërmarra për konsolidimin e strukturës së sipërme të monumentit, qoftë me anë të fugatimeve, qepjeve apo injektimeve, po ashtu edhe duke siguruar rigjiditetin dhe eliminimin e shtytjeve horizontale të kupolave me anë të fibrave të karbonit, duke u nisur nga çarjet në tamburet e kupolave, të cilat nuk shkonin gjatë gjithë trashësisë së muraturës, por vetëm në faqen e jashtme, u mendua që në krye të tamburit juglindor, i cili paraqitej më problematik për sa i përket çarjeve, të vendoseshin unaza metalike, të cilat u realizuan prej lamash çeliku inoksidabël 30x2 mm (Fig. 27).

Ripërtëritja e dekoracionit. Siç është vënë në dukje në studimet mbi monumentin, tipar dallues i tij është dhe dekoracioni shumë i pasur keramoplastik. Motive të shumëllojshme dekorative, të realizuara me tulla, qarkojnë dritaret dhe timpanet e tyre, korniza në formë dhëmbësharre mbyllin muraturat poshtë strehëve të çative, motive në formë gërsheti, zigzagu, kurrizpeshku, breza murature të ndërtuara me teknikën e kluasonazhit, pa përmendur zonën e poshtme të ndërtesës veshur me blloqe gurësh, të gdhendur dhe të zbukuruar aty-këtu me reliefë të ndryshëm. Por, me kalimin e viteve, ky dekoracion është dëmtuar nga dekompozimi i llaçit dhe vende-vende nga rënia apo dhe thyerja e tullave, gjë që i ka dobësuar vlerat estetike të monumentit, por edhe ato







DO NOT COPY

Fig. 24.1-24.3. Konsolidimi i strukturës së mbulesës dhe përforcimi me fibra karboni

funksionale të tyre, sidomos nga dëmtimet e kornizave nën çati (Fig. 28.1-28.3).

Për të shmangur dëmtimet e mëtejshme dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e kornizave u mendua për pastrimin dhe zëvendësimin e llaçit të dekompozuar dhe plotësimin e tullave të munguara ose të thyera. Karakteri linear dhe përsëritja uniforme e motiveve na lejon plotësimin, pa krijuar rrezikun e tjetërsimit apo falsifikimit të tyre. Në këtë mënyrë, monumenti do të rifitojë në sytë e vizitorit tërë potencialin artistik që ai posedon (Fig. 29.1-29.3).

Riformulimi i dritareve. Numri i madh dhe përmasat e konsiderueshme të tyre janë elemente të rëndësishme të pasurisë së formulimit arkitektonik të jashtëm dhe të brendshëm. Përgjithësisht dritaret janë trilobëshe, të ndara me kolonçina guri, secila





Fig. 25.1, 25.2. Mbrojtja e strukturës së kupolave me një shtresë llaçi horasan

me mbulesë harku me tulla dhe të tria së bashku përfshihen nga një hark i madh i ndërtuar gjithashtu me tulla, ndërsa gjithë fusha e plotë nën këtë hark është dekoruar pasurisht. Ndërkohë, dritaret ishin murosur pjesërisht ose tërësisht, hapja e të cilave nuk kishte problem (Fig. 30.1-30.3).

Numri i madh i kolonçinave ndarëse bënte të mundur riprodhimin e tyre. Kolonçinat dhe kapitelet e tyre ishin të thjeshta, ndonëse në ndonjë rast, siç dëshmon një e tillë në një pjesë dritareje origjinale e mbetur në murin verior, ishte tepër e dekoruar (Fig. 31.1-31.3).

Zbulimi nga A. Meksi i një dritareje në pamjen jugore[9] na dha një model që mund përdorej për riformulimin e diafragmave të dritareve, pa kërkuar modele të tjera nga kishat e ndryshme të njëkohshme për analogji (Fig. 32.1, 32.2). Dhe meqenëse përgjithësisht në kishat bizantine, në shumicën e rasteve përdoret i njëjti model diafragme në gjithë ndërtesën, nuk e ndryshuam modelin sipas vendit të dritareve, në tambur apo në pamjet e ndryshme. Përjashtim bënë dritaret e tambureve lindore, që i përkasin fazës mbas rikonstruksionit të ndërtesës, ku u vendosën dritare të thjeshta me kasë druri.

Diafragmat e dritareve u prodhuan me beton të lehtësuar me peshë 300-500 kg/m^3, të realizuar me një përzierje çimentoje të bardhë me copa polisteroli dhe të armuar me shufra çeliku inoksidabël φ8. Në vrima u vendosën xhama, ndërsa në vrimat e sipërme rrjeta teli për të siguruar ajrosjen e brendësisë (Fig. 33.1-33.4).

Riformulimi i portës perëndimore. Hyrja aktuale e kishës bëhet në anën veriore nëpërmjet një porte të vogël të modifikuar mbas hapjes së ndonjë nikeje. Gjurmë të qarta në murin perëndimor dëshmojnë për ekzistencën e hyrjes kryesore të kishës, e cila ishte e murosur. Heqja e mbushjeve zbuloi në pragun e portës gjurmët e fiksimit dhe mekanizmit të hapjes të portës. Në pamundësi të riformulimit të portës sipas modelit origjinal, nga mungesa e elementeve përbërëse të saj, u prodhua

9 Meksi, A., *Shën Kolli…vep. Cit.* fq. 77-78

DO NOT COPY




Fig. 26. Shtrimi i tjegullave



Fig. 27. Përforcimi i tamburit juglindor me unaza metalike

DO NOT COPY



DOWNLOAD

Fig. 28.1-28.3. Gjendja e dekoracionit të monumentit

dhe u vendos një portë e rëndë druri, e zakonshme për kishat, por e zhvendosur pak për të lënë në dukje gjurmët e zbuluara në prag. Për t'i dhënë monumentalitet hyrjes, mbi portë u vendos një lunetë dekorative e prodhuar me të njëjtën teknikë si diafragmat e dritareve (Fig. 34.1-34.4).

Trajtimi i dyshemesë së portikut. Portiku apo galeria, që e qarkonte kishën në tri anë, ishte e shtruar me pllaka guri të mëdha, gjendja e të cilave ishte tepër e dëmtuar. Riplotësimi i dyshemesë me pllaka guri do të ishte një veprim që nuk do të sillte ndonjë përmirësim, si të anës funksionale meqenëse galeria sot nuk kryen ndonjë funksion, por dhe të vlerësimit arkitektoniko-estetik të monumentit. Për këtë arsye, ndërhyrjet u përqendruan në evidentimin më të qartë të bordurës rrethuese të galerisë dhe nivelimit të pllakave të mbetura të dyshemesë, ndërsa pjesa e pashtruar e saj u shtrua me zhavorr të imët, për të krijuar një sfond neutral vlerësimi të pjesëve origjinale. Me pllaka guri u shtruan vetë pjesa e hyrjes perëndimore dhe një bordurë rreth e qark mureve të kishës, për t'i ruajtur ato nga ujërat e reshjeve (Fig. 35).

Ndriçimi i monumentit. Ndriçimi i vendosur plotësonte dy funksione: ndriçimi i brendshëm do të shërbente për nevojat e liturgjisë, ndërsa







DO NOT COPY

Fig. 29.1-29.3. Kornizat dhe frizat dekorative mbas ripërtëritjes

ndriçimi i jashtëm ishte projektuar për soditjen dhe vlerësimin e monumentit (Fig. 36.1, 36.2).



Fig. 30.1-30.3. Gjendja e dritareve para ndërhyrjeve

Përfundime

Ndërhyrjet që parashtruam mund të konsiderohen si të një faze në vazhdim, por duke mos qenë përfundimtare. Brenda kohës dhe buxhetit në dispozicion, një vend parësor në ndërhyrjen e kësaj faze iu dha konsolidimit të monumentit, aftësia



mbajtëse e të cilit ishte dobësuar, si nga plakja në kohë e konstruksionit, ashtu dhe nga ndërhyrjet e papërfunduara të fazave të mëparshme. Në saje të këtyre ndërhyrjeve u arrit rikthimi në parametrat e kërkuar të aftësisë mbajtëse të konstruksionit, si me ndërhyrjet lokale, si fugatimet, qepjet apo injektimet, ashtu dhe duke e ndihmuar skemën konstruktive me elemente të reja, si shufrat, profilet

ZOTI COPY



Vendet e gjetjeve të kolonave

Fig. 31.1, 31.2. Kolonçinat e dritareve dhe vendet ku u gjetën





Fig. 31.3, 31.4. Dritare në murin verior dhe kolona e murosur në të

DO NOT COPY







Fig. 32.1, 32.2. Dritare e zbuluar nga Meksi në murin jugor


metalike, fibrat e karbonit etj., të cilat zëvendësuan elementet munguese apo të dala jashtë funksionit të konstruksionit, si brezat e drurit, tirandat, mbulesa etj.

Për sa i përket ndërhyrjeve të karakterit morfologjik, ato u përqendruan në pjesën e sipërme, aty ku kërkimet e kryera dhe elementet e dala gjatë punimeve të restaurimit kishin evidentuar format origjinale të detajeve arkitektonike e dekorative, si riformulimi i dritareve, ripërtëritja e dekoracionit, rimbulimi i çatisë etj.

Me këto ndërhyrje tentuam t'i rikthenim monumentit qëndrueshmërinë statike dhe vlerat e vërteta arkitektonike e dekorative. Jemi të bindur se ka vend akoma për ndërhyrje të mëtejshme, për të plotësuar përfundimisht monumentin me elemente ende të paprekur e të pazbuluar të tij.

Mbeten për t'u kryer sondazhet, për të sqaruar formulimin arkitektonik e dekorativ të pjesës së poshtme të monumentit. Në brezin e poshtëm të muraturës, mbetet për t'u restauruar "hyrja" e dikurshme për në Kishë në anën veriore, e sajuar duke hapur atë, që në formulimin origjinal të ndërtesës ishte nike. E tillë, që duhet kthyer në formën fillestare, është dhe ajo në anën jugore të narteksit. Po kështu mbetet për t'u riformuluar dritarja e dikurshme treshe në brezin e sipërm të muraturës së narteksit, mjaft e tjetërsuar gjatë punimeve të vitit 1845. Mendojmë se me rëndësi për të kuptuar formën e dikurshme me dy bema është dhe gërmimi në hapësirën e apsidës së sotme, si dhe pastrimi nga meremetimet i brezave me mozaikë të





DO NOT COPY



Fig. 33.1-33.3. Diafragmat e dritareve

dyshemesë.

Gjurmët e zbuluara për ekzistencën e pikturës murale (Fig. 37.1, 37.2), na çojnë të kërkojmë kryerjen e sondazheve për evidentimin dhe zbulimin e pikturës nën shtresën e bojatisjes, gjë që do ta kompletonte monumentin dhe me këtë komponent të rëndësishëm të kishave bizantine.

Pajisja e monumentit me elementet e liturgjisë, si ikonat, restaurimi i ikonostasit, fronit peshkopal, amvonit, prosqinitarëve, karrigeve etj., do ta bënte monumentin më funksional, duke i kthyer atij funksionin më të natyrshëm, atë fillestar dhe më të përdorshëm nga komuniteti, funksionin e kryerjes së liturgjisë fetare.

Po të shtohen edhe gërmimet për zbulimin e elementeve të ndryshme të Manastirit dhe restaurimin e tyre, do të kishim një pamje të plotë e të denjë të këtij monumenti, që në literaturën shkencore është cilësuar si një monument i rrallë i arkitekturës bizantine në rajon (Fig. 38.1-38.12).

DO NOT COPY







DO NOT COPY




Fig. 34.1-34.5. Porta perëndimore




Fig. 35. Formulimi i galerisë

DO NOT COPY






Fig. 36.1,36.2. Ndriçimi i brendshëm dhe i jashtëm i Kishës





Fig. 37.1, 37.2. Gjurmë të pikturës murale

DO NOT COPY





DO NOT COPY





DO NOT COPY





DO NOT COPY





DO NOT COPY





DO NOT COPY



DO NOT COPY

Fig. 38.1-38.12. Pamje të monumentit para dhe mbas restaurimit

Prof. Dr. Aleksandër Meksi
Prof. Dr. Pirro Thomo
Ing. Rest. Zaim Lila
Ing. Rest. Alfred Çoma

CONSERVATION AND RESTORATION INTERVENTIONS IN THE CATHOLICON OF THE MONASTERY OF ST. NICHOLAS AT MESOPOTAM[1]

DO NOT COPY

The monastery of St. Nicholas is situated on top of a low hill near the village Mesopotam, in the vicinity of Saranda, between two rivers. The monument belongs to the type of fortified monasteries. At the monastery's western side are preserved part of high surrounding walls, probably functioning as a belfry tower.

The catholicon stood at the center of the monastery complex. The whole building represents a unique architectural and volumetric solution.

The catholicon has a square plan and constitutes of a nave, the altar space and the narthex, separated through a double arcade. At the center of the nave stands a massive pilaster, linked with the parietal walls through arches, creating four vaulted nuclei.

The archaeological investigation (from 1966 to 1973) discovered that initially the church had two apses. The excavations also brought to light the ruins of a porch, surrounding threes sides of the catholicon, from which traces of the pilasters and of the barrel vaulted roof are still visible in the present state of the monument. At the northern part of the porch were discovered two panels of mosaic pavement (nowadays housed in the Museum of Medieval Art, Korçë).

The monument distinguishes for the lavish decorative rendering of its exterior surface. The construction involved the using of large ashlar blocks of stone, some of them bearing relief sculpture of diverse motifs.

The bricks constitute the dominant building material, used not only for structural purposes but also for the creation of different ornamental motifs. Consequently, based on the features of its plan and its volumetric composition, the building has constantly drawn the attention of scholarly investigation which has led to the formulation of different opinions regarding to its chronology.

Detailed studies related to the monument have noticed two fundamental interventions in the building, the first in 1793 and the second happened in 1845, dealing with the reconstruction of the ruined parts of the monument.

The state of the monument before the conservation and restoration intervention of 2018

During 2007 and in advance restoration interventions of removal and reinforcement character were implemented in the church. The removal affected mainly the counterfort/buttress in the southern wall and the pilaster of the arcade between the nave and

1 The interventions were conducted following the project compiled by Architect Restorer Gentian Stratobërdha, Architect Odhise Zoto, Engineer Zaim Lila from Institute of Cultural Monuments (consultant Prof. Dr. Aleksandër Meksi). The works were implemented by "AD - STAR" company during 2019.

the narthex. These are some of the reinforcement system dating in 1793. In order to restore the function that these now missing elements formerly played in the structure of the monument, was attempted the undertaking of some reinforcement measures, which were left unfinished.

Consolidation intervention

The monument suffered from a critical state of preservation caused as result of previous interventions and reconstructions, the lack of continuous maintenance and attention and finally the removal of the reinforcing element of 1793, without taking the appropriate or adequate measures to restore their constructive function in the building. Multiple fractures affecting the entire structural system, wall, arches, vaults, the malfunction of constructive elements etc. led to the total degradation of the monument. This situation conditioned the undertaking of consolidation intervention as an emergent measure.

The fixing of stanchion armature was necessary for protecting the object from eventual damages during the intervention works.

The reconstruction of the counterfort/buttress in the southern part of the wall and of the pilaster in the interior, part of the demands of the project, which aimed the restoring of the static equilibrium of the construction, disturbed from their removal without formerly taking the adequate consolidation measures.

Local interventions, a term referring to the grouting process, the stitching/connection and injection of cracks in walls, are some of the initial interventions undertaken for the restructuring the constructive elements and in order to restore their static function.

The lack of tie – beams in order to absorb the thrust, relieving the supports of the horizontal force, and the degradation of wooden bond beams/ spreader beams of the masonry, were some of the causes of the damages and demolitions happened in the previous centuries. The re-establishment of traditional constructive elements was quite impossible, conditioning their replacement with metallic elements. The replacement of decayed wooden bond beams of the masonry with metallic ones was implemented in the quote of 2.80m and 4.80m. These bond beams were connected with the additional tie beams of the same quote in the interior of the building, creating a closed system, not only perimetral but horizontal as well.

The photographic documentation and the beginning of the works for the consolidation of the structure confirmed the assumption that the original western part of the monument preserved intact the roof and the tiles, while the eastern part reconstructed in a later period and largely affected from previous interventions was covered of different kinds of tiles.

The bad state of the domes marked by the presence of multiple cracks in the interior, conditioned the necessity for their consolidation.

The primary interventions of dome construction consisted in the rendering of the grouting process and the stitching of cracks (fissures). The final phase of consolidation involved the implementation of carbon fibers, placed following the meridians and parallels.

Over the surface of the domes was laid a 12cm thick bedding of mortar following the traditional byzantine technique, providing the hydro isolation and thermo isolation of this part and what's more important allows the respiration of the construction. Over the mortar bedding were placed the tiles.

The tiles were of two kinds. The part of the roof preserved in its original state, was covered with tiles with the same shape and dimensions with the original ones produced in an artisanal manner, while in the reconstructed part were equally used byzantine tiles, bur having diverse shapes and dimensions from the originals, in order to make visible the difference between the different building phases.

The renovation of decoration

A distinctive feature of the monument is the lavish

DO NOT COPY

ceramoplastic decoration on the façade. Over the years the decorative rendering was badly damaged, partially because of the decomposition of the mortar and partially due to the fall or break of the bricks, weakening in this way the aesthetic values of the monument, especially the damaging of the cornices under the roof. In order to avoid further damaging and to assure the stability of the cornices was performed the cleaning and the replacement of the decomposed mortar and the process for the completion of the missing or broken part of decoration.

The linear character and the uniform repetition of the decorative motifs allow this process, without rescuing the forgery or alienation. In this way the monument regains its artistic potential in front of the visitors' eyes.

Removal of the infill wall on the windows

The large number and their considerable dimensions represent important elements of the internal and external architectonic formulation. Generally the windows are tripartite, divided with stone columns. The windows were partially or entirely walled up, but their releasing didn't present a problem. The discovering of a window in the southern façade of the wall constitute a model in order to continue with the reformulation of the diaphragms of the windows, without further searching for models from analogous contemporaneous churches.

Removal of infill wall of western doorway

The actual entrance leading into the church is in the northern part and constitute of e modest size doorway modified probably after the opening of a niche. Evident traces on the western wall of the church bear testimonies on the existence of a central door toward this side, which was walled up in a later period. The removal of the infill wall discovered the traces of the old doorstep and door – opening mechanism.

Unable to reformulate the door following the original model, because of the lack of the rest of the components, was produced and fixed a heavy wooden door, common for church buildings, and slightly displaced from the original position in order to make evidence of the old traces found in the doorstep. The monumentalizing of the central doorway was further completed with the placement of a decorative lunette above the door, produced according to the same technique with that of the windows diaphragm.

Conservation of portico floor

The portico or the open gallery extending toward three sides of the church was paved with large badly preserved stone slabs. The interventions aimed a better evidence of the preserved traces of the portico and the leveling of the remaining stone slabs, while in the rest of the pavement was laid with fine gravel, in order to achieve a neutral background for the evaluation of the original remnants.

The lightening of the monument

The applied lightening system had twofold function: the inner lightening will served to the liturgical needs and the outer lightening was projected for the evaluation and view of the monument.

Conclusions

The above interventions constitute a continuance of the formerly interventions carried out on the monument, but not a definitive stage. They were mostly concentrated on the consolidation of constructive structures; the morphological character interventions were performed in the upper part of the building, in those places were the research discovered traces of the original architectonic and decorative elements. These interventions attempted to re-establish the stability of the structure and of architectural and decorative values of the monument.

We are convinced that further interventions are

DO NOT COPY

necessary in order to complete the monument with the rest still undiscovered elements. The carry out of small scale excavations (sondages), in order to clarify the architectonic and decorative formulation of the lower part of the building and the evidence and discovery of mural painting, the equipment of the church with the rest of liturgical element as icons, restoration of iconostasis, of the Episcopal throne, the ambo, the proskenytarion, the seats for the faithful etc. are some of the remaining tasks for the future.

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Prof. Dr. Emin RIZA

STUDIMET E BANESËS POPULLORE SHQIPTARE DHE E ARDHMJA E TYRE

DO NOT COPY

Tash, në moshën e shtyrë mbi tetëdhjetëvjeçare, që prej vitit 1962, pra për 57 vjet, vijueshëm kam ushtruar profesionin e vlerësuesit të banesës populllore shqiptare në hapësirat e Shqipërisë e të Kosovës. Gjuha në përgjithësi, dhe ajo shqipe në veçanti, janë formësuar duke synuar ndërlidhjen e një grupi historik njerëzor, atë të shqiptarëve në shekuj. Ajo si pasqyruese edhe e përparimit mbarëkohor të një kombi vital, kuptueshëm është në rritje të vijueshme, duke u shoqëruar kjo dukuri edhe me formësimin e termave të rinj. Kështu tashmë, termi vlerësim, kur shoqëron atë monument, shpreh bashkësinë e veprimtarive përvijuese të gjurmimit, përzgjedhjes, vënies në mbrojtje, dokumentimit, studimit dhe restaurimit të kësaj pasurie unikale historike – kulturore. Përfillja e njëjtë e veprimtarive ndërtimore të së kaluarës, pra të ndërtimeve mbrojtëse, të kultit, të banesës dhe ndërtimeve shoqërore, e shfaq rastin shqiptar si një rast, në mos të vetëm, thelbësisht të veçantë. Konsiderimi i gjinisë ndërtimore banesë populllore, pjesë organike e trashëgimisë ndërtimore të bashkësisë së gjerë njerëzore komb, është një arritje e vlerave të përfillshme për rritje e treguesve jetësorë të shoqërisë njerëzore. Termi populllore, cilësor thelbësor i kësaj veprimtarie ndërtimore, lidhet me dukurinë e përhapur gjerësisht në të kaluarën, deri rreth fundit të shoqërisë feudale, kur projektet e banesave të shtresave të varfra, të mesme dhe pjesërisht të pasura, nuk hartoheshin prej profesionistëve të fushës së projektimit, por prej kryemjeshtrave të grupeve të ndërtuesve, sipas kërkesave thelbësore të porositësit. Kuptueshëm, arkitektura populllore përfshinte mbarë gjinitë ndërtimore, por ajo në fushën e banesës në Evropë qe njëkohësisht më e qëndrueshme në hapësirën ballkanike, pra edhe atë shqiptare. Në këtë kontekst, albanologu i mirënjohur Prof. E. Çabej thekson se trojet shtetërore shqiptare janë mbarë rrethues prej të njëjtëve troje paralele, të përfshirë në shtete fqinjë. Fillesat e ngritjes së ndërtimeve jetësore, pra banesave, janë të lidhura me fillesat e jetës sedentare të shoqërisë shqiptare që me zanafillën e familjes, një dhe shumë çifteve. Banesa populllore si objekt studimor, madje me specialistë të veçantë në rastin shqiptar, i ka fillesat e saj në Sektorin e Etnografisë. Në Revistën "Etnografia Shqiptare", që nxirrte ky sektor, Studiuesi i Parë i kësaj kategorie ndërtimore Kolegu Koço Zheku botoi artikujt e parë, për banesën fshatare shqiptare.

Ashtu si në mbarë studimet, në fushën e dukurive shoqërore dhe në atyre të fushës albanologjike, pra edhe banesës populllore shqiptare, kriteret metodologjike studimore janë ata thelbësorët. Duke qenë se përgjithësisht trajtimet në këtë fushë janë, së pari objekt i trajtuesve diletantë, metodologjia e trajtimeve përgjithësisht është larg kritereve thelbësorë. Edhe në rastin e trajtesave fillestare të banesës populllore shqiptare, deri rreth viteve 1975, me formimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, mbi bazën e një sektori të mëparshëm, problemi kryesor i klasifikimit, mbeti i patrajtuar thellësisht. Ritheksojmë se edhe me studimet e banesës populllore shqiptare dhe mbarë kësaj

dukurie, vlerësimi i kriterit të kompozimit vëllimor si kriteri bazor për klasifikimin e banesës popullore, dhe më gjerë, në mbarë shfaqet e saj, është dukuria parësore e koncepcionit shkencor për studimin e kësaj dukurie.

Klasifikimet e dukurive të shumta, të lidhura me veprimtarinë njerëzore në rrjedhë të kohës, shfaqin tiparet thelbësore të këtyre fenomeneve, duke ndihmuar ndjeshëm në kuptimin e tipareve thelbësore të këtyre realiteteve. Dukuria banesë popullore, është thellësisht rrëfyese, prandaj e rëndësishme, për të ndjekur në kohë tiparet jetësore të familjes, prandaj si e tillë, klasifikimi i saj shfaqet me rëndësi parësore. Dukuritë jetësore, si ato në përgjithësi, shfaqen me tipare të shumta, ndërmjet të cilave një, apo disa, marrin vlera të rëndësishme shfaqësh të karakteristikave të tyre. Përsërisim se lloji i kompozimit vëllimor, është shfaqësh parësor i thelbit të dukurisë banesa, në shumësinë e pafundme të llojeve të saj. Kuptueshëm, ashtu si për mbarë dukuritë bashkëjetësore dhe natyrore, disa tipare të kategorisë banesë, janë shfaqur në vijimësi të kohës, ndërsa disa të tjera janë shuar. Dukuritë përfaqësuese të banesës popullore, ashtu si edhe të shumësisë së llojeve të ndërtimeve, sipas funksionit, shoqërohen edhe me një mori dukurish dytësore dhe më tej, duke zgjeruar llojet e klasifikimeve me vlera dhe përhapje të ndryshme në hapësirë edhe kohë. Banesat popullore shqiptare, të cilat ende ruhen në shembujt e hershëm, me numër të vogël, ndërsa ata të shekullit XIX, me shembuj krahasimisht të shumtë, kuptueshëm shfaqin dukuritë dokumentare më të vlefshme në rrafshin kompozicional dhe atë të përbërësve dhe tipareve të reja të banesave. Është fjala për teknikat dhe materialet ndërtimore, elemente funksionale dhe ata dekorativë, ndërlidhjen me truallin etj. Studimet mbi rrafshe qendrash të banuara, kryesisht qytetare dhe atyre mbi rrafshe krahinore banesave fshatare, janë themeloret që mundësojnë kalimin e mbështetur në studimet përgjithësuese të kësaj gjinie ndërtimore. Më gjerë në bashkësitë ndërtimore kombëtare në përgjithësi, dhe ato shqiptare në veçanti, dallimet midis gjinive të ndryshme ndërtimore, janë njëherazi të qarta thellësisht. Kështu ndërtimet mbrojtës, kryesisht fortifikime, emërtuar kala, përgjithësisht me kompozimin dhe trajtimin e tyre, kanë përafri të qarta. Kompozimi, gjithë duke ruajtur parametrat mbrojtës, kryesisht me muret rrethues, të cilët i përshtaten formës së truallit, shfaqet me variacione të kuptueshme, duke përjashtuar kalatë e ngritura mbi troje të rrafshët fushorë. Këto të fundit kanë forma drejtkëndore, të madhësive të ndryshme. Ndërtimet e kultit, të çdo besimi, me kohë kanë fituar qëndrueshmërinë e tipareve kompozicionale vëllimore, duke qenë përmasat dhe trajtimi arkitekturor e teknik, dhe veçanërisht ai dekorativ, me dallime, gjithë duke pasur skema të përbashkëta kompozicionale të shumë njësive dekorative.

Tërësia e veprimtarisë komplekse, për vënien në mbrojtje dhe ruajtjen e gjinisë së banesës popullore shqiptare, ashtu si edhe për fushat e tjera, formësohet prej gjurmimit, përzgjedhjes dhe vënies në mbrojtje, dokumentimit, restaurimit dhe studimit. Këto veprimtari të njëjta, për mbarë gjinitë e monumenteve, shfaqen me realizime me tipare thelbësore dhe dytësore në vende të ndryshme. Rasti shqiptar i cili, ashtu si dhe disa vende ballkanike dhe më gjerë, fillesat dhe zhvillimin e përfillshëm të vlerësimit të monumenteve të arkitekturës popullore, dhe mbarë kësaj trashëgimie historiko-kulturore, e pati pas Luftës së Dytë Botërore, shfaq një arritje të vlerave të spikatura në rrafshin profesional. E gjej me rëndësi shoqërimin e Drejtuesit të Qendrës Ndërkombëtare të Studimit dhe restaurimit të Monumenteve z. Xhevat Erder në Shqipëri në vitin 1981, të cilin u urdhërova ta shoqëroj. Ai, pasi u njoh me arritjet në vlerësimin e monumenteve në Shqipëri më tha: “Qendra Ndërkombëtare e Studimit dhe Restaurimit të Monumenteve, duhet të jetë në Tiranë, jo në Romë. Ky vlerësim superior në veprimtarinë për vlerësimin e monumenteve në Shqipëri, prej një

DO NOT COPY

specialisti të rangut të lartë, është dhe do të mbetet i një vlere të veçantë për arritjet shqiptare , në fushën në trajtim.

Kuptueshëm, vënia në mbrojtje e monumenteve ndërtimore, fillon me gjurmimin e mbarë gjinive, duke përfshirë edhe atë të banesës popullore. Pa hyrë në hollësi, do të pohojmë se ashtu si në vendet e zhvilluara evropiane, në vitet e para të gjysmës së dytë të shek. XX, banesat popullore nuk përfilleshin për vlerat e tyre historiko=kulturore, duke pasur në konsideratë vetëm vlerat arkitekturore dhe ndërtimore të veprave të mëdha. Konsiderimi i banesës popullore fshatare dhe qytetare , si dëshmi e së kaluarës, përputhej me zgjerimin e hapësirës jetësore të së kaluarës së njerëzimit. Jetën e një populli, në rrjedhat historike e përbëjnë dhe realitetet e shtresave të mesme dhe të varfra, të cilat janë përbërës thelbësorë të dukurive historike. Sensibilizimi i intelektualëve shqiptarë për sa më sipër, shfaqet që rreth viteve 1950. Përmendim më pas, vënien në mbrojtje të Beratit të vitin 1961, si qytet-muze, duke u shpallur krahas gjinive të tjera dhe 54 banesa –monumente të kategorisë së parë. Veçanërisht pas vitit 1965, me krijimin e Instituti të Monumenteve të Kulturës, vëmendja ndaj bashkësisë së banesës popullore shqiptare në Shqipëri, pati rritje të dukshme. Ky kujdes, së pari përfshin hapësirat qendrore qytetare dhe vijimisht atyre fshatare. Këto të fundit, me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, në vitin 1974, për katër vjetët pasues iu nënshtruan një gjurmimi të hollësishëm, i cili, krahas eksplorimeve të kryera nga Sektorët e Institutit të Historisë e pastaj atij të Kulturës Popullore ka lënë gjurmë të një vlere madhore për identifikimin dhe vënien në mbrojtje të banesave përfaqësuese të arkitekturës sonë popullore, në hapësirë dhe në kohë.

Vënia në mbrojtje e banesës popullore, dhe më gjerë e monumenteve të arkitekturës, kuptueshëm lidhet me praninë e specialistëve të kësaj fushe, të cilët janë bartës të veprimtarive për gjurmimin, përzgjedhjen dhe më tej për mirëmbajtjen, restaurimin dhe studimin e këtyre vlerave autentike historike- kulturore. Shqipëria, duke mos pasur institucione mësimore për përgatitjen profesionale të punonjësve të kësaj fushe, duhej ta zgjidhte këtë mungesë me rrugën e njohur dhe produktive, të krijimit të kuadrit të duhur, në punë dhe nëpërmjet saj. Rasti shqiptar në këtë fushë, është me arritje sa krahasimisht të shpejta, aq dhe thellësisht kualitative. Veprimtaria praktike vlerësuese e monumenteve, duke filluar prej përzgjedhjes së profesionistëve të kualifikuar, në fushën e inxhinierisë ndërtimore, dhe ndarjes së këtyre në gjini të veçanta ndërtimore, duke përfshirë edhe banesën popullore, është meritë e arkitekt Gani Strazimirit. Më tej, edhe ndarjet , brenda fushës studimore të banesës popullore të Shqipërisë mbi baza rajonale, i dhanë një shtysë të dukshme mundësive për ecurinë e krahasimit të shpejtë të këtyre studimeve. Bashkërenditja e kritereve vlerësuese, në rrafshin tipologjik arkitekturor dhe teknik të banesës popullore në Shqipëri dhe më gjerë në Kosovë, duhen vlerësuar si arritje madhore në afrimin relativisht të shpejtë dhe të saktë ndaj të vërtetave, synim i çdo veprimtarie studimore. Kuptueshëm, banesat popullore, të vëna në mbrojtje shtetërore, për vlerat e tyre, vinë përgjithësisht në momentin e vënies në mbrojtje, në gjendje të vështirë teknike, e cila kërkon urdhëruesheëm ndërhyrjet e duhura mirëmbajtëse dhe më gjerë restauruese. Edhe në këtë fushë, tejet të rëndësishme të vlerësimit të banesës popullore dhe monumenteve shqiptare në Shqipëri, rasti shqiptar shfaqet me arritje sa të shpejta aq edhe të arritura metodikisht. Përmbledhtas, ndërhyrjet restauruese, që në fillesat e tyre janë konceptuar si synuese për ruajtjen e dëshmive origjinale të ndërtimeve-monument, dhe aspak në synimet ç'vlerësuese të të ashtuquajturit kthim në identitet të monumentit. apo rindërtimit në shkallë të ndryshme, të cilat s'kanë asnjë lidhje me restaurimin.

Në krahasim me gjinitë e tjera të monumenteve, ruajtja e origjinalitetit vlerëplotë të banesës,

DO NOT COPY

shfaqet me probleme të dukshme, edhe për faktin se banesa, në dallim prej gjinive të tjera të monumenteve, ndërtimore, është e lidhur thellësisht me jetesën familjare kuptueshëm vijueshëm problematike. Në këtë çështje, mirëkuptimi i institucioneve mbrojtëse të monumenteve me pronarët dhe shfrytëzuesit e këtyre banesave, duhet të jetë i ngushtë dhe mbarëkohor, për të parandaluar dhe penguar, sa më parë, ndërhyrjet dëmtuese të vlerave origjinale të pakthyeshme, për arsyet e kuptueshme. Kur trajtohet problemi i gjerë dhe njëherazi i rëndësishëm i restaurimit, mirëmbajtja e vazhdueshme e monumenteve, pra edhe e banesave popullore me shfrytëzueshmëri sa të vijueshme, aq edhe me dukuri të shumta të drejtpërdrejta apo tërthorazi, cenojnë vlerat autentike të banesës=monument. Mirëmbajtja e vazhdueshme, kuptueshëm lidhet me njohjen e vijueshme të gjendjes së monumentit, dhe barazisht me të dhënat prej banorëve të tij. Vijueshmëria e ndërhyrjeve mirëmbajtëse, bart përparësinë thelbësore për cenimin minimal të strukturës së monumentit , duke parandaluar ndërhyrje më të gjera, kuptueshëm më cenuese të autenticitetit të vlerave strukturore të veprës. Më tej, këto ndërhyrje rrisin dhe përkujdesjet e banorëve mbarëbrezash të këtyre veprave, të cilat autenticitetin e kanë cilësorin thelbësor të vlerave të tyre unikale historiko-arkitekturore. Sistemi i mbrojtjeve efikase dhe përvijuese të banesave monument, lidhet dhe me plotësimin e sistemit mbrojtës të tyre, nëpërmjet grupit të gjerë të kujdestarëve të monumenteve, të cilët mbi kriterin e afërsisë të monumenteve të çfarëdo gjinie, caktohen si kujdestarë të tyre. Këta punonjës mbikëqyrin kujdesshëm mbarëkohësisht gjendjen e banesave monument, duke rregulluar vetë dukuri dëmtuese në këto vepra, ose duke njoftuar njësitë e ngarkuara për mbrojtjen e këtyre objekteve. Atelietë e monumenteve, nëpër qendra të ndryshme qytetare të vendit, kanë grupe të vegjël specialistësh që janë ngarkuar me ndërhyrjet mirëmbajtëse, sipas të dhënave prej kujdestarisë së monumenteve.

Është rasti për tu theksuar se restauratori i banesave-monument, është njëherazi studiues i kësaj kategorie ndërtimore, dhe më ngushtë i njësisë së caktuar tipologjike, apo hapësinore. Kjo ndarje, është e domosdoshme, për të garantuar rritjen e njohjes së monumenteve që i nënshtrohen ndërhyrjeve të duhura restauruese. Kuptueshëm, restauratori i një njësie të caktuar tipologjike të monumenteve, është edhe studiues i objekteve formuese, ndërsa studiuesi i gjinive të ndryshme të monumenteve mund të jetë vetëm i tillë.

Veprimtaritë studimore në përgjithësi, dhe ato për banesën popullore, shoqërohen përfundimisht me botimin e tyre, në revista shkencore, dhe me botime te veçanta. Kështu, rruga e gjatë dhe e pafundme e vlerësimit të banesës popullore, bëhet pjesë organike e kujtesës historike- kulturore të një populli dhe më gjerë. Botimet në vazhdimësinë e tyre të pafundme, ndihmojnë në ecurinë e pandalshme të t'iu afruar përherë më gjerë e më thellë të vërtetave, qëllimit madhor të fushës studimore, shtyrëses së prekshme të përparimit njerëzor. Edhe studimet për monumentet shqiptare dhe atyre të banesës popullore, kuptueshëm përfundojnë në botime. Botimi i parë për monumentet i përket vitit 1958, me punimin e S. Adhamit "Monumentet e Kulturës në Shqipëri", kuptueshëm përfaqësues i fillesave të kësaj fshesa komplekse aq edhe problematike në rrafshin profesional. Viti 1971 shënon një ngjarje të rëndësishme kulturore, atë të fillimit të botimit të revistës "Monumentet", organ shkencor i Institutit të Monumenteve të Kulturës. Kjo nismë tejet e rëndësishmen disa drejtime, lidhet me emrin e arkeologut Selim Islami, i cili vlerëson me objektivitet kuadrin, në formim e sipër të Instituti të Monumenteve. Në këtë organ, një vend të rëndësishëm zënë temat që trajtojnë vlerat e banesës popullore në Shqipëri. Ato kanë rëndësi sepse pasqyrojnë procesin e gjatë dhe njëherazi të rëndësishëm të vlerësimit të banesës popullore në hapësirën e Shqipërisë, kur ende për arsyet e njohura,

DOKTORATURA

shumë shembuj ruanin vlera origjinale të plota, apo pjesore. Dokumentimi i tyre i gjerë fotografik, dhe fillesat e atij grafik janë të një rëndësie të veçantë për studimet e kësaj gjinie, kuptueshëm, binjake në jetën njerëzore, pra dëshmi autentike të saj. Revista "Monumentet" pati jehonë pozitive në Shqipëri dhe në institucionet paralele ballkanike dhe evropiane më gjerë. Krahas që rreth viteve 1980, shfaqet botimi i albumeve dhe monografive që kishin për temë arkitekturën popullore në Shqipëri. Së pari përmendim monografinë e studiuesit Pirro Thomo "Arkitektura fshatare e Shqipërisë Veriore", Tiranë 1981, e cila ka vlera të rëndësishme, sepse është e para që trajton në një botim të veçantë, banesën në një hapësirë të gjerë të trojeve shqiptare, mbi kritere të shëndosha metodike. Më tej do të paraqesim veprimtarinë time në këtë fushë, e cila tashmë është 47 vjeçare, e ushtruar vijueshëm, kryesisht në lëmin e banesës qytetare shqiptare. Deri tani kam botuar 17 vepra, në disa prej të cilave bashkautor dhe një numër të konsiderueshëm artikujsh të botuar në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Veprat përfshijnë dhe albume dhe tekstin universitar për arkitekturën tradicionale shqiptare.

Në veprimtarinë shkencore për vlerësimin e banesës popullore shqiptare, një vend të rëndësishëm zënë simpoziumet, sesionet shkencore dhe konferencat, në të cilat tema e banesës popullore shqiptare ka qenë gjerësisht e trajtuar. Edhe organet propaganduese në përgjithësi, pra radio, televizioni, shtypi etj kanë treguar interesim për përhapjen e lajmeve mbi veprimtaritë vlerësuese të banesës sonë popullore. Studiuesit shqiptarë të arkitekturës sonë popullore kanë marrë pjesë aktive në veprimtaritë promovuese të ekspozitave të ndryshme të vlerave të trashëgimisë historiko kulturore.

Në këtë artikull, do të shtroj edhe interpretimin e togfjalëshave, të cilët, në këtë kontekst dhe më gjerë, me gjithë afërsitë deri pranë identitetit, shfaqin dy realitete të ndryshme. Është fjala për togfjalëshin: banesa e shqiptarëve dhe banesa shqiptare. Është e kuptueshme se banesa, ashtu sikurse shumë dukuri të tjera ndërtimore, ka përhapje mbarë hapësinore, duke qenë e njëllojtë me funksionet për të cilat është ndërtuar, pra atë të banimit, por e ndryshme në kompozim vëllimor dhe trajtim tekniko-arkitekturor.

Më tej, e ndikuar në llojin e këtyre treguesve prej shumë kushtesh, popuj të ndryshëm ngrenë dhe banojnë në banesa tradicionale ndërkombëtare, krahas një numri të vogël tipash krijuar prej një kombi të caktuar, prej rrethanave specifike. Në realitetin shqiptar, ashtu si në atë mbarëevropian dhe më gjerë, tipologjia e përbashkët, në njësi të ndryshme kombëtar shoqërohet dhe me tipe të veçantë, të lidhur me një komb, apo me një pjesë të tij, , për arsye të diskutueshme. Kështu, në rastin shqiptar, vetëm llojet e banesës me shtëpi zjarri përgjatë të dy kateve (banesë tiranase) dhe asaj me tipare mbrojtëse (banesa gjirokastrite), janë banesa shqiptare. Edhe këta dy tipe banesash, përfshihen në termin, tejet më përgjithësues, banesa e shqiptarëve. Ky vrojtim i drejtohet studiuesve të fushës dhe të interesuarve për dukuri të veçanta, pa ngarkuar masën e gjerë me çështje specifike të një rëndësie dytësore.

Historia e veprimtarisë vlerësuese të monumenteve shqiptare në përgjithësi ka zhvillimin e saj kohor, që prej fillesave të kësaj veprimtarie dhe deri më sot. Sipas nesh, periodizimi i veprimtarisë vlerësuese të monumenteve të arkitekturës shqiptare, pra dhe banesës popullore, përfshin tre periudha kohore, që shquajnë për llojin dhe tiparet e veprimtarive përnjohëse të monumenteve – banesave popullore. Periudha e parë, kohësisht i përket fillimeve të shek. XX, deri në mbarimin e Luftës së Dytë Botërore në vitin 1945. Periudha e dytë, fillon në vitin 1946 dhe shtrihet deri në themelimin e Institutit Të Monumenteve të Kulturës në vitin 1965. Periudha e tretë fillon në vitin 1965 dhe vijon ende sot.

Periudha e parë është një hapësirë pa veprimtari në fushën e banesës popullore në Shqipëri, ashtu si edhe në mbarë vendet evropiane. Akt i rëndësishëm ligjor i kësaj periudhe është dekret-ligji për

DO NOT COPY

monumentet kombëtarë, i datës 28.05.1929. Ky ligj gjeti zbatim vetëm në fushën e gërmimeve arkeologjike në Shqipëri, lidhur me koncesionet për këtë veprimtari, të kryer në trojet e Shqipërisë, prej misioneve arkeologjike franceze dhe italiane.

Periudha e dytë (1946 – 1965) shënon një rritje të ndjeshme të veprimtarisë juridike dhe konkrete në fushën e monumenteve të Shqipërisë. Përmendim dekretin 568, datë 17.03.1948 "Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe sendeve natyrore të rralla" Po këtë vit shpallet lista e parë e monumenteve në mbrojtje shtetërore në Shqipëri. Në këtë numër përfshiheshin ndërtime mbrojtëse, kulti dhe shoqërore. Gjatë kësaj periudhe u zgjerua sfera e interesimeve për mbarë gjinitë ndërtimore në Shqipëri, duke përfshirë edhe banesat popullore. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 172, DT. 02.06.1961, u vunë në mbrojtje shtetërore qytetet e Gjirokastrës dhe Beratit, nëntoka e Durrësit dhe Pazari i vjetër i Krujës. Ky vendim i hapi hapësirë të gjerë përfshirjes së banesave popullore qytetare shqiptare, për përkujdesjet e duhura vlerësuese të kësaj pasurie unikale. Më tej, me vendimin nr. 170 të së njëjtit institucion dhe datë, miratohet dhe "Rregullorja mbi administrimin e qytetit-muze të Beratit" e cila trajtonte problematikat e zonimit të qytetit-muze, klasifikimin e monumenteve në dy kategori, të I dhe të II, si dhe administrimin dhe restaurimin e këtyre vlerave.

Periudha e tretë e vlerësimit të monumenteve në shqiptare, pra edhe të banesës popullore, fillon me themelimin e Institutit të Monumenteve të Kulturës, sipas vendimit nr. 67, datë 15.03.1965, të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë. Instituti përfshinte ish Sektorin e Mbrojtjes dhe restaurimit të Monumenteve, atelienë qendrore dhe atelietë për konservimin dhe restaurimin e monumenteve në rrethe. Instituti në vitin 1990, cilësohet Institucion kërkimor–shkencor. Sektorët shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës përfshinin edhe atë të arkitekturës popullore, i cili kishte për objekt vlerësimi banesat popullore në qytet dhe në fshat. Siç kemi përmendur, Instituti i Monumenteve ishte, që prej themelimit të tij, në vartësi administrative prej Ministrisë së Kulturës. Është rasti për të theksuar të vërtetën e vijueshme se deri në vitin 1990, Instituti i Monumenteve, si një organ i veçantë për vetë natyrën e tij, mbeti thellësisht i pavarur jo vetëm për veprimtarinë e gjerë profesionale, por dhe në atë të fushave të tjera, si radhën e ndërhyrjeve restauruese në monumente, përzgjedhjen e kuadrit etj. Kjo dukuri pozitive, pas vitit 1990, ka pësuar rënie në rritje, e cila ka cenuar veprimtarinë e veçantë profesionale të këtij institucioni.

Ripërsërisim se për Shqipërinë, madje edhe për vende të tjera ballkanike, përkujdesjet disaplanëshe për vlerësimin e monumenteve, dhe veçanërisht banesës popullore, krahasimisht më të vonat, gjithë duke pasur në bazën e tyre përpjekjet vetjake, janë mbështetur edhe prej përvojës së vendeve të tjera. Në fushën e arkitekturës popullore theksojmë ndihmesën e studiuesit dhe restauratorit çek Kostka, i cili ndihmoi thellësisht për vënien në mbrojtje të qytetit – muze të Beratit. Kriteret për klasifikimin e zonave të banuara të qytetit-muze të Beratit dhe monumenteve të veçantë, sipas vlerave urbanistike dhe arkitekturore, i qëndruan kohës. Ato u përvetësuan prej kuadrit vendas, të formuar në punë dhe nëpërmjet saj, me arritje përherë e në rritje, duke përballuar profesionalisht problematikat bazike të vënies në mbrojtje edhe të banesës popullore në Shqipëri.

Në vitin 1962, Shqipëria u anëtarësua në ICCROM (Qendra Ndërkombëtare e Konservimit dhe Restaurimit të Monumenteve), me seli në Romë. Shpallja e Qendrave Historike të Gjirokastrës dhe Beratit "Pasuri Botërore", duke qenë banesa popullore shqiptare gjinia kryesore e këtyre qyteteve, është një vlerësim i rëndësishëm ndërkombëtar për këto vepra të krijimtarisë shqiptare ndër shekuj. Edhe për gjininë e banesës popullore shqiptare, ashti si për mbarë monumentet, viti 1990, m,e rënien e diktaturës enveriste, apo të bolshevizmit të skajmë, janë krijuar kushtet për thellimin dhe zgjerimin e

DO NOT COPY

veprimtarisë vlerësuese të kësaj fushe. Siç e kemi trajtuar, ajo është me veçanti tejet më problematike se gjinitë e tjera, dhe në përgjithësi monumentet e pashfrytëzuara për funksione jetësore. Është rasti për të pohuar ngultas se këta dy dhjetëvjeçarët e parë, pas vendosjes së rendit real demokratik në Shqipëri, kujdesi për monumentet ka një rënie drastike. Ky realitet. Ky realitet, sa një ndërprerje e pashpjegueshme është faktikisht një shkujdesje që buron dëmtime të pakthyeshme të vlerave origjinale të monumenteve, madje deri në rrënime pjesore, e madje tërësore të tyre.. Ritheksojmë se monumentet, pra bashkësia e tipareve të tyre ndërtimore, shfaqin vlera të papërsëritshme dhe si të tilla ato, qofshin pjesore, apo tërësore, janë vlera historiko-kulturore kombëtare dhe pjesërisht ndërkombëtare, dhe si të tilla duhen ruajtur me çdo kusht.

Vlerësimi i banesës popullore shqiptare, ashtu si edhe i monumenteve në përgjithësi, është një proces i pambarim, si për vlerat ndërtimore pararendëse, ashtu dhe për ato që vijimisht shtohen realiteteve të çdo kombi. Tashmë, kur vlerësimi i monumenteve të kulturës, është i arritur në mbarë domethënien e tyre historiko-kulturore, përkujdesjeve të gjera dhe shpesh problematikave të shpeshta të tyre, i shtohet dhe dukuria e pasurimit të këtij fondi me ndërtimet bashkëkohore. Kështu, si me shumicën e theksuar të fushave vlerësuese të veprimtarive njerëzore në rrjedhë të kohës, edhe fusha e monumenteve pret përvijueshëm rritje të vlerësimit të tyre. Në këtë kontekst, kuptueshëm. shkalla e profesionalizmit për zbatimin përherë dhe më adekuat të parimeve vlerësuese, do të shfaqet me arritje të reja. Krahas, veçanërisht për gjininë e banesës popullore, besojmë se përkujdesja e banorëve të këtyre ndërtimeve, do të vijë në rritje, me thellimin e ndërgjegjësimit për vlerat e tyre të rëndësishme dhe të papërsëritshme. Posaçërisht, në rastin shqiptar, besoj jo të vetmin në këto vite, jemi në mbylljen e veprimtarisë vlerësuese të monumenteve, pra edhe të gjinisë së banesës popullore, prej brezit të parë të studiuesve, me fillesa rreth viteve 1965 me themelimin e Instituti të Monumenteve. Ky brez, siç kemi parashtruar përmbledhtas edhe në këtë artikull, ka pasur përpara një fushë sa të patrajtuar , aq edhe problematike, veçanërisht për gjininë e banesës popullore. Kjo e fundit, në shumë drejtime, lidhej me një realitet ekonomiko – shoqëror, i cili me shpejtësi po ndryshohej, duke ndikuar si në kompozimin e kësaj tipologjie, ashtu edhe në teknikat dhe materialet e ndërtimit. Mjaft të përmendim, kryesisht në qytete, banesat shumëfamiljare, dhe skemat bashkëkohore kompozicionale të banesave njëfamiljare, për të theksuar realitetin e ri, edhe në këtë fushë ndërtimore. Këto dukuri, rrisin dukshëm vlerat historiko – kulturore të banesës popullore shqiptare të së kaluarës, si treguese të prekshme të mënyrës së jetesës së shoqërisë shqiptare, një periudhë të caktuar kohore. Në këto rrethana studimi i banesës popullore shqiptare të së kaluarës, kryesisht të shek. XVIII – XIX, por besojmë tipologjikisht më të hershëm, është tejet i rëndësishëm.. Kjo veprimtari studimore, e cila do tl karakterizohet kryesisht me rishikimin e veprimtarisë së deritanishme, do të përmbledhë mbarë gamën e gjerë të veprimtarisë vlerësuese për banesën popullore, pra gjurmimin, përzgjedhjen, dokumentimin, restaurimin, studimin dhe botimin.

Gjurmimi i banesës popullore shqiptare, sot dhe vijueshëm, është një veprimtari e pandërprerë, kuptueshëm me ritme përherë e në rënie. Ajo përfshin, në radhë të parë, hapësirën ende krahasimisht të gjerë të banesës popullore fshatare. Studimet e vijueshme të kësaj gjinie vënë në pah edhe vlerësimet për elementet arkitekturorë, ata funksionalë dhe teknikat e ndërtimit, të cilët edhe në veçantinë e tyre bashkëpërbërëse të dukurisë banesë popullore, janë pjesë organike e saj. Studimet e këtyre përbërësve, shoqërojnë vijueshëm tipologjinë e banesës sonë tradicionale, duke qenë disa shembuj të këtyre elementëve apo teknikave në hapësira të transformuara rëndë të banesës, në vlerat e tyre origjinale, madje tejet të rralla. Për

DO NOT COPY

këto arsye, këto dukuri duhen vënë në mbrojtje, shoqëruar kuptueshëm me dokumentacionin përkatës. Brezat pasues të studiuesve të banesës popullore shqiptare kanë para tyre studime me vlerë, të cilat iu rrisin atyre kompetencën për vlerësimin e veprave të panjohura, apo pavlerësuara siç e meritojnë, duke u përfshirë në mbarësinë e grupit të madh, e në rritje të banesave monument. Dokumentimi i banesave- monument, grafik, fotografik dhe përshkrimor, shfaqet si një dukuri e një rëndësie madhore, për pasqyrimin e vlerave shumëplanëshe të kësaj kategorie ndërtimore, në kohë të ndryshme. Kuptueshëm, për arsye të vetëvetshme të vetëshkatërrimit të dukurisë, dhe shkaqeve natyrore si erëra, rrëshqitje dheu, përmbytje, tërmete etj., banesat - monument shfaqin ndryshime të shkallëve të ndryshme, të cilat duhen dokumentuar dhe arkivuar në dosjet vetjake të monumenteve, në arkivin përkatës të Institutit të Monumenteve të Kulturës. Arkivi është institucioni më i rëndësishëm vlerësor i organit administrativo-profesional, përkujdesjet e duhura profesionale ndaj monumenteve në përgjithësi, pra dhe atyre të gjinisë së banesës popullore. Arkivi i ruajtjes profesionale të shumësisë në lloje dhe kategori monumentesh, ka rregulloren e vet, e cila synon ruajtjen , mirëmbajtjen kategorizimin dhe ofrimin e saj për studiues dhe të interesuar, gjithë duke mos cenuar këto vlera madhore autentike. Rregullorja zbaton edhe të drejtën e autorit për hartuesit e dokumentacioneve të llojeve të ndryshme.

Banesat popullore-monument, për arsye të mbarë shfrytëzimit të tyre për banim, me përjashtim të disa shembujve të spikatur, të kthyer në muze, janë më të ekspozuarat ndaj dëmtimeve të shkallëve të ndryshme. Dëmet eventuale të këtyre veprave duhet të jenë në vëzhgim të vazhduar dhe të shpeshtë, për të rrokur sa më parë dëmtimet eventuale dhe ndërhyrjet e menjëhershme mirëmbajtëse, thelbi i restaurimit. Në këtë kontekst dhe më gjerë, duhet që sa më parë, të arrihet rivendosja e rrjetit të kujdestarëve të monumenteve, si zgjidhje më racionale për të penguar dëmet e pakthyeshme të vlerave origjinale të banesave popullore-monument. Ritheksojmë se veprimtaria e vijueshme mirëmbajtëse, për dëmtimet krahasimisht të vogla, fillesat e atyre pasuese, përherë e më të mëdha, është thelbi i restaurimit në përgjithësi, pra edhe i banesave popullore-monument.

Ndërhyrjet restauruese në banesat popullore në mbrojtje, për arsyet e njohura zënë numerikisht vendin e parë në bashkësinë llojësore të monumenteve shqiptare në Shqipëri. Këto ndërhyrje garantuese të bllokimit të dëmtimeve të mëtejshme të monumenteve, pra të humbjes së pakthyeshme të vlerave origjinale të banesave të ndryshme me vlera të veçanta, vijimisht do të jenë të pranishme te veprat e mbrojtura. Sa më të shpeshta, pra mbarëvijuese të jenë ato, aq më gjerë ruhen vlerat origjinale të banesave-monument. Besojmë se shoqëria shqiptare me rritje e vijueshme t zhvillimit ekonomik, do të sensibilizohet, përherë dhe në rritje edhe kur vlerat e banesave-monument, duke i larguar shkallë-shkallë këto vepra unikale historiko-kulturore prej shfrytëzimit për banim, i cili bart rreziqe sa të shumta, aq edhe të pakthyeshme në vlerat origjinale. Ashtu si restaurimi, dhe studimi i këtyre veprave, në rrafshin e tyre ndërtimor dhe funksional, mbetet një rrugë e hapur për zgjerimin dhe thellimin e tyre, për t'iu afruar përherë dhe pranë të vërtetave.. Kuptueshëm, studiuesit shoqërohen vijueshëm me botime të llojeve të ndryshme që prej artikujve, kryesisht në revista shkencore etnografike, si edhe monografike dhe albumeve. Brezave pasardhës, do t'ju bjerrë barra edhe për zgjerimin dhe thellimin e trajtimit të temës krahasuese të banesës popullore shqiptare me atë ballkanike dhe më gjerë evropiane.

DO NOT COPY



Fig. 1. Lagjja Kala, Berat




Fig. 2. Lagja Mangalem, Berat

Do not copy



Fig. 3. Lagja Goricë, Berat



Fig. 4. Banese karakteristike, Berat



Fig. 5. Rrugicë në lagjen Goricë, Berat

DO NOT COPY



Fig. 6. Lagje e Gjirokastrës





Fig. 7 - 8. Banesë karakteristike, Gjirokastër

DO NOT COPY




Fig. 9. Banesë karakteristike, Gjirokastër



Fig. 10. Banesë karakteristike, Gjirokastër



Fig. 11. Pazari i Gjirokastrës

DO NOT COPY




Fig. 12. Pazari i Gjirokastrës



Fig. 13. Interier banese, Gjirokastër

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Fig. 14. Banesë tradicionale, Korçë





Fig. 15 - 16. Banesa të tipit të ri, Korçë



Fig. 17. Pazari, Korçë



Fig. 18. Han në Pazarin e Korçës

DO NOT COPY



Fig. 19. Banese tradicionale, Krujë



Fig. 20. Pazari, Krujë

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Fig. 21. Thethi, Shkodër



Fig. 22. Banesë e fortifikuar, Tropojë


DO NOT COPY

Fig. 23. Banese tradicionale, Tërnovë, Dibër


DO NOT COPY

Fig. 24. Banesë e fortifikuar, Mat



Fig. 25. Vunoi




Fig. 26. Rrugicë në fshatin Rehovë, Kolonjë



Fig. 27. Qeparoi




Fig. 28. Odriçan, Përmet

Donot Copy

monumentet
58/2019

Emin RIZA

STUDIES ON THE ALBANIAN VERNACULAR DWELLING AND ITS FUTURE

DO NOT COPY

As a researcher working on vernacular architecture of Albania for over 50 years, I believe that with assessment we have to understand the actions of investigation, selection, protection, documentation, study and restoration of cultural heritage assets.

In the Albanian context the study of the vernacular dwellings starts with the Ethnographic Department under the lead of the first researcher, Koço Zheku, to later continue with the creation of the Institute of Cultural Monuments. One of the main challenges remained the classification of the vernacular dwellings even though the studies suggested that the volumetric composition was the main element used for the purpose. Behind it resides the multitude of the human activity. That is why both elements are at the basis of understanding how they complement each other as fundamental characteristics of the evolution of the vernacular architecture. It is clear that the house itself is deeply narrative of the family activity through time. The most representative phenomenon of the vernacular dwelling, as well as most of the building categories are accompanied with considerable secondary ones in order to widen the types of valuable classifications spread through time and space.

The examples of vernacular architecture inherited from the past centuries belong mostly to the 19th century and only small numbers of them from the more remote past. But nevertheless, these examples are decisive in helping the compositional documentation of the house and its components. On the other hand the studies on the urban settlements are fundamental in understanding the transformation of this typology in general.

With the creation of the Institute of Cultural Monuments in 1965, we testimony an increase of interest and awareness of young professionals towards the traditional settlements in cities and in the rural areas. Facing the lack of specialized institutions, these young professionals were mainly trained throughout working in the field under the direction of the architect Gani Strazimiri, to whom has to be attributed the main role in the assessment process of the cultural monuments (mostly vernacular dwellings). Along with the study and documentation of this typology, comes restoration interventions designed for the preservation of the original testimonies of the protected buildings as monuments, even though when dealing with vernacular dwelling it is necessary to have an understanding among institutions and owners due to the typology characteristics and uses.

It is worth mentioning that the restorer or vernacular architecture is simultaneously a researcher on the topic. Research activities on this typology are followed by publications in scientific reviews that help continuing discovering their truth. Moreover there are symposiums, scientific sessions and conferences.

Let us focus on the words *Albanian's dwelling* and *Albanian dwelling;* with such a territorial spread that serves to a same use but different in volumetric composition and architectural technical treatment. In the Albanian reality this typology is followed

by different and colorful types related to specific nations or parts of it. For example in Albania the only two types are genuine of Albania: the house with fire place in along storey's and the Gjirokastra fortified house.

Having said that, the assessment activity phases can be divided into three periods: beginning of 20th century till the end of WWII, 1946 until the foundation of the Institute of Cultural Monuments in 1965 and from 1965 and ongoing.

The Multiplan care for the cultural monuments have been based also in international experience throughout the help of foreign researchers, the membership in international organizations for the protection of cultural assets.

The evaluation of vernacular dwelling is an ongoing process of the past values as well as for those adding up with time. In my opinion, we are facing the end of the evaluation process for monuments of culture, such as vernacular architecture, from when the first researchers of the Institute of Cultural Monuments started working in challenging conditions and unknown territories. The identification of Albanian vernacular architecture in a never ending activity firstly of the waste territory occupied by the vernacular rural dwelling. Their graphic, photographic and narrative documentation is of the main importance for the representation of the values throughout the archive institution. Nevertheless it is worth mentioning that the dwelling listed as monuments of culture face destruction risks. That is why their monitoring and interventions ought to be significant. The restoration interventions of houses constitutes the major part of interventions in Albania. It is understandable why researcher continue publishing in order to better uncover their truth. These interventions guarantee the protection of their original values.

The coming generations have the burden of carrying on the further scientific research for the comparison of the Albanian vernacular dwelling and those from the Balkans and even Europe.

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Prof. Dr. Apollon BAÇE

ANATOMIA E MBISHKRIMIT TË MEDAURËVE

DO NOT COPY

Zoti nuk është mendja, por shkaku përse mendja është.
Zoti nuk është shpirti, por shkaku përse shpirti është.
Zoti nuk është drita, por shkaku përse drita është.
Corpus Hermeticum (Apuleius ?) [1]

Mbishkrimi

Mbishkrimi i Medaurit është një përkushtim në vargje, të cilin konsulli i provincës Africa Proconsularis, origjinar nga qyteti Ilir Rizon



1.Fig. 1. Gjiri i Rizonit (Kotorska Boka)

(Fig. 1), ia dedikon hyut ilir Medaur.

Mbishkrimi u zbulua në mesin e shek. 19 në Lambaesa (Tazoult, Algjeri), kryeqytetin ushtarak të Africa Proconsularis-it (Fig. 2), dhe u përfshi në korpusin e Mbishkrimeve Latine (Corpus Inscriptionum Latinarum, CIL. 3. 1716; 8. 2581)[2].

1 Sipas studiuesve, Perfect Sermon, pjesa e fundit e Corpus Hermeticum, është hartuar nga fundi i shek. 3 e.s dhe po sipas studimeve, ai u përkthye në latinisht nga gjuha kopte (egjiptiane) nga shkrimtari dhe filozofi Apuleius (125-170 e.s). Duke i lënë mënjanë këto absurde, përmbajtja, stili platonian (ndërkohë që Apuleius vlerësohet si një ndër filozofët kryesorë Neoplatonianë), dhe pjesëzat e pasqyruara në Metamorfosis-in e Apuleius, për bindjen tonë e dëshmojnë atë autor të Perfect Sermon-it. Për një analizë të plotë të botës së tij G. N. Sandy The Greek World of Apuleius: Apuleius and the Second Sophistic, Leiden 1997.

2 Mbishkrimi, i kopjuar paradoksalisht mjaft saktë nga ushtari i legjionit të huaj J. Konarzewski dhe mjaft keq nga epigrafi L. Renier (Inscription romanes de l'Algerie, Paris, 1858, 85, 36) u përfshi në Korpusin e Mbishkrimeve




Fig. 2. Planimetria pjesore e Lambaesa-s

DO NOT COPY

Mbishkrimi u gjend në një nga tempujt e vegjël (naiskos)[3] të Asclepeion-it (162 e.s),[4] (Fig. 3), arealit të shenjtë të gjysmë-perëndisë së mjekësisë Eskulap (Aesculapius) dhe perëndeshës së shëndetit Salus (Fig. 4). Ky i fundit, krahas funksionit fetar, shërbente për trajtimin termal dhe shërimin theurgjik (θεουργία) të ushtarëve, kurimin nga perëndia gjatë gjumit mistik, dhe si i tillë ishte një nga mjediset më të frekuentuar të qytetit. Nga ky mbishkrim ishte ç'gdhendur me daltë dhe çekan, shkronjë pas shkronje, emri i konsullit blatues, çka dëshmon për fatin e tij tragjik: Ekzekutimin dhe dënimin me "mallkim të kujtimit", me Damnatio Memoriae. Në përputhje me aksiomën Orwell-iane "Ai nuk ekziston. Ai nuk ka ekzistuar kurrë",

Latine të drejtuar nga T. Mommsen (CIL 3. 1716, CIL 8. 2581) dhe më tej u ribotua në korpuset Mbishkrime të Zgjedhura Latine (ILS (Inscriptiones Latinae Selectae 4881) dhe Poezi Epigrafike Latine (CLE, Carmina Latina Epigraphica 1527). Ndërsa tërë rreshtat e mbishkrimit kanë interpunksion, shenja pikësimi mes fjalëve, rreshti 3., për shkak të gjatësisë nuk ka shenja interpunksioni. Po për shkak të kësaj gjatësie ET shkurtohet në E dhe QVOQUE në QVOQ. Për balancimin e teksteve të shkurtër të rreshtave 2 dhe 4, në mbishkrim janë gdhendur gjethe bliri (Tilia europaea). Këta gjethe janë përdorur edhe për ndarjen e dy pjesëve, përkatësisht rreshtit 1-10 nga rreshtat 11-14, dhe theksimin e emrit të blatuesit në rreshtin 14. CIL plotëson shkurtimet e rreshtit të tretë dhe korrigjon fjalën PARVS (xhixhimës, trishtil) të rreshtit të 10 në CLARUS. Variantet e sjellë nga studiuesit e tjerë janë CARUS (i vyer), GNARUS (i njohur), PARTUS (i lindur). Krejt ndryshe nga këto variante, fjalën PARUS e korrigjojmë me fjalën RARUS i rrallë/i pashoq (mbiemër, gjinia mashkullore, numri njëjës, rasa emërore, shkalla pohore), e cila nuk është marrë parasysh në asnjë nga korrigjimet. Ndërkohë kopja ekselente e J. Konarzewski-t nuk lejon asnjë formë tjetër veç RARUS që shpjegohet lehtë me gërryerjen e bishtit të R-së dhe leximit të saj P. Krejt ndryshe, variantet CLARUS, GNARUS dhe PARTUS kanë një shkronjë më tepër, ndërkohë që nuk ka asnjë vend për një shkronjë plus, ndërsa P nuk ka asnjë shans të lexohet C. Sprovat e tjera për korrigjimin e mëtejshëm të tekstit, si ajo e gjuhëtarëve T. Ploccienik, K. Rzsepkovski (në P. Dyczek, J. Kolendo, A. Lajtar, T. Ploccienik, K. Rzsepkovski (The illyrian god Medaurus and the defenssis of Risinium (summary), Novensia 21, Warzszava, 128-133) janë thjesht spekulime. Për ilustrim, sipas tyre, rreshti i 7. i CIL 3. 1716 dhe CIL 8. 2581 nuk duhet lexuar nam por iam, ndërkohë që edhe CIL 3. 1716 dhe CIL 8. 2581 shkruhet qartë iam dhe jo nam.

3 R. Cagnat, Lambèse, Paris, 1893, 59.

4 Për tempullin e Eskulapit Michele Janon, Le temple d'Esculape, Archeologia, Paris, 1985, no. 201, 42-49; Recherches á Lambése III: Essais sur le temple d'Esculape, Antiquites africaine, 21, 1985, 35-102.



Fig. 3. Asclepeion-i i parë nga balli dhe nga pas (foto e R. Cagnat e vitit 1895)

emri i tij ishte fshirë nga tërë mbishkrimet, aktet dhe librat e historisë. Ky proces, i njëjtë me atë të rishkrimit të historisë dhe retushimit të fotografive në periudhën e komunizmit (Fig. 5) kundrohet si censurim historik, por për romakët ai ishte shumë më tepër (Fig. 6). Dënimi pas vdekjes (poena post mortem) me mallkim të kujtimit, synonte këputjen e jetës transcendental-e, jetës së përtejme, e cila sipas besëtytnisë vazhdonte falë ngulmimit të kujtimit (perseverantia memoriae). Kur kujtimi mallkohej, ai nuk ngulmonte dot më dhe jeta e përtejme shuhej. Çka të çon në paradigmën po Orwelliane "Kush kontrollon të shkuarën, kontrollon të ardhmen. Kush kontrollon të tashmen, kontrollon të shkuarën"[5].



Fig. 4. Shtatoret e Eskulapit dhe Salus-it nga Asclepeion-i Lambaezias (Cagnat v. 1895)

Damnatio Memoriae ishte dënimi skajor që senati Romak u jepte perandorëve dhe elitës

5 Konceptin e gjykimit pas ekzekutimit, me pasoja tejet të rënda për të afërmit, e pasqyron bukur mirë Dekreti komunist nr. 1223, dt. 26. 2. 1951, i cili sanksiononte gjykimin e personit pas ekzekutimit të personit.

DO NOT COPY

pas ekzekutimit për tradhti të lartë ndaj Romës[6]. Ndonëse numri i këtyre dënimeve është mjaft më i madh se duzina e njohur, zhdukja e çdo gjurme zbatohej tejet rrallë[7].

Krejt ndryshe, këtë herë Damnatio Memoriae u zbatua me skrupulozitet të rrallë, duke e ç'gdhendur Ndërkohë, vetë mbishkrimi shpëtoi falë tabu-së së për moscenimin e emrave të shenjët, në këtë rast perëndisë Mars dhe perandorit Mark Aurel.

Përjashtuar cungun M. Lucceius Torqua[…..] në zyrën e humbur të peshëmatjes në El-Kantara[8], ku ç'gdhendja e plotë ishte përtuar, emri i konsullit



Fig. 5. G. Madhi: "Mbledhja e 81 partive në Moskë, 1960" (para dhe pas prishjes së marrëdhënieve me Kinën.)



Fig. 6. Damnatio Memoriae e Konsullit Medaur dhe Perandorit Commodus

emrin me zell të admirueshëm nëpërmjet kanalesh të thellë në gur (Fig. 6).

qëndroi për 18 shekuj në terr të plotë. Emri i tij: M. Lucceius Torquatus Bassianus, u deshifrua vetëm

6 Varro. Ling. 6.49. Analiza tek E. Warner, Mutilation and Transformation. Damnatio Memoriae, Leiden, 2004, 2,3.

7 PWRE. s.v. Damnatio Memoriae

8 J. Lassus, M Lucceius Torquatus, legat de 167 a 169, Antiquites Africaines, 1968, 2, 206.

Do Not COPY

50 vjet më parë nga L. Leschi[9], duke u pranuar si i mirëfilltë nga tërë shqota dyshimtare e epigrafeve[10]. Por edhe sikur ky deshifrim të mos ishte i saktë, kjo do kishte një rëndësi të dorës së dytë. Rëndësi të dorës së parë ka mesazhi që bart mbishkrimi dhe jo emri i hartuesit të mbishkrimit.

Ndonëse ndër të cituarit, mbishkrimi është trajtuar si një vile rrushi nga e cila këputen kokrra për t'i konsumuar tjetërkund, pa u ndalur në ndërveprimin e elementëve dhe mesazhin. E shumta duke e kundruar këtë mesazh si jehonë ekzotike të një mjedisi të paqytetëruar ekzotik. Për sa i përket botës shqipfolëse, e cila duhet të ishte dhe më e interesuara, ai ka qenë domenë kryesisht e enciklopedive ambulante, të cilat për gjithçka dinë thuajse asgjë. Ndërkohë, mbishkrimi i Medaurit arrin të ndrydhë brenda vetëm 14 vargjeve një histori të mistershme si ajo e Kodit të da Vinçit, kabalistike dhe të përgjakur si historia e kodit, por krejt ndryshe nga kodi, një histori reale dhe jo e stisur.

Parë në një optikë të tillë dhe duke pasur parasysh mangësinë thuaj të plotë të burimeve autentike për botën ilire, ky mbishkrim është një dokument historik në shkallën më të lartë të vërtetësisë dhe një mesazh shpirtëror në shkallën më të lartë të sinqeritetit. Si i tillë, ai është dokumenti i parë dhe i fundit ku një ilir shpalos vetë ndjenjat e tij për botën shpirtërore ilire.

Në mungesë të përkthimit të saktë[11], zbërthimi i këtij mesazhi kërkonte së pari përkthimin besnik të tekstit dhe njëkohësisht respektimin e mbartëses së tij, poezisë. Përkthimi shkronjë për shkronjë, ad litteram, do lëndonte mesazhin shpirtëror dhe përkthimi letrar do deformonte vërtetësinë e dokumentit. Për t'i paradalë kësaj, përkthimi është shoqëruar me zbardhjen fjalë për fjalë të tekstit[12], ndërsa ndjesinë e kohës ja kemi lënë origjinalit të botuar sinkron me përkthimin.

DO NOT COPY

9 L. Leschi, Autour de l'Amphithéâtre de Lambèse, Libyca a/é, 2, 1, 1954, 171-181.

10 Ndër ta miku im i ndjerë, epigrafi më i shquar i mbishkrimeve romake Geza Alföldy, (Bevölkerung und Gesellschaft der römischen Provinz Dalmatien. Akadémiai Kiadó, Budapest 1965, 141, Epigraphische Studien, Rheinland verlag, Sammelband, 5, 124). Kundër këtij deshifrimi janë shprehur një pakicë arkeologësh, ndër ta R. Marić, Ist der Name des Dedikanten in der zweiten metrischen Medaurusinschrift getilgt? Archaeologia Iugoslavica 3, 1959, 75 ff. dhe P. Dyczek, J. Kolendo, A. Lajtar, T. Ploccienik, K. Rzsepkovski (vep.cit, 128-133), të cilët sjellin dhe versionin e tyre giallo. Sipas këtij versioni 10 vargjet e para i përkasin konsullit Ignatius (emër që nuk merret vesh nga është peshkuar), delmat dhe rizonitan, i cili sapo u caktua në detyrë i kushtoj Medaurit një skulpturë dhe 10 vargje. Më tej vendin e tij e zuri konsulli Medaur, po delmat dhe rizonitan, i cili i kushtoi hyut Medaur 4 vargje të tjera, poshtë 10 vargjeve të Ignatius-it, dhe një skulpturë, logjikë kjo shumë e vështirë për t'u ndjekur dhe pranuar. Më tej ata mendojnë se vargu "madhështor në shëmbëlltyrën e vogël", ka kuptimin se kjo shëmbëlltyrë është e vogël krahasuar me statujën e madhe në Rizon e cila pavarësisht se nuk është zbuluar, ndonjë ditë do zbulohet.

11 Mbishkrimi është përkthyer 2-3 herë me të meta të dukshme të cilat ia tjetërsojnë përmbajtjen. Për ilustrim, përkthimi i Z. Várhelyi (The Religion of Senators in the Roman Empire. Power and the Beyond. Cambridge, 2010), e cila pretendon të jetë dhe përkthyesja e parë e mbishkrimit, vargun e fundit "Ty Medaur ta dedikon Medauri" (tuus Medaure, dedicat Medaurius), e përkthen me "Ty Medaurus, Medauriani yt ta dedikon këtë shtizë" (To you Medaurus, your Medaurian dedicates this spear).

12 Ad litteram, fjalë për fjalë, përkthimi vijon:
(Ti) që përkujdesesh për muret që Rizonin ajakid e bëjnë kryekështjellë të/Delmacisë. Lar publik i popullit tonë,/I shenjti Medaur në shtëpi, i shenjtë dhe këtu, pikërisht edhe (për) këtë tempullin këtu/Përkujdesu të lutem, i madhërishëm (siç je) në imazhin e vogël/(ku) e me të majtën përshkund kalin që ngrihet në ajër/dhe me dorën tjetër nga (afër) veshit vdekjen flak./Të tillë ty konsulli tashmë i emëruar, në këtë/seli të vendos, duke të adhuruar i yti [.....]/i njohur prej Marsit nga luftërat e vjetra dhe prej teje Cezar/Marku kudo i shquar nga radhët e para të betejës.
(Ai) që e morri konsullatën [.....],/ty vizionit frymëmarrës të qenies së perëndishme të atdheut/ që flak ushtën larg nga kali i frenuar/ty Medaur ta dedikon Medauri.

[1] Moenia qui Risinni Aeacia, qui colis arcem
Delmatiae, nostri publice lar populi,
Sancte Madaure domi e(t) sancte hic, nam/
templa quoq(ue), ista
Vise, precor, parva magnus in effigia,
[5.] Succussus laeva sonipes cui surgit in auras
Altera dum letum librat ab aure manus.
Talem te consul iam designatus in ista
Sede locat venerans ille tuus [……]
Notus Gradivo belli vetus ac tibi, Caesar
[10] Marce in primore rarus ubique acie.

---

[11] Adepto consulatu [……]
Tibi respirantem, faciem patrii numinis,
Hastam eminus quae iaculat refreno ex equo,
[14]Tuus Medaure, dedicat Medaurius.

[1](Ti) që për ledhet e Rizonit ajakid, kryekështjellës
sonë Dalmate përkujdesesh, Lar publik i popullit tonë,
Medaur i shenjtër në atdhe, i shenjtër dhe këtu,
Të falem shumë: edhe për këtë tempull kujdesu,
I madhërishëm siç je në shëmbëlltyrën vocërrake,
[5] Ku kalin me të majtën qirithi ngre
Gjersa me të djathtën vdekjen ta përflakësh.
Të blaton dhe adhuron në këtë strehë tënden
konsulli, tashmë i emëruar, [……]
I njohur nga beteja-prijësit Mars dhe ti o Cezar Mark
[10] Nga fama radhëve të para të betejave të shkuara,

Ai që tanimë e nisi konsullatën [……],
Ty, vegim i gjallë i Hyut të atdheut,
Që kur kalin ndal, ushtën larg e flakëron.
Ty Medaur, ta përkushton Medauri.

Sesa i përafrohet ky përshkrim imazhit të Medaurit, kjo nuk dihet, pasi ai ka humbur prej kohësh. Me siguri mund të thuhet vetëm se ai ka qenë skulpturë, dhe jo vetëm se po të kish qenë ndonjë altoreliev do ish gdhendur në një copë me mbishkrimin. Por, çka dhe është kryesore, sipas venomeve, çudibërja, thaumaturgjia, funksionon vetëm me shëmbëlltyra tredimensionale[13]. Ndonëse mbishkrimi e quan atë shëmbëlltyrë të vogël (parva effigia), naos-i, dhoma e shenjtë ku ajo ishte vendosur, është voluminoz[14]. Kjo dhe madhësia e bazamenteve në tempujt përreth, tregojnë për një skulpturë kalorësiake mes 1/2- 2/3 të madhësisë natyrale.

Nisur nga përshkrimi, Medauri është identifikuar me "Kalorësin Trak". Por, ndërsa ky i fundit përfytyrohet gjuetar a me patera-n, kupën e flijimit shpirtrave në dorë (Fig. 7), Medauri është thjesht luftëtar. Kjo e afron atë me kalorësin e paftave të Selcës dhe Gostiljes (Fig. 8)[15], por sërishmi koncepti është i ndryshëm.

Ndërsa kalorësi i Selcës dhe Gostiljes paraqitet me armatim të rëndë mbrojtës, Medauri është i konceptuar si shpirt i lirë, i pakërcënueshëm nga askush[16]. Ikonografia e tij përputhet mirë vetëm me dekorin e një kupe nga Rizoni, në të cilën kali i frenuar beftas qëndron me këmbët e para pezull në ajër, ndërsa kalorësi pa asnjë armatim mbrojtës,

13 Appuleius, De Magia 27. H. Hiller, Lexikon des Aberglaubens, München 1986.

14 Përmasat e naos-it janë 5 x 5 m, ndërsa bazamentet në naiskos-et përreth mbi 2.20 m të gjatë. Sipas M. Janon (Recherches à Lambèse 3. Essais sur le temple d'Esculape, Antiquite Africaine 21, 1985, 99), në bibliotekën e Sorbonës, në dosjen Delamare ekziston një vizatim kualitativ i depozituar nga L. Renier.

15 Në të dy paftat ku përshkruhet ngadhënjimi i fitores, kalorësi paraqitet soditës, në një skenë tashmë të përfunduar, me përkrenare të fuqishme dhe mburojë të madhe. Ndërkohë M. Zeqo (Panteoni Ilir, Tiranë, 1995), shprehet me siguri të plotë se "në skenën e paftës së Selcës së Poshtme... kemi Medaurin... kulti i Medaurit është i lidhur me kultin e ujërave (figura e gjarprit – monstër detar, e peshkut etj.) pra me kultin e vetë Redonit... është e sigurt: të dyja këto hyjni kanë bashkëjetuar dhe kanë qenë në krye të vendit në panteon".

16 Ky ndryshim konceptual e ndan Medaurin edhe nga ikonografia e panteonit greko-romak, ku perënditë, të cilat luftuan gjatë me perënditë e vjetra dhe gjigantët, mbajnë armatim mbrojtës. Tema e plazmimit të mitologjisë nga e shkuara historike është një temë e gjerë dhe jashtë vendit, por sipas poetit- filozof romak Lukrec "sikur njerëzit të kishin fytyra kafshe, edhe perënditë do kishin fytyra kafshe".

DO NOT COPY



Fig. 8. Pafta e Selcës (shek. 4/3 p.e.s.)



Fig. 7. Kalorësi Trak (Sofie, muzeu arkeologjik)

flak ushtën e ngritur afër tëmthit[17] (Fig. 9).
Kjo dhe i jep përparësi kohore ikonografisë proto-ballkanike të Medaurit ndaj ikonografisë së Kalorësit Trak, të përhapur në shekujt 1-3. e.s.

Hyu Medaur

Theonomia, emri më i hershëm i një perëndie Ilire, është ai i Medaurit. Fillimisht ai shfaqet në një mbishkrim të shek. 3 p.e.s nga Rizoni, në

17 Sipas Prof. P. Dyczek (www.uw.edu.pl/en/ news/ risan. New treasure found by University archaeologists), i cili është dhe zbuluesi i saj "Ky imazh përputhet plotësisht me përshkrimin e Medaurit, Perëndisë së adhuruar në Rizon." Dinamizmin e lëvizjes dekori i kupës rreh ta japë nëpërmjet mantelit të flakëruar nga era, element ky i pazbatueshëm në një skulpturë. Ndonëse prof. Dyczek mendon se qeramika e luksit në Rizon është e importuar, një kallëp menade i botuar po prej tij (P. Dyczek, Illyria and the Balkan provinces in United Europe, Warszava, 2011, fig 68), tregon të kundërtën. Riprodhimi i kupave (për ne të Megarës dhe jo Korintit), dëshmohet shpesh edhe në punishtet e qyteteve të Ilirisë Jugore. Dinamizmin e lëvizjes dekori i kupës rreh ta japë nëpërmjet mantelit të flakëruar nga era, element ky i pazbatueshëm në një skulpturë tredimensionale.

DO NOT COPY



Fig. 9. Kupë nga Rizoni

një përkushtim këtij hyjnie nga peripoliark-u, komandanti ushtarak i qytetit (περιπολιαρ[κον]/..... Μεδαύρου)[18]. Në shek. 2 e.s, krahas mbishkrimit në vargje, emri i Medaurit përmendet edhe në dy mbishkrime të tjerë. I pari, po nga Asklepeion-i i Lambezias, është sërish një përkushtim, "Medaurit të madhërishëm dhe të shenjtë" (Medau/ro Aug[usto]/ S[acru]m)[19]. Mbishkrimi tjetër, në shkëmbin e një shpelle buzëdetare në Leuca, Medaurin e përmend së bashku me perëndinë tjetër ilire Redon, si emra anijesh ose në vend të Dioskurëve, të cilëve detarët u luteshin për t'i mbrojtur nga të papriturat e detit[20]. Për herë të fundit, ai shfaqet në trajtën paksa të shprishur Medeur në një mbishkrim gjermanik nga Afrika Veriore. Datimi i këtij mbishkrimi rreth shek. 5 e.s, dëshmon përhapjen dhe mbijetesën e kultit të Medaurit edhe kur krishterimi ishte kthyer në fe zyrtare[21]. Mbishkrimi poetik i Medaurit nuk merr mundin t'i hedhë supeve Medaurit as edhe mantelin e "interpretimit romak" (interpretatio romana) të cilin ishin të detyruar ta mbanin një varg perëndish, si ilire, si Diana e Kandavisë (Diana Candaviensis), ashtu dhe jo ilire, si Jupiter Dolichenus-i hitit. Në të kundërt, ai krenohet me origjinën ilire të Medaurit, duke parapëlqyer trajtën origjinare delmat, të kafshës totem të fisit, delme a dele, ndaj trajtës zyrtare romake dalmat. Nisur nga gjetja e këtij mbishkrimi në Asclepeion dhe rrënja med, e cila në indo-europianisht dhe në greqishten arkaike ka kuptimin përkujdesem, shëroj dhe mjekoj, W. Tomaschek e zbërtheu emrin në Med-aurus dhe

18 Mbishkrimi në një pllakë mermeri, i marrë fare pak në konsideratë, vijon περιπολιαρ[- - - - -]/[-] Μεδαύρου ε[- - -]/ [--]αρχοντων... (W. Kubitschek, Mitteilungen der k. k. Zentral-Kommission zur Erforschung und Erhaltung der Kunst- und historischen Denkmale, 2. 1903, 170-173). Formula e tij është krejt identike me atë të mbishkrimit të Rabijes dhe një mbishkrimi nga rrethinat e Apolonisë në Ashmolean Museum-Oxford (Louis Robert , Jeanne Robert, Bulletin epigraphique, Revue des Études Grecques, 86, 1973), të cilët i dedikohen po nga peripoliarku Dionisit. Mbishkrimi i Rizonit, datohet gabuar nga Kubitschek në shek 2 e.s., ndërkohë që formula është tipike për shek. 3 p.e.s dhe më herët.

19 CIL 8. 2642

20 AE (Année épigraphique 1979) Mbishkrimi, i gdhendur në faqet e shpellës Porcinara, motrës perëndimore të shkëmbit të Gramës (Karaburun) në bregun lindor të kanalit të Otrantos, vijon "I(ovi) O(ptimo) M(aximo) / C(aius) Cordius Aqu(i)l/linus vot(um) sol(vit) / cum pleroma / Rhedo[n]is et / Me[d]aur[i]" Sipas C. Pagliara (La grotta Porcinara di S. Maria di Leuca, Annali Universita Lece, Facolta letter e Filosofia, 1972-73 (1974), 76-9, ai transkriptohet në "Jupiterit Optimo Maksimo, Kaius Kordius Akuilinius, i ofron përkushtimin, bashkë me ekuipazhet (pleroma) e Redonit dhe Medaurit". Si i tillë ai është një nga mbishkrimet votive të marinarëve që përshkojnë Kanalin e rrezikshëm të Otrantos dhe që sipas zakonit i drejtohen me përkushtime mbrojtësve të marinarëve, bijve të Zeusit, vëllezërve Dioskurë Castor dhe Polyx. Sipas Pagliara-s Redoni dhe Medauri ishin anije patrullimi të Adriatikut të poshtëm. Kjo nuk është tepër logjike, pasi anijet e patrullimit kalonin nga njëri breg në tjetrin dhe ex voto-t duhet t'i ripërsërisnin në pafundësi. Ndërkohë pas fjalës pleroma, që edhe mund të përkthehet ekuipazh, ka një lakunë dygërmëshe, e cila po të plotësohej në pleromata do merrte kuptimin "Jupiterit Optimo Maksimo dhe fuqive hyjnore të Redonit dhe Medaurit, Kaius Kordius Akuilinius u ofron këtë përkushtim". Ndër të tjera, të vetmet hyjni të cilat paraqiten me kalë, si Medaurusi, janë bijt e Zeusit Castor dhe Polyx.

21 Th. von Grienberger, De Servando medito, Zeitschrift für deutsches Altertum, 51, 1909, 257

DO NOT COPY

e konsideroi Medaurin perëndi mjekësie[22]. Kjo i kushtoi atij shpotinë e zbulimit të "Eskulapit me kalë". Ndërkohë mbishkrimi nuk e quan Medaurin perëndi, çka për besimin romak do nënkuptonte mbulimin e një lëmie të caktuar, si të luftës për Marsin a mjekësisë për Eskulapin. Por, ndonëse Medauri përmendet me superlativat më të larta të mundshme: i madhërishëm (magnus), i admirueshëm (Augusto) dhe i shenjtë (sancte), ai rreshtohet më tej në specien më mish-mashe të religjionit romak, në atë të larëve[23] të përzier me kategoritë më të habitshme të shpirtrave (di manes, genius, penates)[24].

Mospërmendja e tij si perëndi, por si lar, emri origjinar i të cilëve "laza" të kujton ashtu larg lazoret e ditës së verës, nuk është as rastësi as edhe prudencë. Stelat dhe altarët e Lambaesia-s kozmopolite gulonin nga emrat e perëndive më ekzotike të mundshme: nga Torehoboldi Deo (Fig10) në Dea Africa dhe nga Dei Mauri në Deo Silvano Pegastano[25] dhe nëse ushtarët nuk hezitonin t'i quanin perëndi zotët e tyre, aq më pak do hezitonte ta quante Medaurin perëndi i pari i këtyre ushtarëve. Si e tillë, arsyeja përse ai e quan Medaurin lar dhe jo perëndi është krejt tjetër.

Venomet protoevropiane, i ngarkonin larët me përkujdesjen për gjithçka, nga shëndeti tek të korrat dhe pjelloria tek lufta, por gjithnjë brenda një sinori të caktuar, qoftë ai familje a fshat, qytet a njësi



Fig. 10. Mbishkrim nga Lambeza i Deo Silvano Pegastano

etnike dhe asnjëherë jashtë tij. Si i tillë përcaktimi "Lar publik i popullit tonë" (nostri publice Lar populi), ka gjasë të dëshmojë një strukturë religjioze të ndryshme nga struktura politeiste greko-romake me shumë zota. Përkatësisht, për një strukturë monoteiste me një zot të vetëm, por totemike, të veçantë për çdo njësi etnike. Parë në një dritë të tillë, konsulli Medaur "i njohur nga... fama e radhëve të para të betejave", logjikisht do parapëlqente nga tërë funksionet e Medaurit, funksionin ushtarak. Si e tillë, hipoteza e Tomaschek për një hyjni mjekësie, të paktën nuk është për t'u shpotitur.

Apex-in, pikën e tij kulmore, mbishkrimi e shënjon

22 W. Tomaschek (Bezzenbergers Beiträge z. Kunde der indogermanischen Sprache 9. 1884, 97). Teza e Tomaschek pranohet nga Ganszymiec (PWRE 15, 26) dhe linguisti A. Mayer (Die Sprache der alten Illyrier. Wien 1959). Fillimisht ajo u kundërshtua nga C. Patsch (Der "Heililgott" Medaurus, Jahreshefte des Österreichischen Archäologischen Institutes in Wien, Wien, 1903, 6, Beiblatt, 71) dhe më tej nga të tjerët.

23 Larët, perënditë kujdestare të etruskëve vëzhgonin, mbronin dhe ndikonin në gjithçka, por vetëm brenda sinorit të tyre (vatrës, lumit, rrugës tokësore a detare, qytetit, ushtrisë dhe shtetit), F. Böhm, s.v. Lares, PWRE 12, 1 Stuttgart 1924; A. Mastrocinque, s.v. Laren, Der Neue Pauly (DNP). 6, Stuttgart 1999; W. Smith, Dictionary of Greek and Roman Biography and Mythology, 1867, 416.

24 G. Hetzberg, De diis romanorum patriis sive de Larum atque Penatum, Halae, 1840. Cilësimi i mëtejshëm "lar publik", e ndërfut Medaurin edhe më thellë, në nënspecien e larëve publikë, të cilët ato fare pak herë që përmenden, përmenden vetëm në shumës, lares (Larium publicorum Plin N.H, 21.8, Lares publici, AE 1980, nr 56 (shek. 4. p.e.s), Laribus publici CIL 6, 456) dhe asnjëherë në njëjës, lar. Ndonëse me rinovimet augustiane larët publikë të Romës nderoheshin në tërë qytetet me të drejtë romake dhe Rizoni si municipium gëzonte të drejtë romake edhe për banorët autoktonë, mbishkrimi i Medaurit nuk u drejtohet larëve publikë të Romës, por "larit publik të popullit tonë Delmat".

25 M. Le Glay. La vie religieuse à Lambèse d'après de nouveaux documents, Antiquités africaines, 5,1971. 125-153

DO NOT COPY

me telesma-n (τέλεσμα), lutjen rituale "Hyjnor në atdhe, hyjnor edhe këtu. Të falem: Përkujdesu edhe për këtë tempull, i madhërishëm siç je në shëmbëlltyrën vocërrake". Kjo lutje, sipas riteve sekrete të mystai-ve, shënjon finalen e inicimit mistik, çastin kur pas libacioneve, sakrificave dhe shqiptimit të formulave kabalistike, krijuesi i objektit (konsulli Medaur) grish subjektin (hyun Medaur) që ta shkarkojë forcën e tij magjike tek objekti (skulptura e Medaurit)[26]. Pas kësaj, shëmbëlltyra e Medaurit, skulptura e tij, nis ushtrimin e forcës së Medaurit në mjedisin e kërkuar, tempullin e Eskulapit.

Ky akt i paprecedent, shpërfill venomin e larëve për moskalimin e sinoreve të tyre, thyen kapsulën lokale dhe i atribuon Medaurit universalizëm. Një veprim i tillë është sinkretizëm i pastër, ndërfutje dhe amalgamim traditash, hap i parë proselitizmit, grishjes për ndërrimin e fesë. Ndërkohë, formulimi "të falem: përkujdesu edhe për këtë tempull", krijon paradoksin e paparë të marrjes nën tutelë të një perëndie zyrtare romake nga një lar dhe kthimin e kësaj perëndie zyrtare në subjekt subaltern të hyjnisë pagane[27].

M. Lucceius Torquatus Bassianus

Mbishkrimi paraqet një puzzle game, copëzat e të cilit fshehin surpriza nga më të papriturat, q; t; befasojnë edhe aty ku nuk pritet asnjë befasim. Vetë emri, në dukje krejt i rëndomtë, në realitet është një emër rebus. Ta analizojmë:

Sipas antroponimisë romake M. Lucceius Torquatus Bassianus zbërthehet në emrin (praenomen) M., atësinë (patronimicus) Lucceius, cilësorin Torquatus të kthyer në mbiemër (agnomen/cognomen) dhe vend-origjinën (residentia) Bassianus.

Falë numrit tejet të vogël, më pak se 20, emrat romakë shënjoheshin me iniciale. Ndër to M. zbërthehet në Marcus dhe asgjë tjetër[28]. Në pjesën e parë të mbishkrimit, kur M. Lucceius Torquatus Bassianus ishte emëruar konsull, por ende nuk e kishte nisur ushtrimin e detyrës (consuli iam designatus), ai vazhdon të luajë, si në mbishkrimet e sigluara në postin e legatit, adashin Mark të Mark Aurelit. Në pjesën e dytë, kur ai e kishte nisur ushtrimin e detyrës (adepto consulatu) dhe si i parë i provincës, nuk druhej më nga kush, ai e ç'kodon M. Vargu "ty Medaur, ta përkushton Medauri", tregon se M.-ja nuk nënkuptonte sipas rregullave Mark, si Mark Aureli, por Medaur si hyu Medaur[29]. Ndërkohë, siglimi i mbishkrimit me emrin real Medaur, duhet kundruar edhe si gjest publik, pasi ai tashmë u afishua dukshëm në mjedisin më të frekuentuar të qytetit, në Asklepeion.

Mbiemri Lucceius, i pranuar nga antroponimia romake vonë, nga mesi shek. 1. p.e.s, së pari shfaqet si emri i pronarit të një vile në Butrint[30]. Ndryshe

26 E. Radcliffe, Extra-Ordinary People: Mystai and Magoi, Magicians and Orphics in the Derveni Papyrus." Classical Philology 103, 2008, 16-39.J. B. Rives, Religion and Authority in Roman Carthage from Augustus to Constantine, Oxford, 1995. E. Florian , Das Geheimnis des Hermes Trismegistos. Geschichte des Hermetismus. C.H. Beck, München 2005. Apuleus De Magia (63 v) e tregon këtë eksperiencë në vetë të parë. Sipas tij, nga druri i çmuar i ebanitit, më gdhendën shëmbëlltyrën e vogël të Merkurit.... Unë kujdesem dhe i lutem atij ditët e festave duke i ndezur vajra aromatikë, derdhur verë dhe nganjëherë duke i bërë sakrifica (gjëje të gjallë) Apuleus (De Magia. 63 v.). Duke iu referuar mystai-ve ai i quan ata persona të shenjtë supremë, të cilëve magjia hyjnore u ishte mësuar drejtpërdrejt nga perëndia (De Magia 25, 27)

27 Nëse ky formulim ka parasysh naiskos-in e Medaurit, çka ka pak mundësi, kjo e rendit Medaurin në rang perëndie zyrtare.

28 Dy shkurtimet e tjera me M janë Mam.= Mamercus dhe M'= Manius

29 . Kjo do shpjegonte edhe enigmën e mos mbylljes së poezisë që në fillim dhe lënies vend në bllokun e gurtë për vargje të tjerë. Si i tillë, ndryshimi i metrikës elegjiake të 10 vargjeve të parë në metrikë iambike të 4 vargjeve të fundit dhe ndarja nëpërmjet dy fletëve bliri të egër, synon ndarjen kohore të periudhës para dhe pas fillimit të detyrës së konsullit. Kamuflimi gjatë i emrit real Medaur, ndoshta tregon një përkujdesje të tijën për shmangien e pengesave që mund t'i shkaktonte ky emër për ngjitjen e shkallëve të hierarkisë së lartë.

30 Cic. Att. 1, 3, 3; 1, 5, 5; 1, 17, 11; 5, 20, 8; 5, 21, 13; 6, 1, 23. Fillimisht dhe kryesisht tek Ciceroni (42 herë): Cicero, Ad Atticus 26 (A 2, 1) Favonius... Lucceius (tribum) perdidit. . Favoniusi... humbi fisin e Lucceius-it

BOTIMI

nga trajta e hershme Lucius (Lukius), ai shqiptohet i palatalizuar, me ç dhe jo k, ndërkohë që mendohet se emrat me mbaresë ç i përkasin nomenklaturës ilire[31]. Duke vijuar më tej me emrin, Torquatus është shembulli më klasik i kthimit të cilësorit (agnomen) në mbiemër (cognomen): Sipas Tit Livit, Konsulli Manlius (357 p.e.s), "i hoqi nga qafa kundërshtarit të sapo vrarë kelt torkën dhe e vuri në qafën e tij,... çka i solli atij emrin e nderuar Torquati (Liv. 7. 10)"[32] Torka,[33] gjerdani metalik që mbanin në qafë luftëtarët e shquar (Fig. 11), nuk është pjesë e repertorit romak por e atij protoballkanik dhe për "prijësit Ilirë, të cilët mbanin torka të rënda prej bronzi"[34] ajo ishte simbol pushteti" (Fig. 12). Si i tillë, Torquatus, i kthyer në mbiemër nga cilësori "ai me torkë" (agnomen/cognomen), do ishte dëshmi e origjinës aristokratike prej prijësish delmatë. Së fundi vend-origjina (residentia) Bassianus, për shkak të rrallësisë së saj, zakonisht korrigjohet në Cassianus[35]. Ndërkohë, Tit Livi, krahas Rizonit përmend edhe qytetin tjetër Ardian "Bassania, pesë mile larg Lisso-s (Lezhës)" (168 p.e.s Liv. 44, 30)[36]. Si i tillë ky emër qyteti jep trajtën Bassianus, origjinar nga Bass(i)ania. Si i tillë, gjithnjë duke e pranuar si të mirëfilltë deshifrimin, emri M. Lucceius Torquatus Bassianus do mund të lexohej papritur në formën "Meduari, (i biri) Luç(ius)it me Torkë, (me origjinë nga) Bassiania".



Fig. 11. Torkë, shek. 4 p.e.s.,

Sigla M. Lucceius Torquatus Bassianus në vargun e nëntë mbishkrimeve të hirtë në trishtim, të tipit "Mark Aurel Antonin Augustit, Pontifeks Maksimusit,.. Legati i Legjionit III August... ia dedikon... teatrin bashkë me portikun"[37] dëshmon

31 Sipas rregullave të shqiptimit latin cc para ae, e, oe dhe i, palatalizohej në ç. Si i tillë, emri Lucceius lexohet Luçeius. Për toponiminë me mbaresë ç H. Ceka, Skënder Anamali, Mbishkrime të pabotueme latine të Shqipërisë, BUSHT, ser. Shken. Shoq, nr.1 Tiranë, 1961.

32 Ai nuk e keqtrajtoi trupin e armikut që vrau, përveç se i morri torkën (torque spoliavit) dhe ashtu të spërkatur me gjak e vuri në qafë… Ushtarët i kënduan një këngë për torkën… dhe kjo u kthye në mbiemrin e nderuar Torkuatus (Torquati). Por, kërkimi i origjinës së një luftëtari që Delmacinë e quan atdheun e tij dhe mban emrin e një hyjnie ilire, tek Torkuatët romakë të shek 4 p.e.s. është thjesht një absurd.

33 Torka, nga fjala e spërdredhur, ndoshta e gjen reminishencën e saj në shqipen e sotme, ku torkë quhet tufa e fillit të spërdredhur.

34 J. Wilkes, The Illyrians, Oxford, 1992, 223.

35 Sipas G. Alföldy (Epigraphische Studien, Rheinland verlag, Sammelband, 5, 124) ky emër nuk njihet, të paktën në rrethinat e Rizonit.

36 Bassania urbem quinque milia ab Lisso (Liv 44.30) Duke pasur parasysh se ngjarjet e këtyre viteve Livi veç i përkthen latinisht nga vepra e humbur e Polibit, mundësia e shkrimit të Bassiania-s Bassania do ishte më se normale. Në të vërtetë transkriptimi i toponimeve edhe sot e kësaj dite fiton forma deri ekzotike. Për ilustrim tabela Dogana Qafë Thana, nga ana jugosllave transkriptohej në "Carina Kafatan".

37 Mbishkrimet datohen me saktësi nga vitet përkatës të Mark Aurelit dhe Luc Verrusit në postet e konsullit, tribunit dhe perandorit. Mbishkrimet e viteve 167-168 e.s i dedikohen bashkëperandorëve Mark Aurel dhe Lucius Verus dhe ato të vitit 169, pas vdekjes së Verusit, vetëm Mark Aurelit. Mbishkrimet janë 6 nga Timgadi, (167 e.s Ant. Afr 2 1968, 215, Ant. Afr 1968, 216; 168 e.s. CIL 8, 17867), 4 nga Lambezi (169 e.s, AE 1955, 134; Ant. Afr 2 1968, 219) dhe 1 nga Verukunda (167 e.s. CIL 8, 4208), S. Tourrenc, La dédicace du temple du Génie de la colonie à Timgad, Antiquités africaines (AntAfr) 2, 1968, 219, M. Leglay, S. Tourrenc, Nouvelles inscriptions de Timgad sur des légats de la troisième Légion Auguste, Rev. afr. 21, 1985,125 v.

DOWNLOAD



Fig. 12. Monedhë e mbretit Ballaios (Rizon, shek. 3 p.e.s.) me torkë në qafë

se në vitet 167- 169 ai ishte gjeneral (legatus) i legjionit
III. August, bërthamës elitare ushtarake në Afrikën e Veriut[38]. Një post me rëndësi të veçantë ky, pasi legjioni i siguronte Romës bukën (frumentarius romae) dhe shprehja cinike e Juvenalit panem et circenses, bukë dhe cirk (Satire 10.81), ka kuptimin se Roma është e atij që i siguron falas bukën dhe ndeshjet e gladiatorëve. Mbishkrimet burokratike të mësipërme, tregojnë dhe se ky legjion, veç rolit ushtarak ishte edhe motor i veprimtarisë ndërtuese dhe kulturore në Africa Proconsularis. (Fig. 13)
Vargu i mbishkrimit "i njohur nga... ti o Cezar Marku, nga fama e radhëve të para të betejave të shkuara", tregon se konsulli njihej nga afër me Mark Aurelin, gjasisht nga fushëbetejat e Luftës Parthine (161-167 e.s.) dhe se rrugën hierarkike ai e kishte çarë me shpatë[39]. Mospërmendja në të e bashkëperandorit Lucius Verus të Mark Aurelit, tregon se mbishkrimi u shkrua pas vitit 169 e.s, pas vdekjes së Verus-it.
Përmbledhtas, këto tregojnë se konsulli M. Lucceius Torquatus Bassianus u caktua legat i legjionit III. August nga fundi i luftërave Parthine (167 e.s), detyrë që e kreu deri në vitin 169/170, nga viti 170/1 u emërua konsull (Consuli designato) dhe rreth vitit 171/2 e nisi detyrën e konsullit (Adepto consulatu)[40].

Por, në plotësimet e S. Tourrenc (, 2, 1968, 197-220) vërehet kompleksi i horror vacui, tmerrit nga boshi, me pasojë atribuimin e thuaj tërë ndërtimeve në Africa Proconsularis konsullit M. Lucceius Torquatus Bassianus. Në to vërehen një sërë artificash, si në rastin kur nuk ka vend për legionis III Augusta dhe ai e plotëson thjesht me Aug. Nuk është bindës as plotësimi me titullin legatës pro praetore, pasi këtë titull e mbanin ish konsujt të cilëve u jepej drejtimi i provincës si pretor, ndërkohë që në këto vite Africa Proconsularis varej nga konsulli dhe jo legati.

38 Y. le Bohec, La troisième Légion Auguste. (Études d'Antiquités Africaines), Paris, 1989, 386.

39 Paradoksalisht historia e Mark Aurelit, perandorit që ka shkruar më tepër se tërë perandorët e tjerë së bashku, është copë-copë. Sidonius Apollinaris historian i shek. 5. e.s shkruan se Mark Aureli ka komanduar në këtë luftë legjione të pafund, çka hidhet poshtë nga historianët e sotëm me pretendimin se Apollinaris ka jetuar në shek. e 5, pavarësisht se ata vetë jetojnë në shek. 20, dhe shumë nga librat asaj kohe sot kanë humbur. Betejat e përmendura në mbishkrim logjikisht, i përkasin luftërave Parthine (161-167 e.s), pasi në luftën Markomane (167/8 e.s.) M. Lucceius Torquatus Bassianus dëshmohet legat i legjionit III August në Lambezia.

40 Kjo përkon me largimin nga kjo detyrë në vitin 169 e.s të konsullit Titus Sextius Lateranus (Ludwig Friedlaender, George Wissowa, Darstellungen aus der Sittengeschichte Roms in der Zeit von Augustus bis zum

DO NOT COPY



Fig. 13. Parakalimi i Legjionit të Huaj francez në Praetorium-in e Lambezias

Ekzekutimi dhe Damnatio Memoriae e konsullit, i ngarkohet unanimisht kurrizit të perandorit Commodus (161 - 192 e.s), fundit të sundimit të tij, madje edhe vitit 193 e.s, çka supozon rikthimin nga bota tjetër të shpirtit të Commodus-it të ekzekutuar dhe mallkuar, thjesht për të ekzekutuar dhe mallkuar M. Lucceius Torquatus Bassianus -in. Argument për këtë është se mes pafundësisë së personave (alios infinito) të dënuar nga Commodus, ka edhe një Lucceius Torquatus[41] dhe se në Hefes paskesh jetuar auditi i financës (logisteia) M. Lucceius Torquatus. Kjo do kishte kuptimin se tërë gurgdhendësit e Africa Proconsularis-it dhe skribët e perandorisë u mobilizuan për të fshirë emrin e një auditi në prag të pensionit.

Ndonëse ekzekutimi dhe mallkimi i kujtimit të konsullit do t'i shkonte shumë më mirë për shtat Commodus-int, që i veshur si Herkuli vriste Koloseut deri strucër dhe xhirafa të pafajshme, dhe jo filozofit Mark Aurel, ekzekutimi dhe vulosja e konsullit armik i Romës nuk ka si të kërkohet kasaphanave ordinere të Commodus-it, por në një akt shumë më serioz.

Nëse ai nuk është dënuar për proselitizëm, në konsideratë do vinte grushti aksidental i shtetit nga Gaius Avidius Cassius në vitin 175 e.s, i cili përfundoi me vrasjen e tij dhe të birit dhe dënimin me Damnatio Memoriae[42]. Me Cassius-in, konsulli Medaur do të ketë qenë i njohur nga luftërat partine, por në vitin 172 Cassius-it i jepet imperium-i[43], plotfuqishmëria për provincat lindore, çka de facto

Ausgang der Antoine, Leipzig, 1922 , 3, 144). Një sërë shkrimesh e përcaktojnë largimin e Lateranusit në vitin 167 duke e datuar gabuar mbishkrimin në vitin 167. Për M. Lucceius Torquatus Bassianus, Bassianus RE 13 1561, s.v. Bassianus dhe mjaft saktë, ndonëse me disa rezerva B. E. Thomasson (Die Statthalter der Römischen Provinzen Nordafrikas von Augustus bis Diocletianus, Lund, 1960).

41 Argumentimi mbështetet në Historia Augusta, sipas së cilës mes pafundësisë së personave (alios infinito) të ekzekutuar në vitet e fundit të sundimit të Commodus-it përmendet edhe ish konsulli Lucceius Torquatus, dhe se në këtë kohë në Hefes dëshmohet një audit financash (logisteia) me emrin M. Lucceius Torquatus. Ndërkohë Lucceius Torquatus ka me dhjetëra, mes tyre dhe 2-3 konsuj, dhe auditi i Hefesit figuron si i tillë që nga "nga 160 e vonë" (RE 13, 1927, 1561-2), kur M. Lucceius Torquatus Bassianus ishte legat i legjionit III August.

42 Grushti i shtetit i Gaius Avidius Cassius, i cili nisi aksidentalisht kur u kujtua se Mark Aureli kishte vdekur, përfundoj me vrasjen e tij dhe të birit, shpalljen armik i Romës dhe Damnatio Memoriae-n e tij (Dio Cass, 9.72).

43 A. Birley, Marcus Aurelius: A Biography, London and New York, 2001, 174

ZONOTOPY

e bënte konsullin Medaur vartës të tijin. Në ngjarjet e grushtit të shtetit përmendet prefekti i Kapadokisë së largët si besnik i Mark Aurelit, por nuk përmendet konsulli i Africa Proconsularis ngjitur me Egjiptin, ku shpërthyen aksionet ushtarake, përmenden 7 legjione të Afrikës, por asnjëherë nukli elitar, legjioni i III August, ndërkohë që emri i këtij legjioni ç'gdhendet si dënim nga tempulli i Silvanit në Asclepeio (Fig. 14);
vargu i pandalur i 174 konsujve të Africa Proconsularis shkëputet për 23 vjet pikërisht nga konsulli Medaur dhe në këto vite zhduket pa gjurmë edhe kryeprifti i provincës dhe i pari i



Fig. 14. Prishja e emrit të legjionit III August në ballin e Asclepeion-it

Këshilli Provincial Apuleius. Të tëra këto tregojnë se këtu diçka ndodhi dhe këto ndodhi do mund të shpjegoheshin vetëm me errësirën e Damnatio Memoriae-ve, të cilat si gropat e zeza kozmike që përpinë dritën e tyre, përpinë tërë gjurmët historike.

Poezia

Poezia e cila ndahet pakuptueshëm në dy pjesë, i përket një pene të kultivuar, e cila krijon ritëm dhe kadencë nëpërmjet alternimit të silabave të gjata me silabat e shkurtra dhe kalon lehtas nga një metrikë në tjetrën. Dhjetë vargjet e pjesës së saj të parë i përmbahen metrikës elegjiake (hexametron/ pentametros), ndërsa katër vargjet e pjesës së dytë metrikës iambike (pentametros).
Nëpërmjet vargjeve të poezisë konsulli Medaur dialogon me hyun Medaur në vetë të parë me Ti (Te, Tibi, Tuus), si në anglishten e vjetër ku forma Ti (Thou) rezervohej vetëm për zotin. Nëpërmjet bashkëbisedimit natyral, pa metafora dhe ndërmjetësime, në të përcillet me sinqeritet të papërsëritshëm afria dhe adhurimi për hyun. Ky adhurim i veçantë del edhe më tepër në pah nga mospërfillja e treguar ndaj Perëndisë Mars dhe Perandorit Mark Aurel, të cilët thirren si dëshmitarë gjyqi, thjesht për të dëshmuar bëmat e konsullit, pa ua shpërblyer këto dëshmi me asnjë epitet miklues dhe pa u bërë as më të voglën katikule.
Raporti i dy Medaurëve, konsullit me hyun,

DO NOT COPY

zhvillohet në një korrelacion të çuditshëm, ndoshta narcisist për Freud-in, në të cilin portretizimi i hyut bazohet në cilësitë dhe mbresat vetjake të konsullit. Befasinë vrastare të ushtës, që e kupton se po të ngulet pasi të është ngulur dhe përshpejtimin e kësaj ushte nga frenimi i beftë i revanit të kalit, mund ta dinte vetëm një ushtar-kalorës profesionist.

Figuracioni i poezisë është huazuar nga poeti më brilant romak, Virgjili: Ashtu si në Eneidë perëndia Mars nuk thirret Mars, por Gradivo, pararojë betejash (Aen. 3.35), ndërsa kali nuk quhet equo, por sonipes, i këmbëzhurmshëm (Aen. 4.1); nëse në Eneidë frenimi i fortë shkumëzon kalin (sonipes ac frena ferox spumantia Aen. 4.1.299), në poezi frenimi i fortë e ngre kalin vrik në erë (v. 5, 6. succussus sonipes cui surgit in auras). Ndërsa në Eneidë "shtatorja shpirtërohet përmes frymëmarrjes së butë" (v. 5,6. spirantia mollius aera vivos ducent Aen. 6. 847-51), në poezi konsulli i drejtohet hyut me fjalët "imazh i gjallë frymor i hyut të atdheut" (v.16. respirantem faciem patrii numinis) dhe sërishmi si në Eneidë, ku "ushta tjetër shungullon pranë tëmthit" (aliud summa telum librabat ab aure. Aen. 9. 417), hyu Medaur me të "djathtën pranë tëmthit, vdekjen shungullon" (v. 6. altera dum letum librat ab aure manus). I tërë ky figuracion, kadenca dhe troku dinamik, krijojnë ndjesinë sikur tre përmasave të hapësirës u është shtuar përmasa e katërt, e kohës së ndalur çuditshëm, ajo e shigjetës së sapongulur në pemë, e cila nuk lëviz më para, por vibron me zukamë letale.

Por, a do mundej i vetëm një ushtarak profesionist, i cili kishte arritur në hierarkinë e lartë falë shpatë dhe jo penës, të dinte përmendësh Virgjilin, të kalonte lirshëm nga metrika elegjiake në atë iambike dhe të njihte me hollësi ritualet e mystoive dhe postulatet e Hermes Tresmegystos-it ? Vështirë se po, dhe këtu nga mungesa absolute e dokumentacionit për diçka që absolutisht nuk kish si të mos pasqyrohej në dokumentacion, fut në lojë personazhin më fantastik dhe kontrovers të shek 2. e.s, Lucius Apuleius Madaurensis-in (Fig. 15): Autorin e kryeveprës botërore Metamorfosis dhe thurrësin e poezive lajkatare për konsullin Orfitus; pasanikun që shpenzon me shpejtësi marramendëse 2 milion sesterca (7 milion dollarë) dhe shet rrobat e trupit për të marrë pjesë në seancat e mystoive; të akuzuarin në gjyq si Sokrati për sajim perëndish të reja (simalucrum alicuis dei, App. De magia, 25.5) dhe që për pak sa nuk u ndëshkua si Sokrati me dënim kapital dhe që një vit më tej u nderua me shtatore në Kartagjenë, Madaura dhe Konstantinopol (Florida 16, Apolog. 445, 494, Aug. Epistula.). Personin për të cilin thuhet se po të mos kish qenë Krishti, feja e re do ish themeluar prej tij dhe për të cilin Lactantius-i, filozofi që e shtyu Konstantinin e Madh drejt krishterimit, pranon tërthoras se mrekullitë e tija ishin më të mëdha se të Krishtit (Lactant. Div. Inst. 5.3.)[44].

Marrëdhëniet mes konsullit Medaur dhe Apuleius-it nuk përmenden askund, por në vitin 164 e.s. Apuleius u zgjodh Sacerdos Provinciae, kryeprift i Africa Proconsularis (Apul. Florida 16. 38 Aug. Epistulae 138.19), i parë i këshillit të provincës (concilium provinciae) dhe prift i Eskulapit (Apul. Florida 18.38, Aug.Epist. 138.19.9). Ndërkohë në vitet 167-169 konsulli Medaur zgjidhet legat i Legjionit III August dhe në 170/71 konsull, guvernator i provincës. Kjo dhe lind pyetjen retorike: A mund të mos ta njihte fare kryeprifti dhe i pari i këshillit të provincës legatin dhe guvernatorin e provincës dhe a do mund të ndërtonte ky guvernator në Asclepeion tempullin e Medaurit pa dijeninë e priftit të Eskulapit[45]?

Dëshmi e njohjes së tyre është poezia. Teknikat

44 Apuleio, De magia, 25. 5 Florida 16, Apolog. 445, 494, Aug. Epistula. De Mundo, 729. S. Harrison, Apuleius. A Latin Sophist. Oxford and New York, 2000, 16-20.

45 B. Todd Lee, Apuleiu's Florida, Berlin, 2005 Nëse mospërmendja e konsullit Medaur do kërkohej në indiferencën e Apuleius-it ndaj pushtetit qendror, poezitë e tij panegjirike për konsujt dhe fjalia mbyllëse e laudatum-it për konsullin e shkuar: Ah! Severianus, e tërë provinca do psherëtijë thellë kur ti të largohesh (Apul. Florida. 9), do ta përmbysnin këtë mendim. Duke iu përmbajtur argumentum ex silentio-s, në kriminalistikë fshirja e çdo gjurme është gjurmë.

DO NOT COPY



Fig. 15. Kontorinat, medalje përkujtimore me bustin e Apuleius-it, prerë në Konstantinopol (shek. 4-5)

poetike të Apuleius i përmbahen figuracionit arkaik; protagonisti trajtohet prej tij me plasticitet tredimensional; bashkëlidhja me poetin e preferuar arrihet nëpërmjet fjalëve dhe metaforave të tija të veçanta. Ndërkohë, poeti numër një për të është Virgjili[46], të cilin në gjyq e reciton përmendësh, ndërsa në vetëm 50 faqet e Florida-s e risjell 10 herë. Të tërë këta elementë janë të pranishëm në poezinë e Medaurit: Në vetëm 16 vargjet e kësaj poezie sillen dy fjalë krejt specifike të Eneidës (sonipes, Gradivo) dhe nga pesë figuracionet e përdorur që të pestë janë marrë nga Eneida.

Nisur nga idetë dhe bindjet e Apuleius-it dhe postulatet e Hermes Tresmegystos-it të tij, më saktë nga postulati 1. i Tabula smaragdina-s, Tabelës së Smeraldtë, duket sikur nis e ftillohet edhe kuptimi i ndarjes së pakuptimtë të poezisë në dy pjesë, theksimi i kësaj ndarjeje me fletët e blirit dhe kapërcimi nga një metrikë në tjetrën.

Në të vërtetë, të dy pjesët reflektojnë, thuaj në refleks pasqyre, njëra tjetrën: Po i njëjti portret i hyut Medaur me kalë të ndalur duke shungulluar ushtën, po i njëjti konsull Medaur, po i njëjti adhurim i tiji. Parë me një optikë të till,ë poezia nuk është më një mesazh i thjeshtë, por mesazh hermetik në kuptimin e dyfishtë të kësaj fjale: i mbyllur hermetikisht dhe hermetik sipas kodeve hermetike të Hermes Tresmegistus-it, kryemjeshtër i të cilëve ishte prifti i Eskulapit Apuleius-i, autori i Perfect Sermon- predikimit të përsosur. Sipas postulatit 1. të Tabula smaragdina-s "Ajo që është poshtë, i korrespondon asaj që është lart dhe ajo që është lart i korrespondon asaj që është poshtë dhe kjo sjell mrekullinë e Njësendit[47]". Kuptimi i poezisë, hymnit kushtuar Medaurit, do ishte më i qartë nëse do shtonim këtu edhe postulatin e Eskulapit (CH 17), prift i të cilit ishte Apuleius,

"Adhuroji imazhet, pasi edhe ato kanë formën e tyre si të botës lëndore".

Dhe në këtë mjedis të muzgët dhe mistik, të parë nga imagjinata me libacion vere dhe tymra vajrash aromatikë, rite dhe formula kabalistike, vjen e mbështillet me vello misterioze koincidenca e pastër e përkimit të emrit Drinn të burimit të Lambaesia-s me Drinn-in që sipas Scylax-it rridhte në Rizon; e emrit Medaur të hyut, emrit Medaur të konsullit dhe mbiemrit Madaurensis të Apuleius-it; e mbiemrit të panjohur Bassianus të konsullit që fill pas ardhjes së tij shpërthen në emra kryepriftërinjsh Dielli deri dhe mbiemra perandorësh[48]. Por, kryesorja, tej koincidencave dhe misticizmit, qëndron adhurimi i Konsullit Medaur për hyun Medaur të Rizonit Ajakid, respekti dhe përulja ndaj botës shpirtërore, traditës, dokeve të vendit të tij të lindjes. Krejt i gjallë dhe i paasimiluar edhe pas 4 shekujsh nën commonwealth-in romak.

46 S. Mattiaci, Appuleio e i poeti arcaici, 1, Firence, 1986,163

47 Quod est inferius est sicut quod est superius, et quod est superius est sicut quod est inferius, ad perpetranda miracula rei unius. Et sicut res omnes fuerunt ab uno, meditatione unius, sic omnes res natae ab hac una re, adaptatione (Corpus Hermeticum 17).

48 E ëma e Elegabalit ishte bassianus

DO NOT COPY

Apollon BAÇE

THE ANATOMY OF THE INSCRIPTION OF MEDAUROI

DO NOT COPY

God is not the mind, but the reason why the mind is.

God is not the soul, but the reason why the soul is.

God is not the light, but the reason why the light is.

Corpus Hermeticum (Apuleius)

The inscription of Medaurus (CIL. 3.1716) is a verse dedication, which the consul of the Roman province Africa Proconsularis, native from the Illyrian city of Rhizon (fig. 1), dedicates to the Illyrian divinity Medaur. The inscription was discovered in the middle of the 19th century in Lambaesa (Tazoult, Algeria), the military capital of Africa Proconsularis (fig. 2), in the Asclepeion (fig. 3), the sacred area of the hero and half god of medicine Asclepius.

From the inscription was chiseled away, letter after letter, the name of the giver, which testifies to his tragic fate: The execution and the curse of memory, the Damnatio Memoriae. According to the Orwellian paradigm "He does not exist. He never existed", his name was deleted from all the inscriptions, acts and history books. This process, similar to that of retouching photographs in the communist era (fig. 5), today is considered as censorship, but for the Romans it was much more. The posthumous punishment (poena post mortem) by curse of memory caused the rupture of the transcendental life, which continued through the persistence of memory (perseverantia memoriae). When the memory was cursed, he could no longer persevere and the afterlife was extinguished. This leads to Orwell's other paradigm "Who controls the past, controls the future. Who controls the present, controls the past".

Although the disintegration of any trace was very rarely applied, in this case it was applied with a rare scrupulosity, eradicating the name through deep grooves in the stone (fig. 6). Meanwhile, the inscription itself survived thanks to the taboo for not violating the holy names of the god Mars and the Emperor Mark Aurelius. Excluding the truncated inscription "M. Lucceius Torqua..." in the lost office of the weight measurement in El-Kantara, the consul's name remained in the dark for 18 centuries. His full name was deciphered only 50 years ago by L. Leschi [1]

Although one of the most cited inscriptions, it was treated as a grape luster which grains are cut to consume them elsewhere, without focusing on the interaction of the elements and the message. Meanwhile the Medaurus inscription manages

1 *Translated by the autor. Literary editing by Dr. Lori E. Amy, professor at Georgia Southern University.
L. Leschi, Autour de l'Amphithéâtre de Lambèse, Libyca, 1954, 171-181.

to sprain within just 14 verses a mysterious story like that of Da Vinci Code: cabalistic and bloody like the history of the Code, but unlike the Code, a

1 Moenia qui Risinni Aeacia, qui colis arcem/ Delmatiae,
nostri publice lar populi,
Sancte Madaure domi e(t) sancte hic, nam/
templa quoq(ue), ista
Vise, precor, parva magnus in effigia,
5. Succussus laeva sonipes cui surgit in auras
Altera dum letum librat ab aure manus.
Talem te consul iam designatus in ista
Sede locat venerans ille tuus […….]
Notus Gradivo belli vetus ac tibi, Caesar
10 Marce in primore rarus ubique acie.

---

11 Adepto consulatu [……]
Tibi respirantem, faciem patrii numinis,
Hastam eminus quae iaculat refreno ex equo,
14Tuus Medaure, dedicat Medaurius.

true, not fictional story. Seen in this light and given the scarcity of authentic sources for the Illyrian world, the inscription is a historical document in the highest degree of authenticity and a spiritual message in the highest degree of sincerity.
In the absence of faithful translations,[2] I was obliged to retranslate (with utmost care) the inscription

The inscription has been associated with the sculpture of the divinity. If it had been a relief or altoreliev, it would have been engraved on a piece

(Thou, who take care of)
1 The walls that make the aeacidian Rhizonus the stronghold
of Delmacia, public Lar of our people,
Sacred Medaurus home and Sacred here, Take care (also) for this temple here,
Mighty (as you are) in the small effigy
5. The left- hand breaks the horses rising in the air
The other near the temple, the death away flings.
Such (as you are), the already appointed consul,
Worshiping in this site puts yours [……]
Recognized from prior wars by Mars and you Caesar
Mark, everywhere first in the rare first ranks of the battle.

---

11. He (……) who has taken the consulate
To the breathing vision of the native land divinity,
Throwing away the spear from the restrained horse
Thou Medaurus, dedica thine Medaurus.

with the inscription and, what's more important, according to cabalistic credulities, the thaumaturgy performs only by three-dimensional imageries.[3]
Based on the descriptions, the god Medaur is identified with the "Thracian Knight". But while the latter is a hunter with patera, the cup of the sacrifice to the souls (fig. 6), Medaur is a warrior. This brings him closer to the knights of Selca and Gostilie

2 To illustrate, the last verse "tuus Medaure, dedicat Medaurius"is translated "To you Medaurus, your Medaurian dedicates this spear."

3 Appuleius, De Magia 27. H. Hiller, Lexikon des Aberglaubens, München 1986.

DO NOT COPY

belt buckles (fig. 7), but again the notion is very different: While the knights of Selca and Gostilie are presented with heavy armors, Medaur is conceived as a free spirit, that can't be endangered by anyone. This shift of different concepts also separates Medaur from the iconography of the Greco-Roman deities, where the gods in the fight scenes with the ancient gods or giants carry defensive armor. The iconography fits well only with the relief of a cup from Rhizon (fig. 8), in which the bridged horse stands abruptly on the air with the first legs, while the rider with no protective armor throws his spear raised near the temples.

The deity Medaur. The earliest name of an Illyrian god is that of Medaur. Initially it appears in an inscription from the 3rd century BC by Rizon, in a dedication to him by the peripoliarchos, the military commander of the city (περιπολιαρ[κον]/..... Μεδαύρου). [4] At the 2nd century AD, the name Medaur is mentioned in three other inscriptions. The first, also from the Asclepeion of Lambaesa, is again a dedication to "Medauro Augusto Sacrum (CIL 8. 2642). At the other inscription, in the coastal cave at Leuca (southeastern Adriatic, fig. 9) the name of Medaur, along with that of the Illyrian god Redon, appears as a ship's name. For the last time, it emerges in the slightly blunted form Medeur in a Germanic inscription from North Africa. The date of this inscription, around the 5th century AD, shows the survival of the cult of Medaurus even when Christianity became the official religion.

The inscription does not even bother to cover the shoulder of Medaur with the mantel of interpretatio romana. Otherwise, it is prude on the Illyrian origins of Medaur, preferring the original form "delmatiae" of the totem animal of the tribe, delme or sheep, to the official Roman "dalmatiae" form.

Meanwhile, the inscription does not call Medaurus god, which for the Roman faith would mean god for a particular domain. But, though Medaur is glorified with the highest possible superlatives: magnificent/magnus, consecrated/Augusto, and sacred/sancte, he is listed in the most perplexed species of Roman religion, that of "lares",[5] mixed with the matchless categories of spirits (di manes, genius, penates). [6]

The classification of Medaurus not as a god, but as a lar, whose reminiscence of original Etruscan name "laza" with the name "lazore" of the Albanian "summer day" pagan feast, is neither a coincidence nor an accident. The stelae and altars of the cosmopolitan Lambaesia, vivify with the names of most exotic gods: from Torehoboldi Deo to Dea Africa (fig. 10), and if the soldiers did not hesitate to call their deities gods, much less would hesitate the commander of these soldiers. As such, the reason is quite different.

The Proto-Indo-European beliefs tasked the lares to take care of everything, from health to harvest and from fertility to war, but only within an assigned boundary, soever family or city, but never outside of it. As such the designation "public lar of our people" (nostri publice Lar populi), display a different structure from the polytheistic Greco-Roman structure of many gods. Namely a monotheistic structure with a single totemic god, specific to each ethnic unit.

The apex of the inscription is the telesma (τέλεσμα), the prayer "Divine in the Fatherland, Divine here too. I pray thou: Take care of this temple, magnificent as you are in the effigy." This prayer, according to the secret rituals of mystoi, marks the finale of the mystical initiation, the moment when,

4 W. Kubitschek, Mitteilungen der k. k. Zentral-Kommission zur Erforschung und Erhaltung der Kunst- und historischen Denkmale, 2. 1903, 170-173.

5 A. Mastrocinque, s.v. Laren, Der Neue Pauly (DNP). 6, Stuttgart 1999.

6 G. Hetzberg, De diis romanorum patriis sive de Larum atque Penatum, Halae, 1840. Further qualification " Lares publici ", inserts Medaur into the subspecies of the "public lares", guardian deities, mentioned only in plural, lares (Larium publicorum Plin NH, 21.8; Lares publici, AE 1980, No. 56/4th century BC, Laribus publici CIL 6, 456) and never in singular.

DO NOT COPY

after libations, sacrifices, and the pronouncement of cabbalistic formulas, the creator of the object (Consul Medaur) sermon the subject (the divinity Medaurus) to unload his magical force to the object (the effigy of Medaur). After this, the effigy of Medaur begins to exercise the Medaur's potential in the required environment.

This unprecedented act neglects the rule of lares not to cross their borders and attributes to Medaurus universalism. And that is a pure sincretism, a first step towards the proselytizing, the changing of the religion. Meanwhile the wording "I pray thou: Take care of this temple as well" establish the unprecedented paradox of taking under the tutelage of a lar a roman official god. Turning this official god into subaltern subject of a heathenish deity.

M. Lucceius Torquatus Bassianus. According to the Roman anthroponymy, the name M. Lucceius Torquatus Bassianus separates into the name/ praenomen M.; paternity /patronimicus Lucceius; qualifier Torquatus, converted to surname (agnomen/cognomen) and the home country/ residentia Bassianus.

1. By the Romans, the first letter M. deciphers in Marcus and nothing else. In the first part of the inscription, when M. Lucceius Torquatus Bassianus was appointed consul, but had not yet begun his duty (consuli iam designatus), he continued to play the role of M/Markus, like Mark Aurelius. But, in the second part, when he had started his duty (adepto consulatu) and as the number one of the province he was not afraid of anyone, he decoded the initial M. differently: The Verse " Thou Medaurus, dedicates it thine Medaurus", indicates that the decryption of M. was not Mark, but Medaur, like the deity Medaur. Accordingly, the signing with his real name Medaur, should be regarded as a showdown, because the inscription was displayed in Lambaesia 's most frequented environment, at the Asclepeion.,

2. The surname Lucceius appears in the Roman anthroponomy late, at the middle of the 1st century BC, first in southern Illyria, in Butrint.[7] Unlike the antecedent form Lucius (Lukius), it is pronounced palatalized, "ch" (like Albanian ç), and not k, while the names ending with "ç" belongs to the Illyrian nomenclature.[8]

3. The name Torquatus is a classic example of the conversion of the qualitative adjective into cognomen: According to Titus Livius the Consul Manlius (357 BC), "stripped the torque from the neck of the newly killed Celtic adversary and put it in his neck.... That gave him the honorable name Torquatus (Liv. 7. 10)." The torque,[9] the large neck ring in metal, was not a part of the Roman but of the Celtic and Illyrian repertory, whose chieftains wore torches as a symbol of power (fig. 12).[10] As such, Torquatus, "the one with the torque" is a symbol of the aristocratic origin.

4. Residentia Bassianus, because of its rarity, has been corrected to Cassianus.[11] But Livius, beyond the Rhizon mentions "Bassania, five miles from Lisso/Lezhë (Liv. 44, 30),"[12] not far away from Rhizon. As such, the full name M. Lucceius Torquatus Bassianus could suddenly be read as "Medaur, son of Luçius with torque, originary from Bassania".

Damnatio Memoriae. Nine inscriptions of the boring type "Pro salute Imperatoris Caesaris Marci Aurelii Antonini… legatus… legio III Augusta…

7 Cicero, Ad Atticus 26 (A 2, 1) Favonius... Lucceius (tribum) perdidit.

8 According to the Latin pronunciation cc before ae, e, oe and i, is palatalized to ç (ch). Consequently the name Lucceius should be read Luç[ch]eius. About Illyrian words ending with ç(ch) H. Ceka, S. Anamali, Mbishkrime të pabotueme latine të Shqipërisë, BUSHT, ser. Shken. Shoq, nr.1 Tiranë.

9 The word torque/twisted, finds its reminiscence in the present-day Albanian, where the bundle of twisted yarn is called torque (torkë)

10 J. Wilkes, The Illyrians, Oxford, 1992, 223.

11 G. Alföldy, Epigraphische Studien, Rheinland verlag, Sammelband, 5, 124

12 Bassania urbem quinque milia ab Lisso (Liv 44.30)

DO NOT COPY

dedicavit" [13] prove that in the years 167-169 Medaurus was the commander of the III Legion, the core of North Africa's military elite.[14] A very important position, since the legion provided Rome with grain (frumentarius romae) and the cynical Juvenal's expression "panem et circenses" (Satire 10.81), means that Rome belongs to the one who provides the bread and Gladiator fights. The above-mentioned inscriptions also indicate that this legion, in addition to its military role, was also the engine of construction and cultural activity of Africa Proconsularis. (fig. 13)

The verse "Recognized from prior wars by… you Caesar Mark", specify that the consul was closely acquainted with Mark Aurel, probably from the battlefields of the Parthinian Wars (161-167 AD). The omission of the Mark Aurel's co-emperor Lucius Verus, indicates that the inscription was written after the death of Verus at 169 AD.

The execution and the "condemnation of memory" of consul, is unanimously charged to the emperor Commodus (161-192 CE), at the end of his reign, even in 193 AD. What presupposes that the executed Commodus (192 AD), reappeared from hell, simply to execute and invoke to Damnatio Memoriae the consul M. Lucceius Torquatus Bassianus .Although the execution of the consul fits much better to Commodus, who killed till ostriches and giraffes at Colosseum, as to the philosopher Markus Aurelius, the execution and the labeling of him as the enemy of Rome is not to be sought in the ordinary carnages of Commodus, but in a much more serious act.

If he had not been convicted for proselytizing, would be considered the coup d'état by Gaius Avidius Cassius (175 AD), which ended with his murder and condemnation of his memory (Dio Cass, 9.72).[15] In fact the coup events mention the prefect of the very distant Cappadocia, but there is no mention of the consul of Africa Proconsularis, adjacent to Egypt where the military action broke out. There are mentioned seven African legions, but never the elite nucleus of the army, Legio tertia Augusta, meanwhile its name was chiseled away from the temple of Silvanus in the Asclepeion of Lambaezia (fig. 17). The uninterrupted string of 174 consuls of Africa Proconsularis, was broken off for 23 years exactly at the time of the consulate of Medaurus and during these years Apuleius, the high priest of the province and the chairman of the Provincial Council, disappeared without a trace. All that shows that something was happen and these happenings could be explained only by the darkness of the Damnatio Memoriae, which, like the black holes swallows their own light, swallows up the traces of all historical facts

The poetry belongs to a highly cultivated pen, which creates rhythmus and cadence by alternating long syllables with short syllables, easily passing from one metric to another. The ten verses of the first part are written with elegiac metric (hexameter), while the four verses of the second part belong to iambic metric (pentametron).

Through the verses of poetry the consul Medaur dialogues with the deity Medaur in first person (Te, Tibi, Tuus), as in the old english translations of the Bible, where the pronoun "thou" is exclusively addressed to God, using you in other places. Through simple natural conversation, without metaphors and interferences, is forwarded with an unrepeatable sincerity the affinity and the deep

13 The inscriptions are 6 from Timgad, (167 es Ant. Afr 2 1968, 215; Ant. Afr 1968, 216; 168 es CIL 8, 17867), 4 from Lambezia (169 es Ant. Afr 1955, 134; Ant. Afr 2 1968, 219) and 1 by Verukunda (167 es CIL 8, 4208), S. Tourrenc, The Temple of the Génie de la Colonie à Timgad, African Antiquities (AntAfr) 2, 1968, 219; M. Leglay, S. Tourrenc, Nouvelles inscriptions de Timgad sur légés de troisième Légion Auguste, Rev. afr. 21, 1985,125 v.

14 Y. le Bohec, La troisième Légion Auguste. (Études d'Antiquités Africaines), Paris, 1989, 386.

15 In the year 172 AD to Cassius was given the imperium, the omnipotence, of the eastern provinces (A. Birley, Marcus Aurelius: A Biography, London and New York, 2001, 174), which de facto did the Consul Medaur his subordinate.

DO NOT COPY

worship for the deity. This particular worship is still more highlighted by the neglect shown to God Mars and the Emperor Markus Aurelius, which are called as the witnesses of the trial, simply to testify the consuls' deeds, without any complimentary epithet and without the slightest praise.

The relationship of both Medaurs, the deity and consul, develops into a strange, perhaps narcissistic correlation, in which the portrayal of the deity is based on the consul's own qualities and impressions. The murderous suddenness of the spear, realizing that it's intruding only after it is intruded and the fling of the spear from the sudden braking of the horse's fury, only a professional rider could know.

The figuration of poetry is borrowed from the most brilliant Roman poet, from Virgil: As in the Aeneid, the god of war Mars is not called Mars, but Gradivo/vanguard in battlefield (Aen. 3.35) and the horse is not called equo, but sonipes, noisy feet (Aen. 4.1); in Aeneid the strong braking foams the horse (sonipes ac frena ferox spumantia Aen. 4.1.299) and in the poetry the strong brake raises the horse promptly on the air (v. 5, 6. succussus sonipes cui surgit in auras).

Whereas the Aeneid phrase "the vivified sculpture through the gentle breathing" (v. 5,6. spirantia mollius aera vivos ducent Aen. 6. 847-51), in poetry the consul address to the deity the words "the breathing vision of the native land divinity". (v.16. respirantem faciem patrii numinis). As in Aeneid, where "the other spear roars near the temple" (aliud summa telum librabat ab aure. Aen. 9. 417), Medaur with "the other (hand) near the temple, the death away fling" (V. 6. altera dum letum librat ab aure manus). All this creates the feeling that to the three dimensional space is added the fourth dimension of the strange stopped time, of the arrow just penetrate on the tree, which don't move forward, but vibrates with a lethal drone.

Apuleius. Could a professional soldier, a man who reached the top position thanks to the sword but not to the pen, memorize Virgil, move freely and elegantly from the elegiac to iambic metrics? Could he know the details of the mystoi rituals and the postulates of Hermes Tresmegystos? Hardly yes and here we come to the argument ex silentio, to the absolute lack of testimonies for something that absolutely happened.

This joins to the game the most fantastic and controversial character of 2nd century, Lucius Apuleius Madaurensis (fig. 18), the author of the worlds masterpiece Metamorphosis, the rich man who spends for a very short time 2 million sesterces, about 7 million dollars, and after that sells his clothes for attending mystois sessions. Accused as Socrates of fabricating new gods (simulacrum alicuis dei, App. de magia, 25.5), escaping capital punishment for a bit and in the following honored with statues in Cartagena, Madaura, and Constantinople (Florida 16, Apolog. 445, 494, Aug. Epistula). The person who was said if not have been the Christ, the new religion would be founded by him. For which Lactantius, the philosopher who converted Constantine the Great to Christianity, alluded that his miracles were greater than that of Christ (Lactant. Div. Inst. 5.3.). [16]

The relationship between Consul Medaurus and Apuleius is nowhere mentioned, but in the year 164 AD Apuleius was elected Sacerdos Provinciae, high priest of Africa Proconsularis (Apul. Florida 16. 38 Aug. Epistulae 138.19), head of the provincial council (concilium provinciae), and priest of Asclepios (Apul. Florida 18.38, Aug. Epist. 138.19.9). Meanwhile in the years 167-169 Consul Medaur was commander of legio III Augusta and in 170/71 governor of the province. This raises the rhetorical questions: is it possible that the head of the provincial council and high priest of the province not to know the governor of the province and could the consul Medaur erect the temple of Medaurus in Asclepeion without the knowledge of the priest of Asclepios ?

16 S. Harrison, Apuleius. A Latin Sophist. Oxford and New York, 2000, 16-20.

DO NOT COPY

The indirect proof of their close acquaintance is the poetry, its Virgilian figuration, meanwhile for Apuleus the poet number 1 is Virgil which he recites by heart at trial and reproduce 10 times in only 50 Florida pages. [17]Based on Apuleius's beliefs, "What is below corresponds to what is above and what is above corresponds to what is below and this make the miracle of the thing-in-itself (Corpus Hermeticum 17)," the meaning of the meaningless division of poetry into two parts and skipping from one metric to another becomes understandable. The two parts reflect in a mirror reflex one another:

The same portrait of the deity Medaurus with the braked horse whistling the spear, the same consul Medaurus, the same worship of the deity Medaurus. Seen with such optical, the poetry is not a simple message, but a hermetic message in the dual sense of the word: hermetically sealed and hermetic according to the codes of Hermes Trismegistus, whose chief master was Apuleius, for me, the author of Perfect Sermon.

And in this mystical twilight, amidst wine libations, fragrances of aromatic oils and cabalistic words, arrives wrapped in mysterious veils the coincidence of the name Drinn of Lambaesia's spring and Drinn river which flowed near Rhizon (Scylax 23); the divinities name Medaur, consuls name Medaur and Apuleius surname Madaurensis; the surname Bassianus of the consul and the surname Bassianus of high priests of the Sun and emperors. But most important, beyond coincidences and mysticisms, is the worship of the Consul Medaur for his home divinity Medaur, the deep respect to the spiritual world and traditions of his native land. Quite alive and unassimilated even after 4 centuries in the Roman commonwealth.

DO NOT COPY

17 S. Mattiaci, Appuleio e i poeti arcaici, 1, Firenze, 1986,163

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Prof. Dr. Valter SHTYLLA

KULLA E SAHATIT E QYTETIT TË OHRIT

DO NOT COPY

Qyteti i Ohrit me gjithë rrethinat, i ndërtuar buzë liqenit me të njëjtin emër përfaqëson një nga trevat me të spikatura natyrore dhe kulturore-historike, jo vetëm për Maqedoninë, por edhe për të gjithë rajonin e Ballkanit. Malet përqark, brezi i gjelbër dhe ujërat e shumtë që rrjedhin në liqen e rrethojnë qytetin e Ohrit me një panoramë piktoreske tepër të veçantë. Përveç pasurive dhe bukurive natyrore, kjo trevë është mjaft e pasur edhe në monumente të trashëgimisë kulturore-historike nga të gjitha periudhat. Lyhnidi antik përgjatë rrugës së njohur romake Via Egnatia përfaqësonte një stacion të rëndësishëm të kësaj rruge. Kalaja e Samuilit, bazilikat paleokristiane, kishat bizantine si Shën Klementi, Kaneo, Zaumi, Shën Naumi etj. janë monumente nga Mesjeta në këtë trevë. Dhe së fundi, shembuj të spikatur të arkitekturës popullore qytetare, ndër të cilat spikat banesa Robevi, si edhe objekte fetare osmane si xhami dhe teqé, apo objekte publike si hamamet, çezmat dhe kullat e sahateve përfaqësojnë vlerat e Mesjetës së vonë në rrethinat e Ohrit.




Fig. 1. Pjesa e sipërme e Sahat Kullës së Ohrit



DO NOT COPY

Fig. 2. Pamje e plotë e Kullës së Sahatit në Ohër

Epiqendra e Ohrit turistik mbetet Çarshia e Vjetër e qytetit, ose pazari karakteristik i mbushur me njësi tregtare dhe me specialitete tradicionale të qytetit. Brenda tij ndodhen edhe dy nga xhamitë më të vjetra të Ohrit.

Në fundin e Çarshisë, majtas në kodër, në vendin e quajtur "Deboj", mbi Kishën e Shën Marisë, ndodhet Kulla Mesjetare e Sahatit, e vendosur në anën lindore të Kalasë së Ohrit. Kjo kullë ka vetëm një orë rrethore me anën e dukshme të saj nga Çarshia. Fusha e orës përmban shifrorë me 12 ndarje me numra romakë. Ora orientohet nga lindja e diellit dhe shihet nga Çinari (kroi) dhe nga të gjitha drejtimet. Për rreth dy shekuj, nga viti 1726 deri në vitin 1912, kambana e saj binte në çdo orë sipas sistemit "alla turka" të orëve, duke qenë kështu, një bashkëshoqëruese e ngushtë e aktivitetit të tregtarëve në Çarshi, ndërkohë që lajmëronte banorët e zonës për oraret e zakoneve dhe riteve fetare. Që nga koha kur u ndërtua e deri në vitin 1979 sahati përmbante një mekanizëm austriak. Më pas, ky mekanizëm u zëvendësua me një mekanizëm të ri të prodhuar nga fabrika e orëve "Insa" në Beograd.

Në vitin 1965, Kulla e Sahatit e Ohrit u dogj. Djegia shkaktoi dëme në të gjithë elementët e drunjtë të saj, si shkallët dhe pjesa e sipërme me konstruksion druri. Në aspektin proporcional, në dy të tretat e lartësisë së saj, kulla shfaqet si një paralelopiped brenda të cilit qarkohen shkallët e drunjta. Lartësia e pjesës së gurtë arrin 7.1 m ndërsa baza ka formën e një katrori me brinjë 4.06 m. Muret me trashësi 0.77 përbëhen nga gurë gëlqerorë të lidhur me llaç. Mbi kullën e gurtë ngrihet pjesa e drunjtë me lartësi 2.5 m, në të cilën është vendosur ora e rrumbullakët. Në mesin e çatisë prej llamarine të kullës lartësohet një kubik prej dërrase, me dritare në të katër faqet, në të cilin është vendosur kambana e sahatit. Edhe ky konstruksion është i mbuluar me kapuç llamarine. Lartësia e përgjithshme e kullës nga toka deri në majën e kambanores është 12.3 m.

Pas djegies së vitit 1965, Kulla e Sahatit e Ohrit u restaurua në vitin 1979 nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës së Ohrit, me projektin e hartuar nga ark. Todor Paskali, një nga restauratorët më të njohur të Entit Qendror të Monumenteve në Shkup. Gjatë punimeve të 79-ës, në kambanën e sahatit u zbulua një mbishkrim në turqishten e vjetër, i shkruar me shkronja arabe. Mbishkrimi thotë:

"Sajbia (personi-zotnia) i plotë i të mirave është SHKODRANI ÇAUSH DERE SULEJMAN AGA në muajin e Rexhepit 1138 H". E dhuron më 05.III. - 06.IV.1138 (pra më 1726).

Nga ky mbishkrim rezulton se Kulla e Sahatit të Ohrit është ndërtuar dhe i është dhuruar qytetit të Ohrit nga një fisnik nga qyteti i Shkodrës. Bamirësia ishte një praktikë e njohur për ndërtimin e objekteve publike gjatë Mesjetës. Kulla e Sahatit e qytetit të Ohrit sot me orë elektronike, me siluetën e saj dominon mbi Çarshinë karakteristike të Ohrit. Ajo paraqet një element arkitektonik me proporcione të goditura mur guri — konstruksion druri. Ky ndërtim pasuron gamën e objekteve kulturore-historike të qytetit të Ohrit, i cili, për vlerat e tij natyrore dhe historike, më 5 shtator 1980 ka marrë nga UNESCO statusin e Pasurisë Kulturore Botërore të Njerëzimit.

Literatura e konsultuar

1. Dr. Nebi Dervishi, "Etnokultura e Fushëgropës së Ohrit 1", Tetovë 2005, f. 169

2. Viktor Plevnes, "Konservacija i Rekonstrukcija na Saat – Kulata vo Ohrid", Lihuid 6, p. 285

3. Mirjana Dimovska Čoloviќ, "Saat – Kulite vo Republika Makedonija", Skopje 2008, p. 31.

UNESCO Copy

Prof. Dr. Valter SHTYLLA

CLOCK TOWER OF THE CITY OF OHRID

DO NOT COPY

The city of Ohrid with its surroundings, built by the lake of the same name, represents one of the most prominent natural and cultural-historical sites, not only for Macedonia, but also for the entire Balkan region. The surrounding mountains, the green belt and the many waters flowing into the lake surround the city of Ohrid with a very unique scenic view. In addition to its richness and natural beauty, this area is also rich in monuments of cultural-historical heritage from all periods. Ancient Lyhnides along the famous Roman road Via Egnatia represented an important station of this road. The epicenter of tourist Ohrid remains the Old Town Bazaar, or the characteristic bazaar filled with commercial units and traditional town specialties. Inside are two of Ohrid's oldest mosques. At the bottom of the Bazaar, to the left of the hill, in the place called "Deboj" above St. Mary's Church, is the Medieval Clock Tower, located on the east side of the Ohrid Fortress. This tower has only a circular clock, with its visible side by the Bazaar. The clock field contains 12-digit Roman numerals. The clock is orientated by sunrise and is seen from the Cinar (spring) and from all directions. For about two centuries, from 1726 to 1912, its bell rang hourly under the "alla turka" clock system, being a close companion of the merchants' activity in the Bazaar while alerting the locals for schedules of religious customs and rituals. From the time it was built until 1979 the clocktower contained an Austrian mechanism. Subsequently, this mechanism was replaced with a new one produced by the “Insa” watch factory in Belgrade. In 1965, the Ohrid Clock Tower was burned down. The burning caused damage to all of its wood elements, such as stairs and the upper part of the timber structure. Proportionally, at two-thirds of its height, the tower appears as a paralelopiped within which the wooden stairs are circulated. The height of the stone reaches 7.1 m while the base has the form of a square with 4.06 m ribs. The 0.77 thick walls consist of mortar bound limestone. Above the stone tower rises the wooden part 2.5 m high, in which is placed the round clock. In the middle of the tower's steel roof is a wooden cube, with windows on all four sides, on which the clock bell is placed. This structure is also covered with sheet metal. The total height of the tower from the ground to the top of the belfry is 12.3 m. After the burning of 1965, the Ohrid Clock Tower was restored in 1979 by the Ohrid Institute for the Preservation of Cultural Monuments, with a project designed by the arch. Todor Paskali, one of the most renowned restorers of the Central Monument Authority in Skopje. During the work of the year 79, an inscription in the old Turkish language, written in Arabic letters, was discovered at the bell tower. The inscription reads: "The complete Sajbia (person-sir) of goods is SHKODRANI CHAUSH DERE SULEJMAN AGA in the month of Rexhepi 1138 H". Donated on 05.III. - 06.IV.1138 (hence 1726). This inscription shows that the Ohrid Clock Tower was built and donated to the city of Ohrid by a nobleman from the city of Shkodra. Charity was a popular practice for building public facilities during the Middle Ages. The clock tower of the city of Ohrid today with the electronic clock, with its silhouette dominates the characteristic Ohrid Bazaar. It represents an architectural element with the proportions of a hit stone wall and a wooden structure. This construction enriches the range of cultural and historical sites of the city of Ohrid, which for its natural and historical values, on September 5, 1980 received from UNESCO the status of World Cultural Heritage of Humanity.

monumentet
58/2019

Andi REMBECI

ZHVILLIMI ARKITEKTUROR DHE URBANISTIK NË KORÇË GJATË SHEK. XV-XIX[1]

DOKTORATURA

Qyteti[1] i Korçës është qendra më e dendur demografike në skajin juglindor të luginës homonimike, një nga më të pasurat dhe më të rëndësishmet e Shqipërisë së sotme jugore. Të dhënat e para lidhur me ekzistencën e qytetit të Korçës burojnë nga periudha bizantine. Gjin Muzaka, në një dorëshkrim të tij me titull "Historia dhe gjenealogjia e shtëpisë Muzaka" e përmend Korçën si qytet që përfshihej, rreth fundit të shek. XIII (1280-1319), në zotërimin e stërgjyshit të tij Andrea[2]. Fillesa osmane e qytetit të Korçës mund të konsiderohet bërthama urbane që themeloi Iliaz Beu më 1495. Sipas regjistrimit të parë të bërë nga administrata osmane menjëherë pas pushtimit, në vitet 1431 - 1432[3], Korça paraqitet si një kala e banuar me 26 shtëpi, të gjitha të krishtera. Shënimet kronike që ruhen në kodikun e Korçës dhe të Selasforit[4], na njoftojnë se rreth fundit të shekullit të XV, Iljaz[5] Mirahor Evel beut iu dhurua nga Sulltan Bajaziti, nëpërmjet 4 fermanëve[6], një

1 Dëshiroj t'i shpreh falënderimet e mia të përzemërta prof. dr. Pirro Thomos, jo vetëm për këshillat dhe sugjerimet e tij për këtë punim, por edhe për materialin e vyer ilustrues qe më aq bujari e vuri në dispozicion nga arkivi i tij personal fotografik. Ky artikull shërben si një shenjë modeste mirënjohjeje për punën dhe kontributin e madh që Profesor Pirro Thomo ka dhënë në evidentimin, studimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë sonë kulturore.

2 «Breve memoria de li discendenti de nostra casa Musachi», scritta da D. Giovanni Musachi, despoto dell' Epiro», në: Charles Hopf, *Croniques Gréco-Romanes, inédites ou peu xonnues*, publiées anev notes et tables généalogiques, Berlin (Wieidmann, 1873), 270-340. Kronisti Gjin Muzaka duke ju referuar më 1510 paraardhësit të tij Andrea Muzaka, që mbante titullin e "despotot të Epirit" përmend se ky i fundit në vitet e zotërimit të tij (1280-1319) «… possedi e signoriggi la citta di Corizza, per insino a villa nomine Savoiana, e anche lo casale di Viola…». Dijetari Charles Hopf e zbuloi këtë dorëshkrim në vitin 1863 në bibliotekën Brancacciana të Napolit dhe e botoi më 1873 në veprën e tij Croniques Greco-Romanes.

3 *Defteri i regjistrimit të Përmetit dhe Korçës i vitit 1431.* Përkthyer nga Vexhi Buharaja, **p**ërgatitur për botim nga Eduart Caka, Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike – Instituti i Historisë, 2018.

4 Dorëshkrimi i kodikut të Korçës dhe Selasforit gjendet sot në Arkivin Qendror Shtetëror të Tiranës dhe ruhet në fondin Kodikët e Shqipërisë F. 488, D. 99. Kodikut është në proces botimi nga autori i këtij artikulli. Për një analizë shteruese kodikologjike dhe paleografike të Kodikut të Korçës nr. 99 shih Andi Rembeci, "The Codex of the Holy Metropolis of Korça and Selasphorus: Edition and Historical Documentation (17th – 19th centuries)", Master's thesis in Greek, Ionian University 2009, ku paraqitet edhe e gjithë bibliografia studimore e deriatëhershme mbi këtë kodik. Po ashtu, shih edhe Sinani Sh., "Një nga kodikët e Korçës", në *Kodikët kronografikë të Shqipërisë,* bot. Naimi, Tiranë 2014, f. 383-410. Për një botim të mëhershëm të kodikut, shih Petraq Pepo, Zija Shkodra, *Materiale dokumentare për Shqipërinë juglindore të shek. XVIII-fillimi i shek. XX: kodiku i Korçës dhe i Selasforit*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1981.

5 Për jetën e Iliaz beut shih Andi Rembeci, "The Codex of the Holy Metropolis of Korça and Selasphorus: Edition and Historical Documentation (17th – 19th centuries)", Master's thesis in Greek, Ionian University 2009, dok. nr. 161/1. Shih, po ashtu,Petraq Pepo, «Dy dokumente mesjetare mbi Shqipërinë. Berati i Bajazitit II dhe Vakëfnameje e mirahor Iliaz beut», *B.Sh.Sh*. nr. 3, Tiranë 1956, 271-272; «Περὶ Κοριτσᾶς», *Πανδώρα*, nr. 219 (1859), vëll. 18, 175-177, Παναγιώτης Αραβαντινός, *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου εἰς τρία μέρη,* E. I. Νικολαΐδου (ed), Ιοαννινα: E.H.M., 1984), vëll. 1, 111, shën. 1.

6 Këta fermanë ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror të Tiranës, Fondi: 143, Dosje: 180, 181, 182, 183, 184. Fermani i parë, i datës 1484, përmban fshatrat e parë Leshnja dhe Vikthkuq që ju dhanë si mylk Iliaz beut. Dymbëdhjetë vjet

pjesë nga zona e Korçës. Iliaz Beu u vendos në vendbanimin mesjetar të Peshkëpisë (Episkopi)[7], e përbërë nga 10-15 shtëpi, ku gjendej edhe kisha e vjetër e Shën Parashqevisë, të cilën Iljaz beu e ktheu në xhami[8]. Përveç xhamisë (1495)[9] (Fig. 1),



Fig. 1. Xhamia e Ilias bej Mirahorit

ai ngriti po aty edhe katër ndërtesa fetaro-sociale: një teqe, një imaret me hapësira ndihmëse, një medrese dhe një hamam. Kalaja dhe instalimet e Iliaz Beut përbënë bërthamën e zhvillimit urban të Korçës në periudhën osmane (Fig. 2).




Fig. 2. Zhvillimi urbanistik i Korçës gjatë shek. XVI

Gjatë luftërave kundër osmanëve në gjysmën e dytë të shekullit XIV, zona e Korçës pësoi shkatërrime të mëdha, njëra prej të cilave ishte rrënimi i qytetit të famshëm të Selasforit, gjurmët e të cilit mendohen

DO NOT COPY

më vonë këto fshatra u kthyen në statusin e tyre të mëparshëm (timare), për shkak të vështirësive që Iliaz beu ndeshi me mbledhjen e të ardhurave; ata u zëvendësuan përmes një fermani të dytë (viti 1497) me fshatin Peshkëpi (Episkopi) që përfshinte dy pjesë. Firmani i tretë në radhë kronologjike (1497) përcakton kufijtë e fshatit Peshkëpi (Episkopi), i cili shtrihet midis Mborjes, Barçit dhe Vulgarecit, d.m.th., në të njëjtin territor ku shtrihet qyteti i sotëm i Korçës. Së fundi, firmani i vitit 1503 konfirmon përsëri, pas kërkesës së Iliaz beut, sundimin e tij mbi fshatrat Panaret dhe Trembicka. Shih: Pepo Petraq, «Katër dekrete (fermane) të Sulltan Bajazitit II për Mirahor Iliaz Beun», *Studime Historike* 3 (1967): 217-238.

7 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis,* dok. nr. 179/1.

8 Rembeci, The Codex of the Holy Metropolis, dok. nr. 161/1.

9 Bëhet fjalë për kishës e Shën Parashqevisë, të cilën Iliaz beu e ktheu në xhami. Mirëmbajtja e xhamisë sigurohej nga të ardhurat e siguruara nga vakëfet. Data e ndërtimit të xhamisë sipas kodikut të Korçës dhe të Selasforit "αριθμεί δε η ανέγερσις αύτη μέχρι σήμερον *392* έτη" ("nga ngirtja e saj deri më sot numërohen 392 vjet (1587)", është e pasaktë. Sipas mbishkrimit të xhamisë me një tekst të shek. XIX, jepet si datë e ngritjes viti 1495. Shih AQSh, F. 141, D. 622, Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis,* dok. nr. 161, 161/1. Petraq Pepo, "Katër dekrete (fermane) të Sulltan Bajazitit II për Mirahor Iljaz Beun", *Studime Historike* 3 (1967): 189. Machiel Chiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri 1385-1912,* Tiranë: Mileniumi i Ri, 2012, 211-212. Aleksandër Meksi, "Ndërtimet e kultit mysliman", në: A. Meksi et al. *Historia e arkitekturës në Shqipëri*, Tiranë, 2016, 531.

se ndodhen në fshatin e Zvezdës, pranë Korçës[10]. Me përfundimin e fushatave pushtuese të Osmanëve, Korça nisi të ndiqte një zhvillim të ngadaltë, por të qëndrueshëm, si në aspektin demografik, ashtu edhe në zhvillimin ekonomik. Gjatë shek. XVI, Korça shfaqet në një hapësirë të përcaktuar banimi, e përbërë nga pjesa e rreth kalasë, e quajtur Varosh dhe nga Kasabaja, që u formua në vendin e fshatit Peshkëpi (Episkopi).

Gjatë shek. XVIII dhe gjysmës së parë të shek. XIX, Korça, e gjendur në kryqëzimin e rrjeteve të rëndësishme rrugore, përmes të cilave lidhej me

Që nga viti 1853, Korça bëhet seli e kajmekamit me vendim të Portës së Lartë, që synonte të zvogëlonte fuqinë e bejlerëve lokale të Kosturit dhe të forconte sigurinë në zonë[13]. Si pikë lidhëse mes pashallëqeve të Manastirit dhe Janinës, Korça fitoi një rëndësi të përveçme tregtare. Për shkak të panairit të saj tregtar javore, Korça tërhiqte një numër të madh njerëzish dhe aty funksiononin vatra të shumta tregtare[14]. Të krishterët e qytetit banonin në lagjen e Varoshit, ndërsa myslimanët jetonin në Kasaba. Varoshi përbëhej nga 1.250 shtëpi, ndërsa Kasabaja kishte jo më shumë se 800[15].



Fig. 3. Pazari i vjetër i qytetit

zonat lindore, veriore dhe jugore[11], u bë një nga qendrat më të rëndësishme politike, ekonomike dhe kulturore të juglindjes së Shqipërisë. Në këtë zhvillim kontribuoi edhe rënia dhe shkatërrimi i qendrave të rëndësishme fqinje, të tilla si Mborja dhe veçanërisht Voskopoja në vitin 1769[12].

Nga fundi i shek. XIX, Korça kishte 800 dyqane, megjithëse tregu i saj ishte shkatërruar tre herë nga

10 Pepo, Shkodra, *Materiale dokumentare,* 3. Sneragov I., "Turskoto vladiçestvo preska za kulturnoto rasvitie", në: *Ballkanski narodi*, Sofia 1958, 7. Për qytetin e Selasforit dhe Devollit, shih gjithashtu Αραβαντινός, *Περιγραφὴ τῆς Ἠπείρου,* vëll. 1, 108, 100-101 dhe 130-131.

11 Rembeci, The Codex of the Holy Metropolis, dok. nr. 37-39.

12 Γκ. Αρς, *Η Αλβανία και η Ήπειρος στα τέλη του ΙΗ καὶ στις αρχές του ΙΘ αἰώνα,* (translated in Greek by An. Dellas), Athens: Gutenberg, 1994, 63-66. Apostolos Vakalopoulos, *History of Northern Hellenism, Epirus*, Thessalonica: Kyriakides 1992, 170-171, Pepo, Shkodra, *Materiale dokumentare,* 9-10. Ἰωακείμ Μαρτινιανός, *Συμβολαὶ εἰς τὴν ἱστορίαν τῆς Μοσχοπόλεως. Ἡ Ἱερὰ Μονὴ τοῦ Τιμίου Προδρόμου κα τὰ τὸν ἐν αὐτῷ κώδικα (1630-1875),* ἔκδ. Δημητρίου Δημητράκου, Ἀθήνα 1939, 52-53.

13 Vakalopoulos, *History*, 283-284.

14 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, 82-84. Zija Shkodra, *Les corporations albanaises,* Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë (Tiranë)-Instituti i Historisë, 1973, 78-79.

15 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, 61-66, dok. nr. 178/2. Shih, gjithashtu, Zija Shkodra, "Rreth kumtesës "Të dhëna mbi Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut sipas një dokumenti të shek. XVII", *BShSh* 4 (1958), 266 shën. 45. Thimi Mitko, "Disa shënime rreth Korçës", në: *Vepra,* Tiranë: AShSh-IKP, 1981, 538. Πλουμίδης Γ., «Ὁ ἑλληνισμὸς τῆς ρου στὶς παραμονὲς τῆς ἀπελευθέρωσής του», *Δωδώνη* 6 (1977): 358.

DO NOT COPY

zjarri (1822, 1858, 1879) (Fig. 3). Produktet më të rëndësishme vendase ishin qilimat, shtrojat e leshta të krevateve dhe opingat. Për më tepër, në qytet funksionon një furrë e famshme gëlqereje dhe një mulli i madh me avull[16].

Zhvillimi shumëvjeçar i Korçës që nga shek. XV deri në fund të shek. XIX, ndikoi drejtpërdrejt në zhvillimin urban të qytetit, i cili kaloi në dy periudha. Periudha e parë, nga shek. XV deri në mesin e shek. XIX, karakterizohet nga kalimi gradual i qytetit nga një qendër e vogël administrative në një qendër artizanale dhe tregtare që po fitonte vazhdimisht tipare urbanistike. Periudha e dytë, e përcaktuar në gjysmën e dytë të shekullit XIX, paraqet kulmin e zhvillimit ekonomik dhe demografik të qytetit, gjë e cila solli edhe zgjerimin e shtratit urbanistik dhe zhvillimin e qytetit në hapësira të reja[17].

Përqendrimi i vazhdueshëm i popullsisë në qytet gjatë shek. XVII, si rezultat i sistemit tashmë në shthurje të timarit, solli kondensimin urban të hapësirave të banimit dhe bashkimin e lagjeve në një njësi banimi kompakte (Fig. 4)[18].

Rrjeti rrugor i parregullt dhe gjarpërues i Korçës, i cili ende ruhet sot në pjesën e vjetër të qytetit,



Fig. 4. Qyteti i Korçës 1767. Gravurë

16 Thomo, Korça, *urbanistika dhe arkitektura*, Tiranë: Morava, 2012, 201-271. Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis,* dok. nr. 36, 37, 162.

17 Thomo, Korça, 105-133, 135-200. Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis,* 85-86.

18 Thomo, Korça, 46-52.

dëshmon për natyrën e pavarur të zhvillimit urban. Ndërkohë, vendndodhja e largët e dy njësive të reja të banimit dëshmon nga njëra anë për mënyrën e formimit dhe të zhvillimit të qytetit dhe, nga ana tjetër, për dallimi social dhe kryesisht fetar, i cili është i zakonshëm për qytetet mesjetare[19].

Në shek. XVIII (Fig. 5), si rezultat i shpërbërjes së sistemit feudal ushtarak osman, u shfaq prodhimi artizanal urban, por paralelisht rritet




Fig. 5. Zhvillimi urbanistik i Korçës, shek. XVI-XVIII

edhe shfrytëzimi i bujqve nga çifligarët. Kushtet e vështira gjithnjë e në rritje, bënë që një pjesë e madhe e bujqve të zhvendoseshin drejt Korçës, duke e rritur popullsinë urbane në rreth 3.000 deri në 3.500 frymë[20]. Gjatë procesit të gjatë të ndryshimit, kalaja kishte humbur me kohë rëndësinë dhe funksionalitetin e saj dhe nuk citohet më në burimet historike të kohës[21]. Si rezultat, Varoshi tashmë zhvillohet si një njësi e pavarur banimi.

Kishat[22] nuk ndikuan në peizazhin urban të qytetit

19 Shkodra, *Les corporations albanaises,* 28-30.

20 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis,* 61-73. Leake W.M, *Travels in northern Greece,* v. I, London 1835, 337. Beaujour F., *Voyage militaire dans l'Empire Ottoman,* τ. 1, Παρίσι 1998, 5.

21 Ballauri R., «Histoire de l'essor de la ville de Korçë durant les XVIIIe-XIXe siecles», *Studime Historike* 1 (1988): 101.

22 Andi Rembeci, "Kodiku i mitropolisë së Korçës dhe Selasforit (Shek. XVII-XIX): Të dhëna për kulturën në zonën

DO NOT COPY

të vjetër. Kisha metropolitane e Burimit Jetëdhënës ishte ngritur në anën verilindore të qytetit (Fig. 6). Vetëm më vonë, rreth mesit të shek. XIX, me




Fig. 6. Kisha Burimi Jetëdhënës. U ndërtua më 1707 në kohën e Mitropolitit të Korçës dhe Selasforit Joasaf dhe u pikturua nga vëllezërit korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi më 1720.

zgjerimin e qytetit dhe me ngritjen pranë saj të institucioneve arsimore dhe të selisë metropolitane, kisha e Burimit Jetëdhënës shndërrohet në një pol tërheqës, rreth të cilit u zhvilluan zonat e reja me popullsi të dendur[23]. Po ashtu, kisha e Shën Gjergjit[24] (Fig. 7), e Shën Marisë[25] dhe e Trinisë së Shenjtë gjendeshin jashtë qytetit, ndërsa dy kishat e tjera, ajo e Profetit Ilia dhe e Shën Thanasit, ndodheshin të vendosura në kodrat që kufizojnë qytetin në lindje.

Ndërtimi i varrezave të reja në fund të shek. XVIII dhe instalimi i ujësjellësit në fillim të shek. XIX luajtën një rol të rëndësishëm në formimin urbanistik të pjesës së vjetër të qytetit. Varrezat e reja, që u vendosën në anën veriore të qytetit, pranë kishës së Shën Marisë, zgjidhën problemin e varrosjeve arbitrare të të vdekurve në oborret e kishave. Leja e autoriteteve osmane për të ndërtuar varrezat u arrit përmes këmbënguljes dhe ndihmës së komunitetit. Në kodikun e Korçës dhe të Selasforit, në lidhje me këtë, lexojmë: "*Në vitin shpëtimtar njëmijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë (1799), atyre që luftuan për pjesën e të vdekurve të Varoshit të Korçës dhe atyre që u bënë bashkëpjesëmarrës në këtë kauzë me aspra a me fjalë a me mundim, i përjetshëm kujtimi, tri herë*"[26]. Për më tepër, sjellja



Fig. 7. Kisha madhështore e Shën Gjergjit, e ndërtuar në Lagjen e Re (Jenimahalla)

e ujit të pijshëm në shtëpitë e banimit, u realizua me instalimin e çezmave dhe të puseve, të cilat ishin të ndara ose private. Çezmat e përbashkëta ishin të vendosura në kryqëzimin e rrjeteve rrugore të qytetit, ndërsa ato private ndodheshin në oborret e rrethuara me mure[27]. Kodiku i Korçës dhe i Selasfori ruan këto të dhëna në lidhje me instalimin e ujësjellësit: "*Mehmet pasha nga Plasa, përpara 80 vjetësh (rreth 1800), ndërtoi ujësjellësin dhe e*

e Korçës", *Monumentet* 52 (2011-2014): 97-124

23 Thomo, Korça, 46-52.

24 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 7: «Το ρουφέτοιων τῶν Ταμπάκων ἐπλερωσαν καὶ ἐφθηάστηκεν, ὸ καλντερμᾶς ἀπὸ τὴν ἐκλησίαν τοῦ μεγάλο μάρτηρος Γεωργίου μέχρη στὴν χῶρα». ("Esnafi i Tabakëve pagoi dhe rregulloi kalldrëmin nga kisha e Martirit të Madh, Gjergjit, deri në qytet")

25 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 161/1: «τήν Μονήν τῆς Παναγίας, νῦν δέ ἐκκλησίαν τοῦ Νεκροταφείου ἔχουσαν θέσιν μεμονωμένην είς μικράν τινα ἀπόστασιν τοῦ Βαροσίου» ("Manastiri i Shën Marisë, tanimë kisha e varrezave, gjendet i veçuar, në një distancë të shkurtër nga Varoshi").

26 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 24: "Εν ἔτῃ ˏαψϟθ$^{\omega}$ 1799 ὅτις ὑπερμάχεσεν διά τό μέρετιτῶν | ἀποθανόν των τοῦ Βαροσίου τῆς Κορυτζὰς, καί ὅσοι ἦσαν συγγοινω|νοὶ τῆς αὐτῆς αἰτίας καὶ ἔδωσαν ἄσπρα, και με λόγον καὶ ἐκόπηκεν | αἰωνία τοὺς ἡ μνήμη τρεῖς».

27 Thomo, Korça, 46-52.

DO NOT COPY

solli ujin nga një vend pranë Drenovës, të quajtur Drenica, 20 minuta larg Korçës. E shpërndau ujin në shtëpitë, të cilat i ndërtuan çezmat vetë. Ndërsa bijtë e tij, Ismail pasha bashkë me të vëllezërit, shpenzuan për mirëmbajtjen e ujësjellësit"[28].

Këto vepra të komunitetit të Korçës patën ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin urbanistik të qytetit. Shtëpitë më të hershme të ruajtura në pjesën e vjetër të qytetit, sipas studiuesve[29], datojnë nga fundi i shek. XVIII. Mungesa e ndërtesave më të vjetra në qytet është shpjeguar me faktin se në Korçë nuk ka pasur më herët një klasë të konsoliduar feudalësh ose tregtarësh të mëdhenj, siç ndodh në qytete të tjera shqiptare, si Gjirokastra, Berati dhe Shkodra, ku feudalët dhe tregtarët e mëdhenj kishin filluar të ndërtonin shtëpi të mëdha e të gurta para shek. XVIII[30]. Forma arkitekturore e shtëpive të shek. XVIII kryesisht plotëson nevojat e kohës, pa zënë sipërfaqe të mëdha ndërtimi, duke ju përgjigjur shumicës së funksioneve të përditshme.

Në tipologjinë e banesave, gjatë shek. XVIII dhe në fillimin e shek. XIX përhapje të gjerë njohën shtëpitë me hajat, që karakterizoheshin nga hapësira të kufizuara, përmasa të vogla, mungesa e elementeve dekorative dhe përdorimi i katit përdhes si hapësirë banimi[31]. Një informacion i rëndësishëm për përbërjen tipologjike të banesave të periudhës në fjalë na jep kodiku i Korçës dhe e Selasforit. Nga testamenti i priftit zotit Manushi[32], i cili është edhe më i vjetri i regjistruar në kodik (1725), përveç informacionit mbi gjendjen financiare të familjes, përftohen gjithashtu të dhëna të vyera për pjesët përbërëse të vendbanimit. Djali i parë trashëgon "*shtëpinë e madhe, me çardak, oborr dhe pus, bashkë me truallin që ka prapa dhe me hajatin*"[33], djali i tretë "*çardakun me një odë dhe me dy ahuret, edhe [pjesë] nga oborri*"[34], djali i katërt "*një odë me qilar nga shtëpia e Halilit, me oborr nga të dyja anët*"[35] dhe djali i pestë "*i dha qilarët dhe odën që ndodhet nga [ana e] Kostan Kalotës me gjithë oborr*"[36]. Bëhet, pra, fjalë për dy shtëpi: shtëpia e vogël (Fig. 8) me hapësira të kufizuara,




Fig. 8. Banesë e shtresës së ulët të shoqërisë

28 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 161/1: "ὁ ἐκ Πλιάσσας | Μεχμέτ Πασσιάς πρό 80 ἐτῶν ἔκαμε τό ὑδραγωγεῖον καί μετεκόμισε τά ὕδατα ἀπό μέρος πλη|σίον τοῦ Δρενόβου Δρενίτσα καλουμένου εἰς ἀπόστασιν 20 λεπτῶν τῆς Κορυτσᾶς, διένειμε δέ οὕτως | τά ὕδατα εἰς τάς συνοικίας, ἅτινες ἀνήγειραν τάς βρύσεις ἐξ' ἰδίων, οἱ δέ υἱοί αὐτοῦ Ἰσμαήλ | Πασσιάς μετά τῶν 'δελφῶν αὐτοῦ ἐδαπάνων πρός διατήρησιν τοῦ ὑδραγωγείου".

29 Thomo, Korça, 53-59. E. Riza, B. Strazimiri, «Aperçu de l'architecture de la ville de Korçë», *Monumentet*, 3 (1972): 120.

30 Riza, Strazimiri, Aperçu de l'architecture, 120.

31 Pirro Thomo, «Vlerat urbanistike-arkitektonike të qytetit të Korçës dhe vënia në mbrojtje e tyre», *Monumentet* 1 (1988): 6.

32 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 24.

33 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 42: "*τό ὀσπήτιον τό τρανόν μέ τό τζαρδάκι καί τόν ὀ|βορόν καί πηγάδι, καί μὲ τόν τόπον ὃν ἔχει ἔπισθεν καί χαϊάτι*".

34 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 42: "*τὸ τζαρδάκι μὲ ἕναν ὀντάν, καί μὲ τά δύο | τά ἀχούρια, καί ἀπὸ τόν ὀβορόν*".

35 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 42: "*τό ὀσπήτιον τοῦ Χαλίλη ἕναν ὀντάν μέ κελλάρι, καὶ ὀβορόν ἀπό τά δύο | μέρη*".

36 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 42: "*κελλάρια, καί τόν ὀντάν ὁποῦ εἶναι πρός τόν Κῶνσταν Καλό|τα μὲ ὅλον τόν ὀβορόν*".

DOKTORATURA

përbëhet nga dhoma me oxhak, që destinohet për qëndrimin e familjes gjatë dimrit dhe nga dy qilarë, që shërbenin njëri për strehim të kafshëve dhe tjetri për ruajtje të ushqimit (Fig. 9). Sipas prof. Pirro




Fig. 9. Tjetër banesë e shtresës së ulët të shoqërisë në Varosh

Thomos, studiuesit kryesor të urbanistikës së qytetit të Korçës, kjo lloj banese përfaqëson vendbanimin e klasës së ulët shoqërore dhe dëshmon një fazë specifike në zhvillimin historik të banesës së vjetër të Korçës[37] (Fig. 10.1-10.2).

Nga ana tjetër, shtëpia e madhe, e cila është banesa tipike aristokrate e kohës, përfaqëson llojin e banesës së hapur dhe përbëhet nga një ndërtesë dykatëshe me hajat (Fig. 11). Përpara shtëpisë ka një oborr me një pus dhe në pjesën e prapme të shtëpisë ekziston një vend i hapur. Ky vend duket se ka qenë hapësirë e kultivueshme ose është përdorur si lëmë, pasi në kodik përmendet edhe një rast tjetër, ku pranë shtëpisë ekzistonte një lëmë: "*I dhuroi... kishës lemën, e cila gjendet në krah të*




Fig. 10.1-10.2 Banesë e tipit të hapur

shtëpisë së tij"[38]. Vendet e banimit nuk përmenden në testament, por, sipas studiuesve, ato gjenden në katin e parë[39]. Sidoqoftë, shfaqja e hajatit nga fundi i shek. XVII - fillimi i shek. XVIII si element kryesor në përbërjen arkitektonike të banesës, përkon me kushtet mbizotëruese ekonomike feudale, ku pronësia e tokës dhe, veçanërisht, çifligjet ishin burime të rëndësishme të ardhurash[40].

37 Thomo, Korça, 52-55.

38 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 69: "*Ἀφιέροσεν... εις την εκλησιαν το αλονη όπου πλαι ἀποκειτο οσπιτη του*".

39 Thomo, Korça, 52-55. Ballauri R., «Burimet historike për ndërtimet e bëra gjatë shek. XVIII-XIX», *Minumentet* 2 (1985): 110.

40 Γκ. Αρς, *Η Αλβανία και η Ήπειρος*, 49-53. Gjithashtu, sipas P. Thomo, në shtresat shoqërore që ishin

DO NOT COPY



Fig. 11. Banesë me çardak dhe me pus, 1842

Për këtë arsye hajati u bë kriter karakterizues i banesës ("*shtëpia me çardak*") ose pjesë e përllogaritshme në pasuri.

Gjatë gjysmës së parë të shek. XIX, në Korçë vërehet një zhvillim mbresëlënës në tregti dhe në zejtari[41]. Ky zhvillim shkonte paralelisht me ndryshimin e mënyrës së jetesës dhe pati një ndikim të drejtpërdrejtë në përshtatjen e karakterit tipologjik dhe arkitektonik të banesave me kërkesat e reja[42]. Në këtë kontekst, oborret e shtëpive u kufizuan dhe hapësira e lirë u përdor për ndërtime shtesë, duke sjellë si rezultat dendësimin urbanistik të pjesës së vjetër të qytetit. Gjithashtu, rritja e kërkesave të ndërtimit dhe zbatimi i kufizuar i tyre në banesat e vjetra solli shfaqjen e mysafirhanes (Fig. 12.1-12.2), e cila lehtësoi barrën e ndërtesës brenda banesës. Mysafirhanetë u ndërtuan pranë shtëpive të vjetra dhe ishin të destinuara për pritjen e të huajve, por në të njëjtën kohë hapësirat e tyre përdoreshin edhe nga anëtarët e familjes. Sidoqoftë, mysafirhanetë ishin të vlefshme kryesisht për shtresën e fuqishme ekonomike dhe nuk gjetën përhapje të gjerë në shtresat e tjera shoqërore[43]. Në të njëjtën kohë, në banesë u bënë modifikime të ndryshme të brendshme, fasadat e shtëpive evoluuan dhe karakteristikat e tyre arkitekturore dhe dekorative u përmirësuan[44]. Të gjitha këto zhvillime të banesës së Korçës dëshmojnë për kërkimin e shprehjeve më të përparuara arkitektonike dhe vepruan si një urë lidhëse midis formave arkitekturore tradicionale dhe moderne, duke kontribuar në kalimin harmonik drejt karakterit të ri urban dhe arkitekturor, që u shfaq në periudhën e dytë të zhvillimit të qytetit të Korçës.

Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, falë zhvillimit të saj Korça u kthye në qendrën kryesore të jetës ekonomike, kulturore dhe shoqërore në vend. Tanimë, ajo konkurron qytetet tashmë të zhvilluara, si Janina[45]. Ky zhvillim solli edhe ngritjen administrative të Korçës në Sanxhak, në fundin e shek. XIX[46]. Si rrjedhojë, ishte e natyrshme që njësitë ekzistuese të banesave të qytetit të mos përmbushnin nevojat për strehimit të popullatës gjithnjë e në rritje. Të dhënat e para për shtrirjen e banesave në zona të reja të lira i gjejmë në kodikun e Korçës dhe të Selasforit. Që nga viti 1874, dy fshatarë nga Orman Çifligu blejnë nga Mitropolia e Korçës troje jashtë qytetit për ndërtimin e banesave: "*iu dhanë të lartpërmendurve Xhixhi Karan dhe Thimi Kostandini nga toka nga prona e kishës së Shën Marisë për të ndërtuar dy shtëpi*"[47]. Në

DO NOT COPY

të lidhura me ekonominë rurale, hajati shërbente jo vetëm si vendbanim apo hapësirë lidhëse me pjesën tjetër të banesës, por edhe si hapësirë për ruajtjen e produkteve bujqësore.

41 Lidhur me funksionimin e esnafeve në qytetin e Korçës shih "Një dorëshkrim pasbizantin në greqisht: Kodiku i Mitropolisë së Korçës (Kod. Ko. 99): Të dhëna mbi esnafet e Korçës gjatë shek. XVIII-XIX", *Albanohellenica* 5 (2013): 259-269, ku gjendet edhe bibliografia përkatëse.

42 Pirro Thomo, "Vlerat urbanistike-arkitektonike të qytetit të Korçës dhe vënia në mbojtje e tyre", *Monumentet* 1 (1988): 7.

43 Thomo, Korça, 122-127.

44 Thomo, "*Vlerat urbanistike-arkitektonike të qytetit të Korçës*", 7.

45 Zija Shkodra, *La ville Albanaise durant la renaissance nationale,* Tiranë 1984, 425-427.

46 Vakalopoulos, *History of Northern Hellenism, Macedonia*. Thessaloniki: Kyriakidis. 1998, 172-174. Anastasios K. Iordanoglou, "Ottoman yearbooks «Salname» of the vilâyet of Monastiri», *Makedonika* 29 (1994): 308-337.

47 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok.



Fig. 12.1-12.2 Shembuj banesash "mysafirhane"

kodikun e Korçës dhe të Selasforit, gjatë periudhës 1868-1873 janë regjistruar, gjithashtu, akte të shumta shitjeje tokash nga Mitropolia e Korçës për ndërtime në fusha ose në të ashtuquajturat bostane[48]. Kjo dëshmohet edhe nga aktiviteti intensiv ndërtimor i vërejtur në banesa gjatë së njëjtës periudhë (1867-1873)[49].


Zgjerimi i qytetit u zhvillua gradualisht (Fig. 13). Së bashku me rritjen e dendësisë së zonave ekzistuese të banimit, formoheshin lagje të reja. Kështu, në verilindje të Varoshit krijohet lagjja Barç, e cili shtrihej deri në rrëzë të kodrës së Shën Thanasit dhe ishte e shkrirë në një njësi kompakte me lagjet e vjetra. Gjithashtu, vërehet krijimi i vendbanimeve pranë akseve rrugore që lidhin qytetin me zonat e tjera. Kështu, rruga e Shën Gjergjit, që lidhte qytetin nga veriu me arterien e rëndësishme tregtare drejt Manastirit dhe Selanikut dhe nga perëndimi me Kolonjën, Përmetin dhe Janinën, u bë boshti qendror, në anët e të cilit u formuan të dyja lagjet e reja, të Jenimahallasë dhe Kalasë. Në 1880, Varoshi shfaqet me tetë lagje, pesë prej të cilave (lagjja Mano, Qiro, Pençi,

nr. 77: "δώθησεν | πρός τούς ἄνω εἰρημένους Τζῆτζον Καράν, καί Θύμιον Κωνσταντίνου ἀπό τόν ἰδιόκτητον τόπον τῆς κάτω | Παναγίας διά νά κτήσουν ὁσπήτια δύω".

48 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 137-153.

49 Thomo, "*Vlerat urbanistike-arkitektonike të qytetit të Korçës*", 88-102.

DO NOT COPY



DO NOT COPY

Fig. 13. Zgjerimi urbanistik i Korçës nga shek. XVII deri në shek. XX

Mançi, Mandi) përfshiheshin në hapësirën e vjetër të qytetit, ndërsa lagjja e Barçit, Jenimahallasë dhe Kalasë u ndërtuan të reja[50].

Një lagje tjetër e re, themelohet dhe zhvillohet rreth kishës së Shën Marisë në Varoshin e Poshtëm (Katovarosh)[51]. Përveç Varoshit edhe Kasabaja shënon një zhvillimin të dukshëm urbanistik, megjithëse në një masë më të vogël. Kasabaja shfaqet me katër lagje: e Tregut, Ratakut, Qoshkut dhe e Deresë[52].




Fig. 14. Skema ortogonale urbanistike që u aplikua gjatë zgjerimit të qytetit nga mesi i shek. XIX deri në shek. XX

Si rezultat i zgjerimit të qytetit dhe rritjes së shpejtë të aktivitetit ndërtimor, zona urbane e Korçës shtrihet përtej lagjeve të vjetra të banimit (Varoshi dhe Kasaba), duke përfshirë kështu edhe lagjet e sapondërtuara të lartpërmendura.

Rreth fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, vihet re një shtrirje e vendbanimeve të reja drejt anës veriore të qytetit të Korçës me aks qendror rrugën e Follorinës. Vlen të përmendet se shtrirja e vendbanimit në Korçë u realizua sipas një plan të rregullt urbanistik ortogonal[53] (Fig. 14) Këtu, konsiston edhe dallimin midis karakterit urban të zonës së vjetër të qytetit (me rrugë të ngushta, gjarpëruese dhe banesa të ulëta) dhe zonës së re të qytetit (me rrugë të drejta që formojnë zona banimi me forma të rregullta gjeometrike)[54]. Zgjerimi dhe modernizimi i Korçës krijoi njëkohësisht nevojën për shtrirjen e ujësjellësit edhe në lagjet e reja të ndërtuara të qytetit. U bënë përpjekje të konsiderueshme për të rindërtuar rrjetin ekzistues dhe për ta shtrirë ujësjellësin në zonat e reja. Për këtë, në kodikun e Korçës dhe të Selasforit lexojmë: "*Përpara tetëdhjetë vjetësh i ndërtuan çezma të pakta dhe të vogla të qytetit të Korçës... Çezmat e reja dhe të shumta në numër u ndërtuan nga gjatë vitit 1871 nga fort fisniku zoti Jovan Banka, i cili teksa jeton në Bukuresht, shpenzoi njëmijë lira për sjelljen e ujit dhe për ngritjen e çezmave, disa prej të cilave mbajnë emrin e tij "Çezma të Jovan Bankës*"[55] (Fig. 15). Çezmat e Bankës kishin një strukturë arkitektonike monumentale, në formën e një galerie të hapur me harqe që mbështeteshin në kolona guri[56].

50 Thomo, Korça, 135-136

51 Χ. Καρμίτσης, *Γεωγραφία τῆς Κορυτσᾶς καὶ τῆς περιοικίδος,* ἐν Θεσσαλονίκῃ 1888, 9.

52 N.D.N., *Korça δe Πατrat per qark,* Sofje 1901, 3.

53 Thomo, Korça, 136-145.

54 Shkodra, *La ville Albanaise,* 381-382.

55 Rembeci, *The Codex of the Holy Metropolis*, dok. nr. 160/8: "*πρό ὀγδοήκοντα περίπου ἐτῶν ὀλίγαι τινες καί μικραί κατασκευάσθησαν δι' ἰδίων ἐξό|δων ὑπό ἀρχαίας οἰκογένειας Βεήδων ἐκτοῦ χωρίου Πλιάσσας καταγομένων. Νεοτέρας δέ καί πολλαπληθιστέρας | τοι οὑτας κατά τό 1871 κατασκεύασεν ὁ εὐγενέστατος κύριος Ἰωάννης Μπάγκας ὁ ἔτι ζῶν ἐν Βουκουρεστίῳ | δαπανήσας χιλίας λίρας πρός μετακόμισιν τῶν ὑδάτων καί διά τήν ἀνέγερσιν τῶν βρύσεων, αἵτινες φέρουσι | τό ὄνομα «Βρύσεις τοῦ Μπάγκα».*

56 Thomo, Korça, 149.

DO NOT COPY



Fig. 15. "Çezmat e reja", dhuratë nga bamirësi Jovan Banka




Fig. 16. Tipi i ri i banesës korçare me korridor qendror, 1884

Zhvillimi urban i Korçës hapi horizonte të reja për format arkitektonike të ndërtesave (Fig. 16). Lloji i banesave dykatëshe ose trekatëshe me ballkon ose erker frontal të mbyllur u përdor gjerësisht. Lindja e këtij tipi arkitektonik vjen si shkak i ndikimeve të forta të Evropës pas-Rilindjes, kur edhe hyjnë fuqishëm elementet barok arkitekturë[57] (Fig. 17.1-17.2). Karakteristikat tipike arkitekturore të kësaj banese janë vendosja e paradhomës në pozicion




Fig. 17.1-17.2 Banesë e tipit të ri, 1868

57 Ballauri R., «Histoire de l'essor de la ville de Korçë», 108. Thomo, Korça, 191-200.

DO NOT COPY



Fig. 18. Banesa të tipit të ri, 1870.

qendror, në të dy krahët e paradhomës gjendet nga një dhomë e vendosur në mënyrë të plotë simetrike. Në fund të paradhomës dhe përballë hyrjes janë shkallët që lidhin katin e parë me të dytin (Fig. 18). Kati i dytë ka të njëjtat hapësira, por në paradhomë ka një erker të mbyllur.

Banesat kishin gjithashtu një oborr të vogël me kangjella të ulëta ose mure të ndërtuara me gurë, dhe zakonisht faqja e përparme e tyre shihte për nga rruga[58]. Vëmendje e veçantë i kushtohet edhe pamjes së jashtme të banesave (Fig. 19).

Përpara hyrjeve ngrihet portiku, i cili mbështetet në kolona. Në të njëjtën kohë, dekorimi i jashtëm përmirësohet me përdorimin e elementeve dekorative të gdhendur në gurë.

Këto të fundit përdoren tek arkitrarët, shkallët, në kolonat e erkerëve dhe, në fund, në dekorimin e elementeve arkitekturorë, si p.sh. në dritare, në qoshet e mureve, në çatitë dhe madje edhe në punimet e erkerëve[59].




Fig. 19. Dekoracioni i jashtëm i banesës korçare


Si përfundim, bëhet qartësisht e kuptueshme se qyteti i Korçës (Fig. 20), që deri në shek. XVIII shënonte rritje të vazhdueshme, fillon rreth shek. XIX ta përshpejtojë dhe intensifikojë rrugëtimin zhvillimor, i cili dëshmohet nga rritja demografike, zgjerimi i territorit, karakteri i saj arkitektural dhe

58 Thomo, Korça, 52-75. Shkodra, *La ville Albanaise,* 382-383.

59 Thomo, Korça, 180-190.

DO NOT COPY

urban, duke përfunduar në fund të shek. XIX dhe fillimin e shek. XX - sipas Durham – "qyteti më i pastër i Perandorisë Osmane, me rrugë të shtruara dhe të drejta ... dhe krahasuar me Ohrin lindor, Korça duket e civilizuar"[60].



DO NOT COPY

Fig. 20. Pamje e qytetit të Korçës në fund të shek. XIX, fillim të shek. XX.

60 Durham E. M., *The burden of the Balkans,* London 1905, 152-153

monumentet
58/2019

Andi REMBECI

ARCHITECTURAL AND URBAN DEVELOPMENT IN KORCA DURING THE XV-XIX CENTURY

DO NOT COPY

The city of Korça is the densest demographic center on the edge of present-day Southern Albania. The perennial development of Korça from the 15th century to the end of the 19th century directly influenced the urban development of the city, which went through two periods. The first period, from the 15th century until the mid-19th century, was characterized by the gradual transition of the city from a small administrative center to a craft and commercial center, which was constantly gaining urban features.

The second period, defined in the second half of the 19th century, represents the peak of the city's economic and demographic development, which also led to the expansion of the urban layout and the development of the city into new spaces.

At the end of the Ottoman conquest campaigns, Korça began to pursue both demographic and economic development. The concentration of population in the city during the 17th century brought urban condensation of living spaces and the merging of neighborhoods into a compact housing unit. In the 18th century, as a result of the disintegration of the Ottoman military feudal system, urban artisanal production appeared. At the same time, there is a displacement of the rural population, increasing the urban population of the city.

The construction of new cemeteries at the end of the XVIII century and the installation of the water supply at the beginning of the XIX century played an important role in the urban formation of the old part of the city. During the first half of the 19th century, Korça saw a remarkable development in commerce and craftsmanship, which had a direct impact on adapting the typological and architectural character of the dwellings to the new requirements. During the second half of the 19th century, Korça became the main center of economic, cultural and social life in the country. As a result, new neighborhoods are formed as the density of existing residential areas increases. Around the end of the 19th century and the beginning of the 20th century, new settlements extend to the north side of the city. The urban development of Korça opened new horizons for the architectural forms of buildings.

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Ιωάννης Σαρηγιαννίδης

ΑΠΟΚΩΔΙΚΟΠΟΙΩΝΤΑΣ ΤΗΝ ΑΙΣΘΗΤΙΚΉ ΚΑΙ ΤΟ ΜΕΤΡΙΚΌ ΣΎΣΤΗΜΑ ΤΟΥ ΜΕΓΆΛΟΥ ΖΩΓΡΆΦΟΥ ΟΝΟΥΦΡΊΟΥ ΑΠΌ ΤΟ ΕΛΜΠΑΣΆΝ. ΤΟ ΠΑΡΆΔΕΙΓΜΑ ΤΗΣ ΦΟΡΗΤΉΣ ΕΙΚΌΝΑΣ ΤΩΝ ΑΓΊΩΝ ΙΣΑΠΟΣΤΌΛΩΝ ΚΩΝΣΤΑΝΤΊΝΟΥ ΚΑΙ ΕΛΈΝΗΣ[1]

DO NOT COPY

Από το τέμπλο, πιθανότατα, του ιερού ναού των αγίων Κωνσταντίνου και Ελένης στο Βεράτι, προέρχεται μία εικόνα, του 16ου αιώνα, των ομώνυμων αγίων, διαστάσεων 87,5X58X3,2 εκ., αποδιδόμενη στον ζωγράφο Ονούφριο, ιερέα και πρωτοπαπά Νεοκάστρου-Ελμπασάν (Εικ. 1).[2]



Εικ. 1

Εικ. 1, Μουσείο Βυζαντινού Πολιτισμού, *Εικόνες από τις*

1 Ιωάννης Σαρηγιαννίδης, Μεταδιδακτορικός ερευνητής της Θεολογικής Σχολής του Αριστοτελείου Πανεπιστημίου Θεσσαλονίκης.

2 Εξαιρετική ζωγραφική φυσιογνωμία του 16ου αιώνα στην Αλβανία υπήρξε ο Ονούφριος, με πιθανό τόπο καταγωγής του την πόλη του Ελμπασάν. Η τέχνη του συνδέεται με την κρητική ζωγραφική και τη ζωγραφική της βορειοδυτικής Ελλάδας, έχοντας ο ίδιος εργαστεί και φιλοτεχνήσει έργα εντός του κλίματος της Αρχιεπισκοπής της Αχρίδας. Για περισσότερα, όπου και σχετική βιβλιογραφία, ενδεικτικά βλ. Μουσείο Βυζαντινού Πολιτισμού, *Εικόνες από τις Ορθόδοξες κοινότητες της Αλβανίας. Συλλογή Εθνικού Μουσείου Μεσαιωνικής τέχνης Κορυτσάς*, Θεσσαλονίκη: Μ.Β.Π., 2006, 74. Μ. Χατζηδάκης-Ε. Δρακοπούλου, *Έλληνες ζωγράφοι μετά την άλωση (1450-1830)*, Αθήνα: Ε.Ι.Ε., Τόμος 1, 1987, 256-258. Μ. Γαρίδης, *Μεταβυζαντινή Ζωγραφική (1450-1600) Η εντοίχια ζωγραφική μετά την πτώση του Βυζαντίου στον Ορθόδοξο κόσμο και στις χώρες υπό ξένη κυριαρχία*, Αθήνα: Σπανός, 2007, 271 κ.ε. K. Jakumis, «Vlerësim estetik i veprës së piktorit Onufri dhe dëshmia e tij në Shqipërinë e Mesme», Mihail Naço-Xhevair Lleshi Redak., *Mijëvjeçari i ri i miqësisë heleno-shqiptare*, Tiranë: Uegen, 2004, 183-186. T. Popa, «Të dhëna të reja rreth piktor Onufrit», *Studime Historike 1* (1966) 141-145. T. Popa, «Onufri ikonograf i shquar Shqiptar», *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës 1*, Tiranë 1962, 54-75. Puzanova V., «Piktori shqiptar i shekullit të XVI Onufri nga Neokastra –Elbasan», *Buletin për Shkencat Shoqërore 3*, Tiranë 1953, 8-23.

Οι άγιοι ισαπόστολοι Κωνσταντίνος και Ελένη ιστορούνται βαστώντας τον Τίμιο Σταυρό ανάμεσά τους, με τον Χριστό να τους στεφανώνει από τον σχηματοποιημένο ημικυκλικό ουρανό.[3] Τα τέσσερα γνωστά αρκτικόλεξα γράμματα γραμμένα σε μικρή ταινία κοσμούν την κορυφή του Σταυρού: **Ι**(ΗΣΟΥC) **Ν**(ΑΖΩΡΑΙΟC) **Β**(ΑΣΙΛΕΥC) **Ι**(ΟΥΔΑΙΩΝ), ενώ κάτω από αυτήν, σε ορθογώνιο πλαίσιο, γραμμένη με σύμφωνα, η φράση**: Ο Β**(Α)**C**(Ι)**Λ**(ΕΥC) **Τ**(ΗC) **Δ**(Ο)**Ξ**(ΗC). Εξωτερικά των κεραιών του Σταυρού με κόκκινα γράμματα είναι γραμμένη η πασίγνωστη ρήση: **Ι**(ΗΣΟΥ) **C Χ**(ΡΙΣΤΟ)**C Ν**(Ι)**Κ**(Α) και με αρχικά η φράση: **Φ**(ΩC) **Χ**(ΡΙΣΤΟΥ) (ΦΑΙΝΕΙ) **Π**(ΑCΙ).[4]

Οι άγιοι φορούν πολυτελή αυτοκρατορικά ενδύματα, που αποδίδονται κυρίως με αποχρώσεις του κυανόλευκου, του πορφυρού και του πράσινου σε διάφορους τόνους.[5]

Άνωθεν των αγίων δεσπόζει σε ημίσωμη μορφή ο Χριστός, να αναφαίνεται, σε μικρότερης κλίμακας διάσταση, προκειμένου να στέψει τους αγίους για την προσφορά τους στην Εκκλησία και τη συμβολή τους στη διάδοση του Χριστιανισμού .[6]



Εικ. 2

Οι άγιοι κρατούν ανάμεσά τους με σταθερότητα την κάθετη κεραία του Τιμίου Σταυρού με το ένα τους χέρι, ενώ με το άλλο χέρι ο άγιος Κωνσταντίνος βαστά κλειστό ειλητάριο, ενώ η αγία Ελένη προβάλλει την παλάμη της σε στάση αντίστασης.

Η εικόνα διακρίνεται για το δίχρωμο βάθος της. Το βαθυπράσινο αποτελεί τη βάση, όπου πατούν οι πόδες των αγίων και φθάνει μέχρι τα γόνατά τους, ενώ στο αντίστοιχο άνω μέρος κυριαρχεί το ωχροκίτρινο.

Επιπρόσθετα, ως προς τον σχεδιασμό και τη συμμετρία της μορφής των Ισαποστόλων, έχουμε να παρατηρήσουμε τα εξής:[7]

Ορθόδοξες κοινότητες της Αλβανίας. Συλλογή Εθνικού Μουσείου Μεσαιωνικής τέχνης Κορυτσάς, Θεσσαλονίκη: Μ.Β.Π., 2006, 75.

3 Επιγραφές των αγίων: Ο ΑΓΙΟC ΚΩΝCΤΑΝΤΙΝΟC Ο ΜΕΓΑC, Η ΑΓΙΑ ΕΛΕΝΗ Η ΕΑΥΤΟΥ ΜΗ(ΤΗ)Ρ, ΟΙ ΘΕΟCΤΕΠΤΟΙ Κ(ΑΙ) ΟΙCΑΠΟCΤΟΛΟΙ. Ο συγκεκριμένος εικονογραφικός τύπος μάς είναι γνωστός από τον 10ο αιώνα με επιμέρους αποκλίσεις. Α., Τούρτα, Οι ναοί του αγίου Νικολάου στη Βίτσα και του αγίου Μηνά στο Μονοδένδρι, Αθήνα: Υπουργείο Πολιτισμού, 1991, 155-156.

4 Η φράση προέρχεται από τη Θεία Λειτουργία των Προηγιασμένων Δώρων που τελείται την περίοδο της Μεγάλης Τεσσαρακοστής.

5 «Στο πλαίσιο του κοινωνικού κώδικα της ιεραρχημένης βυζαντινής κοινωνίας, το ένδυμα *αντιμετωπιζόταν ως δηλωτικό στοιχείο της ταυτότητας, της κοινωνικής τάξης και της επαγγελματικής ιδιότητας αυτού που το έφερε*». Κ. Ράπτης, «Το ένδυμα», Χ. Μπακιρτζής (Επιμ.) *Άγιος Νικόλαος ο Ορφανός. Οι τοιχογραφίες*, Θεσσαλονίκη: Ακρίτας, 2003, 101.


6 Σχετικά με τις ιδιότητες του Τιμίου Σταυρού και τη συμβολή των αγίων στην Εκκλησία, όπου και ενδεικτική βιβλιογραφία βλ. Α. Καραγιάννη, *Ο σταυρός στη βυζαντινή μνημειακή ζωγραφική: Η λειτουργία και το δογματικό του περιεχόμενο*, Θεσσαλονίκη: Κ.Β.Ε., 2010. 27 κ.ε. Ευσέβιος Παμφύλου, «Λόγος εἰς τὸν βίον τοῦ Μακαρίου Κωνσταντίνου τοῦ Βασιλέως», *PG* 20, 943-944.

7 Η συμμετρία και οι αναλογίες, ως προς το γενικό σχεδιασμό στη ζωγραφική, αποτελούσαν σημαντικό τμήμα της επιτυχίας του έργου τόσο στην αρχαιότητα όσο και στη βυζαντινή αλλά και μεταβυζαντινή εποχή. Για περισσότερα, ενδεικτικά βλ. *Ι.* Βράνος, *Η τεχνική της αγιογραφίας*, Τόμος Α'&Β', Θεσσαλονίκη: Ιδιωτική, 1985 & 2001. Πλίνιος ο Πρεσβύτερος, *Περί της αρχαίας ελληνικής ζωγραφικής. 35ο βιβλίο της φυσικής ιστορίας*, Αθήνα: Άγρα, 1994. Διονύσιος εκ Φουρνά, *Ερμηνεία της βυζαντινής ζωγραφικής τέχνης*, Αθήνα: Σπανός, 1997.

DO NOT COPY



Εικ. 2, Β-Θ



Εικ. 2, Θ-Ι

Ο Ονούφριος ιχνογραφεί τον κύριο κύκλο του προσώπου, δίχως το στέμμα, διαιρώντας τον κατακόρυφο ρινικό άξονα σε έξι ίσα διαστήματα, λαμβάνοντας ως μέτρο αναφοράς τον αριστερό οφθαλμό του αγίου Κωνσταντίνου (Εικ. 2), προσδιορίζοντας κατ' αυτόν τον τρόπο την περιφέρεια του κύκλου (Εικ. 2, Β-Θ). Κατόπιν, προσθέτει ένα έβδομο διάστημα ίσο με τα προηγούμενα, προκειμένου να οριοθετήσει το πηγούνι του αγίου (Εικ. 2, Θ-Ι). Αναφορικά με το πλάτος του προσώπου παρατηρούμε ότι το συνολικό πλάτος του είναι ίσο με το διάστημα των 4½ οφθαλμών (Εικ. 3, Ε3-Ε7-Ε8).

Ιδιαίτερο χαρακτηριστικό στην απόδοση του αγίου Κωνσταντίνου αποτελεί η αίσθηση της αντικίνησης με το υπόλοιπο σώμα του που είναι στραμμένο στα αριστερά του αγίου, ενώ το βλέμμα του κοιτάζει δεξιά, δίνοντας μια μοναδική ζωντάνια στην κίνησή του. Αναλυτικότερα, αυτό επιτυγχάνεται με τον σχεδιασμό της απόστασης από τον έσω κανθό του δεξιού ματιού του αγίου μέχρι τα μαλλιά να είναι ίσος με το διάστημα των τεσσάρων οφθαλμών, (Εικ. 3, Ε1-Ε5) ενώ η απόσταση του έσω κανθού του αριστερού ματιού του αγίου μέχρι τα μαλλιά να είναι ίση με το διάστημα των 3½ οφθαλμών (Εικ. 3, Ε6-Ε9-10).

Επιπρόσθετα, ο οριζόντιος οφθαλμικός άξονας στο πρόσωπο του αγίου το διαιρεί στη μέση, περιλαμβάνοντας το ένα διάστημα, την απόσταση από το τέλος του κρανίου έως τον οφθαλμικό άξονα, και το δεύτερο διάστημα, την απόσταση από τον οφθαλμικό άξονα έως το πηγούνι (Εικ. 3, Β-Ε & Ε-Θ).

Σχετικά με τον σχεδιασμό των αυτιών, ο Ονούφριος

ΔΟΚΙΜΙΟ



Εικ. 3, E3-E7-E8



Εικ. 3, E6-E9-10



Εικ. 3, E1-E5



Εικ. 3, B-E & E-Θ

DO NOT COPY

ακολουθεί την πάγια αρχή των βυζαντινών και κοσμικών ζωγράφων τα αυτιά να σχεδιάζονται, στη στάση κατ' ενώπιον, στον ίδιο οριζόντιο άξονα της βάσης των ρωθώνων του αγίου (Εικ. 4).[8]

Αναφορικά με το μετρικό σύστημα που ακολούθησε ο Ονούφριος ως προς το συνολικό σώμα, αυτό προσομοιάζει με τον κανόνα αναλογιών του δορυφόρου του Πολυκλείτου και του αποξυόμενου του Λύσιππου, που πέρασε και στη βυζαντινή ζωγραφική και έχει ως βασική αρχή το περίπου μέτρο των 7-½-8 κεφαλών στην οικοδόμηση του σώματος.[9]

Στην εικόνα της αγίας Ελένης, ο ζωγράφος μας, παρατηρούμε ότι σχεδιάζει το πρόσωπο της αγίας έχοντας ως μέτρο αναφοράς τον αριστερό οφθαλμό της αγίας και το αποτυπώνει με το συνολικό μήκος των έξι οφθαλμών, λόγω του χαμηλού μετώπου από την επικάθιση του στέμματος (Εικ. 5, Β-Θ). Η αποτύπωση αυτή τονίζει το μικρό μέτωπό της πάνω στο οποίο κάθεται η βασιλική κορώνα.

Ως προς το πλάτος του προσώπου της αγίας,

8 Leonardo collection, *Anatomy for artist* 4, 31.

9 Πλίνιος ο Πρεσβύτερος, *Περί της αρχαίας ελληνικής ζωγραφικής. 35ο βιβλίο της φυσικής ιστορίας*, 307. Leonardo collection, *Anatomy for artist* 4, 3.



Εικ. 4

παρατηρούμε ότι αυτό ισούται περίπου με το διάστημα των 4 οφθαλμών, σε αντίθεση με το πρόσωπο του αγίου Κωνσταντίνου, όπου ισούται περίπου με το διάστημα των 4½ οφθαλμών (Εικ. 5, Δ2-Δ7).

Αναφορικά με το μετρικό σύστημα, που ακολούθησε ο Ονούφριος ως προς το συνολικό σώμα της αγίας Ελένης, αυτό έχει ως βασική αρχή το μέτρο των 8 κεφαλών στην οικοδόμηση του σώματος (Εικ. 6).[10]

Συμπερασματικά, για την εξεταζόμενη εικόνα, παρά τις μικρές φθορές που έχει υποστεί στη ζωγραφική της επιφάνεια, μπορούμε να παρατηρήσουμε από χρωματικής άποψης ότι τα πρόσωπα των αγίων αποδίδονται με ανοικτό ωχροπράσινο προπλασμό, που αποτελεί τη χρωματική βάση, πάνω στην οποία ο Ονούφριος πλάθει μαλακά και με λεπτά σβησίματα τα ωχροπράσινα σαρκώματα.

Από καλλιτεχνική άποψη ο Ονούφριος καταφέρνει να αναδείξει τις σεβάσμιες μορφές των Ισαποστόλων Κωνσταντίνου Ελένης, χρησιμοποιώντας τα γήινα χρώματα στο πρόσωπο και εξαίροντας με εκφραστική σαφήνεια τα χαρακτηριστικά των αγίων με το μαλακό πλάσιμο, υποβάλλοντας με αυτό τον τρόπο στον θεατή το



Εικ. 5, Β-Θ



Εικ. 5,Δ2-Δ7

βίωμα της υπερβατικής πραγματικότητας.[11]

Η τέχνη του διακρίνεται για την ευγένεια των μορφών, τον εκλεκτισμό των μοτίβων και την καλλιγραφία των επιγραφών.[12] Ο ίδιος

10 Ι. Βράνος, *Η τεχνική της αγιογραφίας*, Τόμος Β', 87.


11 Ιερά Μονή Τιμίου Προδρόμου, *Τι ξέρεις εσύ για τις εικόνες;* 42-43. Η εικονογράφηση των αγίων στην Ορθόδοξη Εκκλησία αποτελεί μια διαρκή υπενθύμιση στο πλήρωμα Αυτής ότι *«δεῖ το φθαρτόν ἐνδύσασθε ἀφθαρσίαν καί το θνητόν ἐνδύσασθαι ἀθανασίαν»*, δηλαδή να αποδώσει πνευματικά την υλική υπόσταση των ανθρωπίνων μορφών. Κ. Καλοκύρη, *Η ζωγραφική της Ορθοδοξίας. Ιστορική αισθητική και δογματική ερμηνεία της βυζαντινής ζωγραφικής*, Θεσσαλονίκη: 1972, 163.

12 *«Με τα στοιχεία αυτά ο Ονούφριος μπορεί να χαρακτηρισθεί εκπρόσωπος μιας εκκλησιαστικής τέχνης*

DO NOT COPY

αναδεικνύεται άριστος γνώστης του σχεδίου και της ζωγραφικής,

δημιουργώντας μια «σχολή ζωγραφικής», όπου είναι γνωστή ως σχολή του Βερατίου.[13]



DO NOT COPY

Εικ. 6

αστικού χαρακτήρα με υψηλούς, για την περιοχή, στόχους, του οποίου το έργο δεν μπορεί να περιορίζεται στα λίγα γνωστά μνημεία που έχουν την υπογραφή του», Μ. Χατζηδάκης-Ε. Δρακοπούλου, *Έλληνες ζωγράφοι μετά την άλωση (1450-1830)*, Τόμος 1, 88.

13 Μ. Γαρίδης *Μεταβυζαντινή Ζωγραφική (1450-1600) Η εντοίχια ζωγραφική μετά την πτώση του Βυζαντίου στον Ορθόδοξο κόσμο και στις χώρες υπό ξένη κυριαρχία*, 271 κ.ε.

ΕΠΙΛΕΚΤΙΚΗ ΒΙΒΛΙΟΓΡΑΦΙΑ

Βράνος Ι., *Η τεχνική της αγιογραφίας, Τόμος Α',* Θεσσαλονίκη: Ιδιωτική, 1985.

Βράνος Ι., *Η τεχνική της αγιογραφίας, Τόμος Β',* Θεσσαλονίκη: Ιδιωτική, 2001.

Γαρίδης Μ., *Μεταβυζαντινή Ζωγραφική (1450-1600) Η εντοίχια ζωγραφική μετά την πτώση του βυζαντίου στον Ορθόδοξο κόσμο και στις χώρες υπό ξένη κυριαρχία,* Αθήνα: Σπανός, 2007.

Διονύσιος εκ Φουρνά, *Ερμηνεία της βυζαντινής ζωγραφικής τέχνης,* Αθήνα: Σπανός, 1997.
Ευσέβιος Παμφύλου, «Λόγος εἰς τόν βίον τοῦ Μακαρίου Κωνσταντίνου τοῦ Βασιλέως», *PG* 20, 943-944.

Ιερά Μονή Τιμίου Προδρόμου, *Τι ξέρεις εσύ για τις εικόνες;* Αθήνα: Ετοιμασία, 2001.

Jakumis K., «Vlerësim estetik i veprës së piktorit Onufri dhe dëshmia e tij në Shqipërinë e Mesme», Mihail Naço-Xhevair Lleshi Redak., *Mijëvjeçari i ri i miqësisë heleno-shqiptare*, Tiranë: Uegen, 2004, 183-186.

Καλοκύρης Κ., *Η ζωγραφική της Ορθοδοξίας. Ιστορική αισθητική και δογματική ερμηνεία της βυζαντινής ζωγραφικής,* Θεσσαλονίκη: 1972.

Καραγιάννη Α., *Ο σταυρός στη βυζαντινή μνημειακή ζωγραφική: Η λειτουργία και το δογματικό του περιεχόμενο,* Θεσσαλονίκη: Κ.Β.Ε., 2010.

Κόρδης Γ., *Αυγοτέμπερα με υποζωγράφιση. Το χρώμα ως φως στη βυζαντινή ζωγραφική. Θεωρία και πρακτική»* Αθήνα: Αρμός, 2009.

Leonardo collection, *Anatomy for artist 4*, Milano: Vinciana, 1987.

Mioni E., *Εισαγωγή στην Ελληνική Παλαιογραφία*, Μτφρ. Νικολάου Μ. Παναγιωτάκη, Αθήνα: Μ.Ι.Ε.Τ., 1977.

Μουσείο Βυζαντινού Πολιτισμού, *Εικόνες από τις Ορθόδοξες κοινότητες της Αλβανίας. Συλλογή Εθνικού Μουσείου Μεσαιωνικής τέχνης Κορυτσάς,* Θεσσαλονίκη: Μ.Β.Π., 2006.

DO NOT COPY

Πλίνιος ο Πρεσβύτερος, *Περί της αρχαίας ελληνικής ζωγραφικής. 35ο βιβλίο της φυσικής ιστορίας,* Αθήνα: Άγρα, 1994.

Popa T., «Të dhëna të reja rreth piktor Onufrit», *Studime Historike 1* (1966) 141-145.

Popa T., «Onufri ikonograf i shquar Shqiptar», *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës 1*, Tiranë 1962, 54-75.

Puzanova V., «Piktori shqiptar i shekullit të XVI Onufri nga Neokastra –Elbasan», *Buletin për Shkencat Shoqërore 3*, Tiranë 1953, 8-23.

Ράπτης Κ., «Το ένδυμα», Χ. Μπακιρτζής (Επιμ.) *Άγιος Νικόλαος ο Ορφανός. Τοιχογραφίες,* Θεσσαλονίκη: Ακρίτας, 2003.

Τούρτα Α., *Οι ναοί του αγίου Νικολάου στη Βίτσα και του αγίου Μηνά στο Μονοδένδρι,* Αθήνα: Υπουργείο Πολιτισμού, 1991.

Χατζηδάκης Μ.-Δρακοπούλου Ε., *Έλληνες ζωγράφοι μετά την άλωση (1450-1830),* Αθόμοι 1 & 2, 1987.

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Joannis SARIJANNIDIS*

DUKE DEKODIFIKUAR ESTETIKËN DHE SISTEMIN METRIK TË PIKTORIT TË MADH ONUFËR NGA ELBASANI. SHEMBULLI I IKONËS SË LËVIZSHME TË SHENJTORËVE TË BARABARTË ME APOSTUJT, KONSTANDINIT DHE HELENËS.

DO NOT COPY

Nga ikonostasi i kishës, me shumë gjasë, të Shën Konstandinit dhe Helenës në Berat vjen një ikonë e shek. XVI e shenjtorëve me po këtë emër, me përmasa 87,5 x 58 x 3,2 cm, e cila i atribuohet piktorit Onufër, prift dhe protopapë i Neokastrës – Elbasanit (fig. 1)[1].



Fig. 1

1 * Joannis Sarijannidis, Punonjës kërkimor-shkencor, postdoktorant i Shkollës Teologjike të Universitetit Aristoteli të Selanikut. Onufri ishte personalitet i jashtëzakonshëm i pikturës gjatë shek. XVI në Shqipëri. Sipas të gjitha gjasave prejardhjen e kishte nga Elbasani. Arti i tij lidhet me pikturën e Kretës dhe me pikturën e piktorëve të Greqisë veri-perëndimore, pasi dhe ai vetë pati punuar dhe realizuar vepra brenda territorit të Kryepeshkopatës së Ohrit. Për më shumë, citojmë veprat e mëposhtme, ku jepet dhe bibliografia përkatëse: Μουσείο Βυζαντινού Πολιτισμού, *Εικόνες από τις Ορθόδοξες κοινότητες της Αλβανίας. Συλλογή Εθνικού Μουσείου Μεσαιωνικής τέχνης Κορυτσάς,* Θεσσαλονίκη: Μ.Β.Π., 2006, 74. Μ. Χατζηδάκης-Ε. Δρακοπούλου, *Έλληνες ζωγράφοι μετά την άλωση (1450-1830),* Αθήνα: Ε.Ι.Ε., Τόμος 1, 1987, 256-258. Μ. Γαρίδης, *Μεταβυζαντινή Ζωγραφική (1450-1600) Η εντοίχια ζωγραφική μετά την πτώση του Βυζαντίου στον Ορθόδοξο κόσμο και στις χώρες υπό ξένη κυριαρχία,* Αθήνα: Σπανός, 2007, 271 e më tej. Jakumis, K., "Vlerësim estetik i veprës së piktorit Onufri dhe dëshmia e tij në Shqipërinë e Mesme", Mihail Naço-Xhevair Lleshi (red.), *Mijëvjeçari i ri i miqësisë heleno-shqiptare*, Tiranë: Uegen, 2004, 183-186. Th. Popa, "Të dhëna të reja rreth piktor Onufrit", *Studime Historike 1* (1966) 141-145. Popa, Th., "Onufri ikonograf i shquar Shqiptar", *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës 1*, Tiranë 1962, 54-75. Puzanova, V., "Piktori shqiptar i shekullit të XVI Onufri nga Neokastra – Elbasan", *Buletin për Shkencat Shoqërore 3*, Tiranë 1953, 8-23.

Shenjtorët e barabartë me Apostujt, Konstandini dhe Helena, paraqiten duke mbajtur Kryqin e Çmuar mes tyre, teksa Krishti i kurorëzon nga qielli i punuar në formë gjysmërrethi[2]. Katër germat e njohura akronime, shkruar në një shirit të hollë, dekorojnë majën e kryqit: **Ι**(ΗΣΟΥC) **Ν**(ΑΖΩΡΑΙΟC) **Β**(ΑΣΙΛΕΥC) **Ι**(ΟΥΔΑΙΩΝ) (Jezu Nazareasi Mbret i Judenjve), kurse poshtë shiritit, në fushë drejtkëndëshe, shkruar vetëm me bashkëtingëllore, jepet fraza: **Ο Β**(Α)**C**(Ι)**Λ**(ΕΥC) **Τ**(ΗC) **Δ**(Ο)**Ξ**(ΗC) (Mbreti i lavdisë). Në anët e jashtme të degëve të kryqit, është shkruar shprehja më se e njohur: **Ι**(ΗΣΟΥ)**C Χ**(ΡΙΣΤΟ)**C Ν**(Ι)**Κ**(Α) (Jezu Krishti Fiton), dhe me germa iniciale fraza: **Φ**(ΩC) **Χ**(ΡΙΣΤΟΥ) (ΦΑΙΝΕΙ) **Π**(ΑCΙ) (Drita e Krishtit ndriçon të gjithë)[3].

Shenjtorët kanë veshur petka perandorake luksoze, të cilat janë ekzekutuar kryesisht me nuanca të së kaltrës dhe të së bardhës, të së purpurtës dhe jeshiles në tone të ndryshme[4]. Mbi shenjtorët dominon pamja në bust e Krishtit, në shkallë më të vogël, që duket se po kurorëzon shenjtorët për blatimin e tyre ndaj Kishës dhe kontributin për përhapjen e krishterimit[5].



Fig. 2

Shenjtorët mbajnë fort mes tyre krahun vertikal të Kryqit të Çmuar, secili me nga një dorë, kurse me dorën tjetër Shën Konstandini mban një rrotull të mbyllur dhe Shën Helena tregon pëllëmbën në shenjë kundërshtie.

Ikona shquhet për sfondin dyngjyrësh. Jeshilja e errët përbën bazën ku shkelin këmbët e shenjtorëve, duke u lartuar deri në nivelin e gjunjëve të tyre, kurse në hapësirën gjegjëse sipër dominon ngjyra e verdhë e çelur.

Veç kësaj, për modelimin dhe simetrinë e pamjes së shenjtorëve të barabartë me Apostujt, vëmë re sa më poshtë:[6]

Onufri e vizaton rrethin kryesor të fytyrës, pa llogaritur kurorën, duke e ndarë aksin e hundës në gjashtë hapësira të barabarta. Për ndarjen në njësi më të vogla merr si masë referimi syrin e majtë të Shën Konstandinit (fig. 2), duke përcaktuar, me këtë mënyrë, perimetrin e rrethit (fig. 2, Β-Θ). Pas

2 Mbishkrimet e shenjtorëve: **Ο ΑΓΙΟC ΚΩΝCΤΑΝΤΙΝΟC Ο ΜΕΓΑC, Η ΑΓΙΑ ΕΛΕΝΗ Η ΕΑΥΤΟΥ ΜΗ**(ΤΗ)**Ρ, ΟΙ ΘΕΟCΤΕΠΤΟΙ Κ**(ΑΙ) **ΟΙCΑΠΟCΤΟΛΟΙ**. Ky tip ikonografik është i njohur që prej shek. X, me përjashtime të vogla. A., Τούρτα, *Οι ναοί του αγίου Νικολάου στη Βίτσα και του αγίου Μηνά στο Μονοδένδρι,* Αθήνα: Υπουργείο Πολιτισμού, 1991, 155-156.

3 Fraza vjen nga Liturgjia e Shenjtë e Dhuratave të Parashenjtëruara që kryhet gjatë periudhës së Kreshmës së Madhe.

4 *«Në kuadrin e kodit shoqëror të shoqërisë bizantine të hierarkizuar, veshja konsiderohej element deklarativ i identitetit, klasës shoqërore dhe veçorive profesionale të atij që e mbante veshur».* Κ. Ράπτης, «Το ένδυμα», Χ. Μπακιρτζής (Επιμ.) *Άγιος Νικόλαος ο Ορφανός. Οι τοιχογραφίες,* Θεσσαλονίκη: Ακρίτας, 2003, 101.

5 Lidhur me veçoritë e Kryqit të Çmuar dhe blatimit të shenjtorëve ndaj kishës, shih: A. Καραγιάννη, *Ο σταυρός στη βυζαντινή μνημειακή ζωγραφική: Η λειτουργία και το δογματικό του περιεχόμενο,* Θεσσαλονίκη: K.B.E., 2010. 27 e në vijim, ku jepet bibliografia gjegjëse. Ευσέβιος Παμφύλου, «Λόγος εἰς τόν βίον τοῦ Μακαρίου Κωνσταντίνου τοῦ Βασιλέως», *PG* 20, 943-944.

6 Simetria dhe përpjesëtimi në skicimin e përgjithshëm të pikturës përbëjnë element të rëndësishëm të suksesit të veprës sa në botën antike, aq dhe në bizant, por edhe në periudhën pas-bizantine. Për më shumë, shih: Ι. Βράνος, *Η τεχνική της αγιογραφίας,* Τόμος Α'&Β', Θεσσαλονίκη: Ιδιωτική, 1985 & 2001. Πλίνιος ο Πρεσβύτερος, *Περί της αρχαίας ελληνικής ζωγραφικής. 35ο βιβλίο της φυσικής ιστορίας*, Αθήνα: Άγρα, 1994. Dionisi nga Furna (Διονύσιος εκ Φουρνά), *Ερμηνεία της βυζαντινής ζωγραφικής τέχνης,* Αθήνα: Σπανός, 1997.

DO NOT COPY



Fig 2, B-Θ




Fig. 2, Θ-I

kësaj, shton një hapësirë të shtatë, të barabartë me të mëparshmet, me qëllim që të kufizojë mjekrën e shenjtorit (fig. 2, Θ-I). Tek shqyrtojmë gjerësinë e fytyrës, vëmë re se gjerësia totale është e barabartë me 4½ e syve (fig. 3, E3-E7-E8).

Karakteristikë e përveçme në ekzekutimin e Shën Konstandinit përbën ndjesia e palëvizshmërisë së fytyrës, krahasuar me pjesën tjetër të trupit, që është i kthyer paksa majtas, kurse vështrimi shkon djathtas, duke sjellë një gjallëri unike në lëvizjen e tij. Po të shohim më hollësisht, kjo arrihet duke krijuar barazi të distancës që krijohet nga qoshja e brendshme e syrit të djathtë të shenjtorit, deri tek flokët, me përmasën e katër syve (fig. 3, E1-E5), kurse distanca e qoshes së brendshme të syrit të majtë të shenjtorit, deri tek flokët, është e barabartë me përmasën e 3 ½ syve (fig. 3, E6-E9-10).

Për më tepër, boshti horizontal i syve në fytyrën e shenjtorit e ndan fytyrën në mes, duke krijuar dy hapësira, nga të cilat njëra përbëhet prej distancës nga vija e sipërme e fytyrës, deri tek boshti i syve, kurse tjetra nga boshti i syve, deri tek mjekra (Fig. 3, B-E & E-Θ).

Për sa i përket skicimit të veshëve, Onufri ndjek parimin e konsoliduar të piktorëve bizantinë dhe laikë, duke i skicuar të dukshëm nga pozicioni ballor, në të njëjtin bosht , që ka për bazë vrimat e hundës të imazhit të shenjtorit (fig. 4)[7].

Sistemi metrik që ka ndjekur Onufri në punimin e pjesës tjetër të trupit ngjason me rregullin e simetrisë të ushtëtarit të Poliklitit dhe të Apoksiomenit të Lisipit, forma të cilat u bartën në pikturën bizantine dhe kanë parim fillestar përdorimin e masës së

7 Leonardo collection, *Anatomy for artist 4*, 31.

COPY NOT



Fig. 3, E3-E7-E8



Fig. 3, E6-E9-10



Fig. 3, E1-E5



Fig. 3, B-E & E-Θ

pothuaj 7½ - 8 kokave në ndërtimin e gjatësisë së trupit[8].

Tek ikona e Shën Helenës vëmë re se piktori ynë e skicon fytyrën e shenjtores duke pasur si pikë referimi syrin e majtë të saj, masën e të cilit e përdor gjashtë herë, për shkak të ballit që bëhet më i ulët si pasojë e pozicionit të kurorës (fig. 5, B-Θ). Kjo mënyrë ndërtimi thekson ballin e ulët të shenjtores, mbi të cilin qëndron kurora.

Për sa i përket gjerësisë së fytyrës së shenjtores, vëmë re se ajo është e barabartë me gjerësinë e syrit marrë për katër, ndryshe nga fytyra e Shën Konstandinit, fytyra e të cilit është e barabartë me syrin marrë 4½ herë (fig. 5, Δ2-Δ7)

Gjegjësisht tek sistemi simetrik, të cilin ka ndjekur Onufri për krejt trupin e Shën Helenës, ky ka parim bazë masën e 8 kokëve për ndërtimin e trupit (fig. 6)[9]. Përfundimisht, për ikonën që shqyrtojmë mund të themi se, pavarësisht dëmtimet e vogla që ka pësuar në sipërfaqen e pikturimit, për sa u përket ngjyrave, fytyrat e shenjtorëve janë ekzekutuar me

8 Plini Plak: *Περί της αρχαίας ελληνικής ζωγραφικής. 35ο βιβλίο της φυσικής ιστορίας,* 307. Leonardo collection, *Anatomy for artist 4*, 3.

9 I. Βράνος, *Η τεχνική της αγιογραφίας,* Τόμος Β', 87.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5, B-Θ



Fig. 5,Δ2-Δ7

parashtresë të jeshiles së çelur, e cila përbën bazën e ngjyrës, mbi të cilën Onufri krijon ëmbël dhe me penelata të holla pjesët trupore me rozë të çelur.
Nga këndvështrimi artistik Onufri ia del të nxjerrë në pah figurat e nderuara të të barabartëve me Apostujt, Konstandinit dhe Helenës, duke përdorur ngjyrat e dheut në fytyrë dhe duke veçuar me qartësi shprehëse tiparet e shenjtorëve përmes përgatitjes së butë, duke i paraqitur shikuesit përjetimin e realitetit transhendental[10].
Arti i tij dallohet për fisnikërinë e formave, eklektizmin e motiveve dhe kaligrafinë e mbishkrimeve. Vetë piktori shquhet si njohës i shkëlqyer i skicës dhe pikturës, duke krijuar një "shkollë pikture" që njihet si Shkolla e Beratit[11].

DO NOT COPY

10 Manastiri i Shenjtë i Pararendësit të Nderuar, *Τι ξέρεις εσύ για τις εικόνες;* 42-43. Pikturimi i shenjtorëve në Kishën Ortodokse përbën një rikujtim të vazhdueshëm të përmbushjes së Saj, sepse "[qeniet] që kalben do të ngjërojnë paprishje, kurse qeniet e vdekshme do të ngjërojnë pavdekësi", pra përmasa lëndore e qenieve njerëzore do të japë frut shpirtëror. Κ. Καλοκύρη, *Η ζωγραφική της Ορθοδοξίας. Ιστορική αισθητική και δογματική ερμηνεία της βυζαντινής ζωγραφικής*, Θεσσαλονίκη: 1972, 163.

11 Μ. Γαρίδης *Μεταβυζαντινή Ζωγραφική (1450-1600) Η εντοίχια ζωγραφική μετά την πτώση του Βυζαντίου στον Ορθόδοξο κόσμο και στις χώρες υπό ξένη κυριαρχία,* 271 κ.ε.

Artikulli origjinal nga greqishtja u përkthye nga z. Sokol Çunga



DO NOT COPY

Fig. 6. [12]

12 Muzeu i Artit Bizantin, M.B.П., 2006, 75.

Bibliografi e përzgjedhur:

Βράνος Ι., *Η τεχνική της αγιογραφίας, Τόμος Α',* Θεσσαλονίκη: Ιδιωτική, 1985.

Βράνος Ι., *Η τεχνική της αγιογραφίας, Τόμος Β',* Θεσσαλονίκη: Ιδιωτική, 2001.

Γαρίδης Μ., *Μεταβυζαντινή Ζωγραφική (1450-1600) Η εντοίχια ζωγραφική μετά την πτώση του βυζαντίου στον Ορθόδοξο κόσμο και στις χώρες υπό ξένη κυριαρχία,* Αθήνα: Σπανός, 2007.

Διονύσιος εκ Φουρνά, *Ερμηνεία της βυζαντινής ζωγραφικής τέχνης,* Αθήνα: Σπανός, 1997.
Ευσέβιος Παμφύλου, «Λόγος εἰς τόν βίον τοῦ Μακαρίου Κωνσταντίνου τοῦ Βασιλέως», *PG* 20, 943-944.

Ιερά Μονή Τιμίου Προδρόμου, *Τι ξέρεις εσύ για τις εικόνες;* Αθήνα: Ετοιμασία, 2001.

Jakumis K., «Vlerësim estetik i veprës së piktorit Onufri dhe dëshmia e tij në Shqipërinë e Mesme», Mihail Naço-Xhevair Lleshi Redak., *Mijëvjeçari i ri i miqësisë heleno-shqiptare*, Tiranë: Uegen, 2004, 183-186.

Καλοκύρης Κ., *Η ζωγραφική της Ορθοδοξίας. Ιστορική αισθητική και δογματική ερμηνεία της βυζαντινής ζωγραφικής,* Θεσσαλονίκη: 1972.

Καραγιάννη Α., *Ο σταυρός στη βυζαντινή μνημειακή ζωγραφική: Η λειτουργία και το δογματικό του περιεχόμενο,* Θεσσαλονίκη: Κ.Β.Ε., 2010.

Κόρδης Γ., *Αυγοτέμπερα με υποζωγράφιση. Το χρώμα ως φως στη βυζαντινή ζωγραφική. Θεωρία και πρακτική»* Αθήνα: Αρμός, 2009.

Leonardo collection, *Anatomy for artist 4*, Milano: Vinciana, 1987.

Mioni E., *Εισαγωγή στην Ελληνική Παλαιογραφία*, Μτφρ. Νικολάου Μ. Παναγιωτάκη, Αθήνα: Μ.Ι.Ε.Τ., 1977.

Μουσείο Βυζαντινού Πολιτισμού, *Εικόνες από τις Ορθόδοξες κοινότητες της Αλβανίας. Συλλογή Εθνικού Μουσείου Μεσαιωνικής τέχνης Κορυτσάς,* Θεσσαλονίκη: Μ.Β.Π., 2006.

Πλίνιος ο Πρεσβύτερος, *Περί της αρχαίας ελληνικής ζωγραφικής. 35ο βιβλίο της φυσικής ιστορίας,* Αθήνα: Άγρα, 1994.

DO NOT COPY

Popa, Th., «Të dhëna të reja rreth piktor Onufrit», *Studime Historike 1* (1966) 141-145.

Popa, Th., «Onufri ikonograf i shquar Shqiptar», *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës 1*, Tiranë 1962, 54-75.

Puzanova, V., «Piktori shqiptar i shekullit të XVI Onufri nga Neokastra –Elbasan», *Buletin për Shkencat Shoqërore 3*, Tiranë 1953, 8-23.

Ράπτης Κ., «Το ένδυμα», Χ. Μπακιρτζής (Επιμ.) *Άγιος Νικόλαος ο Ορφανός. Τοιχογραφίες,* Θεσσαλονίκη: Ακρίτας, 2003.

Τούρτα Α., *Οι ναοί του αγίου Νικολάου στη Βίτσα και του αγίου Μηνά στο Μονοδένδρι,* Αθήνα: Υπουργείο Πολιτισμού, 1991.

Χατζηδάκης Μ.-Δρακοπούλου Ε., *Έλληνες ζωγράφοι μετά την άλωση (1450-1830),* Αθήνα: Ε.Ι.Ε., Τόμοι 1 & 2, 1987.

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Joannis Sarijannidis*

DECODING THE AESTHETICS AND METRIC SYSTEM OF THE GREAT PAINTER ONUFËR FROM ELBASAN. THE EXAMPLE OF THE MOVING ICON OF THE SAINTS, EQUAL TO THE APOSTLES CONSTANTINE AND HELEN.

DO NOT COPY

The grand 16th century icon of Saint Constantine and Helen, by Onufri, a painter from Elbasan, measuring 87,5x58X3,2 cm, probably comes from the iconostasis of the sacred temple of Saint Constantine and Helen in Berat, and is now exhibited in the National Museum of Medieval Art of Korca.

What makes this image distinguish from others is the harmony of painting composition and the use of a metric system in the depiction of saints. Also, painter's colorful palette impresses with his strong, rich and brilliant colours.

Onufri, as a painter, expresses himself through his icons with self-confidence, quality and precious willfulness.

Onufri and his work influenced the Post-Byzantine art in Albania and his artistic spirit formed an iconographic school in Albania, which is called the "*School of Berat*".

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Era XHAFERAJ
Skënder BUSHI
Renald META

DO NOT COPY

RRËNOJAT E KISHËS SË SHËN GJERGJIT NË FSHATIN MËRTISH (LUSHNJË). RAPORT PARAPRAK.

Të dhëna historike

Rrethi i Lushnjës dhe zona e Myzeqesë në tërësi, përfaqëson një ndër krahinat më të populluara të Shqipërisë. Rrethinat e saj paraqesin një ekonomi të zhvilluar bujqësore, me intensitet të lartë ndërtimesh, të periudhave të ndryshme. Kushtet e përshtatshme të relievit dhe klimës kanë favorizuar një popullim të dendur të kësaj treve, e cila dëshmohet edhe nëpërmjet mbetjeve të kulturës materiale. Të dhënat më të hershme arkeologjike në zonë datojnë në periudhën e Neolitit[1], ndërsa nuk mungojnë dhe gjetje të epokës së Bakrit dhe të Bronzit të Hershëm[2]. Këto territore përshkoheshin nga traseja e rrugës pararomake, që kalonte nëpër luginën e Shkumbinit, e cila përbënte një arterie të rëndësishme tregtare dhe ekonomike, që mundësonte komunikimin ndërkrahinor për trafikun ndërmjet dy qyteteve të mëdha të Adriatikut, Apolonisë dhe Dyrrahut, por dhe pjesë e rëndësishme e një arteri rrugor me rëndësi, që lidhte bregdetin e Ilirisë me Thesalinë dhe krahinat kufitare të Greqisë Veriore[3].

Ekzistenca e kësaj rruge kushtëzoi lindjen e vendbanimeve të tilla, siç është evidentuar në sondazhet dhe gërmimet në fshatin Babunjë, ku janë zbuluar rrënojat e një qyteze të periudhës antike[4]. Përdorimi i kësaj rruge vazhdoi edhe gjatë

1 Kjo datë dëshmohet nga sëpata prej guri e gjetur në kodrat në veri të qytetit të Lushnjës dhe sëpata e gurit e zbuluar në Karbunarë të Vogël. Shih: Çuko, P., "Gjetje prehistorike nga rrethi i Lushnjë (Prehistoric findings from Lushnjë district)", *Iliria*, 1987, 1, f. 221 – 222.

2 Epoka e bakrit dhe e bronzit të hershëm përfaqësohet nga gjetjet në kodrën Gallovë (Ballagat). Shih: Çuko, P., "Gjetje prehistorike nga rrethi i Lushnjës (Prehistoric findings from Lushnjë district)", Iliria, 1987, 1, f. 221 – 222.

3 Adami, J., "Historia e rrugëve të Shqipërisë, I, Rrugët e Shqipërisë në kohën antike (Histoire des routes d'Albanie, I. Les communications dans l'antiquite)", Buletin për Shkencat Shoqërore, 1953, 1, f. 36 – 65; Ceka, N., - Papajani, Ll., "Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike. (La route de la vallee de Shkumbin dans l'antiquite)", Monumentet, 1971, 1, f. 43 – 59; Ceka, H., "Dega jugore e rrugës Egnatia", Monumentet, 2, 1971, f. 25 – 32; Hammond, L. G. N., "The Western Part of the via Egnatia", The Journal of Roman Studies, Vol. 64 (1974), f. 185 – 194; Ceka, N., "Rrugët dhe shekujt. (Les routes et les siecles)", Monumente të Kulturës në Shqipëri, 1975, 2, f. 17 – 22.

4 Çuko, P., "Gërmimet arkeologjike të vitit 1988 – Babunjë (Lushnjë) (The archaeological excavations of the year 1988 in Babunjë of Lushnjë)", Iliria, 1988, 2, f. 254 – 255; Po ai, "Gërmime arkeologjike të vitit 1989 – Babunjë (Lushnje)", Iliria, 1989, 2, f. 274; Në dekadën e fundit, ekspedita shqiptaro–gjermane ka ndërmarrë gërmimet sistematike, të cilat kanë si qëllim zbulimin e qytezës antike të Babunjës, me të gjithë komponentët e saj, si sistemi urbanistik, banesa, etj., dhe të evidentojë raportet e saj me qytetet kryesore si Apolonia dhe Durrësi. Shih: Fiedler, M., Döhner, G., Panczel, S. – P., "Babunjë: Eine Spätarchaisch – Klassische Kleinsiedlung Zwischen Apollonia und Dyrrhachion (Albanien)", L'Illyrie Méridionale et L'Epire dans L'Antiquité, VIe Colloque International – VI – Actes du VIe colloque international de Tirana, 20-30 mai 2015, Volume III), f. 1003 – 1016.

Mesjetës[5].

Gërmimet sistematike të kryera në varrezën e dystë në Kodrën e Rërës, pranë fshatit Gërmenj, në vendin që njihet nga banorët vendas me toponimin "Sopi i Bukur", zbuluan material kulturor që datonte nga Bronzi i Hershëm deri në Mesjetë[6].

Në fakt, roli i rëndësishëm i këtij territori dokumentohet gjatë gjithë historisë mesjetare.

Krahas tokave pjellore dhe kulturës së prodhimit të grurit, lagunave të shumta, ku ndër më të mëdhatë ajo e Karavastasë (καραβόστασις, stacion anijesh), pasuritë natyrore si druri, i cili përdorej për ndërtimin e anijeve[7], kriporet e shumta[8], kjo krahinë vlerësohej edhe për tregtinë e bagëtisë dhe të kuajve në veçanti.

Të gjitha këto burime kishin kushtëzuar zhvillimin e tregtisë dhe eksporteve, ku rol të rëndësishëm në shkëmbimin e mallrave kishte deti dhe lumenjtë që përshkonin territorin, grykëderdhjet e të cilëve, të thellë dhe të hapur, krijonin kushtet e favorshme për qarkullimin e anijeve në brendësi të vendit[9].

Gjatë gjithë Mesjetës nëpër këto vise kalojnë dhe mbivendosen një seri pushtetesh dhe sundimtarësh, që i lënë vendin njëri tjetrit, si Bizantinët; Matrangët, zotërinjtë e Karavastasë me qendër Pojanin; Stefan Dushani i Serbisë (rreth vitit 1343 – 1344); Aranitët dhe Muzakajt e Beratit, me ndihmën e sundimtarëve të tjerë, si Balshajt e Shkodrës, të cilët arritën të zgjeronin shtrirjen e tyre territoriale në pjesën më të madhe të Myzeqesë[10], duke e përfshirë atë në Despotatin e Beratit[11], dhe më vonë Topiajt e Durrësit.

Raguza dhe Venediku, në raporte ekonomike të drejtpërdrejta, ushtruan edhe ato ndikimin e tyre në rrethanat historike të kësaj treve[12].

Pavarësisht burimeve të shumta, të pakta janë monumentet që datohen gjatë kësaj periudhe dhe botimet që lidhen me to. Ato konsistojnë në tekste kryesisht me karakter restaurimi (si p. sh.

Manastiri i Ardenicës)[13], botime të përgjithshme nën kuadrin e zhvillimit të arkitekturës pas bizantine në Shqipëri[14] si dhe monografi dhe artikuj nën kuadrin

5 Rruga Durrës – Vlorë vazhdoi të përdorej dhe gjatë Mesjetës. Shih: Adami, J., Rrugë dhe objekte arkeologjike në Shqipëri, Tiranë, 1983, f. 62.

6 Andrea, Zh., Varre të periudhës antike dhe mesjetare në Gërmenj (Rrethi i Lushnjës) (Ancient and medieval graves in Gërmenj – Lushnjë district), Iliria, 1988, 1, f. 169 – 187; Po ajo, Një varrezë e dystë në fshatin Gërmenj/rrethi i Lushnjes/ (La necropole de Gërmenj), Iliria, 1981, 1, f. 219 – 226.

7 Ducellier, A., La façade maritime de l'Albanie au Moyen Age. Durrazzo et Valona du XIe ai XVe siècle, Thessaloniki, 1981, f. 6, 60.

8 Sipas të dhënave dokumentare Matranga kishte në pronësi kriporet e lagunës së Karavastasë, në vendin e quajtur Slanicë. Shih: Raguse, Div. Canc,. I; Acta Albaniae, I, no. 528, f. 156 – 157.

9 Adami, J., *Rrugë dhe objekte arkeologjike në Shqipëri,* Tiranë, 1983, f. 62.

10 Për herë të fundit për Matrangët dëgjojmë në vitin 1360 për Vlash Matrangën, ndërsa në vitin 1374, duket se zotërimet e tij i kanë kaluar Karl Topisë. Muzakajt gjithashtu përfituan nga vdekja e Vlash Matrangës duke u imponuar në grykëderdhjen e Shkumbinit në 1371, kohë kur ishin në apogjeun e tyre. Matrangët dhe Muzakajt ua lënë vendin princave të fuqishëm të Durrësit. Shih: Ducellier, A., La façade maritime de l'Albanie au Moyen Age. Durrazzo et Valona du XIe ai XVe siècle, Thessaloniki, 1981.

11 Soulis, G. Ch., The Serbs and Byzantium during the reign of of Tsar Stephen Dušan (1331 – 1355) and his successors, Washington D. C., 1984, f. 138 dhe 142.

12 Ducellier, A., La façade maritime de l'Albanie au Moyen Age. Durrazzo et Valona du XIe ai XVe siècle, Thessaloniki, 1981; Xhufi, P., Nga Paleologët te Muzakajt. Berati dhe Vlora në shekujt XII – XV, Tiranë, 2009.

13 Adhami, S., "Një ansambël monumental në Myzeqe", Tradita ndërtimore në Shqipëri, 1981, f. 18 – 24; Mihalçka, S., "Manastiri i Ardenicës dhe konservimi i pikturës murore të tij", Monumentet, 2, 1986, f. 77 – 97; Gega, R., "Arkitektura dhe restaurimet në manastirin "Fjetja e Shën Mërisë" në Ardenicë", Monumentet, 1, 1988, f. 141 – 176; Mihalçka, S., Beçi, M., "Rezultate të ekzaminimit dhe të punimeve restauruese në pikturën murore të manastirit të Ardenicës gjatë viteve 1984 – 1985", Monumentet, 2, 1988, f. 107 – 110.

14 Thomo, P., Kishat Pasbizantine në Shqipërinë e Jugut, Botim i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë, 1998, f. 206 – 209.

DO NOT COPY

e studimit të aktivitetit artistik të piktorëve të njohur të periudhës pas bizantine siç janë Kostandin Shpataraku[15], vëllezërit Zografi[16] apo familja Çetiri[17], aktiviteti i të cilëve dhe ikonografëve të tjerë të periudhës në këtë zonë është dokumentuar edhe nëpërmjet mbishkrimeve të shumta në objektet e kultit të krishterë[18], duke krijuar një këndvështrim më të plotë rreth volumit të punës që u atribuohet këtyre atelieve të rëndësishme të kohës.

Kontributet e mësipërme e kanë pasuruar vazhdimisht hartën arkeologjike të zonës dhe kanë injektuar në ndërgjegjen e popullsisë lokale rëndësinë për vlerat kulturore, monumentale, historike dhe artistike të saj. Në këtë kontekst, identifikimi, evidentimi dhe paraqitja e një raporti paraprak mbi kishën e Shën Gjergjit, përfaqëson një vlerë të shtuar për zonën dhe plotëson panoramën historike dhe kronologjike të saj[19].




Fig. 1. Vendndodhja e Kishës së Shën Gjergjit, lagja Korie – Mërtish

Kisha e Shën Gjergjit

Kisha e Shën Gjergjit ngrihet në pllajën e kodrës me të njëjtin emër, 45,5 m mbi nivelin e detit, në lagjen Korie të fshatit Mërtish (Fig. 1). Nga burimet e deritanishme dokumentare nuk ka të dhëna të mjaftueshme të cilat i referohen monumentit. Në regjistrin e sanxhakut të Arvanidit, i vitit 1431, gjejmë një referencë ndaj fshatit Ajo Jorgji, i cili kishte statusin e mezraa – së, në nahijen e Myzeqesë, me dajlan[20]. Sipas rregullit termi mezraa përdorej për qendrat e vjetra, popullata e të cilave ishte shpërndarë[21]. Siç dihet, në Anatolinë perëndimore dhe në Ballkan osmanët trashëguan pronat rurale bizantine, së bashku me fshatrat dhe vendbanimet.

Në kohën e bizantinëve, nga shek. X e më tej, tokat mezraa nën varësinë e një fshati ishin të njohura ndryshe si agridia ose proasteia, një term i përdorur për tokat e banuara nga popullsi fshatare ose për të përcaktuar periferinë nga qendrat qytetare[22].

15 Popa, Th., "Piktor Kostandini prej Shpati", Buletin për Shkencat Shoqërore, 1955, 4, f. 211 – 214; Drishti, Y., Marika, Z., Kostandin Shpataraku (Piktor i Artit Mesjetar Shqiptar), Tiranë, 1992; Mbishkrimet e ikonave në kishën e manastirit të Ardenicës janë përkthyer nga Th. Popa, ku gjenden informacione për kohën e pajisjes së ikonostasit me ikona në vitet 1739, 1744, dhe piktorin që u angazhua, domethënë jerodhiakon Kostandini nga Shpati. Dy mbishkrime të tjera të realizuara në pikturë, në brendësi të kishës, tregojnë për kohën e ndërtimit të manastirit në vitin 1744 dhe datën e pikturimit të tij nga dora e vëllezërve Kostandin dhe Athanas Zografi nga qyteti i Korçës. Shih: Popa, Th., Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë, 1998, f. 96 – 97, mbishkrimet nr. 115 dhe 117.

16 Popa, Th., "Piktorët korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi dhe freskat e tyne me skenat e Apokalipsit", Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Nr. 1, 1959, f. 24.

17 Popa, Th., "Piktorët grabovarë Çetiri nga familja Katro", Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria e Shkencave Shoqërore, 3, 1960, f. 121.

18 Popa, Th., Mbishkrime të kishave në Shqipëri, Tiranë, 1998.

19 Sinjalizimi i parë për ekzistencën e rrënojave, krahas hartave të shek. XX, vjen nga Niko Ferro, drejtor i Muzeut Historik të Lushnjes.

20 Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit i Vitit 1431, Akademia e Studimeve Albanologjike, 2017, f. 185; Mezraja Ajo Jorgji – e cila ka dajlan, iu kthye Ozgurit, dhëndrit të Dhimitri Prespës, pasi i ishte dhënë Zaganos Beut. Nga Mezraaja Ajo Jorgji nxirreshin të ardhura 400 a.

21 Shih për termin Mezraa: Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit i Vitit 1431, Akademia e Studimeve Albanologjike, 2017, f. XLI dhe XLII; Inalcik, H., Faroqhi, S., An Economic and Social History of the Ottoman Empire, Volume 1: 1300 – 1600, Cambridge University Press, 1994, f. 163 – 165.

22 Kazhdan, A., Oxford Dictionary of Byzantium,

DO NOT COPY

Toponimi Ajo Jorgji e ka dukshëm origjinën nga një ndërtim kishtar që ndodhej në këto prona dhe, duke marrë në konsideratë faktin që i vetmi monument aty rrotull, që ka elementë të cilat e datojnë në periudhën bizantine është kisha e Shën Gjergjit, mund të hamendësojmë se ishte pikërisht ajo që i kishte dhënë emërtimin pronave përreth saj dhe në afërsi të Divjakës, të cilat përmenden dhe në regjistrin osman të vitit 1431.

Në shek. XIX, Mitropoliti erudit i Beratit Anthimos Aleksudhi, rendit në fshatrat që përfshihen në enorinë e Shakuj edhe fshatin Mërtish, i cili, për nevojat liturgjike përdorte kishën e Shën Mitrit[23].

Dijetari i njohur nuk përmend kishën e Shën Gjergjit. Kisha e Shën Mitrit, ndodhet në pjesën e poshtme, pranë lumit Seman, çka tregon se kisha e Shën Gjergjit në këtë periudhë e kishte humbur funksionin dhe rolin e saj. Pavarësisht këtyre të dhënave, duket se kisha e Shën Gjergjit nuk ka qenë tërësisht e panjohur për komunitetin shkencor.

Në fillim të shek. XX, G. Veith, i referohet kodrës dhe kishës së Shën Gjergjit, në kuadrin e interpretimit të tij për vendosjen e kampeve kundërshtare të Pompeut dhe Cezarit, në afërsi të fshatit Gradishtë, por pa dhënë një datim lidhur me të apo të dhëna të tjera[24].

Me sa duket ekzistenca e kishës, e cila i ka dhënë kodrës ku ngrihet emrin e vetë, është trashëguar në kujtesën e popullsisë lokale, por tashmë me krijimin




Fig. 2. Planimetria provizore e Kishës së Shën Gjergjit

e fshatrave të rinj dhe ndërtimin e kishave të reja përreth së cilave organizohen fshatrat, rezonanca e emrit të kishës së Shën Gjergjit përkufizohet vetëm në kodrën ku ajo ngrihet.

Arkitektura

Kisha ka orientim Lindje – Perëndim, e spostuar nga Lindja në drejtim të Jugut 18° (Fig. 2).

Muratura e saj paraqet dy teknika ndërtimi të ndryshme; muri verior dhe lindor bazohet në ndërtimin me teknikë tipike bizantine, me gurë shtufi dhe tulla të lidhur me llaç (Fig. 3, a – b). Gurët e shtufit, me gjasë të marrë nga kodrat përreth, dhe tullat janë vendosur me breza të rregullt, duke krijuar efektin e kluasonazhit. Trashësia e mureve është rreth 80 cm. Tullat e përdorura kanë përmasa:

New York, New York and Oxford, United Kingdom: Oxford University Press, 1991, f. 1724.

23 Teksti i plotë: Enoria/famullia e Shakuj përbëhet prej fshatrave Shakuj, Stan Shakuj, Goriçaj, Këmishtaj, Sopëz, Shënepremte, Mërtish dhe Senesa, të cilat kishin një total prej 96 familjesh, që kryenin liturgjinë e tyre në kishën enoriake të Shën Kollit në Këmishtaj dhe në paraklisin e Shën Thanasit në Goriçaj dhe të Shën Mitrit në Mërtish, ku i vizitonte një prift. Αλεξούδη, Δ. Α., Σύντομος Ιστορική Περιγραφή της Ιεράς Μητροπόλεως Βελεγράδων, Κέρκυρα, 1868, f. 57.

24 Veith, G., Der Feldzug Von Dyrrhachium Zwischen Caesar und Pompejus, Wien, 1920, f. 95 – 96.

DO NOT COPY



Fig. 3a. Pamje e përgjithshme e nikes, së bashku me fillimin e faqes veriore të apsidës



Fig. 3b. Faqja veriore e murit të Kishës

18 x 31 x 6,5cm[25].

Në anën veriore të kishës, në pjesën e jashtme të murit, është integruar një pllakë guri ranor me përmasa 150 x 55 x 10 cm, ndoshta e ripërdorur si material ndërtimor (Fig. 4, a – b). Në murin jugor dhe perëndimor vërehet një tjetër teknikë ndërtimi, me gurë të lidhur me llaç, në fugat e të cilit janë integruar copëra qeramike, të cilat kanë shërbyer për nivelimin e sipërfaqes dhe për arritjen e lidhjes



Fig. 4a. Gjurma e pllakës ranore e shkëputur nga faqja e jashtme e murit verior



Fig. 4b. Pllaka ranore e përdorur në faqen e jashtme të murit verior

më të mirë. Në anën jugore ndodhet edhe hyrja e vetme e cila u identifikua në terren. Vlen për të përmendur që në anën jugore të kishës vazhdon dhe vargu kodrinor, mbi të cilin ngrihet dhe manastiri i Ardenicës.

Në afërsi të kishës, në të njëjtin izoips me të, janë identifikuar gjurmët e një kulle, e ndërtuar me gurë konglomerati. Nga të dhënat e deritanishme nuk mund të sugjerojmë apo të vërtetojmë një lidhje organike midis kishës dhe kullës, si dhe kronologjinë e saktë të gjurmëve të mbetura, për të cilat do të lipsej organizimi i disa sondazheve arkeologjike. Megjithatë, bazuar në të dhënat që ofron terreni dhe ekzistenca e gjurmëve të tjera të gurëve, mund të kemi të bëjmë me një fortifikim të

25 Në një prej tullave është vërejtur monogrami X.

DO NOT COPY




Fig. 5a. Kisha e Shën Gjergjit në raport me kullën



Fig. 5b. Kisha e Shën Gjergjit në raport me kullën, foto ajrore (projekti shqiptaro – gjerman në Babunjë)

DO NOT COPY

mundshëm, ndoshta të një periudhe më të hershme (Fig. 5, a – b).

Probleme që lidhen me arkitekturën e kishave të periudhës bizantine janë adresuar në disa studime, qoftë të karakterit përgjithësues edhe në artikuj të veçantë[26]. Nga të dhënat e deritanishme, nëse i referohemi përmasave të naosit, i cili vjen si një katror thuajse i rregullt, me përmasa 7 x 7,16 m, dhe teknikës së ndërtimit, kryesisht muri lindor i cili është punuar tërësisht në kluasonazh, mund të hedhim hipotezën se planifikimi origjinal konsiston në një kishë, me arkitekturë tip kryq i brendashkruar me kupolë mbi tambur, me mbështetje të brendshme, e variantit provincial. Në anën lindore të kishës ndodhet ambienti i altarit, i cili përbëhet nga apsida qendrore trefaqëshe nga jashtë dhe rrethore nga brenda, dhe pastoforet, niket e protezisit dhe diakonikonit, të cilat janë trefaqëshe, të dala nga muri lindor (Fig. 3a). Në pikëpamje të formës planimetrike dhe formulimit arkitektonik, kisha e Shën Gjergjit lidhet me monumente të tjera të së njëjtës tipologji, të cilat janë mjaft të përhapura në Shqipërinë e Jugut dhe përfaqësojnë variantin provincial të këtij tipi. Shembulli më i hershëm i kësaj tipologjie në Shqipëri ndeshet në kishën e Asomatit në Velçë, datuar në shek. X[27], dhe reflektohet edhe në ndërtime të tjera si kisha e Shën Triadhës (Berat, shek. XIII)[28], Shën Maria Vllaherna (faza I, shek. XIII)[29], Shën Maria në Kosinë (shek. XII)[30], dhe kisha e Shën Triadhës në Lavdar të Oparit (shek. XV)[31], një ndër shembujt më të vonë të arkitekturës tip kryq i brendashkruar me kupolë.

Elementë të tjerë, si absida dhe pastoforet, janë të rëndësishëm në drejtim të përcaktimit të një datimi më të ngushtë rreth monumentit. Apsida dhe niket e protezisit dhe diakonikonit që janë poligonale nga jashtë dhe rrethore nga brenda mbizotërojnë në krahinat që ishin nën influencën e Kostandinopojës. Apsidat poligonale futen në provincë nga fundi i shek. X, ndërsa apsidat rrethore vazhdojnë të përdoren në monumentet me tipare arkaizuese të shek. X – XI[32], si në kishën e Labovës së Kryqit[33],

26 Millet, G., L'École grecque dans l'architecture byzantine, Paris, 1916; Meksi, A., Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII – XV), Tiranë, 2004; Ćurčić, S., "Architectural Significance of Subsidiary Chapels in Middle Byzantine Churches", Journal of the Society of Architectural Historians, Vol. 36, No. 2 (May, 1977), f. 94 – 110.

27 Muçaj, S., Xhyheri, S., Ristani, I., Pentkovskiy, M. A., "Medival churches in Shushica valley (South Albania) and the Slavonic bishopric of St. Clement of Ohrid", Slověne, 1, 2015, f. 5 – 42, fig. 4.

28 Thomo, P., "Mbi dy monumente të arkitekturës sonë mesjetare në shek. XI – XIV", Studime Historike, 4, 1972, f. 56 – 59; Meksi, A., "Tri kisha bizantine të Beratit", Monumentet, 4, 1972, f. 63 – 73; Po ai, "Kishat bizantine të Beratit", Monumentet, 2, 1990, f. 38; Γιακουμής, Γ., Μνημεία 'Ορθοδοξίας στην 'Αλβανία, 'Αθήνα 1994, f. 136 – 138.

29 Meksi, A., "Tri kisha bizantine të Beratit", Monumentet, 4, 1972, f. 59 – 63; Po ai, "Kishat bizantine të Beratit", Monumentet, 2, 1990, f. 37 – 38.

30 Thomo, P., "Mbi dy monumente të arkitekturës sonë mesjetare në shek. XI – XIV", Studime Historike, 4, 1972, f. 51 – 56; Meksi, A., "Restaurimi i kishës së Kosinës në Përmet", Restaurimi 1985, Tiranë, 1986, f. 11 – 14; Γιακουμής, Γ., Μνημεία 'Ορθοδοξίας στην 'Αλβανία, 'Αθήνα 1994, 144 – 145.

31 Meksi, A., Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII – XV), Tiranë, 2004, f. 221 – 222.

32 Koch, G., "Disa mendime për kishën e Labovës së Kryqit", Monumentet 1, 1987, f. 36 – 37 (27 – 63); Nga fillimi i shek. XI në Greqi mbizotërojnë kishat, të cilat kanë absida trefaqëshe ndërsa tamburet me tetë faqe. Për sa i përket apsidës pesëfaqëshe, ajo nuk duket se del përpara shek. XIV. Shih: Millet, G., L'École grecque dans l'architecture byzantine, Paris, 1916, f. 181 – 182; Megjithatë, në Kostandinopojë kemi daljen e apsidave pesëfaqëshe qysh në kohën e Komnenëve, të cilat përbëjnë një infiltrim lindor në kryeqytetin bizantin, transplantim i një tipi nga Kapadokia apo Likaonia (Azi e Vogël), por që u refuzua për shumë gjatë në provinca. Shih: Lathoud, D., "L' école de Constantinople dans l'architecture byzantine - Conférence donnée à l'École des Hautes-Études de Kadi-Keuï", Échos d'Orient, tome 24, n°139, 1925, f. 308 – 309; Një rast të tillë në territorin e Shqipërisë përfaqëson kisha e Apolonisë, me arkitekturë tip kryq i brendashkruar me kupolë, ku apsida është pesëfaqëshe, ku lidhjet me Kostandinopojën janë evidentuar prej kohësh. Shih: Meksi, A., "Arkitektura dhe datimi i kishës së Apolonisë", Monumentet, 1, 1971, f. 103 – 115; Po ai, "Disa probleme të kishës së manastirit të Apolonisë", Monumentet, 12, 1976, f. 233 – 236.

33 Meksi, A., "Dy kisha bizantine në rrethin e

DOKTORATURA

kishën e Marmiroit[34], kishën e Shën Marisë në Peshkëpi të Sipërme, kishën e Shën Mëhillit në Kostar (rrënojë) etj.

Për nga forma trefaqëshe e apsidës, kisha e Shën Gjergjit është e ngjashme edhe me kisha të tjera të ndërtuara në territorin tonë, si faza I në kishën e Profet Ilisë në Buhal (shek. XI – XII)[35], Shën Mitri në Bezmisht, faza I[36], Shën Jovani në Boboshticë (faza I)[37] kisha e Ristozit në Mborje (shek. XIV)[38], Shpërfytyrimi në Herbel (shek. XII – XIII)[39], Shën Triadha në Berat, Shën Maria Vllaherna, bazilika nën xhaminë e Fatihut në Durrës[40], kisha 9 në fshatin mesjetar të Kamenicës, e cila ndodhet në vendin që mban toponimin Fiqt' e Lape (shek. X)[41], kishën e Peshkëpisë në Nivicë – Bubar (shek. XII)[42], Shën Premte në Sop[43], por ajo ndryshon prej tyre për nga forma poligonale e nikeve të protezisit dhe diakonikonit dhe dalja e tyre në murin lindor, element që e vërejmë vetëm në kishën e Shën Kollit në Perhondi, dhe që lidhet me fazën e parë të ndërtimit të bazilikës, e datuar në shek. XI[44].

Në një areal më të gjerë territorial, apsidat trefaqëshe i gjejmë edhe në monumente të Greqisë, si kisha e Shën Stefanit në Kostur (shek. IX – X)[45], Shën Nikola në Aulis të Beotisë[46], kisha e Panagias në manastirin e Hosio Loukas (shek. X), e cila ka dhe pastoforet të dalë në formë apsidash trefaqëshe dhe shërbeu si model edhe për kisha të tjera të territorit të Greqisë me planin e saj kryq i brendashkruar me kupolë dhe teknikën e ndërtimit në kluasonazh[47]; të Maqedonisë së Veriut, si kisha e Shën Pandelejmonit në Nerezi pranë Shkupit (1164)[48], të datuara në periudhën e mesme bizantine.

Teknika e ndërtimit të kishës paraqitet mjaft kanonike, por ende nuk është arritur në kluasonazhin tipik që vërejmë në monumentet e së njëjtës tipologji, të cilat datojnë pak më vonë.

Në rastin e Shën Gjergjit theksohet më tepër linja horizontale me tulla; dy radhë tullash ndajnë blloqet e gurëve, të cilët jo gjithmonë ndahen nga

Gjirokastrës", Monumentet, 9, 1975, f. 82 – 91; Γιακουμής, Γ., Μνημεία 'Ορθοδοξίας στην 'Αλβανία, 'Αθήνα 1994, f. 54 – 57.

34 Meksi, A., "Restaurimi i kishës së Marmiroit", Monumentet, 2, 1971, f. 73 – 82; Po ai, Arkitektura mesjetare në Shqipëri, Tirana 1983, f. 125 – 128; Koch, G., "Einige Bemerkungen zur Kirche in Marmiro/Albanien", DChAE, Τόμος ΚΖ΄ (2006), f. 43 – 48; Ndërsa për pikturën murale shih: Xhaferaj, E., Nesturi, E., "Piktura e kishës së Marmiroit në Orikum", Monumentet, 56, 2017, f. 97 – 106.

35 Meksi, A., "Disa kapela bizantine të vendit tonë", Monumentet, 10, 1975, f. 80 – 81, Tab. VII.

36 Po aty, f. 82 – 83, Tab. VI.

37 Po aty, f. 81 – 82; Meksi A., Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII – XV), Tiranë, 2004, f. 176 – 177.

38 Thomo, P., "Arkitektura e kishës së Ristozit në Mborje të Korçës", Studime Historike, 2, 1967, f. 151 – 159, fig. 9; Meksi, A., "Të dhëna mbi rindërtimin e kupolës së kishës së Ristozit në Mborje", Monumentet, 4, 1972, f. 199 – 200.

39 Po aty, f. 84, Tab. VI.

40 Meksi, A., "Kishat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut (vijim)", Monumentet, 1, 1984, f. 112 – 113, Tab. IV.

41 Ristani, I., Fshati mesjetar i Kamenicës. Studimi i rrënojave arkeologjike – arkitektonike dhe rijetëzimi i tyre, Tezë në kërkim të gradës shkencore "Doktor", Tiranë, 2016, f. 138 – 144, Tab. CLXII, CLXIII, CLXIV.

42 Muçaj, S., Hobdari, E., Vitaliotis, Y., "Kisha mesjetare e Peshkëpisë në Nivicë – Bubar (Sarandë)", Candavia, 2, 2005, f. 273 – 300, fig. 2.

43 Meksi, A., "Disa kapela bizantine të vendit tonë", Monumentet, 10, 1975, f. 85 – 86.

44 Meksi, A., "Arkitektura dhe Restaurimi i kishës së Perondisë", Monumentet 5 – 6, 1973, f. 19 – 39; Po ai, Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII – XV), Tiranë, 2004, f. 153; Për afresket e kishës referohu: Rousseva, R., "The legend of the last emperor and an unpublished eschatological scene from St. Nicholas church in Perhondi village (Albania, 14th century)", Niš and Byzantium, VI, 2007, f. 231 – 243; Dhamo, Dh., Thaçi, F., Piktura mesjetare e Beratit, Monumentet, 2, 1988, 89 – 95.

45 Epstein, W. A., "Middle Byzantine Churches of Kastoria: Dates and Implications", The Art Bulletin, Vol. 62, No. 2 (Jun., 1980), f. 190-207, fig. 2.

46 Μπούρας, Χ., "Συμπληρωματικά στοιχεία για ένα κατεστραμμένο ναό της Βοιωτίας", DChAE, 4, (1966), 227 – 244.

47 Chatzidakis, M., Hosios Loukas. Byzantine art in Greece, Melissa, Greece, 1997, f. 13 – 18, fig. 3.

48 Sinkević, I., The Church of St. Panteleimon at Nerezi: Architecture, programme, patronage, Reichert, Wiesbaden 2000; Po ajo, "Western chapels in middle byzantine churches: meaning and significance", Starinar, LII, 2002, f. 79 – 91, fig. 1.

DOKTORATË

njëri tjetri me tulla vertikale, por në të shumtën e rasteve janë copëra të vogla tullash, të cilat kryejnë kufizimin midis blloqeve.

Njëkohësisht, ripërdorimi i materialit ndërtimor i periudhës antike, kryesisht në pjesën e poshtme të ndërtimit, është një tjetër karakteristikë në muraturën e kishës.

Orvatjet për një lloj përpunimi plastik të sipërfaqes vërehen kryesisht në murin lindor, ku pjesa e sipërme e nikeve të apsidës dhe të pastoforeve janë ndërtuar thuajse tërësisht me tulla, ndërsa dritarja e vetme e ruajtur në niken e protezisit, kurorëzohet nga një hark prej dy radhë tullash.

Të gjitha këto tipare arkaike, të cilat vërehen në ndërtimin e jashtëm, si dhe analiza analogjike për sa i përket artikulimit planimetrik dhe formës së apsidave, e çojnë datimin e monumentit në periudhën e mesme bizantine, midis shekujve X – XII.

Konkluzione

Përgjithësisht mund të pohojmë se sinteza e monumentit përshkohet nga një frymë arkaike, e cila shkon paralelisht edhe me monumente të tjera në territor, të cilat janë të së njëjtës tipologji ndërtimore. Mbetjet e ndërtesës së përshkruar përfaqësojnë vetëm pjesë të rrënojave të ruajtura. Autorët, bazuar në formën planimetrike që rezulton nga dokumentimi i mureve ekzistuese dhe elementëve të tjerë, mbështesin hipotezën se bëhet fjalë për një kishë me arkitekturë tip kryq i brendashkruar me kupolë. Këto të dhëna do të qartësohen më tepër në të ardhmen, kur të realizohet vëzhgimi më i plotë sipërfaqësor i kodrës dhe gërmimi i monumentit të identifikuar, në mënyrë që të zbulohen edhe faza të tjera të tij (nëse ka); në fakt ndërtesa aktuale përfaqëson vetëm kishën e një strukture ndoshta më komplekse, ndoshta të një manastiri. Gjithashtu duket se rrënojat e ekspozuara, kisha dhe kulla, nuk janë të së njëjtës periudhë dhe poshtë mureve aktuale të kishës, mund të fshihen struktura më të hershme.

DO NOT COPY

Era XHAFERAJ
Skënder BUSHI
Renald META

THE RUINS OF THE CHURCH OF ST. GEORGE IN THE VILLAGE MËRTISH (LUSHNJE)

A PRELIMINARY REPORT

The byzantine church of St. George in Mërtish (Lushnje) is little known by the documentary sources and the scientific community. Based on the graphic and the photographic documentation of the church, the authors of this article aimed the reconstruction of the plan and the parallel study and close survey of a series of architectural elements preserved in situ, like the building material employed. Finally, the present article makes some remarks on the form of the monument, the masonry, the type of the windows, the plastic rendering of the surfaces, etc. Based on the data collected during the field survey on the monument, the layout of the main elements as well as the dimensions of the building, it is suggested that the architecture belongs to that of cross – in – square type of the churches. The archaic elements in the masonry constitute further important data for drawing morphological similarities with other accurately dated ecclesiastic buildings and for sustaining the chronological placement of the monument in middle byzantine period.

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Arbela KISI

SKULPTURA DEKORATIVE NË EKSONARTEKSIN E KISHËS SË SHËN MARISË, APOLONI

DO NOT COPY

Për njohjen e ndërtimeve të kultit, një kontribut të mirë jep edhe studimi i skulpturës dekorative arkitektonike, që edhe pse janë gjetje të rastit paraqesin dëshmi me mjaft vlerë. Pra, skulptura ishte një traditë e zhvilluar në vendin tonë. Ajo shfaqej në shumë territore si Kotorri, Ulqini, Tivari, Durrësi, Pojani, Kurjani, Drinopoja apo siç tregojnë edhe mbetjet e bazilikës së Ballshit. Ato kanë karakteristika të përbashkëta me artin bizantin dhe atë të brigjeve të Adriatikut, dëshmi e lidhjeve, por njëkohësisht edhe e nivelit dhe traditës artistike në këto treva, ku me sa duket Durrësi ishte qëndra[1]. Por, për një periudhë gati tre shekullore, ajo pëson një lloj ndërprerjeje për t'u asimiluar sërish prej atelieve lokale, të cilat në kontakt me bregdetin italian dhe qendrat e tjera të rëndësishme, importuan dhe zhvilluan qëndrimet e reja në këtë gjini të artit. Kjo duket edhe tek skulpturat e fasadës së eksonarteksit të kishës së Shën Marisë në Apoloni (Fig. 1).

Autorët Hayde dhe Helmuth Buschhauzen supozojnë se në dhjetëvjeçarin e parë të shek. XII, në kohën e invazionit të dytë norman në Shqipëri, së bashku me Boemundin nga Italia e Poshtme (1107-1108), të kenë ardhur edhe gurëgdhendës dhe artista normanë dhe benediktinë. Ato i kanë shtuar Kishës së Shën Marisë në Apoloni, në anën perëndimore, një eksonarteks (hajat i përparmë) të pajisur me arkadë. Sipas tyre, kjo arkadë ngjason me sistemin e kolonave të galerive të mbyllura të benediktinëve të Apulisë, të cilat datohen që nga shek. XI deri në fillim të shek. XII. Gjithashtu, kapitele me kafshë të kësaj arkade i përgjigjen veprave të restaurimit Italian të Apulisë, sidomos galerisë së mbyllur të San Benedetos në Konversano, ndërtuar pak përpara vitit 1110 [2].

Gjergj Frashëri në studimin e tij rendit tre elemente të njohura për kohën e ndërtimit të eksonarteksit: 1) tablonë perandorake familjare në eksonarteks, 2) mbishkrimin në dy copa gurësh në këndin JP të saj dhe 3) mbishkrimin në njërën nga pilastrat e kolonadës. Edhe Aleksandër Meksi[3] mendon se pikturimi i tablosë familjare duhet të jetë realizuar në të njëjtën kohë me ndërtimin e eksonarteksit, i cili ka krijuar kushte për t'i mbrojtur afresket nëpërmjet çatisë. Meqënëse në tablonë familjare është pikturuar perandori Androniku II Paleologu, mendohet se ky fresk duhet të jetë realizuar pas vdekjes së tij (1328). Në qoftë se tabloja do të ishte realizuar gjatë kohës së mbretërimit të Andronikut II (1282-1328), ajo do të kishte zënë vend më të

1 Anamali, S., "Rreth skulpturës dekorative arkitektonike të bazilikës së Ballshit", Tiranë: *Iliria 2*, 1981, 237 – 242; Muçaj, S., "Kisha e Shën Marisë së Ballshit (Glavenicë). Probleme të identifikimit dhe datimit të saj", Tiranë: *Iliria 1-2*, 2001-2002, 259-281; Meksi, A., *Arkitektura e kishave të Shqipërisë*, Tiranë: Uegen 2004, 138 – 139.

2 Buschauzen, H und H., *Die Merienkirche von Apollonia in Albanien (Byzantiner, Normanen und Serben in Kampf um die Via Egnatia)*, Wien 1976, 17, 234, 235; Simone, S., *Il mostro della Puglia, ossia la storia del celebre monastero di S. Benedetto di Conversano*, Pansini, Bari 1885; Balenci, P., *Gli esaforati del chiostro di San Benedetto in Conversano e della chiesa di Santa Maria in Apollonia (Albania)*, Firenze: La Zincografia 1986, 35-54.

3 Meksi, A., *Arkitektura e kishave të Shqipërisë*, Tiranë: Uegen 2004, 138 – 139.




Fig. 1. Eksonarteksi i kishës së Shën Marisë (Apoloni)

nderuar, në naos ose të paktën në muret e narteksit, por jo jashtë tyre. Prandaj viti i rënies së perandorit Androniku II Paleologut do të konsiderohet si *terminus post quem* i kohës së ndërtimit të eksonarteksit [4].

Mbishkrimi i realizuar në vend, në dy copa gurësh në këndin JP të eksonarteksit, i cili bën fjalë për vdekjen e një igumeni në vitin 1350, tregon se në këtë kohë eksonarteksi ka qënë ndërtuar. Pra viti 1350 është një *terminus ante quem* për ndërtimin e eksonarteksit ndoshta edhe të kolonadës së tij. Bindjen për këtë përfundim e jep mbishkrimi në pilastrën e mesit të krahut të majtë të kolonadës, i cili është një gur varri me datën 1380 dhe i kthyer përmbys. Vendosja e kësaj pilastre e cila ndryshon nga të tjerat edhe si material edhe si plastikë e gdhendjes, i takon një meremetimi mjaft të pjesshëm të kolonadës. Gurët e harkut që mbështeten në të janë rikonstruktuar disa kohë më vonë se viti 1380. Në bazë të këtyre të dhënave del se eksonarteksi së bashku me kolonadën janë ndërtuar midis viteve 1328–1350. Pra, për Gjergj Frashërin përjashtohet mundësia e çfarëdo hipoteze për ndërtimin e tyre nga normanët apo benediktinët e Apulisë në fund të shek. XI ose në fillim të shek. XII.

Por, si shpjegohet ngjashmëria rigoroze e teknikës së ndërtimit me gurët e mëdhenj të Apolonisë klasike midis kishës dhe eksonarteksit? Pikërisht kjo ngjashmëri e madhe teknikash në këto dy

4 Frashëri, Gj., "A ka arkitekturë shqiptare në mesjetë? Bisedë me çiftin Buschauzen", Tiranë: *Nëntori 1*, 1983, 181.

DO NOT COPY

krijime të realizuara në diferencë të konsiderueshme kohe, por që tentojnë të unifikojnë një ndërtesë të vetme, është treguesi më kuptimplotë që ligjëron në aspektin e artit të të ndërtuarit në kishën e Apolonisë, forcën e një tradicioni të qëndrueshëm shumëshekullor[5].

Në shek. XIV, arkitektët, konstruktorët dhe zejtarët gurëskalitës të Durrësit janë të njohur për ndërtimet e tyre, jo vetëm në Evropën Juglindore, por edhe më tej. Në artin dhe kulturën e sferës perëndimore, shkolla e Durrësit, vazhdon të ketë edhe në këtë shekull rrezatimin e saj, i cili ende nuk është dokumentuar sa duhet. Në mënyrë të veçantë ky kontribut njihet në Dalmaci dhe në Italinë e Veriut. Vetëm nga një atelie tradicionale, ajo e krahinës rreth Tivarit, njihen nga kjo periudhë mbi 40 mjeshtra e artista arbëreshë, të cilët u thirrën të punojnë në bregdetin dalmatin: faltore, ura, kështjella. Çifti Buschauzen bën një analogji midis eksonarteksit të Apolonisë dhe Kolonadës së Kuvendit të Fretërve Françeskanë në Dubrovnik (Samostan – Mala Braca). Sipas tyre ato janë krejtësisht të një stili, të së njëjtës teknikë e plastikë dhe nën një orientim artistik në harqe, kolona dhe kapitele. I vetmi ndryshim i tyre në vijë të përgjithshme është se kolonada e eksonarteksit është realizuar me kolona njëshe, ndërsa ajo e Kuvendit të Fretërve me sistem dykolonash[6].

Eksonarteksi ka qenë i mbuluar me piktura, jo vetëm në faqen lindore. Duke u nisur dhe nga gjurmët e pikturës në zona të tjera të eksonarteksit, mendohet se ai fillimisht ka pasur një tjetër konstruksion, nga i cili ruhet vetëm faqja lindore dhe shtresa e pikturës në vazhdimësi. Më vonë gjatë viteve 1275 – 1282, vihet si kufi viti 1275, mbasi sipas burimeve historike më 1275, u pushtua Berati dhe më vonë Vlora e bregdeti nga bizantinët, mbasi u dëbuan prej andej anzhuinët[7]. Pra, është rindërtuar eksonarteksi dhe ndoshta dhe pjesë të tjera të kishës dhe manastirit, është rritur çatia në nivelin e sotëm duke murosur relievin që ndodhet në faqen jugore sipër në kufi me narteksin dhe është ndërtuar kolonada me tetë kapitele siç ruhet përgjithësisht në ditët tona. Midis relievit të faqes jugore dhe skulpturës tjetër të kapiteleve të kolonadës shihet një ngjashmëri mjaft e madhe, në karakterin e formës, zgjidhjes stilistike dhe frymës groteske e romanike që vë re edhe Ducellier në skulpturën e kapiteleve të kolonadës[8].

Interpretimet e datave të tjera, me të cilat lidhet ndërtimi i eksonarteksit, që ekzistojnë në gurin e pilastrës nga veriu i kolonadës, vendosur përmbys me datë 1380 dhe mbishkrimi që gjendet në murin lindor të eksonarteksit me datë 1350, duhet të shihen si të dyshimtë, për arsye se po të shihet me kujdes kolonada, vihet re se ajo ka pësuar rindërtim, që ka ndryshuar edhe pilastrat si dhe ndonjë kolonë dhe kapitel origjinal ndërsa pilastra tjetër e ka të adaptuar formën e bazamentit. Po ashtu edhe kolona e shtatë duke numëruar nga veriu, është e ripërdorur, është më e gjerë dhe me një teknikë punimi të ndryshëm. Gjithashtu, kapiteli i kësaj kolone duket i ribërë, mbasi nuk ruan atë thellësi

5 Frashëri, Gj., *Vep. Cit.* 181-182.

6 *Historia e Shqipërisë, Vëllimi I*, Tiranë 1959, 217; Frashëri. Gj., "A ka arkitekturë shqiptare në mesjetë? Bisedë me çiftin Buschauzen", Tiranë: *Nëntori 1*, 1983, 182.

7 Ostrogorsky, G., *Storia dell Impero bizantino*, Torino: Einaudi 1968, 419.

8 Ducellier, A., *Observations sur quelques monuments d'Albanie*, "Revue Archeologique", Vol II, Octobre-Decembre 1965; Aleksudhi mendon se kisha duhet të jetë ndërtuar në kohën e mbretërimit të Andronikut II Paleolog (1282-1328). *Shih: Aleksudhi, A., *Sintomos istoriki perigrafi tis jeras Mitroplos Velegradon*, Korkira 1888, 76-80; Theofan Popa mbasi interpreton skenën e pikturës me paraqitjen e Paleologëve, mendon se kisha është ndërtuar në kohën e Mihalit VIII Paleolog kur bashkësundonte me të birin, Andronikun dhe vendos si kufi vitet 1264-1282. *Shih: Popa, Th., "Saktësime rreth datimit të kishës së manastirit të Apolonisë", Tiranë: *Studime Historike 1*, 1967, 137-144; Popa, Th., "Mbishkrimet e kishave të Shqipërisë si burime historike", Tiranë: *BSHSH 1*, 1958, 239-240; Për skenën e pikturës së faqes lindore të eksonarteksit flet edhe V. Puzanova, e cila e interpreton atë si të dedikuar Andronikut II Paleolog (1282-1328). *Shih: Puzanova, V., "Manastiri Shën Maria e Apolonisë-Pojan", Tiranë: *BSHSH III*, 1961, 147-153; Nallbani, H., "Të dhëna të reja rreth pikturës së kishës së manastirit të Apollonisë", Tiranë: *Monumentet 11*, 1976, 102.

DOKTORI

forme dhe ka një karakter punimi më primitiv e më grotesk se të tjerët. Veç kësaj, mbi pilastrën qëndrore që ka kanalin përcjellës të ujërave për në çisternë, qëndron një kapitel pa funksion, i cili duket qartë se ka qënë bërë për t'u vendosur në kolonadë. Është i qartë fakti se monumenti ka ekzistuar para periudhës 1275-1282, kohë e cila lidhet me pikturimin e afreskut të Paleologëve dhe rindërtimin e eksonarteksit[9].

Për mendimin tim eksonarteksi ka ekzistuar edhe përpara viteve 1281 – 1282. Në të janë realizuar disa rindërtime. Eksonarteksi është rindërtuar në vitet 1275 – 1282 (datë e pikturimit të tablosë perandorake në formën dhe në nivelet e sotme të mureve dhe të çatisë dhe së bashku me çisternën). Eksonarteksi në formën e sotme i takon rindërtimit të tij pas vitit 1381, të marrë nga mbishkrimi i përmbysur në pilastrin më në veri të arkadës që duhet konsideruar një terminus post quem. Gjatë kësaj kohe është ndërtuar dhe kolona e shtatë nga veriu dhe pilastrat nuk janë origjinale. Që prej vitit 1381[10] në eksonarteks nuk është vënë më dorë.

Kur vështron skulpturën e kapiteleve të eksonarteksit, të vjen ndërmend termi latin *mirabilia*. Ky koncept i referohet vëzhgimit të një fenomeni apo diçkaje ende të panjohur, por edhe përfshirjes emocionale që vjen prej saj: çudi, befasi, admirim para diçkaje të jashtëzakonshme, të panjohur, të përsosur, monstruoze që kërkon të zbulohet, sepse dëshiron të të paralajmërojë ose të të mësojë të mendosh rreth të mirës dhe të keqes, virtyteve dhe veseve.

Virtytet janë konceptuar qysh në antikitet nga filozofët, në veçanti Platoni. Më pas adaptohen nga feja e krishterë, për të kanalizuar shpirtin njerëzor drejt rrugës së Zotit. Sipas katër virtyteve kryesore njeriu duhet të jetë i matur, i drejtë, i fortë për të përballuar vështirësitë në jetë dhe në ekuilibër me gjithçka që e rrethon. Përveç virtyteve njerëzore dallohen edhe virtytet intelektuale (dija, shkenca dhe intelekti). Por mbi të gjitha qëndrojnë virtytet teologjike që bëjnë të mundur jetesën e njeriut me Trinitetin: Besimi, Shpresa dhe Bamirësia[11].

Veset kryesore janë një listë e devijimeve të thella (të moralit dhe sjelljes), të shpirtit njerëzor shpesh të quajtura, ndofta edhe në mënyrë të gabuar, mëkatet kryesore. Këto vese shkatërrojnë shpirtin njerëzor, duke iu kundërvënë virtyteve, që promovojnë dhe nxisin rritjen. Janë quajtur "kapitale – kryesore" sepse janë më të mëdha, më të rënda se sa thellësia e natyrës njerëzore. Përshkrimi i veseve shfaqet tek Aristoteli, i cili i përkufizon si "veshje e së keqes". Ashtu sikurse virtytet, veset përftohen nga përsëritja e veprimeve. Ajo formon tek njeriu që i kryen "një veshje", e cila e orienton të devijojë sjelljen. Lista e veseve është hartuar qysh në krishtërimin e hershëm, nga priftërinjtë, Evagrio Pontico dhe Cassiano. Evagrio, në ato kohë, klasifikonte tetë "shpirtra dhe mendime negative" si dhe rrugët për t'i luftuar ato:

1) grykësia
2) epshi
3) kopracia
4) zemërimi, inati
5) trishtimi (melankolia)
6) përtacia
7) zilia
8) krenaria

Me kalimin e kohës hiqet trishtimi (melankolia) nga lista dhe ngelen shtatë vese kapitale. Gjatë iluminizmit, nuk kishte diferencë midis veseve dhe virtyteve sepse e rëndësishme ishte zhvillimi material (industrial, tregtar dhe ekonomik). Filozofi Kant, do t'i përfshijë sërish në veprat e tij, duke

9 Kjo është koha e ndërtimit ose rindërtimit edhe të çisternës, mbasi vërehet që sipërfaqja e pllakave të dyshemesë që mbulon atë që ka qënë e suvatuar me shamot për hidroizolim që arrin deri në kufirin e bazamentit të kolonadës. *Shih: Nallbani, H., "Të dhëna të reja rreth pikturës së kishës së manastirit të Apollonisë", Tiranë: *Monumentet 11*, 1976, 102-103; Popa, Th., *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë: Akademia e Shkencave 1998, (Nr.89), 83.

10 Po në murin verior, në Portik ndodhet një mbishkrim tjetër i gdhendur. I përket gurit të varrit të një murgu të manastirit dhe mban datën 6 dhjetor 1381. *Shih: Meksi, A., *Arkitektura e kishave të Shqipërisë*, Tiranë: Uegen 2004, 222 – 227; Meksi. A., *Arkitektura mesjetare në Shqipëri*, Tiranë: 8 Nëntori 1983, 166 – 175.

11 Chiesa Cattolica, Catechismo della Chiesa Cattolica, Città del Vaticano: 1992; Croce, B., *Filosofia della pratica*, Bari: 1908; *Dizionario dei concetti biblici nel Nuovo Testamento*, Bologna: Edizioni Dehoniane, 1976.

DO NOT COPY

ngjallur interes për filozofinë morale, psikologjinë njerëzore dhe teologjinë. Vesi, sipas Kantit, ishte një shprehje e tipologjisë humane dhe pjesë e karakterit të njeriut[12].

Analizë e skulpturës dekorative të kapiteleve të kolonadës. Numërimi fillon nga veriu.

Kapiteli 1, paraqitje hibridi (Fig. 2).

Kokë njeriu me gjuhën jashtë dhe trup kafshe. (Vesi – Zilia).

Zilia është një gjendje shpirtërore që e detyron




Fig. 2. Kapiteli 1 Paraqitje hibridi. Kokë njeriu me gjuhën jashtë dhe trup kafshe. (vesi – Zilia)

njeriun të ndjejë mëri dhe zili për dikë që ka cilësi të mira, posedon pasuri, ka sukses ose shihet me sy të mirë në shoqëri. Zilia është aq e madhe, sa tjetrit i uron të keqen. Zilia e djeg përbrenda ziliqarin, aq sa e pëson nga ligësia e tij. Gjuha e gjatë dhe gjarpri i shpifjeve i kthehet kundër dhe e godet në sy, aq sa e verbon[13].

Ekzistenca e krijesave fantastike, zoomorfe, imagjinare dhe monstruoze është një temë shumë e përhapur në art. Akoma më tepër është e pranishme gjatë mesjetës, duke u kthyer në një motiv konstant në kisha, mozaikë, miniaturë dhe në kozmografinë e të gjitha vendeve të Europës. Një varietet kaq i pasur ikonografik nuk mund të lind nga asgjë. Ai tërhiqet nga një traditë e gjatë shekullare, që me ngadalë përcaktoi karakteristikat, duke u rrënjosur në të gjitha shtresat e popullsisë. Trashëgimia teratologjike, që nënkupton krijesat zoomorfe, antropomorfe dhe hibride, përshkruar nga një dinamikë metamorfike, është një sediment i së kaluarës (periudha arkaike, mitologjia greko-romake, Bibla, lindje e afërt dhe e largët). Mesjeta nuk krijoi forma ex novo por merr, thekson, ndot, keqkupton imazhe të traditës. Origjina e kafshëve mostruoze duhet kërkuar në periudha shumë të hershme të historisë së njerëzimit. Sipas ligjit pars pro toto (një pjesë nga e gjitha), besohej se ishte e mjaftueshme për të kapur pjesën më të rëndësishme të çdo kafshe, në mënyrë që të mund të merrnin karakteristikat, pavarësisht nëse ishin fuqi, shpejtësi apo elegancë. Kështu, ishte e mundur bashkimi i pjesëve të ndryshme të kafshëve, me qëllim gjenerimin e një hibridi që ishte në gjendje të përmbledhë të gjitha tiparet e zotëruara nga fragmentet individuale[14].

12 Casagrande, C., e Vecchio, S., *I sette vizi capitali. Storia dei peccati nel Medioevo*, Einaudi: 2000, 282–306; Schumacher. M., *Catalogues of Demons as Catalogues of Vices in Medieval German Literature*: 'Des Teufels Netz' and the Alexander Romance by Ulrich von Etzenbach: Richard Newhauser, In the Garden of Evil. The Vices and Culture in the Middle Ages, Toronto: Pontifical Institute of Mediaeval Studies, 2004, 277–290; Kant, I., *Antropologia pragmatica*, Laterza, 2001.

13 Battaglia, S., *Grande Dizionario della Lingua Italiana*, Utet, (1961-2002); Dante., *Purgatorio XIII*, vv. 43-84.

14 Baltrušaitis, J., *Sei lezioni di storia dell'arte*, Torino 2000, Allemandi, U., & Baltrušaitis, J., *Il Medioevo fantastico. Antichità ed esotismi nell'arte gotica*, Gli Adelphi 1997, Camille, M., *Image on the edge. The margins of Medieval art*, London: Reaktion Books 1992; Le Goff. J, *L'uomo medievale*, Roma-Bari, Laterza 1990; Mâle, É., *Le origini del Gotico: l'iconografia medievale e le sue fonti*, Milano: Jaca Book 1986; Sebenico, S., *I mostri dell'Occidente medievale: fonti e diffusione di razze*

DO NOT COPY

Kapiteli 2, çift hibridësh (Fig. 3).
Kokë njeriu dhe trup shqiponje. (Vesi – Epshi, Tërheqja drejt gjërave të këqija). Versioni femëror i çiftit të mësipërm përfaqëson hibridin e njohur në antikitet dhe mesjete si Arpia (kuptimi është hajdute – të marr diçka). Në mitologjinë greke ato janë krijesa mostruoze me fytyrë gruaje dhe trup



Fig. 3. Çift hibridësh. Kokë njeriu dhe trup shqiponje (Arpia)

zogu (shqiponje). Ato simbolizojnë edhe stuhinë detare, epshndjelljen si dhe transportojnë shpirtin e njerëzve për në botën e përtejme. Popullariteti i tyre i detyrohet natyrës demoniake, por jo të neveritshme. Ato janë cituar shpesh edhe në veprat e Homerit, Virgjilit dhe Dantes[15].

Por a kanë lidhje sirenat me arpiat (kuptimi është hajdute – të marr diçka? Nëse po, cila është kjo lidhje dhe si u realizua transformimi i sirenës nga Grua-Shpend në Grua Peshk?
Kalimi nga qielli (grua-shpend) në det (grua-peshk) nuk është aq i rastësishëm, por ka një kuptim simbolik. Zogjtë janë pjesë e qiellit dhe në një farë mënyre pjesë e natyrës hyjnore. Kjo është në përputhje edhe me sirenat që mbahen si shpërndarëse të dijes. Por, nga ana tjetër deti përfaqëson edhe rrezikun dhe krijesat e saj mund të kenë natyrën e shpërndarësve të fatkeqësisë ose shpëtimit, por gjithashtu i referohet edhe thellësive, humnerës dhe banorët e tij mbajnë ende një natyrë primitive dhe të egër. Tritoni përshkruhet me një oreks të fortë seksual dhe kështu sirena mesjetare, një simbol i epshit bëhet një krijesë e detit[16].
Vepra më e vjetër që citon sirenat është Odisea. Kujtojmë shkurtimisht episodin:
Odisea është lajmëruar nga Çirçe për rrezikun që shkakton kënga e sirenave, prandaj kujdeset që të mbyll me dyll veshët e shokëve që e shoqërojnë ndërsa ai vetë, si kurioz që është, kërkon që ta lidhin fort tek direku i anijes. Në këtë mënyrë ai dëgjon këngën sensuale të sirenave, por nuk mund të tundohet dhe të shkoj drejt tyre. Përderisa sirenat dështuan, si ndëshkim duhet të hidheshin në det dhe të shndërroheshin në gurë. Meqënëse karakteristika e sirenave është kënga atëherë ato duhet të përshkruhen si zogj dhe jo si peshk. Në fakt edhe Dante, sirenat i përshkruan me tiparet e arpiave ashtu sikurse edhe qeramika e antikitetit[17].
Versioni mashkullor i sirenës është Tritoni. Në mitologjinë greke është djali i Poseidonit (Zot i detit) dhe Anfitrite (Nereida). Origjina e tij është pregreke, ndoshta fenikase (*Shih: Dagon). Shpesh

umane mostruose, ibridi ed animali fantastici, Università degli Studi di Trieste, A. A. 2005.

15 Trupi i zogut tek kapiteli nr. 2, të kujton edhe bufin. Bufi në mesjetë mishëronte vdekjen, Djallin, natën dhe paralajmëronte diçka të keqe. Është një zog nate që nderohej nga shtrigat. Virgilio, *Eneide, III*, 210-217, Dante, *Inferno, XIII*, vv. 10-15, Omero, *Odissea, libro XX*, Arpia in "*Enciclopedia dell' Arte Antica*" – Treccani, arpia: Definizione e significato di arpia | Dizionario di Italiano Garzanti.

16 Kerényi, K., *Gli dei e gli eroi della Grecia. Il racconto del mito, la nascita delle civiltà*, il Saggiatore 2010, 61-63.

17 Omero, *Odissea, XII*, 39-54; 158-200, Patroni, G., "Intorno al mito delle Sirene", *in Riv. di filol., XXI* (1891), 321-40, Dante, *Purgatorio, XIX*, 19-21, "Sirena" in *Enciclopedia Italiana – Treccani.*

DO NOT COPY



Fig. 4.1.-4.3 Çift hibridësh. Kokë njeriu dhe trup peshku (Tritoni bifida + Sirena bifida)

ai paraqitet me bisht të dyfishtë (bifida)[18].

Kapiteli i pilastrit qendror: Çift hibridësh (Fig. 4.1-4.3).

Kokë njeriu dhe trup peshku. (sirenë bifide + triton bifidë). Sirenat bifide (me dy bishta) janë simbol i fertilitetit, lindjes, oreksit seksual, epshndjelljes. Ato gjatë periudhës gotike tejmbushnin kapitelet e kishave derisa kthehen në figura të njohura dhe të domosdoshme për të përcjellë një mesazh. Shpesh të sjellin ndërmend Sheela-na-Gig (përkufizim popullor që do të thotë, Xhulia prostitutë), të vendosura një herë e një kohë në hyrjen e kishave të vjetra irlandeze. Ato ishin figura femërore pa bisht, por me këmbë të hapura që duhet të mbronin nga syri i keq dhe forcat e këqija. Sirenat bifide dhe tritonët janë imazhe të përsëritura në artin romanik (Pavia, Como dhe vende të tjera të Europës). Përveç natyrës së dyfishtë, grua – peshk, bishti i dyfishtë kontribuon për të nënvizuar dykuptimësinë si dhe për ta bashkëngjitur me shenjën astrologjike të peshqve[19].

Në traditën mesjetare, sirena identifikohej me Melusina, një grua që ishte normale për gjithë javën dhe të shtunën transformohej në sirenë. Kur burri i zbuloi bishtin atëherë ajo u shndërrua përgjithmonë në sirenë dhe u kthye në habitatin e saj të parë, ujin. Në mitologjinë e shumë vendeve të botës ndeshen gra me bisht peshku që të magjepsin, që dalin nga uji për të joshur të dashurit e tyre. Sirena përfaqëson rrezikun e aventurës, pikërisht një nga përbërësit e takimit burrë-grua dhe të procesit të të dashuruarit. Kujtojmë sirenat tek Odisea Homeri; Mamy Wata (Zonja e Ujit), që ndeshet në traditën afrikane; apo Yemanja në Brazil, që ngatërrohet shpesh me kultin

18 Carassiti, A. M., *Dizionario di mitologia greca e romana*, Roma: Newton & Compton, 1996; Tritone *nell'Enciclopedia Treccani.*

19 Arecchi, A., *Sesso e Chiesa*: *Profano e Sacro*, Antikitera.net; Murray. M, "Female Fertility Figures," in *Journal of the Royal Anthropological Institute*, Vol. LXIV (1934); McMahon, J., & Roberts, J., *The Sheela-na-Gigs of Ireland and Britain: The Divine Hag of the Christian Celts – An Illustrated Guide*, Mercier Press Ltd. 2000.

DO NOT COPY

e Shën Marisë. Edhe në Pavia, Borgo Ticino, njihet tradita e "Zonjës së Ujit", legjendë që lidhet edhe me "Shën Marinë e Yllit"[20].

Përsa i përket kapitelit të tretë dhe të pestë, gjithmonë duke filluar numërimin nga veriu, mund të themi se ajo që i bashkon është shqiponja, por mënyra e realizimit të kësaj skulpture dekorative, i jep karakteristika të ndryshme këtyre kapiteleve.

Kapiteli 3 Shqiponja me krahët hapur mbrapa. (Vesi–Krenaria, Mendjemadhësia). (Fig. 5-6).

Libri "Shtatë veset", hartuar nga Gregorio Magno në shek. VI, pati një sukses që shkoi përtej



Fig. 5. Kapiteli 3 – Shqiponja (Krenaria)

imagjinatës së autorit, sepse u konceptua si një realizim perfekt teologjik për të individualizuar dhe klasifikuar mëkatet. Ky sistem u bazua tek numri shtatë, sepse ishte një numër që ndeshej gjithmonë në Shkrimet e Shenjta dhe kujtonte gjithashtu

20 John, H., *Sacred Waters: Arts for Mami Wata and other divinities in Africa and the diaspora*, Bloomington: Indiana University Press, 1; De La Torre. M., *Santería: the beliefs and rituals of a growing religion in America,* Grand Rapids, Mich.: William B., Eerdmans Pub. Co. 97–98.

edhe shtatë ditët e javës. Ky impiant i realizuar nga Gregorio, jo vetëm bënte lidhjen ndërmjet mëkateve, por vendoste dhe një hierarki midis tyre. Në fillim, ishte mendjemadhësia, kopracia dhe pastaj vinin gjithë të tjerët. Tërësia e tyre reflektoi në mesjetë idenë e së keqes si dhe nxiti njeriun të kërkonte shpëtim tek virtytet. Sipas Biblës, njeriu nuk duhet të ishte krenar dhe mendjemadh, por të qëndronte tek vendi që Zoti kishte përcaktuar për të. Ai duhet të respektonte organizimin shoqëror, sipas modelit hyjnor dhe të mos synonte autoritetin. Njeriu mesjetar duhet t'i bindet superiorëve të tij,




Fig. 6. Kapiteli 5 – Shqiponja (Inati,Zemërimi)

priftërinjve, klerikëve, mbretit, Zotit. Në planin intelektual dhe mendor duhet t'i qëndroj besnik Biblës dhe baballarëve të kishës. Kështu që, një nga virtytet më të mëdha të njeriut mesjetar mbi baza fetare, duhet të jetë bindja dhe jo krenaria[21].

Disa teologë shikojnë tek shqiponja imazhin e Krishtit, që ka ardhur në tokë për të udhëhequr

21 Moneti, A., *Medioevo ereticale, La demonologia medievale, Il concetto del male nel Medioevo*, 2005, 2.

DO NOT COPY

njerëzit drejt rrugës së Zotit. Disa të tjerë në të kundërt, shohin tek ky shpend i tmerrshëm, të pajisur me sqep të stërmadh dhe kthetra të përkulura që dallohet si gllabërues i qënieve të gjalla dhe të vdekura, mishërimin e Djallit. Bestiario Ashmole, në fund të shek.XII, e përkufizon si "grabiqar të tmerrshëm të shpirtrave". Shqiponja në fakt, si pjesa më e madhe e zogjve gjahtarë, të jep idenë e grabitqarit, të pangopësisë, mizorisë dhe për më tepër të krenarisë. Në fund të mesjetës, shumë imazhe e personifikojnë vesin e krenarisë me një burrë të veshur për festë që ka hipur mbi një deve, që shtrëngon në dorë një mburojë me pamjen e një luani dhe palloi dhe që mbi kokë mban një përkrenare me shqiponjë. Të katërta këto kafshë simbolizojnë krenarinë. Pra simbologjia mesjetare për shqiponjën ka dy kuptime. Ky grabiqar shihet si një kafshë e vështirë, autoritare, shpesh mizore, që ngjall frikë tek shpendët e tjerë. Jo vetëm britmat e saj të zemërimit kalojnë retë dhe terrorizojnë ata që e dëgjojnë, por pamja e saj është kaq madhështore, aq imponuese, kaq e rëndë saqë të gjithë janë të frikësuar. Asnjë bishë nuk guxon ta sulmojë, sepse ashtu sikurse ariu dhe luani (mbretër të kafshëve) edhe shqiponja si mbretëreshë e qiejve është e pathyeshme. Në antikitet, Aristoteli dhe Plini e konfirmonin shqiponjën si zog të perëndive, Zeusit dhe Jupiterit. Por edhe në mesjetë, ajo konfirmonte idenë e sovranitetit dhe autoritetit[22].

Qysh tek Platoni, Aristoteli (Etica a Nicomaco), e deri tek Shën Thomai (Il male), e Dante (Purgatorio), përmendet zemërimi, si një tendencë dhe impuls natyror i njeriut. Zemërimi, për Shën Thomain, përcakton si pasionin ashtu edhe vesin, sepse sipas tij, zemërimi, është një nga pesë pasionet që numërohen së bashku me shpresën, dëshpërimin, guximin dhe frikën. Zemërimi, megjithatë, ka natyrë ambivalente sepse është "një pasion që është disi i përbërë nga pasionet shtypëse". Por, në teologjinë biblike kristiane njihet edhe "Zemërimi i Zotit", që manifestohet ndaj gjithçkaje që është mëkatare. Kjo të kujton "Gjykimin e fundit", kur vesi dhe mëkati kishte arritur kulmin dhe njerëzimi duhej të ndëshkohej. Shqiponja konsiderohej si zog i perëndive në antikitet, por në mesjetë gjithashtu ai përfaqësonte hyjnoren. Ashtu sikurse Kryeëngjëlli Mihal (me krahë), që në Gjykimin e fundit lufton me djallin, ashtu edhe shqiponja (Krishti-Zoti) vigjilon mbi sjelljen njerëzore dhe gjykon për mëkatet e tyre. Por, nëse tek njeriu dominon zemërimi mbi mirësinë "tek Zoti zemërimi zgjat një çast dhe mirësia në jetë të jetëve"[23]. Gjatë mesjetës, kisha kishte përfshirë në listën e veseve kryesore edhe malinkoninë (trishtimin), sepse ishte një ndjenjë pasive, dekurajuese, që nuk vlerësonte veprat e mira që Zoti kishte realizuar për njeriun. Në shek. XIX, ky ves neutralizohet dhe bëhet pjesë e mendjemadhësisë.

Kapiteli 4 Paraqitje antropomorfe. Kokë femre e kthyer pak majtas. (Vesi- Melankolia) (Fig. 7).

Femra e paraqitur në skulpturë mund të ketë arsye të shumta që e çojnë drejt dëshpërimit, por arsyeja madhore mund të jetë, humbja e një njeriu të dashur (birit të saj). Figura femërore mund të personifikojë Shën Marinë. Po rendis tre argumenta për ta vërtetuar:

1 – Kisha quhet Shën Maria, pra nderon emrin e saj.

2 – Mbi kokë, skulptura ka një kapele të vogël rrethore, siç e mbajnë priftërinjtë katolikë edhe vet Papa. Ajo quhet dora e Zotit. Në rastin e Shën

22 Pieranti, G., *I bestiary medievali*, Istituto Italiano Edizioni Atlas, 5-6; English illuminated manuscript *Bestiary*; Ezechiele (1.1-28), Apocalisse (4.5-11); Aberdeen University Library, Univ Lib. MS 24; James, M. R., *The Bestiary*, Oxford 1928; Druce, G. C., *The Medieval Bestiaries and Their Influence on Ecclesiastical Decorative Art*, British Archaeological Journal, n.s., 25, 1919, 41-82; 26.

23 Jemi zot të vetes vetëm në fillim pastaj nuk e dimë çfarë bëjmë. *Shih: Aristotele, *Etica Nicomachea, libro II, 4*, 1105b19 -1106a12; d'Aquino, T., *Summa theologica*, I, Il, 46, art. 2; Platone, *Protagora*, 359 b - 360 a; Ezechiele 7,8-9; Giovanni 3,36; Romani 1,18; Efesini 5,6; Colossesi 3,6; Apocalisse 19,15, 11,18, 14,10, 6,16 16,19; Romani 9,22; 2 Tessalonicesi 1,7-9; Marco 9,48; Si bari do të vyshken armiqtë e Zotit (Salmo 36).

DO NOT COPY





Fig. 7.1 - 7.2. Kapiteli 4 Paraqitje antropomorfe. Kokë femre e kthyer pak majtas. (Vesi – Malinkonia)

DO NOT COPY

Marisë, ajo ka qenë vërtet e bekuar, sepse solli në jetë Birin e Perëndisë[24].

3 – Në pjesët anësore të këtij kapiteli ndodhet gjethja e akanthit. Jo pa arsye, sepse ajo është konsideruar si simbol i virgjërisë (Shën Maria) duke qenë një bimë spontane, që rritet në terren të pakultivuar. Në krishtërimin e hershëm dhe atë mesjetar simbolizonte ringjalljen. Acanthus spinosus, është një lloj akanthi me gjëmba i cili kujtonte kurorën me gjëmba të Krishtit gjatë kryqëzimit. Pas vuajtjes, trishtimit, vdekjes, vjen shërimi, shpëtimi, ringjallja[25]. Por, bima e pasqyruar në pjesët anësore të kapitelit nr. 4 mund të përfaqësoj edhe "Pemën e jetës". Luigi Maria Grignion de Montfort, tek "Sekreti i Marias", mendon se përkushtimi fetar është "Pema e vërtetë e jetës", që duhet kultivuar në zemër, për të përfituar frutin "Jezus". Sipas Biblës, Zoti vendosi në kopshtin Eden, së bashku me "Pemën e të mirës dhe të keqes" edhe "Pemën e jetës". Kjo pemë është simbol i Krijuesit dhe të jep idenë e parajsës. Në traditën kristiane "Pema e jetës" përfaqëson në mënyrë simbolike edhe Kryqin e Krishtit[26].

24 Kjo kapele e vogël ka tetë ndarje (për katolikët) dhe shtatë ndarje (për hebrenjtë). Quhet "Dora e Zotit" mbi kokë, në mënyrë që njeriu të qëndroj gjithmonë nën mbrojtjen hyjnore ose nënkupton sferën ose kupën qiellore, Shtëpinë e Zotit, përtej së cilës njeriu nuk duhet të shkoj (siç ndodhi me kullën e Babelit që sfidoi qiellin). Simbolizon përulësinë për krijesat njerëzore dhe shenjtërinë për autoritetet e kishës. Për më tepër *Shih: Battaglia, A., *L'abito dell'anima. Materiali e simboli delle vesti religiose*, Roma: Nuova Cultura, 2015, 177–199.

25 Cattabiani, A., *Florario*, Milano: Arnoldo Mondadori, 1996, 591; Riegl, A., Kain, E., *Problems of style: foundations for a history of ornament*, Princeton: 1992, 187-206.

26 Rey-Mermet, T., Grignion de Montfort, L. M., *Il poeta mistico di Maria (1673-1716)*, Città Nuova, 14; Në origjinal të dyja pemët ishin të bashkuara por Adami më vonë u ndau rrënjët dhe filloi të ushqehej me frutat e tyre duke kryer mëkatin e parë. *Shih: (Genesi 2,9), (Genesi 2,16), (Genesi 3,22), (Apocalisse 2,7), (Apocalisse 22,2), (Apocalisse

Drolerie, është një term francez i përdorur nga historianët e artit për t'iu referuar figurave të çuditshme, që tejmbushnin dorëshkrimet në epokën gotike. Ky term mungonte në burimet mesjetare dhe formulohet gjatë Rilindjes, duke nisur nga shek. XVI, për imazhet fantastike dhe monstruoze. Në fjalorin e Randle Cotgrave, drolerie, do të thotë maskë, satirë, shimje – majmun. Në këtë mënyrë ajo bashkëngjit, ngjashmërinë më të vjetër dhe më të rëndësishme të drolerie me shimjet, krijesa të befasishme (të njohura në tekstet mesjetare si babewyn – babuin). Ky term nuk i referohej vetëm figurave me pamje shimjeje, por të gjithë kategorisë që trajtonte tema pakuptim, përfshi këtu, krijesa hibride, monstruoze dhe krijime të tjera, pjellë e fantazisë mesjetare. Ikonografia që u përfshi në këtë fushë, u përball me vështirësinë e klasifikimit të imazheve që ishin konceptuar si të paklasifikueshme, me problemin për t'i dhënë një emër dhe për të përkufizuar forma që ndryshonin vazhdimisht. Për shumë kohë studimi i imazheve të tilla u pengua nga qëndrime puritane, të cilat i klasifikonin si të turpshme dhe jo të përshtatshme për t'u shpjeguar shkencërisht. Por, interesi për studimet krahasuese në art dhe influenca e psikoanalizës bëri të mundur që në gjysmën e dytë të shek. XX, t'i kushtohej vëmendja e duhur[27].

Kjo krijesë, pra majmuni, paraqitet edhe në një nga kapitelet e eksonarteksit të kishës.

Kapiteli 6 Paraqitje hibride Majmun (Kokë + trup) me krahë shqiponje. (Një tërësi vesesh – kopracia) (Fig. 8).

Majmuni është një kafshë satanike në përsosmëri. Ajo është një karikaturë e njeriut, të cilit i imiton çdo gjest. Është figura e djallit: keqdashëse, hajdute,



Fig. 8. Kapiteli 6 Paraqitje hibride. Majmun (Kokë + trup) me krahë shqiponje

dinake, plot epsh, lakmitare, koprace, idhujtare dhe gënjeshtare. Tek vepra e Albrecht Dürer (1498), e njohur si "Shën Maria e majmunëve", shihet një majmun i ulur tek këmbët e Shën Marisë. Majmuni simbolizon gënjeshtrën mbi të cilën ka triumfuar e vërteta[28].

Djalli joshës ka tiparet e një majmuni me krahë. Frikën, revoltën, dëshpërimin, neveritjen që porositësi kërkon ta zgjojë përmes dorës së artistit, ekzekutuar tek skulptura e majmunit me krahë, i përgjigjet një ekonomie teologjike ku, jo domosdoshmërisht, e shëmtuara duhet të azaurohet në vizionin e pastër të deformimit dhe monstruozes. Cilësitë negative të majmunit marrin një peshë pozitive (nëpërmjet krahëve); është tërheqja e të kundërtave. Pikërisht pse janë të kundërta, shprehin tensionin për t'u liruar nga e gjithë ajo që është e shëmtuar, monstruoze, e deformuar dhe mëkatare. Metamorfoza arrihet nëpërmjet garancisë së besimit. Nëse nuk do të ishte kështu, atëherë nuk

22,19).

27 Cotgrave, R., *A Dictionaire of the French and English Tongues*, London: 1611, Janson, H. W., *Apes and Ape Lore in the Middle Ages and the Renaissance*, Studies of the Warburg Institute, 20, London 1952, 163, Randall, L., *Images in the Margins of Gothic Manuscripts California Studies in the History of Art*, 4, Berkeley-Los Angeles 1966, 10-11, Baltrušaitis, J., *Le Moyen âge fantastique*, Paris 1955, Baltrušaitis, J, *Réveils et prodiges. Le gothique fantastique*, Paris 1960.

28 Mâle, É., *L'art religieux du XII siècle en France*, Paris 1947; Zambon, F., *Il Fisiologo*, Milano 1975; Moretti, F., *Immaginario medievale, mondi medievali.*

DO NOT COPY

do të dinim t'i shpjegonim ndryshe aplikimet e diferencuara dhe simbolikën e kafshëve, që qysh nga shek.XII, përbëjnë një gamë të pasur në paraqitjen e veseve tek kapitelet e kolonave të kishave dhe katedraleve[29].

Në listën e veseve kryesore është edhe përtacia që përfaqësohet në kolonadë me:



Fig. 9. Kapiteli 7 Paraqitje hibride. Kokë njeriu + trup kafshe (ndoshta trup gomari sepse kjo kafshë në mesjetë përfaqësonte përtacinë)

Kapiteli 7 Paraqitje hibride. Kokë njeriu + trup kafshe (ndoshta trup gomari sepse kjo kafshë në mesjetë përfaqësonte përtacinë) (Fig. 9).

Përtacia është neveria për të punuar, një përzierje midis mërzisë dhe indiferencës. Sinonim i inercisë dhe apatisë. Termi përdorej qysh në antikitet për të treguar një mungesë kujdesi ndaj vetes dhe mungesë vëmendjeje ndaj gjërave që të rrethojnë. Rikthehet në mesjetë si koncept në teologjinë morale për të përshkruar mpirjen malinkonike dhe inercinë që kapte ata që i ishin dedikuar jetës së qejfit dhe rehatisë[30].

Thoma D'Aquino e përkufizonte përtacinë si "të trishtohesh për të mirën hyjnore" dhe të aftë për të nxitur inercinë në veprimtarinë hyjnore. Jacopone da Todi e përshkruan kështu në veprën e tij:

"Përtacia është një ftohtësi që është përhapur pa kufij. Tashmë po i shoh njerëzit jashtëzakonisht të frikësuar, sepse mendja e tyre është tjetërsuar nga dembelia për të vepruar".

Në ikonografi, simbolika që përfaqëson përtacinë është një burrë ose grua e përgjumur që nuk i çon punët deri në fund. Nuk mëkaton por as praktikon besimin. Ndërsa nga bota e kafshëve është gomari që përfaqëson përtacinë[31].

Sipas filozofisë kristiane, në listën e mëkateve është edhe grykësia e njohur ndryshe edhe si lakmi apo babëzi. Në kolonadën e eksonarteksit ky ves përfaqësohet nëpërmjet:

29 Në dekorimin e kapiteleve që zbukurojnë kolonat, midis ekzemplarëve të shumtë të faunës reale dhe fantastike, në katedralen e Bitonto (Puglia) dhe në la Puerta de las Platerias di San Giacomo di Compostela (Spanjë), një vend zënë edhe majmunët. *Shih: Gandini. D., *Il Portico della Gloria*, Lourdes, Santiago de Compostela, Finisterre a piedi, Bologna, E.D.B. 1996; Amendolagine, P., *Motivi ornamentali della cattedrale di Bitonto*, Mario Adda Editore, 1954; Charbonneau-Lassay, *Le Bestiaire du Christ*, Arché, Milano 1980; Moretti, F., *Specchio del mondo. I 'bestiari fantastici' delle cattedrali*, Fasano 1996.

30 Vocabolario Treccani,'*Enciclopedia Treccani*; Abbagnano, N., *Dizionario di filosofia, ampliato da Giovanni Fornero*, 13; Catechismo della Chiesa Cattolica - *Il primo comandamento*, su www.vatican.va. URL consultato il 20 settembre 2017.

31 d'Aquino, T., *Summa Theologiae*, II-II, 35; *Laudi. J., Trattato e Detti*, a cura di Franca Ageno, Firenze, Le Monnier, 1953; Pikturat më të bukura që përfaqësojnë malinkoninë dhe përtacinë janë të: Albrecht Dürer., *Melanconia I* (1514); Callot, J., *Accidia* (1620); Bloemaert, A., *I contadini "pigri"* (1624); Për më tutje *Shih: Benvenuto, S., *Accidia. La passione dell'indifferenza*, Il Mulino, 2008; Del Castello, A., *Accidia e Melanconia*, Franco Angeli, 2010; Wasserstein, W., *Accidia*, Raffaello Cortina Editore, 2006; *L'accidia. I vizi capitali*, LAB (Giulio Perrone Editore), Roma 2009.

DO NOT COPY

Kolona 8 Djalli gllabërues. Paraqitje hibride (Fig. 10). Kokë njeriu që mban ndër dhëmbë një kokë tjetër njeriu + trup kafshe (ndoshta trup derri sepse ai



Fig. 10. Kolona 8. Djalli gllabërues. Paraqitje hibride. Kokë njeriu që mban ndër dhëmbë një kokë tjetër njeriu + trup kafshe (ndoshta trup derri sepse ai në ikonografinë e mesjetës përfaqëson babëzinë).

në ikonografinë e mesjetës përfaqëson babëzinë). Përfaqësimi alegorik i babëzisë ka një vlerë të qartë doktrinore. Ai është një model negativ i projektuar për të kujtuar spektatorin për rreziqet që lidhen me teprimin e ushqimit. Në fillim marrja e ushqimit ishte një nevojë që karakterizohej nga thjeshtësia dhe nikoqirllëku. Sipas shpjegimit biblik, mëkati origjinal duhet të jetë ai i grykësisë sepse është nxitur nga "Ndalimi Hyjnor" për t'u ushqyer me fruta të ndaluara. Në mesjetë, duke u bazuar tek vizioni i mësipërm, dominoi idea se nga ky mëkat origjinal, erdhën më pas edhe gjithë të këqijat në këtë botë[32]. Problemi i babëzisë, është se kënaqet me përgjigje që nuk janë zgjidhje e pyetjes sonë të vërtetë: Çfarë do ta mbushi jetën time? Babëzia përgjigjet: unë do të ngop për pak kohë. Mëkati i babëzisë është një përgjigje e gabuar që na fsheh një nevojë dhe dëshirë të vërtetë. Çdo ves është një pasion mashtrues që krijon tek ne një paaftësi për të lexuar atë që vërtet banon në zemrat tona. Babëzia mund të shihet si një strehë drejt hedonizmit (koncept filozofik, ku ndjekja e kënaqësisë, e cila është në vetvete një qëllim i vërtetë dhe qëllimi i të gjitha aktiviteteve). Ne kërkojmë kënaqësi, sepse duam të largohemi nga një situatë që nuk mund ta dominojmë dot, sepse në të ndihemi sikur po mbytemi dhe vdesim. Babëzia është një akt nëpërmjet të cilit na jepet një mënyrë për ta parë jetën: jeta është të marrësh, t'i ofrosh gjithmonë gjëra vetes, të grumbullosh pa ndarë asnjëherë, të gllabërosh dhe të konsumosh vetveten dhe jetën e të tjerëve. Edhe disa forma besimi mashtruese mund të jenë një mënyrë për t'u ngopur dhe për t'u ndjerë "të mbushur". Të veshur me egoizëm, njerëzit lakmitarë nuk e njohin dhe nuk e kuptojnë kënaqësinë e të dhënit dhe të sakrifikimit. Një lakmitar nuk e kupton Zotin (shumëfishimi dhe ndarja e bukës). Shërimi për lakmitarët nuk duhet kërkuar tek dënimi i vazhdueshëm i shqisave, por në bërjen e një jete të pasur dhe të dobishme dhe në gjetjen e shijes tek dashuria për Zotin[33].

Tek kapiteli 8 i kolonadës jepet jo vetëm ideja e babëzisë, lakmisë, gllabërimit të ushqimit, por kuptimi simbolik i skulpturës shkon më tutje se kaq. Paraqitja dekorative e mësipërme, të kujton shprehjen "Njeriu ha njerinë" .

Kjo thënie i ngjason teorive të shek. XVII të hartuara nga filozofi anglez Thomas Hobbes. Sipas

32 Arte: *Peccato di gola* - Taccuini Storici

33 Matteo 27,34; Genesi 3,6-7; 25,29-34; Salmi 13,35; Matteo 4,2; 5,6; 6,25; 15,17; Luca 6,25; Giovanni 4,32-34; 6,27.35; Apocalisse 7,16; Romani 13,12-14; 16,18; 8,5s; Luca 21,34; Filippesi 3,19; 1 Tessalonicesi 5,7-8; 1Pietro 4,1-3; Giudici 5,5; Siracide 31,28ss; Isaia 56,10ss; Michea 3,5; Giuda 1,12; Salmi 4,7.

DO NOT COPY

tij, natyra njerëzore është thellësisht egoiste dhe përcaktuese dhe për veprimet e njeriut është vetëm instikti i mbijetesës. Aty ku nuk ekziston asnjë ligj dhe nuk ka shtet, çdo individ, duke u nxitur nga instikti i mbijetesës, do të kërkonte të cënonte të tjerët dhe të eliminonte këdo që do t'i dilte përpara vetëm për të kënaqur dëshirat e veta. Secili do të shikonte tek tjetri një armik. Një gjendje e tillë të çon në një konflikt të brendshëm dhe në një "bellum omnium contra omnes - lufta e të gjithëve kundër të gjithëve". Shprehja përdoret ende për të nënvizuar keqëdashësinë dhe ligësinë e njeriut. Ka të njëjtën vlerë dhe shpreh të njëjtin egoizëm edhe thënia e komediografit romak Plauto "homini homo lupus est – njeriu për njeriun është ujk". Ajo që do t'i përshtatej më tepër kohës dhe skulpturës është shprehja mesjetare "mors tua vita mea – vdekja jote është jeta ime". E të mendosh që gjithçka nisi nga një shprehje pozitive e komediografit romak Cecilio Stazio "Homo homini deus est, si suum officium sciat – njeriu për njeriun është Zot, në qoftë se secili shikon punën e tij"[34].

Tek kapiteli 8 i kolonadës ndodhet një protom mashkullor (Fig. 11).

Po kështu të tillë ndodhen edhe tek kapitelet e kolonave brenda kishës (Fig. 12). Çfarë kuptimi kanë ato? Për çfarë shërbejnë dhe cili është emri i tyre? Në zonën e Emilias, Toskanës, në Francë dhe në territoret përreth Renit njihen me emrin Marcolfe (Mark – kufi dhe Wolf – ujk pra qen kufiri, ai që ruan kufijtë).



Fig. 11. Kapiteli Nr.8 i kolonadës



Fig. 12. Kapitel brenda kishës së Shën Marisë (Apolloni)

34 Hobbes, T., *Dall'antropologia alla teoria politica*, Treccani "Homo homini Deus", "Homo homini lupus": Recherche des Sources des deux Formules de Hobbes", in R. Koselleck & R. Schurr, Hobbes-Forschungen, Berlino, Duncker & Humblot, 1969, 61-70; Relección primera, De los Indios, III; terza edizione a cura di T. Urdanoz, Madrid, 1960, 709; De dignitate et augmentis scientiarum, 1623, VI, c. III, Exempla antith. XX; Epigrammata, 1606, III, 23; «Homo, sacra res homini», Epistole a Lucilio, XCV, 33; Quaderno XXVIII, «Passato e presente», Torino, Einaudi, 1974, 152-153; Cassirer, E., *Il materialismo di Hobbes come metafisica della realtà espressa in termini logici-nominalistici, Storia della filosofia moderna*, Einaudi 1978.

DO NOT COPY

Ne do të përdorim termin "maska apotropaike" (apotropaike – vjen nga greqishtja dhe do të thotë të largosh diçka të keqe, syrin e keq ose magjinë). Disa kërkues mendojnë se origjina e maskave të tilla është shumë e hershme dhe lidhet me rite makabre. Në fund të çdo beteje, luftëtarët fitimtarë për të mbrojtur veten dhe familjet e tyre nga shpirtrat e këqinj, por edhe për të treguar lavdinë e fitores i vendosnin kokat e armiqëve mbi majat e heshtave. Me kalimin e kohës zakone të tilla barbare u zëvendësuan me riprodhimin e kokave duke i gdhendur në gur ose në dru. Ato gjenden kudo në hyrjen e shtëpive, stallave, të gdhendura pranë oxhakëve por një përhapje të madhe kanë edhe tek muret dhe kapitelet e kishave[35].

Skulptura dekorative e kapitelit nr. 8 përfaqëson "portat e ferrit" dhe maska apotropaike në këtë kapitel tregon njeriun mëkatar, shpirti i të cilit do të shkoj në ferr. Ndërsa maska tek kapiteli brenda kishës përfaqëson njeriun e drejtë, të rrethuar me motive floreale. Po t'i kthehemi termit marcolfe (të ruash kufijtë) është i drejtë si përkufizim, sepse këto maska ruajnë kufirin midis jetës së të gjallëve dhe asaj të përtej varrit. Por edhe kuptimi që, të ruash kufirin midis veseve dhe virtyteve është mëse i drejtë, sepse njeriu është gjithmonë i rrezikuar të kalojë masën dhe të anojë e të tundohet nga e keqja.

* * *

Arti fetar në përgjithësi dhe skulptura dekorative fetare në veçanti më ka tërhequr gjithmonë sepse ajo përfaqëson kapacitetin e artistit për të shpalosur ungjillin dhe besimin nëpërmjet imazheve.

Në këtë mënyrë arti transformohet në katekizëm (Mësim).

Arti i shenjtë nuk duhet të kuptohet si një "punë e konceptuar vetëm në funksion të zbukurimit të kishave, por çdo vepër artistike duhet të konsiderohet si një "punë e krijuar nga domosdoshmëria për të dhënë mësim, për të treguar të mirën dhe të keqen, të bukurën dhe të shëmtuarën".

Kishat janë imazhi se si shprehej besimi rreth viteve 1000, me ndërtesa që karakterizoheshin nga linja të rrepta arkitektonike, esenciale, thelbësore dhe shumë pak arredim i brendshëm sepse asgjë nuk duhet t'i tërhiqte vëmendjen besimtarit gjatë Meshës dhe momenteve të lutjeve. Në kishë hyhej për tu lutur dhe jo për të parë. Vetëm gjatë periudhës gotike, kishat u pasuruan me vepra arti që ilustronin Shkrimet e Shenjta për një popull analfabet.

Shekulli XII roman, pesimist, u dashurua pas librave me përralla. Shekulli XIII, gotik, që provoi lumturinë u kthye nga lulet tek njerëzit. Ai është më alegorik se simbolik. Kështu u paraqitën nën figurën njerëzore, të mirat apo të këqijat, abstraksionet e "Romanit të Trëndafilit" (Kopracia, pleqëria, mikpritja, rreziku, arsyeja, të shtirurit, natyra). Gotikja është ende fantastike. Por ajo sakrifikon më tepër për të çuditshmen se sa për monstruozen. Mbi të gjitha, arti gotik bëhet moral. Ikonografia bëhet një mësim. Jeta aktive dhe jeta soditëse, virtytet dhe veset me pamje njerëzore, të vendosura sipas një rregulli të mirë, zbukurojnë portat e kishave për t'u dhënë predikuesve ilustrimin e mësimeve të tyre morale. Sigurisht që klerikët i kishin dhënë përherë artit një funksion moralizues[36].

DO NOT COPY

35 Orsini, G., *Marcolfe di Fanano*, Storia e leggende dei luoghi lungo le strade - Nel territorio s'affondano le nostre radici; Le "Marcolfe" (teste apotropaiche scolpite sui muri) e i lupi mannari, Legami col simbolismo del Lupo Mannaro; Adams, J. N., *The Latin Sexual Vocabulary*, *Apotropaic and ritual obscenity*, Johns Hopkins Press 1990, 4-7.

36 Le Goff. J., *Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar*, Tiranë: Toena 1998, 430-431.

Arbela KISI

DECORATIVE SCULPTURES IN THE EXONARTHEX OF THE CHURCH OF ST. MARY (APOLONI)

When you look at the sculpture of the exonarthex chapels of the church of St. Mary (Apoloni), remember the latin term mirabilia. This concept refers to the observation of a phenomenon or something still unknown, but also the emotional involvement that comes from it: wonder, surprise, admiration before something extraordinary, unknown, perfect, monstrous seeking to be revealed because it wants to warn you or to teach you to think of good and evil, virtues and vices. Virtues have been conceived since ancient times by philosophers, especially Plato. They are then adapted by the christian religion to channel the human soul to the way of God. In addition to human virtues, intellectual virtues (knowledge, science, and intellect) are also distinguished. The main vices are a list of deep deviations (of morality and behavior), the human spirit often called, perhaps even wrongly, the main sin. These vices ruin the human spirit by counteracting the virtues that promote growth. They are called "capital-key" because they are bigger, more severe than the depth of human nature. Like virtues, vices are derived from repetition of actions. It forms in the man who performs an "outfit" which drives him to deviate behavior. The list of vices has been drafted since early Christianity, by the priests, Evagrio Pontico and Cassiano. Evagrio, at that time, classified eight "souls and negative thoughts" as well as the ways to fight them: 1) gluttonous, 2) lust, 3) avarice, 4) anger, 5) sadness, 6) laziness, 7) envy, 8) pride. Over time the sadness is removed from the list and seven capital wounds remain. All the vices mentioned above are reflected in the exonarthex of the church of St. Mary (Apoloni). Their more detailed and extended analysis will be addressed in the following article.

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Dritan ÇOKU

KULLA E SAHATIT NË KALANË E ELBASANIT

DO NOT COPY

Ashtu si në viset e tjera të Ballkanit edhe në Shqipëri, ndërtimi i kullave të sahateve bëhej zakonisht në mjediset më të gjallëruara dhe më të dukshme të qyteteve, në sheshet e pazareve, pranë xhamive kryesore, apo në vende të ngritura brenda kështjellave etj.[1], si elementë shenjë (referues), në kontrast me siluetin e lagjes dhe qytetit në përgjithësi[2]. Ndërtimi i këtyre objekteve të rëndësishme urbanistike shënonte, pa dyshim, një kërkesë të ngritur të shoqërisë qytetare të kohës në vendin tonë[3]. Në këtë artikull do të ofrojmë një sintezë tërheqëse historike - ilustrative mbi kullën e sahatit në kalanë e Elbasanit[4].

Udhëtarët e studiuesit, që panë Elbasanin në të shkuarën, nuk kanë mbetur indiferentë përpara pasurisë së tij kulturore. Kudo në shkrimet e tyre ata pasqyrojnë realitetin faktik dhe vlerat e tij.

Ndër të parët që ka vizituar Elbasanin është senatori i Venedikut Lorenco Bernardo (1591)[5]. Sipas raportit të peshkopit Nikollë Mekajshi (1609), Elbasani konsiderohej si kryeqendra (metropoli) i Shqipërisë së Mesme dhe njëkohësisht si një qytet me popullsi të madhe dhe me lagje të shumta. Disa vjet më vonë (1635), Frang Bardhi e cilësonte atë me fjalët "urbs popolosa"[6].

Në shek. XVII Elbasanin e vizitojnë udhëtarë e kronistë të Perandorisë Osmane, të cilët kanë botuar shënime udhëtimi, kronika, të dhëna, me interes historik, gjeografik e demografik[7].

Ky qytet njohu një lulëzim të ri me rindërtimin e Kalasë në vitin 1466 gjatë fushatës në Shqipëri nga Sulltan Mehmeti II[8]. Që atëherë, u ndërtuan një sërë faltoresh, më e vjetra e të cilave ishte mbi kullën me portën e hyrjes (që u prish në vitin 1832) për në kala, e njëkohëshme me rindërtimin e Kalasë[9].

Në përshkrimin që udhëpërshkruesi osman Evlija Çelebi i bën fortesës së Elbasanit na informon se: *"Afër kësaj xhamie (xhamisë së Hyngjarit mbi portën e kiblës) është sahati i bukur, i cili nuk shmanget asnjë minutë dhe u prin gjithë muezinëve"*[10]. Ai është i pari deri tani që përmend

1 Shkodra, Z., *Qyteti shqiptar gjatë rilindjes kombëtare*, Tiranë: Mihal Duri, 1984, f. 404.

2 Mitrojorgji, J., "Pazaret – Vështrim mbi morfologjinë urbane dhe strukturën e tyre hapësinore", *Monumentet*, 56/2017, Tiranë: Morava, 2017, f. 27.

3 Shkodra, Z., *Esnafët shqiptarë (shek.XV-XIX)*, Tiranë, 1973, f. 44.

4 Kjo pasuri ndërtimore është shpallur *"monument kulture"* i kategorisë së I-rë me Vendim të Rektoratit të Universitetit Shtetëror, Nr. 6, dt.15.01.1963.

5 Bevapi, K., Lazareni, A., Koburja, R., Plangarica, T., Sarja, Z., *Elbasani – Enciklopedi*, Elbasan: Sejko, 2003, f. 175. Lorenco Bernardo udhëtimin e kreu përmes Shqipërisë, duke qëndruar dhe në këtë qytet. Vepra "Udhëtim i një ambasadori venecian nga Venecia në Kostandinopojë" (Viaggio di un ambasciatore veneziano da Venezia à Constandinopoli, nel 1591).

6 Shkodra, Z., *Esnafët* ..., f. 42.

7 Bevapi, K., Lazareni, A., Koburja, R., Plangarica, T., Sarja, Z., *vep. cit.*, f. 175. Hoka-Efendi (Hoka-Efendi Sadedin) në botimin "Dorëshkrime historie (Taç' ul' Tevarih 1621), përshkruan ekspeditat turke kundër Shqipërisë dhe ndalet në pushtimin e kështjellave të Elbasanit.

8 Për më shumë të dhëna shih Buharaja, Vexhi., "Rreth mbishkrimeve të fortesës së Elbasanit", *Studime historike*, Nr.1-1967, Tiranë, 1967, f. 85-106.

9 Meksi, A., *Arkitektura e xhamive të Shqipërisë (shekujt XV – XIX)*, Tiranë: UEGEN, 2007, f. 57.

10 Dervishi, Dhil-li Ibni. Muhamet (Evlija Çelebi)., *Shqipëria para tre shekujsh, Enciklopedi shqiptare e mesjetës,* botim i plotë, Tiranë: Besa 2000, 2000, f.91 shih

kullën e sahatit, por për këtë vepër ndërtimore nuk kemi dëshmi dokumentare se si ka qenë pamja arkitektonike e saj.

Elbasani paraqitet në një gravurë të Hristofor Žefarović e vitit 1742 (fig. 1). Kjo vepër artistike na tregon peizazhin urban dhe siluetën e shtrirë të qytetit, banesat dhe minaretë brenda dhe jashtë mureve të kalasë mesjetare, kisha brenda saj, selvitë e dendura në sfond dhe ura mbi lumin Shkumbin, por jo kullën e vjetër të sahatit.



Fig. 1. Elbasani - Gravurë nga Hristofor Žefarović e vitit 1742.

Në fund të shek. XVIII, Mehmet Said përshkruan ndërtimin e kështjellës së Elbasanit...[11]

Për Elbasanin, një vend të veçantë zënë shënimet dhe botimet e autorëve evropianë në shek. XIX si: Leak[12], Pouqueville[13], Ami Boue[14], dhe H.Hecquard[15], por pa e përmendur kullën e sahatit. Edward Lear, më 26 shtator 1848, përveçse përshkruan Elbasanin si "një qytet në veçanti piktoresk…"[16], ai realizon edhe disa vizatime, ku kulla e sahatit është e përfshirë tek njëra prej tyre (fig. 10). Ndërsa albanologu Georg von Hahn, ka theksuar në vitin 1850[17], se kulla e sahatit është shkatërruar nga zjarri (pasoja e të cilit ishte edhe shkrirja e kambanës së saj), në vitin e vdekjes së Sulltan Mahmudit II (1839). Sipas tij, kambana e kishës së madhe të Martaneshit nuk u arrit të blihej nga qytetarët dhe për këtë arsye, ata u detyruan të blinin një kambanë të re në Trieste[18] [19]. Kullën e sahatit e përmend edhe Tozeri në vitin 1865[20]. Ajo duhet të jetë shkatërruar përsëri, por deri tani nuk dihen shkaqet e dëmtimit.

edhe Acun, Hakki., *Osmanli İmparatorluğu Saat Kuleleri*, Ankara: Ataturk Kultur Merkezi, 2011, f.112. Elsie, R., *Early Albania: A Reader of Historical Texts, 11th-17th Centuries*, 2003, p. 207.

11 Bevapi, K., Lazareni, A., Koburja, R., Plangarica, T., Sarja, Z., *vep. cit.*, f. 176. Mehmet Said (Mehmed Said), në botimin e tij "Historia e arsimit perandorak" (Tarihi gjylsheni maarif 1787).

12 Leake, Martin William., *Travels in Northern Greece*, Vol 1, London: J.Rodwell, New Bond Street, 1835, p. 343, 356, 357.

13 Pouqueville, M.D. F.C.H.L., *Travels in Epirus, Albania, Macedonia, and Thessaly*, London: 1820, p. 22-23.

14 Boué, Ami., *Recueil d'itinéraires dans la Turquie d'Europe*, Détails géographiques, topographiques et statistiques sur cet empire, Vienne, 1854, p. 16, 19-23. Në vitin 1836-1838 gjatë udhëtimit që bën në Shqipëri, qendron në Elbasan.

15 Hecquard, Hyacinthe., *Histoire et description de la haute Albania ou Guegarie*, Paris, 1858, p. 264-265.

16 Lear, Edward., *Journals a landscape painter in Albania, & C.*, London: Richard Bentley, 1851, p. 90.

17 Elsie, R., *Historical Dictionary of Albania*, Second Edition, Lanham • Toronto • Plymouth, UK: The Scarecrow Press, Inc., 2010, p. 180. Gjatë viteve të tij në Janinë (pas 1847-1850, transferohet si zëvendës-konsul), Hahn vizitoi Shqipërinë tri herë dhe mblodhi të dhëna mbi historinë shqiptare, filologjinë dhe folklorin.

18 Hahn, Georg von Johann., *Studime shqiptare*, Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, pa vit botimi, f.119. *"Martaneshi afër Mallogjeshit ruan edhe sot një kambanë kishe të madhe; kjo shërben sot për të mbledhur katundin. Në kohën kur vdiq Sulltan Mahmudi u dogj kulla e sahatit të qytetit dhe u shkri kambana e tij. Qytetarët kërkuan t'a blinin kambanën e Martaneshit, por katundi nuk dëgjoi dhe ata u detyruan të blinin një të re në Trieste". Po aty*, f. 115. *"... qyteti duket kaq mirë në skajin verior dhe ajri i pastër i mbrëmjes i afron kaq shumë minaretë e holla dhe kullën e trashë të sahatit..."*

19 Furat, Zişan Ayşe., Er, Hamit., *Balkans and Islam: Encounter, Transformation, Discontinuity, Continuity*, Cambridge Scholars Publishing, 2012, p. 195.

20 Tozer, Henry., *Researches in the Highlands of Turkey*; incuding visits to mounts Ida, Athos, Olympus, and Pelion, to the Mirdite Albanians, and other remote tribes, London: John Murray, 1869, Volume 1, Chapter IX, p. 203.*"Minaretë dhe një kullë e madhe sahati, të veshura me alumin vezullues, formojnë objekte të spikatura*".

DOKTORATURA

Në 1875, diplomati dhe filologu francez Auguste Dozon[21] dhe në gusht të vitit 1890 Victor Bérard së bashku me shokun e tij Emile Legrand gjatë udhëtimit të tyre nëpër Shqipëri, midis qyteteve të tjera ofrojnë të dhëna me interes edhe për qytetin e Elbasanit[22], por pa përmendur kullën e sahatit. Ndërsa Hugh Callan në vitin 1898 gjatë përshkrimit që na ofron për këtë trashëgimi arkitektonike e vlerëson atë duke e cilësuar të vjetër[23]. Por cilin ndërtim ka parë ai? Mos vallë nuk kishte filluar ende rindërtimi i kullës që trashëgojmë sot? Apo është thënë në ndonjë kuptim tjetër, duke e përfshirë edhe këtë vepër ndërtimore si të vjetër, në peizazhin urban mesjetar të këtij qyteti? Çfarë të dhënash na tregojnë mbishkrimet, të cilat ndodhen në trupin e gurtë të kësaj trashëgimie arkitektonike?

Mbishkrimet & historiku i rindërtimit

Historia e rindërtimit të fundit të kullës tregohet prej mbishkrimit në turqishten osmane. Mbishkrimi ndodhet mbi derën që të çon në kullë, në pjesën jugore, me pamje nga çarshia. Ai është i rrethuar nga dy pllaka prej guri gëlqeror të një përmase të njëjtë, në të cilat ndodhet një "pasqyrë", e zbukuruar me një hark të shtrirë. Në pllakën e majtë të mbishkrimit osmanisht shkruhet viti 1899 (fig. 2) me shifra si dhe fjalët: "Mestr Ilo, Selo Luko" (Mjeshtri Ilo nga fshati Luko) (me gërma të vjetra sllave). Guri në të djathtë të tekstit në osmanisht duket se është përcaktuar për një tekst në greqisht, i cili për një arsye apo një tjetër, nuk është bërë[24]. Sipas Kiel, teksti në osmanisht ishte i pabotuar…[25] I përkthyer në shqip, ky tekst është si vijon:



Fig. 2. Mbishkrimet mbi portën e hyrjes për në Kullën e Sahatit..

1a) *Mbreti i mbretërve të Botës, Abdulhamid Kani dashamirësi,*

b) *me përkrahjen e tij është ndërtuar kjo kullë (sahati) e mrekullueshme.*

2a) *Populli patriot i gjithë i Elbasanit ka dhënë mbështetjen e tij,*

21 Robert Elsie, *Texts and Documents of Albanian History*, http://www.albanianhistory.net/1875_Dozon/index.html Auguste Dozon, *Excursion en Albanie*, report sent to the French Ministry of Foreign Affairs, Department of Consular and Commercial Affairs, in Paris, and subsequently published in *Bulletin de la Société de Géographie*, Paris, June 1875. "Elbasani (i cili është subjekt i qeverisë në Prizren) ka një kajmakam, 1,400 shtëpi myslimane shqiptare, 100 shtëpi ortodokse shqiptare, 100 shtëpi vllehe, rreth 20 xhami, 12 prej të cilave kanë minare, dy kisha dhe një peshkop".

22 Bérard, Victor., *La Turquie et l'hellénisme contemporain* (Paris: Félix Alcan, 1893, reprint 1911), pp. 1-75.

23 Callan, Hugh., Albania and the Albanians in 1898, "*The Scottish Geographical Magazine*", Volume 15, Edinburgh, 1899, p. 343. *"Sorrat dhe grifshat vërtiten në turma rreth kullës së vjetër të sahatit dhe minareve të veshura me alumin".*

24 Kiel, Machiel., *Arkitektura osmane në Shqipëri 1385-1912*, Tiranë: AIITC, 2012, f. 163. Në periudhat e vona osmane shqipja nuk është përdorur si një gjuhë e njohur në mënyrë zyrtare. Sllavishtja flitej në fshatrat përreth Korçës, në lindje të Elbasanit dhe në të kaluarën ka qenë shumë më e përdorur. Greqishtja njihej pothuajse shumë mirë në Elbasan dhe pjesa më e madhe e regjistrimit të esnafëve të Elbasanit bëheshin në atë gjuhë.

25 *Po aty*, f. 163. Mbishkrimi është i shkruar në pesë bejte (çifte, mbi një pllakë të vogël prej mermeri (36cm me 27cm). Ai është konceptuar si një hezek tetrametrik (v-/v-/v-/v-) dhe është kaligrafuar me shumë zotësi me gërma të ngjeshura, por të realizuara shumë mirë. I krahasuar me një cilësi të tillë, teksti i vjetër në sllavisht është i papërpunuar. Kronogrami është i ashtuquajtur tarih-i lefzi, apo datë verbale, duke e dhënë datën pa llogaritjen e zakonshme.

DO NOT COPY

b) *ka sjellë në jetë (ka krijuar) këtë kronometër të bukur.*

3a) *Akif Beu ka bërë përpjekje dhe kujdes*

b) *Zoti ia shpërbleftë dhe ia kompensoftë me krejt botën dhe çka ndodhet në të!*

4a) *Sa herë që kumbon (bie) ajo me zërin e saj e tregon kohën (orën) në formën më të bukur,*

b) *ajo të tregon minutin dhe orën në të katër anët.*

5a) *Meqë ke talent për poezi, o Refik, shkruaje kronogramin e saj!*

b) *"Ajo është ndërtuar në ditën e parë të vitit 1315.*

Viti 1315 AH (=2.6.1897 – 21.5.1898)
Kështu, ka një vit ndryshim midis kësaj date dhe datës së shkruar në tekstin e vjetër në sllavisht. Mund të marrim me mend se teksti në osmanisht është përgatitur shumë muaj më përpara mbarimit të kullës dhe teksti i thjeshtë në sllavisht pasqyron më shumë datën e saktë të ndërtimit të kullës[26].
Përveç dy mbishkrimeve të mësipërme, gjenden edhe dy të tjera. Nga kërkimet tona deri tani rezulton se këto dy të fundit nuk janë trajtuar më parë në literaturë. Njëra në mekanizmin e orës (fig. 4 d,e) me shënimin **"C. FONTANA, MILANO"** (Cezare Fontana, Milano), ndërsa tjetra në kambanë[27] (fig. 5), ku shkruhet një shprehje në latinisht: **"DEO OPTIMO MAXIMO SIT - OPUS 1819"** ("Për zotin më të mirë dhe më të madh" ose "për zotin, më të mirë, më të madh" dhe datën e prodhimit të kambanës vitin 1819). Me të dhënat e mësipërme kuptojmë se kambana duhet të jetë e ndonjë kishe. Deri në vitin 1912 tingujt e kambanës së kësaj ore dëgjoheshin prej qeraxhinjëve dhe udhëtarëve deri 5-6 km larg. Flitet se gjatë luftrave ballkanike ushtria serbe që pushtoi Shqipërinë e Mesme më 1913, e ndërroi këtë kambanë me një tjetër[28].

Mekanizmi i orës
Kullat e sahatit, siç e tregon dhe vetë termi, janë të ndërtuara përgjatë një aksi vertikal dhe arrijnë lartësi të madhe. Ato janë me bazë kuadratike dhe përbëhen prej pjesës së poshtme që zë lartësinë më të madhe, ku lëvizin peshat (fig. 3) dhe prej



Fig. 3. Gurët e peshave

ambienteve të mekanizmit mbi të dhe kambanës në pjesën më të lartë[29].
Mekanizmi i orës së kullës (fig. 4 a,b,c) mishëron koncepte themelore nga disiplina mekanike dhe inxhinierike e kontrollit. Analiza e mekanizmit mekanik me mekanizmin e karelit të integruar dhe lavjerrësin ilustron qartësisht shndërrimin e saktë të energjisë potenciale në lëvizje periodike[30].
Duke patur parasysh katër metodat e instalimit, kjo e kullës së sahatit në kalanë e Elbasanit është në

26 *Po aty*, f. 164.
27 Shprehja në latinisht dhe data e prodhimit të kambanës gjendet në hapësirën midis rrathëve në pjesën e sipërme të saj.
28 Shkodra, Z., *Qyteti* ..., f. 405, referuar A.Çaushi, *Toponamistika e Elbasanit*, (dorëshkrim në AIH), f. 12.
29 Meksi, A., Baçe, A., Riza, E., Karaiskaj, Gj., Thomo, P., *Historia e arkitekturës në Shqipëri*, Tiranë: Kristalina KH, 2016, f. 670.
30 Wagner, John., P.E., Huey, Cecil, Katie., Knaub, Volk, Eugene., Jagarwal, A., "Modeling and Analysis of a Weight Driven Mechanical Tower Clock", *American Control Conference*, Marriott Waterfront, Baltimore, MD, USA, June 30-July 02, 2010, p. 634-639.

DO NOT COPY



Fig. 4. Mekanizmi i orës & mbishkrimi në të.

skemën Nr. 1, e cila tregon pozicionin e orës me fusha përballë mekanizmit të orës dhe kambanën mbi mekanizmin e orës dhe fushat[31]. Ndërsa përsa i përket pozicionit të fushave me mbërthimin e skeletit të tyre është: a) - muri; b) - skeleti i fushës; c) - mbërthimi i skeletit[32].

Përshkrimi arkitektonik

Nga ana jugore e kalasë së Elbasanit (fig.6), ngrihet kulla e sahatit[33] (fig. 7) me një planimetri katrore 4,05 x 4,09 m mbi njërën prej kullave fortifikuese



Fig. 5. Këmbana dhe mbishkrimi.




Fig. 6. Kalaja e Elbasanit. Planimetria. (Gjerak Karaiskaj, 5000 vjet fortifikime në Shqipëri, Tiranë, 2016, f.97, fig.108.)

31 Frank, Mark., *The evolution of tower clock movements and their design over the past 1000 years*, 2013, p. 39.

32 See fig.4 to Thomas, Seth., *Tower clocks*, New York: Chicago: San Francisco: Trade Mark, Nr.7, 1911, p. 10.

33 Rilevimi i kullës së sahatit është realizuar nga autori i artikullit dhe Gersi Çoku më dt. 09.04.2016. Skicat dhe përpunimi grafik është i autorit.

DO NOT COPY



Fig. 7. Kulla e sahatit.



Fig. 8. Porta e hyrjes për në kullë.



Fig. 9. Shkallët origjinale prej druri.

DO NOT COPY

(ashtu si në Prezë[34], Kaninë[35], Tepelenë[36]) me lartësi 5,70 m (TAB.I-IV). Nga njëzetë e gjashtë kulla që ka pasur kalaja, sot ruhen vetëm tetë[37].

Kalaja mori gjendjen që kemi sot që prej vitit 1832, koha kur ndodhi shkatërrimi rrënjësor prej vezirit të madh Reshit Mehmet Pasha, i cili rrafshoi kështjellën, pasi kishte shtypur kryengritjen e pashallëkut të fundit të Shkodrës[38].

Më shumë se çdo objekt i veçuar arkitektonik, kohës i ka qëndruar struktura urbane e vendbanimeve, strukturë që ka pranuar ndryshimin dhe zhvillimin epokë pas epoke[39].

Kjo trashëgimi arkitektonike deri në lartësinë 3,05 m është e ndërtuar me blloqe të lëmuar prej guri gëlqeror, më pas vazhdon prej tulle, duke ruajtur të gurta qoshet. Kulla e sahatit është e lartë 19,45 m, ndërsa trashësia e mureve të saj është 1 m. Për të hyrë në kullën e sahatit shërben porta me orientim jugor (fig. 8), në të cilën janë gdhendur në reliev disa simbole[40]. Ngjitja deri tek ambienti i kambanës kryhet me shkallë prej druri origjinale (fig. 9). Përveç anës veriore, tri anët e tjera të saj ndriçohen nga hapësira të vogla si frëngji

34 Çoku, D., "Kulla e sahatit në kalanë e Prezës", *Monumentet,* 56/2017, Tiranë: 2017, f. 63-75.

35 Çoku, D., "Kalaja e Kaninës, Misteri i kullës së sahatit, ja gjurmët e mbetura në dokumenta", gazeta *"Shqiptarja.com"*, suplementi "Rilindasi", 31 Maj 2015.

36 Shehu, G. Xh., *Tepelena*, pa vit botimi, f. 90.

37 Karaiskaj, Gj., *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, Tiranë, 2016, f. 98.

38 Prashniker, Kamilo., Shober, Arnold., *Kërkime arkeologjike në Shqipëri dhe Mal të zi*, Tiranë, 2003, f. 52.

39 Mitrojorgji, M., Mitrojorgji, J., "Elbasani - Identiteti i humbur i një qyteti", *Monumentet*, 52/2011-2014, Tiranë, 2014, f. 53.

40 Harku i portës ka katër simbole: simboli i një luleje me gjashtë petale e përdorur 3 herë dhe simboli i hënës rritëse. Ndërsa në gurin vertikal të shpatullës së djathtë të portës ndodhet simboli i gjarprit. Të gjitha simbolet janë punuar në reliev duke u gdhendur fusha. Gjithashtu ka edhe një gur, ku është gdhendur një motiv gjetheje.



Fig. 10. Dritare të vogla si frëngji.



Fig. 11. Kulla e sahatit në Kalanë e Elbasanit

(fig. 10). Tri pilastra të rrafshëta zgjaten lart dhe ndajnë murin në dy rripa vertikalë të barabartë me njëri-tjetrin (fig. 11). Kulla mbaron me dy vrima të mëdha kumbuese, në secilën prej katër faqeve, duke përfunduar të gjitha me një tambur trekëndor. Poshtë vrimave kumbuese ndodhen katër orë të mëdha. E tërë kulla është e ndërtuar në përputhje me arkitekturën e fundit të shekullit XIX dhe si rrjedhojë është tipike për periudhën e vonë osmane të reformës dhe ndryshimeve[41]. Teknika e ndërtimit dhe materialet e përdorura (hekuri në brezat e murit dhe për tiranta, druri për shkallë dhe dysheme, tulla e pjekur mirë në kupolë dhe mure, suvatimi dhe trajtimi koloristik) tregojnë për një vazhdimësi të traditave vendase dhe përvetësim të teknologjive më të reja[42].

Kjo vepër ndërtimore me karakter publik është projektuar dhe ndërtuar në formë dhe përmbatje për matjen e kohës, duke treguar fushat e orës nga të katra anët.

Aktualisht, kulla e sahatit është në gjendje të mirë, por gjithsesi është shumë e rëndësishme që monumenti të mirëmbahet në mënyrë të vazhdueshme. Kështu ruhet gjendja ekzistuese e burimit të trashëgimisë nga shkatërrimi apo ndryshimi[43], pra konservohet. Punimet e fundit me karakter mirëmbatjeje janë kryer në vitin 2012[44].

Vizatimi i vitit 1848 – analizë

Në studimin mbi kalanë e Elbasanit të Gjerak Karaiskajt është shfaqur mendimi, se në vendin ku ndodhet kulla e sotme ekzistonte një sahat i vjetër me konstruksion druri, siç e gjykon ai nga Çelebiu

41 Kiel, Machiel., *Arkitektura osmane në Shqipëri 1385-1912*, Tiranë, 2012, f. 162.

42 Dashi, S., "Kullat mesjetare të sahatit në vendin tonë", *Monumentet,* 12,1976, Tiranë, 1976, f. 105-106.

43 Feilden, M.Bernard, Jokilehto, Jukka., *Udhëzues për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore*, Tiranë, 2010, f. 76.

44 Arkivi i Institutit të Monumenteve të Kulturës - Tiranë, *Situacion përfundimtar punimesh*, Objekti: Mirëmbatja e kullës së sahatit në Elbasan, Dosja nr. 360, Elbasan, 03.10.2012.

DO NOT COPY



Fig. 12. Vizatimi i Edward Lear - Elbasan 26 shtator 1848

qysh prej fillimit të shek. XVII[45]. Ndërsa sipas Sulejman Dashit në të njëjtin vend janë ndërtuar rradhazi tri kulla[46]. Dokumentimi më i vjetër i saktë i kullës së sahatit është vizatimi i realizuar nga Edward Lear më 26 Shtator 1848, ku përveç pazarit dhe njerëzve me veshje karakteristike në sheshin e tij përfshihen dhe dy objekte të cilët zhvillohen në vertikalitet, minareja e xhamisë dhe kulla e sahatit (fig. 12).




Fig. 13. Skicë - Tregu i Elbasanit, Jan Gordon, viti 1925

45 Karaiskaj, Gj., "Kalaja e Elbasanit", *Monumentet*, 1,1971, Tiranë, 1971, f. 69.

46 Dashi, S., *vep. cit.,* f. 105.



Fig. 14. Foto e vjetër e vitit 1916. Pamje e Elbasanit nga minareja e Xhamisë së Agait.




Fig. 15. Shënimi i Lear-it - Clock tower blue gray boards – Vizatimi, Elbasan 26 shtator 1848.

Për të shmangur çdo hamendësim që është apo jo kullë sahati dhe hamendësime të tjera rreth pozicionimit dhe vendndodhjes së tij, apo çdo mendimi tjetër lidhur me vizatimin e Lear mbi këtë vepër arkitektonike, po ofrojmë një vizatim tjetër

DO NOT COPY




Fig. 16. Kulla e sahatit në Kalanë e Elbasanit - Pamje në perspektivë. Skicoi: Dritan Çoku.


realizuar në vitin 1925 nga Jan Gordon (fig. 13), por edhe një foto të vjetër (fig. 14), ku në të tri rastet këndvështrimi është pothuajse në të njëjtën pozicion. Nëpërmjet krahasimit pamor del qartë se vizatimi i Lear dhe konkretisht vepra ndërtimore që paraqitet në të djathtë të tij është pikërisht kulla e sahatit. Përveç kësaj analize kemi dhe faktin e pakundërshtueshëm ku në brendësi të vizatimit mbi datën e realizimit të tij dhe emrit të qytetit kemi shënimin në anglisht "clock tower" (fig. 15), në shqip "kulla e sahatit". Pra, përpara se të ndërtohej kulla e sahatit e vitit 1899, ka pasur një tjetër kullë sahati në atë formulim arkitektonik siç ofrohet prej vizatimit të E. Lear.

Duke vrojtuar me kujdes vizatimin e Lear-it, kemi arritur të nxjerrim në pah dy elementë, të cilët të çojnë në të njëjtin përfundim, se kulla e sahatit mund të ketë qenë prej druri. Këto elementë janë: mënyra e trajtimit të lapsit mbi letër, ku Lear materializon drurin dhe shënimi i tij në brendësi të veprës "clock tower blue gray boards" (shih fig. 15), pra në shqip "dërrasa blu në gri të kullës së sahatit". Pavarësisht se në vizatimin e Lear-it nga këndi i shikimit nuk duket pjesa e poshtme e kullës së sahatit, kjo për arsye të ndërtimeve para tij dhe gjelbërimit të dendur, logjika të çon në arsyetimin se ajo do të ketë qenë e realizuar me material prej guri për arsye qëndrueshmërie, pra konstruktive dhe sipër saj me konstruksion druri (fig. 16 a). Kjo punë kërkimore e ngritur mbi bazën e të dhënave burimore, materialeve dokumentare konkrete, dhe studimit në thellësi e gjerësi të monumentit, vërteton hamendësimin e Gjerak Karaiskajt, se përpara kullës së sotme të sahatit ka pasur një tjetër prej druri. Raste të kësaj zgjidhje arkitektonike me propocione të goditura muraturë guri - konstruksion druri kemi kullat e sahatit të Pejës, Mitrovicës, Vushtrrisë, Tetovës, Ohrit, Strugës, Kosturit etj, ku disa prej tyre ashtu si në rastin e kullës së sahatit në kalanë e Elbasanit nuk i kanë rezistuar kohës.


Përfundimi

Duke gjurmuar dhe studiuar sistematikisht kullat mesjetare të sahatit në trojet shqiptare, krahasimisht dhe ato të Ballkanit, zbulimet gjenerojnë në vazhdimësi të dhëna të reja. Ato na ndriçojnë të panjohurat e arkitekturës si dhe informacione të tjera datuese. Rasti konkret solli zbulimin e një tjetër kulle sahati të ndërtuar në fillim të viteve '40 të shek. XIX (ku u njohëm me arkitekturën dhe karakteristikat e saj të ndërtimit), e cila ishte ndërtuar në të njëjtin vend me kullën e sahatit (rindërtim i vitit 1899) që trashëgojmë sot (fig. 16 a,b). Megjithatë, studime të tjera në të ardhmen do të ndriçojnë dhe plotësojnë kuadrin historik e arkitektonik me të dhëna dhe materiale të reja dokumentare faktike, duke na njohur kështu edhe me arkitekturën e shek. XVII të kësaj pasurie ndërtimore në qytetin e Elbasanit, si pasqyrë e rritjes, zhvillimit dhe rolit të qyteteve shqiptare gjatë asaj kohe.

DO NOT COPY




TAB.I Kulla e sahatit në Elbasan - Pamja perëndimore




TAB.II Kulla e sahatit në Elbasan - Pamja jugore

DO NOT COPY



TAB.III Kulla e sahatit në Elbasan - Pamja lindore



TAB.IV Kulla e sahatit në Elbasan - Pamja veriore

DO NOT COPY

BIBLIOGRAFIA

1. Arkivi i Institutit të Monumenteve të Kulturës - Tiranë, *Situacion përfundimtar punimesh*, Objekti: Mirëmbatja e kullës së sahatit në Elbasan, Dosja nr.360, Elbasan, 03.10.2012.
2. Acun, Hakki., *Osmanli İmparatorluğu Saat Kuleleri*, Ankara: Ataturk Kultur Merkezi, 2011.
3. Bérard, Victor., *La Turquie et l'hellénisme contemporain,* Paris: Félix Alcan, 1893, reprint 1911.
4. Bevapi, Kujtim., Lazareni, Ali., Koburja, Reshit., Plangarica, Tomor., Sarja, Zeqir., *Elbasani – Enciklopedi*, Elbasan: Sejko, 2003.
5. Boué, Ami., *Recueil d'itinéraires dans la Turquie d'Europe*, Détails géographiques, topographiques et statistiques sur cet empire, Vienne, 1854.
6. Buharaja, Vexhi., "Rreth mbishkrimeve të fortesës së Elbasanit", *Studime historike*, Nr.1-1967, Tiranë, 1967.
7. Çoku Dritan., "Kulla e sahatit në kalanë e Prezës", *Monumentet,* 56/2017, Tiranë: 2017.
8. Çoku, Dritan., "Kalaja e Kaninës, Misteri i kullës së sahatit, ja gjurmët e mbetura në dokumenta", gazeta *"Shqiptarja.com"*, suplementi "Rilindasi", 31 Maj 2015.
9. Dashi, Sulejman., "Kullat mesjetare të sahatit në vendin tonë"*, Monumentet,* 12,1976, Tiranë: Mihal Duri, 1976.
10. Dervishi, Dhil-li Ibni Muhamet (Evlija Çelebi)., *Shqipëria para tre shekujsh, Enciklopedi shqiptare e mesjetës,* botim i plotë, Tiranë: Besa 2000, 2000.
11. Elsie, R., *Historical Dictionary of Albania*, Second Edition, Lanham • Toronto • Plymouth, UK: The Scarecrow Press, Inc., 2010.
12. Elsie, Robert., *Early Albania: A Reader of Historical Texts, 11th-17th Centuries*, 2003.
13. Elsie, Robert., *Texts and Documents of Albanian History*, http://www.albanianhistory.net/1875_Dozon/index.html
14. Feilden, M. Bernard., Jokilehto, Jukka., *Udhëzues për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore*, Tiranë: Gent Grafik, 2010.
15. Frank, Mark., *The evolution of tower clock movements and their design over the past 1000 years*, 2013.
16. Furat, Zişan. Ayşe., Er, Hamit., *Balkans and Islam: Encounter, Transformation, Discontinuity, Continuity,* Cambridge Scholars Publishing, 2012.
17. Hahn, Georg von Johann., *Studime shqiptare*, Tiranë: Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, pa vit botimi.
18. Hecquard, Hyacinthe., *Histoire et description de la haute Albania ou Guegarie*, Paris, 1858.
19. Karaiskaj, Gjirak., *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, Tiranë: Pegi, 2016.

DO NOT COPY

20. Karaiskaj, Gjirak, “Kalaja e Elbasanit”, *Monumentet*, 1,1971, Tiranë, 1971.
21. Kiel, Machiel., *Arkitektura osmane në Shqipëri 1385-1912*, Tiranë: AIITC, 2012.
22. Leake, Martin William., *Travels in Northern Greece*, Vol 1, London: J.Rodwell, New Bond Street, 1835.
23. Lear, Edward., *Journals a landscape painter in Albania, & C.*, London: Richard Bentley, 1851.
24. Meksi, A., Bace, A., Riza, E., Karaiskaj, Gj., Thomo, P., *Historia e arkitekturës në Shqipëri*, Tiranë: Kristalina KH, 2016.
25. Meksi, Aleksandër., *Arkitektura e xhamive të Shqipërisë* (shekujt XV – XIX), Tiranë: UEGEN, 2007.
26. Mitrojorgji, Maksim., Mitrojorgji, Joli., “Elbasani - Identiteti i humbur i një qyteti”, *Monumentet*, 52/2011-2014, Tiranë: Borava, 2014.
27. Mitrojorgji, Joli., “Pazaret – Vështrim mbi morfologjinë urbane dhe strukturën e tyre hapësinore”, *Monumentet*, 56/2017, Tiranë: Morava, 2017.
28. Pouqueville, M.D. F.C.H.L., *Travels in Epirus, Albania, Macedonia, and Thessaly*, London: 1820.
29. Prashniker, Kamilo., Shober, Arnold., *Kërkime arkeologjike në Shqipëri de Mal të zi*, Tiranë: Pegi, 2003.
30. Shehu, Gani Xhevat., *Tepelena*, pa vit botimi.
31. Shkodra, Zija., *Esnafët shqiptarë (shek.XV-XIX)*, Tiranë, 1973.
32. Shkodra, Zija., *Qyteti shqiptar gjatë rilindjes kombëtare*, Tiranë: Mihal Duri, 1984.
33. Tozer, Henry., *Researches in the Highlands of Turkey*; incuding visits to mounts Ida, Athos, Olympus, and Pelion, to the Mirdite Albanians, and other remote tribes, London: John Murray, 1869.
34. Thomas, Seth., *Tower clocks*, New York: Chicago: San Francisco: Trade Mark, Nr.7, 1911.
35. Wagner, John., P.E., Huey, Cecil, Katie., Knaub, Volk, Eugene., Jagarwal, A., Modeling and Analysis of a Weight Driven Mechanical Tower Clock, 2010 *American Control Conference*, Marriott Waterfront, Baltimore, MD, USA, June 30-July 02, 2010.

DO NOT COPY

Dritan ÇOKU

THE CLOCK TOWER IN THE CASTLE OF ELBASAN

DO NOT COPY

This construction work stands out as a reference sign element, in contrast to the silhouette of the neighborhood and the city in general. Designed and built in shape and content for time measurement, it shows the clock fields from all four sides.

The story of the recent rebuilding of the clock tower is told by the inscription in Ottoman Turkish, which is located above its door. At the end of this inscription is the year 1315 AH / 1897-1898. On the left side of the Ottoman inscription is written the year 1899 with figures and the words: "Master Ilo from the village of Luko" (in old Slavic letters). According to Michael Kiel, the difference between the two dates can be explained by the fact that the text in Ottoman language was prepared many months before the tower was finished and the plain text in Slavic reflects more on the exact date of its construction.

In addition to the above two inscriptions, there are two more. One in the clock mechanism where we learn that it was produced in Milan by Caesarea Fontana, and the other in the bell, where a religious expression is written in Latin as well as the year of bell production (1819). From the records of the inscription we understand that the bell must be of some church.

The oldest accurate documentation of the clock tower is the drawing made by Edward Lear on September 26, 1848. The two elements we noted in Lear's drawing, such as how the pencil is treated on paper (where Lear materializes the wood) and his note inside the work ("clock tower blue gray boards", hence in Albanian "dërrasa blu në gri të kullës së sahatit"), lead to the conclusion that the clock tower he drew might have been from wood.

This concrete case led to the discovery of another clock tower built in the early 40s of the 19th century, which was built in the same place with the clock tower we inherit today (reconstructed in 1899).

However, further studies in the future will illuminate and complement the historical and architectural framework with new factual documentary data and materials, thus acquainting us with the XVII century architecture of this building property in the city of Elbasan as a reflection of the growth, the development and role of Albanian cities during that time.

monumentet
58/2019

Dr. Federica POMPEJANO*[1]

ÇATITË TRADICIONALE NË GJIROKASTËR, SHQIPËRI TEKNIKA E NDËRTIMIT DHE ÇËSHTJE TË KONSERVIMIT

DO NOT COPY

ÇATITË E DRUNJTA TRADICIONALE SHQIPTARE NË BURIMET E PUBLIKUARA

Studimi[1] i literaturës dhe i arkivit, i bërë gjatë studimeve të doktoraturës, theksoi se ndër elementët strukturorë e arkitektonikë të banesave tradicionale shqiptare ato më pak të studiuarat ishin strukturat e çatisë. Në fakt, analiza e burimeve të publikuara nga studiuesit shqiptarë që punonin me arkitekturën popullore në kontekst urban e rural, gjatë periudhës së komunizmi dhe pas saj, tregon se më shumë vëmendje i kushtohej aspekteve arkitektonike të arkitekturës tradicionale shqiptare, veçanërish tipologjisë së planimetrisë dhe zhvillimit të volumetrisë së banesave.

Kjo rekflektohet në numrin e madh të artikujve lidhur me tipologjitë e banesave tradicionale, publikuar në revistat shkencore kryesore të asaj kohe, si *Monumentet, Etnografia Shqiptare, Kultura Populllore, Studia Albanica, Studime Historike.* Pavarësisht sasisë së madhe të informacionit lidhur me teknikat tradicionale të ndërtimit të grumbulluara nga studiuesit shqiptarë gjatë aktiviteteve etnografike e arkitektonike në terren, vetëm pak informacion lidhur me çatitë e drunjta është publikuar. Analizimi dëshmon se struktura dhe proceset e ndërtimit të çative të drunjta tradicionale shqiptare meritonin të studioheshin më në thellësi:

> *"Kujtoj që ndonëse studimet për banesën tonë popullore janë të relativisht të shumta për nga numri dhe të larmishme për nga problematika e rrokur, në to, ndonëse nuk ka munguar informacioni për çatinë, kjo nuk është bërë, qoftë dhe në një rast të vetëm, objekt i ndonjë trajtese të veçantë."* (Muka 1999: 123)

Njëkohësisht, burimet e publikuara raportonin mbi një tip të çative tradicionale, të quajtur *çati stropil,* që konsiderohej tipike për banesat qytetare tradicionale të qyteteve kryesore shqiptare të shek. XVIII dhe XIX (Muka 2007: 394; Riza 2009: 389). Është interesante të theksohet se ndërkohë që në të gjithë qytet e fshatrat kryesore të Shqipërisë të kësaj periudhe kjo strukturë çatie ishte mjaft e përhapur, përtej disa diferencave lokale lidhur me organizimin dhe numrin e elementëve përbërës të çatisë, në Gjirokastër u zhvillua një sistem

1 Dr. Pompejano ka fituar gradën European PhD, *cum laude*, në "Ruajtja e Trashëgimisë Arkitektonike" në Politeknikun e Milanos (2018) dhe MSc në Inxhinieri Ndërtimi dhe Arkitekturë ne Universitetin e Genovas (2012). Që nga janari 2018 ajo mban titullin Honorary Fellow në "Teknologji e konservimit dhe restaurimit" dhe "Bazat dhe prakikat e teknologjisë" në UNIGE. Anëtare e SIRA (2018) dhe ISCUM (2019). Gjatë vitit të fundit ajo ka qenë Kërkuese Shkencore Post-Doktoraturë në Teknologjinë e Arkitekturës (UNIGE). Gjithashtu, ajo ka qenë e përfshirë si Kërkuese Shkencore Visitor pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike në Tiranë, Shqipëri. Që nga korriku 2019 grada e saj është njohur si "Doktor" në "Ruajtja e Trashëgimisë Arkitektonike" nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë e Shqipërisë.

ORCID ID: https://orcid.org/0000-0002-7602-8013

tërësisht i ndryshëm i strukturave të çatisë (Riza 1981: 136; Riza 2004: 142; Riza 2009: 395), i cili mund të vërehet i plotë edhe sot në shumë *banesa gjirokastrite.*

Veçanërisht, sa i takon rastit të Gjirokastrës, kontributi i burimeve të publikuara kufizohet te disa informacione të pakta e të përgjithshme të raportuara në monografitë e *Emin Rizës* dhe nga disa artikuj të




Fig. 1. Skicë e një çatie tradicionale prej druri në Gjirokastër, publikuar te revista "Monumentet" 2/1971. (Burimi: Kamberi Th., 1971)

paktë të publikuar te periodikja *Monumentet*. Këto burime përmbajnë disa përshkrime të përgjithshme të çative, duke u fokusuar në detaje arkitektonike, si tipologjitë e strehave. Sidoqoftë, janë raportuar edhe disa skica (Fig. 1), edhe pse në to mungon përshkrimi teknologjik përkatës (Riza 1981: 139-140; Riza 2004: 145-146). Megjithatë, ekspertët ishin në dijeni të veçantisë së çative të Girokastrës krahasuar me çatitë e tjera tradicionale shqiptare (Kamberi 1971: 159; Riza 1981: 139; Riza 2004: 143; Muka 2007: 395, Riza 2009: 389).

KËRKIMI ARKIVOR DHE FUSHATA E INSPEKTIMIT

Aktiviteti në terren zgjati për një muaj, në qershor 2014 dhe për katër muaj në vitin 2015. Gjatë kësaj periudhe u bë kërkimi historik në arkivën e IMK-së në Tiranë dhe fushata e inspektimit në Gjirokastër. Koha e shpenzuar në Tiranë dha mundësinë të mblidhej informacion dhe material mbi monumentet e kategorisë I dhe II që gjenden në qendrën historike të Gjirokastrës. Materiali arkivor është i shumtë dhe përfshin fotografi, skica, rilevime gjometrike, pamje, prerje e detaje konstruktive të elementëve kryesorë të tipologjive të *banesave gjirokastrite*, por në shumë raste mungojnë përshkrime të detajuara të strukturave të drunjta të çative. Gjithashtu, vetëm në pak raste, dokumentet arkivore të IMK-së raportojnë material mbi strukturat e drunjta të çative.

Kështu, inspektimi dhe analizimi i drejpërdrejtë i çative të drunjta të Gjirokastrës ishin burimi kryesor i informacionit sa i takon identifikimit të morfologjive strukturore dhe njohurive mbi teknologjitë e ndërtimit. Përzgjedhja e objekteve për inspektim (Fig. 2) u bë duke u bazuar në ndërtesat e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur, sipas përcaktimeve të Dosjes së Nominimit UNESCO 2008; listën e monumenteve të mbrojtura sipas *VKM nr. 619 "Për shpalljen 'Qendër Historike' të një zone në qytetin e Gjirokastrës dhe miratimin e Rregullores 'Për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur në qytetin e Gjirokastrës",* datë 07.07.2015 dhe sipas kritereve të aksesueshmërisë dhe sigurisë. Nisur nga nevoja për të parë e studiuar një numër sa më të madh të çative, mundësisht të përzgjedhura nga të gjitha lagjet e qendrës historike, nuk është bërë rilevim i detajuar i asnjë rasti. Inspektimet u konceptuan si rilevime paraprake, që synonin të kishin si rezultat draft-skica të planeve të çative, prerjeve kryesore dhe detajeve, si dhe një seri fotografish të strukturave të drunjta dhe lidhjeve të elementëve. (Fig. 3) Sidoqoftë, janë bërë matje dhe të seksioneve të elementëve kryesorë, distancat aksiale mes tyre, gjerësia e mureve mbajtëse dhe lartësia e çative. Dimensionet e përgjithshme të ndërtesave dhe largësitë mes mureve mbajtëse janë marrë nga konsultimet me materialet arkivore. Fushata e fotografimit shërbeu

DO NOT COPY




Fig. 2. Harta e inspektimit. (Burimi: Pompejano F., 2018)




Fig. 3. Shembull i skicave me dorë të realizuara gjatë fushatës së inspektimit. (Burimi: Pompejano F., 2018)

për disa qëllime: 1) realizoi një dokumentim të plotë të gjendjes së përgjithshme të strukturës së çatisë; 2) mundësoi krijimin e një "kujtese artificiale", të nevojshme për të mbajtur mend organizimin e elementëve, lidhjet mes tyre, dëmtimet dhe mungesën e qëndrueshmërisë të vërejtura gjatë

DO NOT COPY

inspektimeve; 3) krijon mundësinë për thellimin e observimeve vizive, të pjesëve që nuk ishin shumë të aksesueshme gjatë inspektimeve; 4) krijimi i një dokumenti të fenomeneve të vërejtura të dëmtimeve dhe mungesës së qëndrueshmërisë; 5) krijimi i një materiali bazë për aktivitete të mëtejshme procesimi. Në përfundim të fushatës së inspektimit, faza e procesimit të materialit të grumbulluar rezultoi në identifikimin e katër llojeve të strukturave të çatisë, të cilat mund të konsiderohen specifike për qendrën historike të Gjirokastrës dhe territorin e Shqipërisë.

ÇATITË E DRUNJTA TRADICIONALE NË GJIROKASTËR

Njohuritë empirike apo ato lidhur me strukturat e çative nuk do të thonë patjetër se ndërtuesit apo mjeshtrat e teknikave tradicionale i kuptonin plotësisht sjelljet strukturore të çative, edhe pse e dinin se disa elementë punonin në shtypje e disa në tërheqje. Gjithashtu, njohuritë janë përfituar nga procesi i të mësuarit gjatë punës dhe në disa raste zgjidhjet e suksesshme kopjoheshin në zona të ndryshme për raste të ngjashme. Mjeshtrat e ndërtimit e bazonin ndërtimin e strukturave të drunjta të çative tradicionale në këto njohuri




Fig. 4. Çatitë tradicionale prej druri të Gjirokastrës. (Burimi: Pompejano F., 2018)

empirike, transmetuar brez pas brezi nga mjeshtrat te çirakët. Në një shikim të parë, strukturat e drunjta të çative tradicionale të Gjirokastrës duket sikur nuk i përkasin asnjë llogjike konstruktive: një "pyll" i kompozuar nga elementë strukturorë të pjerrët, të vendosur pranë njëri-tjetrit (Fig. 4). Nëse përqendrohemi në gjerësinë totale të mbuluar nga




Fig. 5. Skemat që përfaqësojnë katër Strukturat e Çatisë të identifikuara në Qendrën Historike të Gjirokastrës. (Burimi: Pompejano F., 2018)

DO NOT COPY

struktura e çatisë, gjëja e parë që vëmë re është se kompleksiteti i strukturës së drunjtë të çatisë rritet me rritjen e numrit të hapësirave të ndërmjetme që duhen mbuluar, pra të numrit të mbështetjeve të mundshme. Kjo tregon se nga këndvështrimi strukturor, organizimi i elementëve strukturorë qartazi i përgjigjet nevojës për të shpërndarë ngarkesën, jo vetëm përgjatë mureve perimetrale, por dhe në muret mbajtëse tërthore ose gjatësore, duke ulur në minimum sipërfaqen e ndikimit të secilit element strukturor. Organizimi i mureve mbajtëse sigurisht varet nga plani i ndërtesës dhe përcakton sekuencën e numrit të distancave më të vogla që duhen mbuluar nga struktura e çatisë. Sa më e madhe të jetë distanca totale për t'u mbuluar, aq më e zhvilluar dhe e artikuluar është struktura e brendshme e drunjtë e çatisë. Kështu, nisur nga numri i mbështetjeve të strukturës së çatisë dhe nga numri i distancave të brendshme për t'u mbuluar, janë identifikuar katër lloje të strukturave të çatisë (Fig. 5): Struktura e çatisë "A"; Struktura e çatisë "B"; Struktura e çatisë "C"; Struktura e çatisë "A". Këto katër lloje strukturash kanë të përbashkët numrin e madh të elementeve të drunjtë të vendosur në distancë të vogël mes tyre, që bashkëpunojnë për të mbajtur mantelin e gurtë të çatisë. Elementët e drunjtë primarë për strukturën janë të njëjtë për të katër strukturat e identifikuara. Numri i lartë i elementëve dhe nevoja për t'i vendosur në distanca të vogla mes tyre argumentohet me seksionin e vogël të këtyre elementëve, me lartësi që varion nga 30-250mm e gjerësi që varion në 50-250 mm. Gjithashtu, të katër llojet e strukturave të çatisë janë të lidhura në mënyre direkte me *brezin e çatisë,* pjesë e brezave të drunjtë të vendosur në muret mbajtëse çdo 80-120 cm, duke nisur nga kati përdhes e deri te niveli i çatisë, jo vetëm nëpërmjet *tabaneve*, trarë horizontalë, por edhe nëpërmjet *testekëve*, elementë të hollë të vendosur në pozicion të inklinuar që mbështesin elementët e drunjtë që formojnë *strehët e çatisë. Testekët* e gjatë, që mbështesin strehën e çatisë në fasadën kryesore, janë të gozhduar me sistemin e brezave të drunjtë të vendosur në muraturën mbajtëse prej guri në nivelin e dyshemesë së katit të sipërm, ndërsa *testekët* e shkurtër janë të gozhduar me sistemin e brezave të drunjtë në një nivel më poshtë se ai i nën-çati, të i cili gozhdohen *tabanët*. Kjo e bën të mundur të përceptohet synimi i krijimit të një sjelljeje të ndërtesës të ngjashme me atë të një kutije. Manteli i rëndë i çative përbëhet nga rrasa guri gëlqeror, 2.4-3.5 cm të gjëra, të vendosura pjesërisht mbi njëra-tjetrën mbi petavra, duke nisur nga *zinxhir i tabanit* deri te *kulmi*. Për vendosjen e rrasave të gurit nuk përdoren gozhdë, lidhëse metalike, apo llaç. *Petavrimi* bëhet me elementë të hollë prej druri, të vendosur në një distancë 5-8cm nga njëri-tjetri. Analizimi i nyjeve mundësoi të kuptohej se si këto katër lloje të strukturave të çative prezantojnë të njëjtin tip lidhjeje realizuar me të njëjtit proces të punës me dru. Në fakt, lidhjet mes elementëve të drunjtë janë gjithmonë shumë të thjeshta dhe sipërfaqet e elementëve janë gjithmonë të punuara shumë vrazhdë me sqepar.



Fig. 6. Realizimi i lidhjeve karakterizohet gjithmonë nga prania e gozhdëve, të quajtura gozhdë kovaçi. (Burimi: Pompejano F., 2018)

Mungesa e një përpunimi të detajuar të lidhjeve tejkalohet nga numri i lartë i elementëve që japin kontributin e tyre në stabilitetin e të gjithë sistemit të strukturës. Realizimi i lidhjeve karakterizohet gjithmonë nga prania e *gozhdëve të kovaçit*, të cilat

DO NOT COPY



Fig. 7. Çatia e banesës Myrteza Toro është një shembull i Strukturës së Çatisë "A". (Burimi: Pompejano F., 2018)

në disa raste mbështeten nga prania e *kunjave*, që e vënë lidhjen në pozita pune. Seksioni i gozhdëve është katror, ndërkohë që gjatësia varion në 12 ÷ 14 cm. Ndërkohë, gozhdët e përdorura për të lidhur *petavrat* me *mahitë*, kanë dimensione mjaft më të vogla (Fig. 6). Përgjithësisht, elementët konstruktivë janë përftuar nga trungje druri me numër të kufizuar nyjesh e pa deformime gjatësore, përpunimi është bërë me sqepar në pyll, e më pas elementët janë transportuar në sitin e ndërtimit. Fotografimi mundësoi të shquheshin qartë shenjat në sipërfaqe të elementëve të drunjtë, që dëshmojnë se përpunimi i tyre bëhej me sqepar. Sipas literaturës shqiptare, drunjtë më të pershtatshëm për strukturat e çative ishin arra, bredhi, lisi e pisha (Muka 2007: 330; 394).

Struktura e çatisë "A"

Struktura e çatisë "A" (Fig. 7) është ajo që mundëson mbulimin e hapësirave të vogla, me distancë rreth 4.5-5.5 m mes mureve perimetral mbajtës, në mungesë të elementëve mbajtës në mes tyre.

Ajo përbëhet nga dy *mahi* të gozhduara në pjesën e poshtme me *tabanët*, të vendosur për të mbuluar distancën më të vogël mes mureve mbajtës, dhe në pjesën e sipërme me *kulmin*. Në shumë raste nuk ka prani *kulmi* e *mahitë* gozhdohen me njëra-tjetrën me kllapë. Në gjysëm të distancës mes mureve mbajtëse vendoset *lumi*, një element horizontal i vendosur në drejtim tërthor ndaj *tabanëve*. Mbi *lumin* gozhdohen të paktën dy elementë vertikalë, të quajtur *baballëk*, që shërbejnë si mbështetje për *kulmin*. Një element horizontal, i quajtur *dajanta,* vendoset nën *mahi*, në 1/3 e gjatësisë totale të tyre.

DO NOT COPY



Fig. 8. Çatia e banesës Nesip Skënduli është një shembull i Strukturës së Çatisë "B" (Burimi: Pompejano F., 2018)

Zakonisht, lartësia e Struktura e çatisë "A" varion te 120 ÷ 160 cm. Variacione të këtij lloji përfshijnë shtimin e elementëve të inklinuar, të quajtur *pajanta*, që zëvendësojnë ose përforcojnë rolin mbështetës të *dajantes*. Këto elementë mund të lidhen në pjesën e sipërme të *mahitë* ose te *zinxhirët*.
Në *banesat gjirokastrite* me planimetri të artikuluara e me sipërfaqe të madhe, struktura e çatisë "A" përdoret për mbulimin e krahëve.

Struktura e çatisë "B"
Struktura e çatisë "B" (Fig. 8) rezultoi të ishte struktura më e përhapur mes banesave të inspektuara në qëndrën historike të Gjirokastrës. Ajo mund të gjendet në banesa me dy a tre hapësira të ndërmjetme për mbulim, ndërkohë që numri i mureve të brendshme mbajtëse është një. Kjo strukturë përdoret në banesa të *variantit me një* dhe *ato me dy krahë*, dhe nënvariantet e tyre. Struktura e çatisë "B" zhvillohet në bllokun bazë të banesave me një krah, ose në pjesën qendrore të planit me dy krahë, duke u realizuar me një numër më të madh *pajantash*, të cilat mbështesin *mahitë* në disa pika kontakti. Në pikën e tyre të sipërme, *pajantat* mbështesin sistemin lidhës të *zinxhirëve* të vendosur e gozhuar bashkë, në faqen e poshtme të *mahive*. Sistemi lidhës i zinxhirëve është një rrip që zhvillohet në pikat kryesore të çatisë. Zinxhirët mund të hasen në 1-3 nivele, në varësi të gjatësisë së *mahive*. Vendosja e zinxhirëve bëhet e nevojshme edhe pse shpeshherë *mahitë* përbëhen nga dy elementë druri të lidhur nëpërmjet një lidhjeje të njohur si *lidhje me fallco*, për të mbuluar distancën e faqes së çatisë. Në shumë raste, një nivel i zinxhirëve vendoset pikërisht në

DO NOT COPY



Fig. 9. Çatia e banesës Myrteza Gurgaj është një shembull i Strukturës së Çatisë "C" (Burimi: Merxhani K., 2014; Pompejano F., 2018)

kuotën e këtij bashkimi nën kokën e elementit të poshtëm që përbën *mahinë.* Struktura e çatisë "B" ka lartësi të brendshme që arrin deri 4 m. *Baballëkët* kanë një seksion më të madh se *mahitë e tabanët*, dhe janë shpesh të barazlarguar, jo me shumë se 150 cm nga njëri-tjetri. Zakonisht kulmi, i mbështetur te *baballëkët*, është një element i vetëm, që shkon nga baballëku i parë tek ai i fundit. Struktura e çatisë "B" dëshmon për konceptimin tredimensional, si një nga veçoritë karakteristike të çative të drunjta tradicionale në Gjirokastër.

Struktura e çatisë "C"

Struktura e çatisë "C" përfaqëson një rast të konceptimit tredimensional. Kjo lloj strukture përdoret për të mbuluar hapësira të mëdha qendrore me 2-3 nëndarje. Në më të shumtën e rasteve, këto struktura mbulojnë tre hapësira të ndërmjetme, duke u mbështetur në dy mure mbajtëse të brendshme, të cilët shpesh janë vazhdim të mureve perimetrale të krahëve të ndërtesës në hapësirën së brendshme të ndërtesës (Fig. 9). Rastet e inspektuara që i përkasin kësaj lloj strukture dëshmojnë se mbështetjet e brendshme janë mure mbajtëse prej guri, në të cilat shtrihet sistemi i brezave të drunjtë. Struktura e çatisë "C" përbëhet nga dy grupe të mëdha *pajantash* të gozhduara në pjesën e poshtme të tyre të brezat e pozicionuar në gjerësinë e dy mureve të brendshëm mbajtës. Në pikën e tyre të sipërme *pajantat* gozhdohen me zinxhirin dhe mbështesin

DO NOT COPY



Fig. 10. Çatia e banesës Dasho Karagjozi, shembull i Strukturës së Çatisë "D" (Burimi: Pompejano F., 2018)

mahitë, në çdo nivel *zinxhirësh*, të vendosur poshtë *mahive*. Në disa raste vendoset një *jastëk*, element i vogël horizontal, mes *pajantave* dhe elementëve që përbëjnë *zinxhirin*. Ka gjithashtu raste kur një tjetër *jastëk* vendoset në gjysmë të gjatësisë së *angonarit*. Në këtë strukturë *angonari* mund të vendoset sipas aksit gjatësor ose tërthor të ndërtesës. Në rastet kur kulmi është vendosur sipas aksit gjatësor, është e rrallë të haset ndërthurja e dy grupeve të pajantave. Ndërsa, në rastet kur kulmi vendoset sipas aksit tërthor, grupet e *pajantave* mund të kryqëzohen dhe gjithashtu, hasim praninë e një lumi mbi tabanët e vendosur mes dy mureve të ndërmjetëm. Në këtë rast, *angonari* mbështetet dhe në elementë vertikalë.

Numri i niveleve të zinxhirëve mund të variojë në 3-4, ndërsa lartësia e brendshme e çatisë shkon deri në 5 m. Duhet veçuar një nga rastet e veçanta të rilevuara, kur një grup *pajantash* ishin mbështetur në pikën e kryqëzimit mes muraturës së brendshme me drejtim gjatësor me atë me drejtim tërthor.

Struktura e çatisë "D"

Struktura e çatisë "D" është rasti më kompleks. Në pamje të parë, duket sikur shkrin konceptimet hapësinore të Strukturës së çatisë "B" e asaj "C" (Fig. 10). Kjo strukturë haset kur numri i hapësirave të ndërmjetme që mbulohen jane 4 dhe kur numri i mbështetjeve të brendshme është 3, nga të cilat, të paktën një është mur mbajtes guri. Prerja

DO NOT COPY

tërthore e kësaj strukture tregon seritë e *pajantave* që kryqëzohen, mbështetur në anët e brendshme të mbështetjes së parë e të tretë të ndërmjetme dhe që në pjesën e sipërme mbështesin zinxhirët në dy faqet e kundërta. Pozicionimi i niveleve të zinxhirëve nuk është aspak i rastësishëm. Ai duket se ndjek modulin që i përket ndarjes më të vogël të brendshme, që zakonisht ka një dimension 190-250 cm. Edhe në këtë rast, mund të ndodhë që *angonari* është i vendosur në drejtim tërthor ndaj aksit kryesor gjatësor të ndërtesës, ose në drejtim gjatësor.

ÇËSHTJE TË KONSERVIMIT

Studimi vuri në dukje se, teksa në qytetet e fshatrat kryesore në Shqipëri haset një lloj strukture e thjështë e përbashkët e çative, në Gjirokastër ishte zhvilluar një sistem strukturor më i artikuluar e specifik i çative. Brenda kësaj tipologjie, janë identifikuar 4 nënvarinatet. Elementët strukturorë, lidhjet dhe elementët metalikë janë identifikuar e përshkruar. Ekzistenca e shumë shembujve të kësaj tipologjie, ende sot e kësaj dite, dëshmon për një sistem të veçantë ndërtimi që meriton të njihet e të ruhet si një shembull i jashtëzakonshëm i teknikave tradicionale të ndërtimit në Shqipëri. Ndërhyrjet në to duhet të karakterizohen nga një qasje e thjeshtë që duhet të marrë në konsideratë varietetet e mundshme të sturkturave në Gjirokastër; të ketë një numër minimal ndërhyrjesh fizike, të nevojshme për të garantuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë; të respektojë materialet, ndërkohe që respekton parimet konstruktive dhe logjikën strukturore. Për më tepër, si pasojë e kompleksitetit të rasteve më të artikuluara të këtyre çative të drunjta tradicionale dhe e numrit të madh të elementeve të drunjtë, çdo zgjidhje teknike lokale apo globale do të ishte e vështirë të përshtatej në të gjithë variantet morfologjike që mund të hasen gjatë inspektimeve në terren. Kështu, çdo ndërhyrje konservimi e përforcimi duhet adresuar me një qasje rast pas rasti. Profesionistët vendas duhet të ftohen të tregojnë kujdes ndaj rëndësisë së jashtëzakonshme të fazave të grumbullimit të njohurive dhe diagnostikimit në proceset e ruajtjes së strukturave të drunjta.

Në nivel ndërkombëtar, teksti i përditësuar i *ICOMOS' Principles for the conservation of wooden built heritage* (ICOMOS 2017: 2) identifikon qartazi tre faza të rëndësishme në të cilat duhet të artikulohet procesi i dizenjimit të ndërhyrjes së konservimit: faza e inspektimit, rilevimit dhe kërkimit; faza e analizimit dhe vlerësimit; dhe faza e ndërhyrjes. Në përgjithësi, dy fazat e para mund të përmblidhen në një, faza e grumbullimit të njohurive, e ndarë në hapa të ndryshëm. Këto hapa përfshijnë kërkimin arkivor dhe historik, rilevimet gjeometrike dhe teknologjike, observimi dhe analizimi i gjendjes së dëmtimit të materialeve dhe të dëmtimeve strukturore e mungesës së qëndrueshmërisë. Faza e parë, e grumbullimit të njohurive, duhet të jetë e detyrueshme për këdo që do dëshirojë të ndërhyjë në trashëgiminë arkitektonike të Gjirokastrës.

Lidhur me procedurat dhe kriteret e vlerësimit të gjendjes së konservimit dhe të funksionimit të strukturave të drunjta UNI 11119:2004 "*Cultural Heritage – Wooden artifacts. Load-bearing structures – On site inspections for the diagnosis of timber members*", shprehet qartë se ekzekutimi i inspektimeve duhet të rezultojë në të dhëna të sakta sa i takon identifikimit të llojit të drurit, kushteve termo-higrometrike dhe përmbajtjes së lagështisë së drurit, përshkrimin e përgjithshëm dhe rilevimin gjeometrik e teknologjik të secilit element të drunjtë të strukturës dhe vlerësimin të secilit element sipas rezistencës. Më tej, procesimi i të gjithë të dhënave historike, grafike, diagnostike dhe numerike të grumbulluara përfaqëson një tjetër moment të rëndësishëm në procesin e dizenjimit të ndërhyrjes. Kështu, duhet mundësuar një analizë e saktë e të dhënave e cila duhet pasuar me një interpretim të plotë të rezultateve. Në këtë fazë, një analizë strukturore e plotë dhe e mirëplanifikuar e aftësisë mbajtëse të strukturës duhet bërë për

DO NOT COPY

të kuptuar plotësisht sjelljen strukturore të këtyre çative, në nivel lokal e global.

Rëndësia e ruajtjes së çative të drunjta tradicionale të Gjirokastrës qëndron, mbi të gjitha, në nevojën për të ruajtur autenticitetin e konceptimit strukturor të tyre, pa përjashtuar kryerjen e ndërhyrjeve emergjente, kur ato janë të nevojshme. Për më tepër, është e ditur se shmangia e zëvendësimit të strukturave origjinale të çative të drunjta dhe adoptimi i teknikave më pak invazive është shpesh zgjidhja më e përshtatshme, veçanërisht kur është e nevojshme një ndërhyrje përforcimi sizmik (Parisi, Chesi & Tardini 2011). Në fakt, arsyeja pse shpesh herë strukturat e çative të drunjta tradicionale janë ende në këmbë është për shkak të qëndrueshmërisë së tyre dhe sjellja gjysmërigjide dhe duktil e nyjeve të tyre, që lejon shpërndarjen e energjisë, veçanërisht në rastin e ngarkesave te jashtëzakonshme, si p.sh. forcat horizontale, si tërmetet dhe ngarkesat nga era (Branco & Descamps 2015: 38). Një analizë e thjeshtëzuar që merr në konsideratë vetëm pjesët dydimensionale është shpesh e vështirë për t'u realizuar, pasi çatitë e drunjta tradicionale të Gjirokastrës janë struktura hiperstatike. Kjo do të thotë që ngarkesat e ushtruara mbi strukturat e këtyre çative përdorin rrugë të ndryshme për të arritur mbështetjet, pra muret perimetrale ose muret e brendshme mbajtëse, gjatësore e tërthore, kolonat e drunjta apo muret *çatma*.

Zgjidhja e një sistemi të papërcaktuar nënkupton të kërkohet për ekuacione të tjera që do të shprehnin ngurtësinë relative të çdo rruge të mundshme që ndikon në sjelljen e strukturës. Në këto kushte, 3D Finite Elements Modelling – FEM është metoda më e përshtatshme për vlerësimin e sjelljes strukturore të këtyre çative të drunjta, ku i duhet kushtuar një vëmendje e madhe ngurtësisë së nyjeve, të elementëve dhe jashtëqendërsisë së nyjeve për njehsimin e forcave të brendshme (EN 1995-1:2005, Part 1-1). Shumë studime kanë dëshmuar se modelimi i strukturave që merr në konsideratë sjelljen gjysmë të ngurtë të lidhjeve është metoda më e mirë (Piazza et al., 2007; Branco, Piazza & Cruz 2010: 371; Branco & Descamps 2015: 37). Ngurtësia e lidhjeve duhet të llogaritet në lidhje me përbërësit pingul, paralel e përkulës të ngarkesave. Kështu, para çdo ndërhyrjeje që synon zëvendësimin apo përforcimin e nyjeve të pranishme në strukturat e çative të drunjta në Gjirokastër, nevojitet një vlerësim dhe studim i secilit element të drunjtë dhe i nyjeve mes tyre në raport me karakteristikat e materialit, forcë dhe ngurtësi të tyre, për përcaktimin e një modeli të përshtatshëm strukturor. Rëndësia e një planifikimi e ekzekutimi rigoroz të fazës së ndërhyrjes, si dhe të dhënave dhe rezultateve të besueshme dhe të plota duhet të jenë kërkesa themelore të çdo ndërhyrjeje konservimi apo përforcimi, si në elementë të veçantë, apo edhe në të gjithë strukturën e çatisë prej druri. Duhet të parapëlqehen ndërhyrje të kthyeshme, reversibel, apo ndërhyrje që nuk do ndikonin apo kufizonin ndërhyrje të ardhshme konservimi, duke ndjekur parimin e realizimit të ndërhyrjeve minimale të mundshme, për të garantuar mbijetesën e konstruksionit, duke i mundësuar funksionimin e sigurt.

Përgjithësisht, *2017 ICOMOS Principles* këshillojnë që në kushtet kur struktura ka një performancë në një nivel të mjaftueshëm dhe përdorimi, kushtet dhe ngarkesat e saj nuk ndryshojnë, atëherë ndërhyrjet mund të jenë të thjeshta, që synojnë të ulin dëmtimin apo dështimin e strukturës. Në të kundërt, nëse struktura është subjekt i ndryshimeve të shumta që shkaktojnë modifikime të regjimit të ngarkesave, para se të bëhen ndërhyrje përforcuese, duhet përllogaritur aftësia e mbajtjes së ngarkesave (ICOMOS 2017: 4). Me synim mbrojtjen e rëndësisë kulturore të strukturave, ndërhyrjet më të përshtatshme janë ato të thjeshtat, që përdorin teknikat tradicionale, lidhës modernë të përshtatshëm, apo ato që përdorin struktura shtesë, që i lehtësojnë ato ekzistuese nga ngarkesat (ICOMOS 2017: 3).

Në përmbyllje, puna e bërë, duke përfituar nga

DO NOT COPY

këto studime arkitektonike, përpiqet të thellojë njohuritë mbi teknikat tradicionale shqiptare të ndërtimit, duke nisur nga analizimi i strukturave të çative të drunjta në Gjirokastër. Duke vazhduar e pasuruar punën e dokumentimit të nisur nga studiuesit shqiptarë gjatë periudhës së regjimit komunist, ky kërkim shkencor synoi të arrinte në një përkufizimin të parë të strukturave të drunjta të çative në Gjirokastër. Sa i takon këtyre strukturave, një studim i mëtejshëm duhet të adresojë sjelljen e plotë strukturore dhe nyjet, në mënyrë që të caktohet një model strukturor i saktë e të formulohen udhëzues specifikë dhe *ad hoc* për ndërhyrjet. Ndërkohë, nga ana e institucioneve vendase duhet implementuar një sistem koherent dhe efektiv i vendosjes në hartë të këtyre strukturave si dhe një strategji monitorimi dhe mirëmbajtjeje për të mundësuar një proces të vazhduar e parandalues, që do të sigurojë një performancë jetëgjatë të çative të drunjta të Gjirokastrës.

SHËNIME

Ky artikull përmban rezultate nga teza e doktoraturës së autores, mbrojtur në Shtator 2018 në Politecnico di Milano (Itali). Autorja dëshiron të falenderojë IMK që bëri të mundur përdorimin e arkivit dhe bibliotekës së institucionit për konsulta gjatë kërkimit shkencor. Ky artikull është përkthyer nga anglishtja në gjuhën shqipe nga Anisa Lloja.

DO NOT COPY

BIBLIOGRAFI

EN 1995-1:2005. EUROCODE 5: Design of Timber Structures – Part 1-1: Common rules and rules for buildings. Brussels: CEN – European Committee for Standardization.

Branco, J. M., Piazza, M., & Cruz, P.J.S., "Structural Analysis of two King-post timber trusses: Non-destructive evaluation and load-carrying tests", *Construction and Building Materials,* 2010, 24, f. 371-383.

Branco, J. M., & Descamps, T., "Analysis and strengthening of carpentry joints", *Construction and Building Materials,* 2015, 97, f. 34-47.

ICOMOS, "Principles for the conservation of wooden built heritage", 19th General Assembly, Delhi, India, 2017, f. 1-6.

Kamberi, T., "Disa të dhëna mbi teknikën e ndërtimit të banesës gjirokastrite", *Monumentet*, 1971, 2, f. 157-163.

Muka, A., "Çatia në banesën fshatare", *Kultura Popullore*, 1999, 39-40 (1-2), f. 99-133.

Muka, A., "Çatia e "shtëpisë" në mendësinë popullore - Shqyrtim etnografik", *Perla*, 2001, 1-4, f. 55-79.

Muka, A., *Banesa fshatare dhe familja e madhe*. Tirana: Akademia e Shkencave, 2001.

Muka, A., *Ndërtimet tradicionale fshatare - Monografi Etnologjike,* 2007, Tirana: Akademia e Shkencave.

Parisi, M. A., Chesi, C., & Tardini, C., "Structural conditions and seismic vulnerability of timber roofs", në *Proceedings of International Conference on Structural Health Assessment of Timber Structures – SHATIS,* (16-17 June 2011), Lisbon, Portugal, 2011, f. 1-12.

Parisi, M. A., Chesi, C., & Tardini, C., "The role of timber roof structures in the seismic response of traditional buildings", në *Proceedings of the 15th World Conference on Earthquake Engineering,* (24-28 September 2012), Lisbon, Portugal, 2012, f. 1-10.

Piazza, M., Tomasi, R., Parisi, M.A., & Branco, J.M., "Analisi sperimentale su collegamenti tradizionali e rinforzati nelle capriate lignee", në *Proceedings of the National Conference 'L'ingegneria sismica in Italia'- ANIDIS*, (10-14 June 2007), Pisa, Italy, 2007, f. 1-9.

Pompejano, F., "Struktura e çatisë së drunjtë të banesës së Skëndulajve, Gjirokastër", *Monumentet*, 2014, 52, f. 159-172.

Pompejano, F., Merxhani, K., "Preliminary studies on traditional timber roof structures in

DO NOT COPY

Gjirokastra, Albania", në *Vernacular Architecture: Towards a Sustainable Future – VerSus. Proceedings of the International Conference on Vernacular Heritage, Sustainability and Earthen Architecture*, (11-13 Sep 2014), Valencia, Spain, 2015, f. 631-636.

Pompejano, F., *Albanian Traditional Architecture-Traditional Timber Roofs in Gjirokastër, Albania. From knowledge to preservation,* PhD Thesis, Politecnico di Milano, 2018.

Riza, E., "Banesa e fortifikuar gjirokastrite", *Monumentet*, 1971, 1, f. 127-147.

Riza, E., *Qyteti-Muze i Gjirokastrës. Monografi.* [1. ed.]. 1981, Tirana: «8 Nëntori».

Riza, E., *Qyteti-Muze i Gjirokastrës. Monografi.* [2. ed.]. 2004, Tirana: Toena.

Riza, E., *Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare e shek. XV-XIX,* 2009, Tirana: Dita2000.

Riza, E., & Thomo, P., "Banesa popullore shqiptare, arritjet dhe e ardhmja", *Monumentet,* 2014, 52, f. 11-24.

Riza, E., "Gjirokastra në rrjedhë të vlerësimit të saj", *Monumentet*, 2015, 53, f. 15-34.

UNESCO, Nomination file 569 rev., 2005.

UNI 11119:2004, *Beni culturali - Manufatti Lignei - Strutture portanti degli edifici - Ispezioni in situ per la diagnosi degli elementi in opera,* 2004.

VKM no. 619, datë 7.7.2015, *"Për shpalljen 'Qendër Historike' të një zone në qytetin e Gjirokastrës dhe miratimin e Rregullores 'Për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur ne qytetin e Gjirokastrës".*

DO NOT COPY

Dr Federica Pompejano*[1]

TRADITIONAL TIMBER ROOFS IN GJIROKASTRA, ALBANIA. BUILDING TECHNIQUE AND CONSERVATION ISSUES

DO NOT COPY

ABSTRACT

This article is based on the author recent PhD research results on Traditional timber roofs in Gjirokastra, historic citadel located in the Drinos Valley, South Albania. In this paper, the author will focus on Albanian traditional timber roof structures and will propose a first typology classification of traditional timber roofs in Gjirokastra, describing the four identified main wooden frameworks, their structural members and carpentry joints. The research, making use of the inductive method, has been developed in operational phases that range from the analysis of the specific literature, to the consultation of archival documents, kept at the Instituti i Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri "- IMK in Tirana, to the subsequent census and survey fieldwork activities of Gjirokastër's wooden roofs. In the conclusion, the author will deal with a series of conservation issues underlining how the evidence of many examples of these roof structures testify a peculiar building system that deserves to be recognized and preserved as outstanding example of the Albanian traditional building techniques. The preservation interventions should be characterized by simple approaches that have to consider the variety of the possible existing structural frameworks within Gjirokastër, to contain minimal interventions, needed to ensure safety and durability, and possibly to respect the original materials while preserving the constructive principle and the structural logic. Moreover, a mapping, monitoring and maintenance strategy and ad hoc conservation guidelines should be implemented to help and ensure a long-term performance and conservation of Gjirokastër timber roofs.

1 Dr Pompejano obtained the European PhD, cum laude, in "Preservation of Architectural Heritage" at the Politecnico di Milano (2018) and the MSc in Building Engineering and Architecture at the University of Genoa (2012). Since January 2018, she is appointed as Honorary fellow in "Conservation and restoration technology" and in "Technology Fundamentals and Practices" at UNIGE. Member of SIRA (2018) and ISCUM (2019). In the last year, she has been Postdoctoral researcher in Technology of Architecture, (UNIGE). Recently, she has been Visiting researcher at the Institute of Cultural Anthropology and Art Studies at the Academy of Albanian Studies in Tirana, Albania. Since July 2019, she has been acknowledged as "Doktor në Ruajtja e Trashëgimisë Arkitektonike" by the Albanian Ministry of Education, Sports and Youth.
ORCID ID: https://orcid.org/0000-0002-7602-8013

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Gentian VOKOPOLA

RESTAURIMI I FRAGMENTEVE TË DËMTUARA TË PIKTURËS MURALE NË KISHËN E "SHËN E PREMTES" NË VALSH, ELBASAN

DO NOT COPY

Kisha e "Shën e Premtes" në fshatin Valsh të krahinës së Shpatit në Elbasan i përket ndërtimeve pasbizantine të shek. XVI me vlera mjaft të rëndësishme, kryesisht për vlerat që mbart piktura murale e realizuar nga Onufri në vitin 1554[1] me teknikën e afreskut (Fig.1, 2). Onufri ka dekoruar interierin në të gjitha muret e kishës përfshi ikonostasin dhe faqen perëndimore të eksterierit të saj. Ndërtimi i kishës është i thjeshtë, njënefëshe me apsidë të vogël gjysmë rrethore me dimensione 10.50 m x 4.5 m. Kisha është e ndërtuar me gurë gëlqerorë lidhur me llaç gëlqereje dhe mjaft rrallë gjen copa tjegullash e tullash të vendosura ndërmjet gurëve. Hyrja e kishës është nga ana perëndimore nëpërmjet një porte të ulët. Me vlerë të veçantë është struktura e drunjtë me kapriata e çatisë, që ruhet nga koha e ndërtimit të kishës[2].

Në Shqipëri kisha e "Shën e Premtes" është i vetmi monument i dekoruar tërësisht nga Onufri dhe një ndër dy kishat ku ai ka lënë të shkruar emrin e tij. Në kishën e "Shën Kollit" në Shelcan, Onufri ka pikturuar në vitin 1555 pjesën e ikonostasit të gurtë, apsidën dhe pjesërisht skenat pranë ikonostasit[3] ndërsa në Greqi ka pikturuar që në vitin 1547 kishën e "Shën Apostujve" në Kostur[4].



Fig. 1. Pamja lindore e Kishës



Fig. 2. Pamja perëndimore e Kishës

1 Puzanova, V., "Piktori shqiptar i shekullit të XVI-të Onufri nga Neokastra (Elbasani)" - *Buletini për Shkencat Shoqërore* - 1953. Nr. 3, f. 2-22.

2 Meksi, A., Thomo, P.,- "Arkitektura pasbizantine në Shqipëri", *Monumentet* 2/1981, f. 99 - 115

3 Popa, Th., "Rreth veprës së Onufrit", *Monumente të Kulturës në Shqipëri,* Tiranë 1975, f. 72 - 74

4 Dhamo, Dh., *Piktura murale e mesjetës në*

Pikërisht për këto vlera mjaft të spikatura kisha e "Shën e Premtes" në Valsh është shpallur Monument Kulture i kategorisë I me dekretin nr. 4874 të datës 23/9/1971 "Mbi mbrojtjen e monumenteve kulturore, historike e pasurive të rralla".

Ndërhyrjet konservuese restauruese në kishën e "Shën e Premtes" në Valsh kanë filluar nga ana e IMK - së që në vitin 1979, të cilat kanë konsistuar në ndërhyrjet në arkitekturë për drenazhimin e objektit me qëllim krijimin e pjerrësisë për rrjedhjen e ujërave, përforcimin e themeleve, restaurimin e qemerit të ikonostasit etj[5]. Punime për konservimin e pikturës murale janë kryer në vitin 1983 dhe 1986 nga Sektori i Artit pranë IMK - së të cilat konsistuan në përforcimin dhe konsolidimin e saj si dhe në mbushjen e lakunave me llaç me një ton neutral[6].

Gjatë fundit të vitit 2012 dhe fillimit të vitit 2013 piktura murale në kishën e "Shën e Premtes" në Valsh u dëmtua mjaft rëndë. Sipas njoftimeve të para nga terreni bëhej fjalë për veprime vandaliste të shkaktuara nga keqbërës të panjohur. Menjëherë pas njoftimit, një ekip nga Sektori i Artit pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës shkoi për të parë nga afër situatën e krijuar[7]. Dëmtimet u evidentuan në të gjitha faqet e brendshme të kishës (Fig.3, 4, 5, 6, 7, 8) dhe me sa duket kishin patur qëllim grabitjeje (Tabela 1, 2, 3, 4, 5, 6,). Duke filluar nga faqja jugore portretet e dëmtuara ishin të "Shën Kollit", "Shën Thanasit" dhe "Krishtit Emanuel", në faqen ballore të ikonostasit portreti



Fig. 3. Ikonostasi i dëmtuar



Fig. 4. Faqja perëndimore e dëmtuar



Fig. 5. Faqja veriore e dëmtuar



Fig. 6. Pjesa jugore e altarit e dëmtuar

Shqipëri, Tiranë, 1974, f. 14

5 Arkivi i IMK, (Dosja nr. 341)

6 Arkivi i IMK, (Dosja nr. 341)

7 Ekipi i specialistëve restauratorë që shkoi për të parë nga afër situatën dhe që solli në Laboratorin e Restaurimit të Veprave të Artit në IMK fragmentet e dëmtuara përbëhej nga Agron Islami, Edlira Çaushi, Adrian Çene, Andi Spahia, Gentian Vokopola.


DO NOT COPY



Fig. 7. Pjesa veriore e altarit e dëmtuar



Fig. 8. Pjesa veriore e faqes lindore e dëmtuar



Faqja jugore e dëmtuar

DO NOT COPY

i "Shën Marisë me Krishtin" dhe "Shën Simeon Stiliti", në faqen e pasme të ikonostasit portretet e "Shën Pjetrit", "Shën Laurentit" dhe "Shën Germanos", në faqen lindore në dy krahët e apsidës "Shën Gregori" dhe "Shën Daniel Stiliti", në faqen veriore "Shën Spiridoni" dhe "Shën e Premte", ndërsa në faqen perëndimore "Shën Kostandini dhe Helena" dhe "Shën Damiani". Këto dëmtime



Faqja veriore e dëmtuar

të rënda, përfshinin, si shtresat përgatitore (arricion dhe intonakon) ashtu edhe pelikulin e ngjyrës. Nga ajo çfarë mund të verifikonim nëpërmjet sondazheve vizive, dukej që keqbërësit teknikisht kishin proceduar në këtë mënyrë: Kanë rrethuar nëpërmjet mjeteve të forta me gërvishtje apo duke krijuar kanale më të gjera, subjektin që kërkonin të hiqnin (në rastin konkret portretet) dhe më pas kanë tentuar t'i heqin nga muri në mënyrë të dhunshme. Në tentativë për t'i shkulur, pjesa më e madhe e portreteve ishin dëmtuar në formën e qindra copëzave të vogla. (Fig. 9, 10)

Të gjitha fragmentet e thërrmuara përfshi dhe copëzat më të vogla u mblodhën me shumë kujdes në kuti të veçanta dhe u transportuan për në laboratorin e IMK - së. Ato u ndanë sipas zonës ku u gjetën në dyshemene e kishës dhe në përafërsi të tonalitetit të ngjyrës që kishin (Fig.11, 12, 13, 14).

Gjatë vitit 2014, në këtë objekt, bazuar në një projekt të hartuar nga specialistët e IMK - së u kryen punime për konsolidimin e mureve me anë të fugatimit dhe qepjes së të çarave me teknikën shqep - qep, u kryen punime për restaurimin e çatisë, brezave të drurit, lyerjen e elementeve të drurit me vaj lini etj[8].

Për rreth 5 vjet, nga fillimi i vitit 2013 deri në vjeshtën e vitit 2017 të ndihmuar dhe nga dokumentacioni fotografik, specialistët e Sektorit të Artit punuan në laboratorin e restaurimit të veprave të artit në

8 Arkivi i IMK, (Dosja nr.341)

DO NOT COPY



Faqja lindore e dëmtuar




Faqja perendimore e dëmtuar

IMK për gjetjen dhe rikompozimin e këtyre qindra copëzave të vogla[9]. Dokumentacioni fotografik u printua në raportin 1:1 me pikturën murale, ndërsa rikompozimi u krye mbi një shtresë rëre të imët të vendosur në plansheta polisteroli. Ka qenë një punë mjaft e lodhshme, pasi kjo lloj ndërhyrje kërkonte përqendrim maksimal e madje ndonjëherë edhe me insistimin e treguar nuk arrihej në një rezultat pozitiv. E kundërta ndodhte ndonjë herë tjetër kur fare rastësisht rezultatet ishin të kënaqshme dhe i gjendej vendi mjaft prej copëzave të afreskut të dëmtuar. Në vjeshtën e vitit 2017 mbetën fare pak copëza afresku të cilave akoma nuk iu ishte gjendur vendi i tyre dhe procesi i rikompozimit të fragmenteve u konsiderua i mbyllur. Bëhet fjalë për copëza mjaft të vogla me ngjyrë të errët, pjesë e sfondit, ndërsa në përgjithësi mund të thuhet që u arrit të rikuperohet një pjesë e madhe e pikturës murale të dëmtuar (Fig.17-27). Fatkeqësisht, në fund të këtij procesi u konstatua se prej tre portreteve dhe përkatësisht të "Shën Kollit", "Shën Thanasit" dhe "Shën Germanos" nuk kishte mbetur asnjë fragment sado i vogël, fakt ky që tregon se këto portrete grabitësit kanë arritur t'i marrin. Pasi përfundoi procesi I rikompozimit të fragmenteve të dëmtuara filloi menjëherë ndërhyrja për përgatitjen finale të këtyre fragmenteve të bashkuara, për t'i vendosur në vendin prej ku ishin shkulur përdhunshëm[10].

9 Ekipi i specialistëve restauratorë që punuan për gjetjen dhe rikompozimin në laborator të fragmenteve të dëmtuara të afreskut përbëhej nga Edlira Caushi, Adrian Cene, Andi Spahia, Genci Treska, Dritan Thomo, Gentian Vokopola.

10 Specialistët restauratorë që punuan për realizimin e këtij procesi ishin Genci Treska dhe Gentian Vokopola

DOKTORATURA



Ikonostasi (pjesa e pasme) i dëmtuar



Ikonostasi përballë i dëmtuar

DO NOT COPY




Fig. 9-10, Fragmente të pikturës murale të copëtuara në dyshemenë e kishës






Fig. 11-14, Fragmente të pikturës murale të copëtuara në laborator

DO NOT COPY




Fig. 15-16, Fragmente të pikturës murale të copëtuara në laborator



Fig. 17. Shën Kostandini në proces rikompozimi

Ndërhyrja filloi me bashkimin dhe ngjitjen përfundimtare të copëzave të vogla e të dëmtuara, të cilat ishin rikompozuar në shtresën e rërës. Ngjitja e tyre u krye me Akril 33, i holluar ose jo sipas rastit. Pas ngjitjes së copëzave të vogla për çdo fragment u krye një pastrim sipërfaqsor me një furçë të butë për heqjen e depozitimeve sipërfaqsore (pluhurave) dhe më pas mbi pjesën e pikturuar u aplikuan bendazhe (ngjitja e merleve) me Paraloid B72 13 % të tretur në Aceton. Meqenëse këto fragmente ishin të përbërë nga shumë copëza të vogla, bendazhet u vendosën në dy shtresa merlesh (napa) për të kryer përforcim të plotë të pikturës. Me tharjen e merleve vazhdoi puna për hollimin me shumë kujdes të

DO NOT COPY



Fig. 18. Shën Gregori në proces rikompozimi



Fig. 20. Shën Helena në proces rikompozimi



Fig. 19. Shën e Premte në proces rikompozimi




Fig. 21. Shën Maria me Krishtin në proces rikompozimi

DO NOT COPY



Fig. 22. Shën Pjetri i Aleksandrisë në proces rikompozimi



Fig. 23. Shën Daniel Stiliti në proces rikompozimi



Fig. 24. Shën Laurenti në proces rikompozimi



Fig. 25. Shën Spiridoni në proces rikompozimi

DO NOT COPY



Fig. 26. Shën Simeon Stiliti në proces rikompozimi



Fig. 27. Krishti Emanuel në proces rikompozimi









Fig. 28-31. Trajtim i fragmenteve të bashkuara në laborator

DO NOT COPY





Fig. 32-38. Trajtim i fragmenteve të bashkuara në laborator

DO NOT COPY



Gjatë punës në objekt



Gjatë punës në objekt

pjesës pregatitore të pikturës murale (arricios). Ky proces u krye me mënyrë mekanike me thika dhe sharra të vogla të dhëmbëzuara. Shtresa e pluhurit të krijuar u hoq me aspirator me presion të ulët. Intonako më pas njomej me ujë të pastër që të realizohej një ngjitje e plotë. Në pjesën e pasme tashmë të niveluar dhe të holluar në trashësinë 0,6 – 0,7 cm u aplikuan përsëri bendazhe me merle

në pjesën e pikturës dhe fragmentet u bënë gati për tu vendosur në kishën e "Shën e Premtes" në Valsh (Fig. 28-38). Nga fundi i muajit tetor deri në mesin e muajit dhjetor 2017 Sektori i Artit në Institutin e Monumenteve të Kulturës organizoi një ekspeditë në fshatin Valsh të Elbasanit me qëllim vendosjen e fragmenteve tashmë të rikompozuara në kishën e "Shën e Premtes"[11].



Shën Gregori para ndërhyrjes



Shën Gregori pas ndërhyrjes

po në këtë rast u përdor si ngjitës Akrilin 33. Me tharjen e tij u krye heqja e bendazheve të ngjitura

11 Ekipi i specialistëve restauratorë që punoi në kishën e "Shën e Premtes" në Valsh për vendosjen e fragmenteve të rikompozuara përbëhej nga Agron Islami, Genci Treska, Gentian Vokopola.

DO NOT COPY



Shën Daniel Stiliti para ndërhyrjes



Shën Daniel Stiliti pas ndërhyrjes




Shën Kostandini dhe Helena para ndërhyrjes



Shën Kostandini dhe Helena pas ndërhyrjes



Shën Laurenti para ndërhyrjes



Shën Laurenti pas ndërhyrjes

DO NOT COPY



Shën Spiridoni para ndërhyrjes



Shën Spiridoni pas ndërhyrjes



Shën e Premte para ndërhyrjes




Shën e Premte pas ndërhyrjes

DO NOT COPY



Shën Pjetri i Aleksandrisë para ndërhyrjes



Shën Pjetri i Aleksandrisë pas ndërhyrjes



Shën Kolli dhe Shën Thanasi para ndërhyrjes



Shën Kolli dhe Shën Thanasi pas ndërhyrjes

Në fillim të procesit për çdo fragment përgatitej suporti i muraturës duke e niveluar me llaç dhe akoma pa u tharë ky i fundit kryhej ngjitja e pjesëve të afreskut.

Këto fragmente në pjesën e pasme të intonakos u mbushën me PLM për të kryer një ngjitje sa më të mirë me suportin e murit. Të gjitha fragmentet u rivendosën me saktësi të madhe duke patur parasysh një dokumentacion të detajuar fotografik 1:1.

DO NOT COPY



Shën Damiani para ndërhyrjes



Shën Damiani pas ndërhyrjes



Krishti Emanuel para ndërhyrjes



Krishti Emanuel pas ndërhyrjes

DO NOT COPY



Ikonostasi para ndërhyrjes



Ikonostasi pas ndërhyrjes

DO NOT COPY



Shen Maria me Krishtin para ndërhyrjes



Shen Maria me Krishtin pas ndërhyrjes

DO NOT COPY

Pas përfundimit të procesit të ngjitjes u krye dhe stukimi i të gjitha boshllëqeve me llaç në ngjyrë neutrale gëlqere + rërë në masën 1:2 (shih fotot në vazhdim).

Gjatë kësaj periudhe krahas vendosjes të këtyre fragmenteve u kryen dhe konsolidime me PLM - S dhe Akril 33 në pjesë të tjera të sipërfaqes së pikturës murale, në zona ku kjo pikturë ishte e shkëputur nga suporti. Me ndihmën e Sektorit të Elbasanit, pjesë e DRKK Durrës, u kryen dhe disa punime të tjera si rindërtimi i harkut verior të ikonostasit dhe zëvendësimi i një pjese të tjegullave në çatinë e kishës të rrëzuara në tokë si pasojë e erërave të fuqishme.

Vlen të theksohet fakti se është hera e parë që në monumentet tona të kulturës realizohet një ndërhyrje e tillë, e veçantë dhe e vështirë njëkohësisht, me një volum të madh pune që nisi me mbledhjen e fragmenteve në kishën e "Shën e Premtes", vazhdoi me rikompozimin e ngjitjen e tyre në laborator dhe përfundoi me vendosjen në muret prej ku ishin shkulur. Me ndërhyrjen për rikompozimin dhe vendosjen e fragmenteve të dëmtuara të kishës së "Shën e Premtes" në Valsh të Elbasanit u finalizua një proces i suksesshëm pune restauruese, që përmbylli një episod të trishtueshëm vjedhje e grabitje të kësaj pasurie unikale, vepër e Onufrit.

DO NOT COPY

Gentian VOKOPOLA

RESTORATION OF DAMAGED FRAGMENTS OF MURAL PAINTINGS IN THE CHURCH OF "SAINT PARASKEVI" IN VALSH, ELBASAN

DO NOT COPY

The church of "Saint Paraskevi" in the Valsh village of Shpati province, in Elbasan, belongs to post-Byzantine constructions of 15th century, and has very important values, mainly because of the values carried by the wall painting made by Onufri in 1554 with the fresco technique.
The wall painting at the Church of St. Paraskevi in Valsh was damaged during late 2012 and early 2013. Damages were recorded on all interior walls of the church, apparently for robbery purposes. All the shredded fragments, including the smallest ones, were carefully collected in separate boxes and transported to the IMC laboratory.

For about five years, from the beginning of 2013 until the fall of 2017, assisted by photographic documentation, Art Sector's specialists worked in IMC's art restoration lab to find and recompose those hundreds small pieces.

The photographic documentation was printed in 1:1 ratio with the wall painting, while the recombination was done on a layer of fine sand placed on styrofoam plates. In the fall of 2017, there were very few frescoes pieces that had not yet found their place and this process was considered closed. It is about very small pieces of dark color part of the background, while in general it can be said that much of the damaged painting was recovered.

Intervention for post-recombination treatment began with the final joining and gluing of small, damaged pieces that had been reconstituted in the sand layer.
Their gluing was accomplished with Acryl 33, diluted or not, as appropriate. After gluing the small pieces for each fragment, was performed a surface cleaning with a soft brush to remove surface deposits (dusts), and then on the painted part were applied bands (cheesecloth's adhesion) with Paraloid B72 13%, dissolved in Acetone.

Since these fragments were made up of many small pieces, the bands were arranged in two layers of cheesecloth to perform complete reinforcement of the painting. After the bands dried the work went on with carefully diluting the preparatory part of the mural (arricios).

This process was done mechanically with knives and small serrated saws. The created layer of dust was removed by a low-pressure aspirator and then saturated with pure water. On the back, already leveled and diluted to 0.6 - 0.7 cm thick, were applied again bands of cheesecloth, only in this case Akryl 33 was used as adhesive. After it dried was performed the removal of the bands glued in the painting part and the fragments were ready to be placed in the church of "St. Paraskevi" in Valsh.

From the end of October until the middle of December 2017, the Art Department at the Institute of Cultural
Monuments organized an expedition to the village of Valsh, Elbasan, with the aim of placing

fragments already reconstituted in the church of "Saint Paraskevi".

For each fragment, the process began with preparing the masonry support by leveling it with mortar and with the latter still wet, was performed the gluing of frescoes. These fragments at the back of the intonaco were filled with PLM to perform an adhesion as good as possible with the wall support. All fragments were restored with great precision according to a detailed 1:1 photographic documentation. After the gluing process was completed, the mortar gaps were filled in neutral lime + sand in 1:2 ratio.

It is worth noting that this is the first time in our cultural monuments that such a unique and difficult intervention has been accomplished, with such a large volume of work that began with the collection of fragments in the church of "Saint Paraskevi", then continued with the process of recomposing and gluing them in the lab, and ended up by placing the fragments on the walls from which they were detached.

With the intervention to reconstitute and place the damaged fragments of the church of "St. Paraskevi" in Valsh, Elbasan, a successful restoration process was completed. This process ended a sad episode of theft and robbery of this unique property, the work of Onufri.

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Rudina PAPAVASILI

KISHA E SHËN MËHILLIT, VITHKUQ, KORÇË[1]. METODOLOGJIA E DOKUMENTIMIT DHE STRATEGJIA E NDËRHYRJEVE

DO NOT COPY



Fig. 1. Pamje e fasadës lindore

Gjatë shekujve XVII – XVIII[2], Vithkuqi përjetoi periudhën më të lulëzuar, paralelisht me Voskopojën[3], me një rritje të konsiderueshme demografike, ekonomike e kulturore, dukuri e cila solli interesin dhe nevojën për ndërtime të shumta. Këto ndërtime, gjykuar njëkohësisht me ato të gjithë malësisë përreth Fushës së Korçës[4]:

1 Artikulli rrjedh nga tema e diplomës me titull "Projekt restaurimi Kisha e "Shën Mëhillit", Vithkuq, Korçë", në kuadër të Masterit Profesional për Restaurimin e Monumenteve të Kulturës, mbrojtur në FAU, në 2017, me bashkëautor R. Papavasili dhe B. Dyrmishi dhe udhëheqës Prof. Dr. Lida Miraj dhe MSc. Arben Dervishaj, duke pasur një trajtim ndryshe për sa i përket metodologjisë së dokumentimit. Rilevimet arkitektonike, hipotezat dhe konkluzionet janë të autores.

2 Thomo, P., *Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut,* Tiranë, 1998, f. 44.

3 Adhami, S., "Marrëdhëniet ekonomike, shoqërore dhe kulturore midis Vithkuqit dhe Voskopojës në shekullin e lulëzimit të tyre", *Monumentet,* 1979, 17, f. 71 – 78.

4 Rembeci, A. "Kodiku i mitropolisë së Korçës dhe

Voskopojë, Lubonjë, Shipskë etj., janë treguesi i fenomenit kulturor që u zhvillua në këtë periudhë dhe pasqyrojnë krijimtarinë ndërtuese të zonës. Ndër të tjera spikat Kisha e "Shën Mëhillit" e Vithkuqit, si një ndërtim i vitit 1682[5], i cili u shpall Monument Kulture i Kategorisë I në vitin 1948[6], për vetë rëndësinë e ndërtesës dhe të kësaj qendre. Monumenti ruan ende mënyrën e ndërtimit, kuptimin arkitektonik e artistik, edhe pse të thjeshtë, duke transmetuar pothuaj të paprekur frymën dhe botëkuptimin e kohës.

ARKITEKTURA E BAZILIKËS

Bazilika është një volum gjatësor linear, me lartësi të ulët për të krijuar proporcione njerëzore, me harkadë si element dominues, që ndihmon në krijimin e dritë-hijeve dhe i jep thellësi objektit. Forma mbuluese e ruan këtë linearitet të godinës por me pjerrësinë e saj i jep lëvizje në altimetri. Objekti është pothuaj i izoluar në eksterier me hapje minimale, duke e bërë ndriçimin dhe ventilimin natyral mjaft të vështirë, me një fasadë minimaliste dhe linja të qarta të drejta dhe pa shumë dekoracione, ku lihet në dukje teknika e ndërtimit. Pavarësisht ngurtësisë së eksterierit, interieri kryesor (naosi) realizohet në mënyrë më të përpunuar artistikisht, me kolona të shumta e mbulim me qemere e kalota sferike, që krijojnë thyerje në lartësi, ku të gjitha muret, si dhe faqja lindore e narteksit janë plotësisht të veshura me pikturë murale, që daton në dy faza të dokumentuara, në vitet 1712[7] dhe 1728[8], (Fig. 2 dhe Fig. 3) dhe ruan ende ikonostasin prej druri i cili mendohet të jetë realizuar po në këtë periudhë.[9] Arkitektura e ndërtesës, në të cilën forma



Fig. 2. Mbishkrimi i shtreses se pare te piktures

ndjek funksionin, në eksterier menjëherë na tregon ndarjen në tre ambiente kryesore (duke respektuar edhe organizimin liturgjik): naos, narteks dhe hajat. Naosi, si ambienti kryesor, është një hapësirë drejtkëndore me 3 nefe, me kolona të lidhura midis tyre me harqe dhe mbulim me qemere dhe kalota sferike (Fig. 4). Në qendër ngrihet një kupolë,

Selasforit (shek. xvii-xix): Të dhëna për kulturën në zonën e Korçës", *Monumentet,* 2011-2014, 52, f. 97 - 98.

5 Popa, Th., *Mbishkrime të kishave të Shqipërisë,* Tiranë, 1998, f. 161, nr. 313.

6 Monumenti ka qenë subjekt shpalljesh në vite të ndryshme: **1**. Vendim i Institutit i Shkencave, nr. 95 - 1948, datë 16.10.1948, **2**. Vendim i Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tiranës, nr. 6, datë 15.01.1963, **3**. Ministria e Arsimit dhe Kulturës Drejtoria e Kulturës, nr. 68/7, datë 30.05.1970, **4**. Ministria e Arsimit dhe Kulturës, nr. 1886, datë 10.06.1973.

7 Shkupi, F., "Zbukurimorja e ndërtimtarisë së kultit në qytezën e Vithkuqit gjatë shekujve XVIII – XIX", *Monumentet*, 1983-2, 26, f. 126.

8 Popa, Th., *Mbishkrime të kishave të Shqipërisë,* Tiranë, 1998, f. 161, nr. 313.

9 Shkupi, F., "Zbukurimorja e ndërtimtarisë së kultit në qytezën e Vithkuqit gjatë shekujve XVIII – XIX", *Monumentet*, 1983-2, 26, f. 126 - 130.

DO NOT COPY



Fig. 3 Pamje nga fasada lindore



Fig. 4 Pamje e naosit

me diametër rreth 5 m dhe lartësi maksimale të brendshme rreth 8 m.

Narteksi, në perëndim, është një ambient me forma të rregullta, mbulimi i së cilës mbështetet mbi dy radhë kolonash guri, vazhdim i kolonadave të ndarjes së nefeve. Radha jugore nuk ruhet më dhe është zëvendësuar me shtylla druri. Këto rreshta kolonash nuk janë vendosur në drejtim me harkadat e naosit (Fig. 5).



Fig. 5 Pamje e narteksit

Hajati (Fig. 6).është një korridor i ngushtë dhe i gjatë sa e gjithë gjatësia e kishës, i hapur në pjesën më të madhe dhe transparent me kolonadën e tij, i cili përveç funksionit si parahyrje në ndërtesë, është edhe motivi dekorativ kryesor i ndërtesës (Fig. 7).

ARKEOLOGJIA E NDËRTESËS[10]

Si metodologji dokumentimi është përdorur parimi i arkeologjisë së ndërtesës, duke bërë një diagnostikim sipërfaqësor joshkatërrues të monumentit dhe duke përmbledhur të gjithë veprimtaritë që kanë ndikuar në ekzistencën e tij. Arkeologjia e Ndërtesës apo e Arkitekturës, përdor më së shumti metodologjinë stratigrafike, si mjet studimi për godinat historike e jo vetëm, duke qenë pjesë e pandashme e projekteve restauruese

10 Për metodologjinë e Arkeologjisë së Ndërtesës shih: Schuller, M., "Building archaeology", *Monuments and Sites VII*, Botim i ICOMOS, 2002.

DO NOT COPY



Fig. 6 Pamje e hajatit




Fig. 7 - a




Fig. 7 - b

dhe studimeve shkencore. Ky koncept është më i gjerë, por në rastin e Kishës së Shën Mëhillit, është përdorur për të njohur më thellë veprimtaritë që kanë ndikuar në gjendjen aktuale të bazilikës (Fig. 8).

Teknika e ndërtimit e përdorur në monument është me lidhje të gurëve gëlqerorë të skuadruar (çmërs) me llaç balte dhe të fugatuara me llaç gëlqere, ku në disa raste evidentohen edhe brezat e drurit.

Për dokumentimin e teknikave më karakteristike është përdorur rilevimi fotogrametrik dhe i drejtpërdrejtë dhe të dhënat janë përmbledhur në 10 skeda të teknikave të muraturës[11] (Fig. 9-13).

11 Për hartimin e skedës u mor për bazë *Manuali i Gërmimit,* hartuar nga Grupi Shqiptar i Arkeologjisë së Shpëtimit.

DO NOT COPY




Fig. 7 - c




Fig. 7 - d





Fig. 8 Fasada lindore. Evidentimi i teknikave te muratures

Gjatë rilevimit arkitektonik, dokumentimit dhe studimit të tyre, u krijua një renditje kronologjike e proceseve konstruktive dhe dekonstruktive, e cila përfshin etapat kryesore të ndërtimit dhe të ndërhyrjeve të dokumentuara ose ato më të dallueshmet, që mund të konsiderohet si pikëfillimi për aplikimin e metodologjisë së arkeologjisë së ndërtesës (Fig. 14).

Kështu, mbi bazën e teknikave të muraturës dhe

DO NOT COPY

atyre të ndërtimit[12] është gjykuar që ndërtimi i



DO NOT COPY

Fig. 9 Skeda e muraturës


naosit dhe narteksit ka qenë i njëkohshëm, dhe më vonë është shtuar zona e hajatit. Kjo hipotezë duhet të verifikohet me anën e sondazheve që duhen

12 Brogiolo, G. P., "Introduzione", në "*Archeologia dell' Architettura: temi e prospettive di ricerca*", Aktet e Konferencës (23-25 Settembre 2010), Gavi 2010, f. 13.

bërë në pjesën veriore të kishës, aty ku gjenden kontrafortet, ku evidentohen fugat dhe ndryshimi i materialit të ndërtimit (Fig. 15).

Kronologjia e ndërtimit (Fig. 16)

Etapa 1 (1682, 1712). Pjesa e poshtme e mureve të




DO NOT COPY

Fig. 10 Skeda e muraturës

naosit është preferuar të ndërtohet me gurë kompaktë të zonës, përgjithësisht të latuar, të vendosur në radhë të rregullta. Në pjesën perëndimore, ky brez i murit ndërpritet në mënyrë të rregullt vertikalisht, në drejtim me kolonat e fundit të dy harkadave.

Etapa 2 (1712, 1728). Ndërkohë që ndërtohej pjesa e sipërme e muraturës së naosit, me blloqe të skuadruar prej guri të lehtë çmërsi, është zgjatur për nga perëndimi edhe pjesa e poshtme e muraturës. Në jug, kjo përfshinte portën hyrëse nga hajati në naos. Ka mundësi që ndërtuesit të kenë vendosur të




DO NOT COPY

Fig. 11 Skeda e muraturës

zgjasin edhe pak gjatësinë e naosit në punë e sipër. Zgjatja e muraturës është ndërtuar kryesisht me gurin e pjesës së sipërme të saj, por është vendosur në mënyrë më pak të rregullt, gjithsesi me radhë të rregullta. Kjo pjesë, ashtu si edhe brezi i sipërm i muraturës së naosit lidhet në mënyrë integrale me muraturën e narteksit, ku tipar i përbashkët është edhe përdorimi i brezave sizmikë të drurit.

Etapa 3 (shek. XVIII?). Qartësisht, hajati në jug është ndërtuar në mënyrë të pavarur nga narteksi dhe naosi në një periudhë më të vonë.

Etapa 4 (rreth 1963). Shtimi i dy kontraforteve në




DO NOT COPY

Fig. 12 Skeda e muraturës

formë trapezoidale në murin verior, në vitet '60[13] është bërë për të garantuar stabilitetin e tij. Këto kontraforte realizohen menjëherë në kampatën e parafundit të naosit, aty ku vihet re ndryshimi i teknikave të ndërtimit dhe fuga. Ky segment muri ka filluar të ketë probleme, që janë mjaft të dukshme edhe në strukturat e harkuara të mbulimit, të cilat këtu kanë dhënë shenja të qarta hapjeje.Etapa 5 (rreth 1966). Hajati është rindërtuar pjesërisht të paktën një herë (pjesa lindore e kolonadës, në vitet '60).[14] Etapa 6 (2006). Rreth gjysma e murit verior

13 Arkivi i I.M.K.

14 Meksi, A., Thomo, P., "Arkitektura pasbizantine në Shqipëri (Bazilikat)", *Monumentet*, 1981-1, 21, f. 106, Arkivi i I.M.K.



DO NOT COPY

Fig. 13 Skeda e muraturës

të narteksit dhe pothuajse i tërë muri perëndimor i tij janë prishur dhe rindërtuar duke mos respektuar plotësisht teknikën fillestare dhe as materialet e përdorura (materialin lidhës). Prishja e pjesshme e narteksit ka përfshirë edhe një pjesë të harkadës veriore prej guri brenda tij.[15] Etapa 7 (1963, 1966, 1980, 2006, 2014, 2019). Kjo etapë, nuk ka të bëjë me ndërtimin e godinës, por me ndërhyrjet e mirëmbajtjes dhe restaurimit që i janë shtuar jetës së monumentit.[16] Ndërhyrjet në çati kanë qenë më

15 Ndërhyrje restauruese të kryera nga D.R.K.K. Korçë, në vitin 2006. Arkivi I.M.K.

16 Për punimet e restaurimit në këtë kishë shih: *Monumente*, 1982, 23, f. 121, 122; *Monumente*, 1983, 26, f.153; *Monumente,* 2013, 52, f. 195.




Fig. 14 Evidentimi i kampionëve të muraturës dhe diferencimi me ngjyrë i teknikave të evidentuara




Fig. 15 Planimetria me ndarjen e fazave te ndertimit

të shpeshta, si pasojë edhe të prishjeve ndër vite[17], ku në disa raste ka patur edhe ndyshim të formës. Sot çatia e narteksit është e sfazuar në krahasim me atë të naosit dhe rakordohet me atë të hajatit, duke nxjerrë në pah kornizën nën çatinë e naosit në pjesën jugore të saj.

17 Meksi, A., Thomo, P., "Arkitektura pasbizantine në Shqipëri", *Monumentet*, 1976, 11, f. 131, (Fig. 7; Ndërhyrje të dokumentuara në Arkivin e I.M.K.




Fig. 16 Kronologjia e ndertimit

DO NOT COPY

STRATEGJITË E NDËRHYRJES

Strategjitë e ndërhyrjes (Fig. 17), duke marrë parasysh edhe ndërhyrjet që janë kryer gjatë viteve, u gjykuan me karakter arkitektonik, konstruktiv, peizazhi dhe menaxhimi, të cilat do të ndihmojnë në jetëgjatësinë e monumentit dhe kanë si parim kryesor ruajtjen e autenticitetit të trashëgimisë arkitektonike dhe harmonizimin me mjedisin.




Fig. 17 Plan sistemimi i propozuar brenda zonës së mbrojtur të kishës

Ndërhyrjet në arkitekturë duhet të kenë për qëllim vlerësimin estetiko-artistik të ndërtesës dhe lexueshmërinë e arkeologjisë së arkitekturës së saj, duke bërë pastrime e fugatime që nxjerrin në pah teknikat e ndryshme të muraturës; duke trajtuar elementët drusorë dhe përpunimin e elementëve si dyer - dritare; duke realizuar plotësime dhe restaurime të imta të dekoracionit siç janë kornizat, parapetet, kolonat me kapitelet dhe bazamentet.

Njëkohësisht, me interes është rivlerësimi i murit të narteksit, i cili sot është ndërtuar me gurë gëlqerorë të lidhur me llaç çimento dhe pa përdorimin e brezave prej druri, me qëllim rindërtimin e tij, duke ruajtur një teknikë të ngjashme, me të njëjtët gurë, por me lidhje llaç gëlqere dhe balte duke krijuar uniformitet me teknikat ekzistuese në ndërtesë. Lidhësi me çimento është një problem që vihet re edhe në fugatime e punime që janë realizuar ndër vite, të cilat duhet të eleminohen.

Në rastin e kishës së Shën Mëhillit, duhet t'i kushtohet shumë rëndësi ndërhyrjeve në konstruksionin e vetë godinës, të cilat janë thelbësore për ruajtjen e qëndrushmërisë. Në këtë kuptim, gjetja e zgjidhjeve me tirantime metalike i të gjithë bllokut të naosit; përforcimi i murit verior si elementi më i rrezikuar, ku evidentohen një seri degradimesh që kanë sjellë humbjen e vertikalitetit të tij (çarje vertikale, humbje të materialit lidhës, lagështi kapilare, që vjen nga kuota e lartë e dherave në këtë anë); vertikalizimi i harkadës së hajatiti; heqja e brezit të betonit mbi kreun e murit të harkadës; vlerësimi i gjendjes dhe efekteve që kanë kontrafortet në veri dhe sigurisht përmirësimi i gjendjes së çatisë do të ndihmojnë në përmirësimin e strukturës. Shumica e problemeve konstruktive vijnë nga humbja e ekuilibrit të strukturave të mbulimit të naosit. Aktualisht, çarjet e qemerëve në brendësi të naosit, për shkak të vjetërsisë dhe lidhjeve të degraduara, kanë ndikuar shumë në deformimin dhe dëmtimin e të gjithë ndërtesës.

Problemi i dytë konstruktiv vjen si pasojë e vendndodhjes së objektit mbi një terren me skarpatë të pjerrët[18] në pjesën perëndimore, ku rrëshqitja e dherave, krijon rrezikshmëri të lartë në stabilitetin e strukturës, e cila ka gjasa të ketë ndikuar gjithmonë në prishjen e kësaj pjese muri dhe për këtë është rindërtuar shpesh herë (Fig. 18). Realizimi i një muri mbajtës në këtë anë, do të mbrojë terrenin, duke parandaluar rrëshqitjet e dheut. Ndërtimi i murit mbajtës do të shërbejë edhe si kufi ndarës në rrethimin e kishës dhe do të bëhet pjesë e rrethimit ekzistues.

Përveç vetë godinës, rol kryesor në monumentalitetin



Fig. 18 Pamje e fasadës perëndimore dhe e pjerrësisë së terrenit në të cilën ndodhet godina

18 Për ndërhyrje në bazamentet e objekteve të kultit, shih: Bozo, L., *Bazamentet e objekteve të kultit në Shqipëri*, Tiranë, 2002, ndërsa për ndërhyrjet në strukturë shih: Meksi, A., *Restaurimi i Monumenteve të Arkitekturës,* Tiranë, 2004, Thomo, P. *Kishat pasbizantine në Shqipërinë e Jugut,* Tiranë, 1998,

DO NOT COPY



Fig. 19 Pamje e kishes Shen Mehilli i Vithkuqit

e saj luan konteksi urban (Fig. 19), i cili duhet të marrë të njëjtën rëndësi gjatë ndërhyrjeve restauruese. Sot, zona përreth bazilikës konturohet me mur rrethues të ulët në jug dhe lindje, nga ku bëhet dhe hyrja për në oborr. Në veri gjenden varrezat e vjetra të fshatit (Fig. 20), me disa varre shumë të vjetër, ndër të tjerë edhe ai i quajtur nga banorët "Varri i Pagëzimit".



Fig. 20 Pamje e varrezave mbrapa kishes

Kështu, ndërhyrjet në peizazh duhet të përfshijnë të gjithë territorin përreth, i cili mund të përmirësohet me anë të punimeve për drenazhimin në veri dhe perëndim, që aktualisht mungon; largimin e dherave nga muri verior dhe mbrojtjen e konturimin me mur guri mbajtës; sistemimin e varreve të vjetra në veri duke ndërhyrë njëkohësisht në shmangien e varrimeve pranë tij, madje edhe futja në mbrojtje e pjesës historike të varrezës, me tendencë largimin gradual të varreve të reja dhe për t'i bërë pjesë të menaxhimit dhe sistemimit të territorit.

Hartimi i një plani menaxhimi[19] është një mjet i domosdoshëm, i cili duhet kryer si për rastin konkret ashtu edhe në rang fshati. Duhet patur parasysh se kisha e "Shën Mëhillit" do të vazhdojë të përdoret për dy qëllime, si deri tani: e para për qëllime shpirtërore për komunitetin dhe e dyta si atraksion turistik. Përsa i përket turizmit, ndërtimi i rrugës nga Korça për në Vithkuq, ka dhënë mundësi që të konsiderohet si një nga fshatrat me interes për zhvillimin e turizmit kulturor. Duke marrë si shembull zhvillimin turistik të Voskopojës, në të ardhmen e afërt mund të mendojmë një interesim të ngjashëm për Vithkuqin.

Pikat e dobëta. Lëvizja e popullsisë dhe largimi jashtë vendit kanë sjellë që popullsia në fshat të pakësohet, por edhe që vendasit të mos kenë më interes për ruajtjen e ndërtesave historike, i cili është një nga problemet më të mëdha në rang kombëtar dhe një nga disavantazhet edhe të Vithkuqit. Pamundësia e mirëmbajtjes nga vetë banorët dhe promovimi i pamjaftueshëm, duhen parë si shkaktarët dhe faktorët kryesorë në mosmenaxhimin e trashëgimisë kulturore në përgjithësi dhe objekteve të kultit në veçanti. Në

19 Feilden, B. M., Jokilehto, J., *Udhëzues për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore,* Tiranë, 2010

DO NOT COPY

këtë gjendje, pa banorë e besimtarë, kisha nuk mund të jetë e hapur gjatë gjithë kohës për vizitorët e rastit. Po ashtu edhe ndërhyrjet që mund të realizohen herë pas here, meqenëse janë sporadike dhe jo plotësisht të kontrollueshme, mund të dëmtojnë historinë e monumentit.

Mundësitë. Hapësira përreth bazilikës krijon mundësi për shfrytëzim optimal të saj (përfshirë edhe varrezat historike në veri), duke e sistemuar dhe duke e përdorur në funksion të edukimit, riteve fetare dhe turizmit. Mirëmbajtja e vazhdueshme dhe promovimi i saj, si dhe i të gjithë kishave të tjera të Vithkuqit, do të ndihmojnë në rritjen e interesit dhe vizitueshmërinë e këtij fshati. Hartimi i projekteve, aplikimi i metodave të reja restauruese dhe metodologjive studiuese, mund të shërbejnë si projekte *pilot* për monumentet me veçori të ngjashme përreth, për restaurimin, arkitekturën dhe trajtimin e peizazhit.

Rreziqet. Rreziku i "mbipopullimit" nga vizitorët e shumtë dhe i kthimit të këtij fshati në një atraksion për turizëm masiv, mund të ndikojë negativisht duke prishur ekuilibrin midis peizazhit historik dhe urbanistikës së tij. Në mënyrë të ngjashme mund të ndodhë që ndërtimet e reja, pa një plan rregullues të qartë, që mund të realizohen edhe në afërsi të zonës së monumentit, mund ta prishin edhe më tej këtë ekuilibër. Monumenti, si pjesë e trashëgimisë kulturore të Vithkuqit, rrezikohet edhe nga mungesa e një plani të detajuar menaxhimi.

DO NOT COPY

Rudina PAPAVASILI

THE CHURCH OF SAINT MICHAEL, VITHKUQ, KORÇA . DOCUMENTATION METHODOLOGY AND INTERVENTIONS STRATEGY

This article is about the documentation methodology for the Church of Saint Michael in Vithkuq, Korça, which, based to the known data, dates back to the 17th century and was declared as Cultural Monument of Ist Category, in 1948.
The Building Archaeology principle was used as documentation methodology, which is a superficial non-destructive diagnostication of the entire building and records all the actions that have impacted the monument's existence. This observation, except facilitating the in-depth knowledge, became the essential basis for the proposition of intervention strategies. Building Archaeology mostly uses the stratigraphic methodology as a study mean for historical buildings and not only, becoming an integral part of restoration projects and scientific studies. The concept is wider, but in the case of Church of St. Michael, it has been applied to better identify and understand the activities that have affected the current state of the building.
For this purpose, the study began with the documentation of 10 masonry techniques which further helped in defining the construction stages of the monument. In addition to the abovementioned, the article sets out some intervention strategies, helping to preserve the monument, by expanding its lifespan and accomplishing the main principle of architectural heritage preservation and its harmonization with the landscape.

DO NOT COPY

monumentet
58/2019

Prof. Dr. Pirro THOMO

APOLLON BAÇE, "ARKITEKTURA NË ILIRI"
Akademia e Shkencave të Shqipërisë,
Tiranë, 2017
Një vepër me një gamë të gjerë të interesuarish

DO NOT COPY

Ka histori mbi njëqindvjeçare të gërmimeve arkeologjike në Shqipëri. Mjafton të përmendim arkeologët e parë, Patsch, Praschniker, Schober, Ippen, Mustili, Ugolini etj., për të vazhduar me gjëmimet e pas Luftës së Dytë Botërore nga arkeologët tanë të nderuar, Ceka, Islami, Anamali, Prendi, Jubani, Andrea, Spahiu, Budina, Korkuti, Komata, Ceka i Ri etj., apo një plejadë të tërë arkeologësh të rinj, apo gërmimet e fundit shqiptaro-britanike, shqiptaro-franceze, shqiptaro-italiane etj., të cilët nxorën në dritë një material të pasur të kulturës ilire.

Ka me qindra artikuj e monografi që ia kanë bërë të njohur botës shkencore vendase e të huaj këto pasuri kulturore ilire.

Por, sado të vëmendshëm që të kenë qenë studiuesit ndaj këtyre gërmimeve dhe literaturës, nuk besoj se mund të jenë të shumtë ata që mund të kenë një përfytyrim të plotë të prodhimit tërësor arkitektonik të botës ilire. Kam parasysh këtu njohjen e gjinive të shumta arkitektonike të kultivuara, shtrirjen e tyre gjeografike, zhvillimin e tyre tipologjik në kohë, paralelizmat e tyre me monumentet analoge të botës antike, veçantitë e tyre dhe vendin që ato zënë në trashëgiminë mbarë mesdhetare.

Mund të themi që në fillim se kjo vepër është një sprovë e autorit, Akademikut Apollon Baçe, që tenton të na japë këtë mundësi të njohjes tërësore të trashëgimisë arkitektonike ilire.

Por, si ia ka arritur autori të plotësojë një boshllëk të ndjeshëm në studimet tona?

Së pari, duke na dhënë kuadrin e përgjithshëm historik, brenda së cilës u mundësua lindja dhe zhvillimi i arkitekturës ilire. Bëhet kështu e kuptueshme se asnjë fenomen arkitektonik apo zhvillim arkitektonik nuk mund të shpjegohet jashtë kontekstit historik. Por, nga ana tjetër, vetë lindja, përhapja dhe zhvillimi i produktit arkitektonik plotëson dhe, herë-herë, hedh dritë mbi pika të errëta të kontekstit historik. Janë pikërisht këto monumente, që analizohen për të hedhur dritë mbi kërkesat e banorëve për këto lloj ndërtimesh, pra, me fjalë të tjera, për të kuptuar nivelin shoqëror e kulturor, por dhe nivelin ekonomik të popullsisë ilire. Sepse nuk mund të ndërtosh një teatër pa pasur një jetë kulturore që do të sillte nevojën e ndërtimit të tij. Nuk mund të ndërtosh një tempull pa lindur kërkesa nga një jetë e pasur shpirtërore për ta ndërtuar atë. Nuk mund të ndërtosh një agora, ku kryhet prodhimi dhe tregtimi i prodhimeve zejtare e bujqësore, pa pasur një veprimtari të vrullshme ekonomike. Nuk mund të kesh jetë të shëndetshme në qytet pa siguruar infrastrukturën e nevojshme, rrugët,

furnizimin me ujë, kanalizimin etj.

Së dyti, falë kompozimit të veprës, materiali është dhënë në rendin kronologjik dhe, brenda tij, sipas kriterit gjinor. Pra janë analizuar: banesat, ndërtimet sepulkrale, ndërtimet shoqërore, si tempujt, urbanistika e qendrave të banuara, teatrot, shëtitoret, stadiumet dhe ndërtimet inxhinierike. Për këto gjini arkitektonike jepen tipat dhe variantet e tyre, që pasqyrojnë fazat e zhvillimit tipologjik në kohë.

Tipat dhe zhvillimi tipologjik i banesës dëshmon për organizimin familjar të shoqërisë ilire dhe ndryshimet që pësoi ky organizim në kohë, gjë që pasqyrohet në zhvillimin e tipave tradicionale e deri në kërkimin e formave të reja të banimit. Ndryshimet në tipologji pasqyrojnë njëkohësisht dhe diferencimet shoqërore dhe ekonomike të shoqërisë ilire. Është me interes të vëmë në dukje vazhdimësinë e përdorimit të disa tipareve tipologjike të banesave deri në ditët tona. Kështu, banesat e sotme me shtëpi zjarri në qendër, ose, siç njihet në literaturë, banesa tiranase, ka të njëjtën skemë kompozicionale me banesat ilire me ambient qendror, ku zhvillohej jeta e përditshme e familjes.

Në arkitektura sepulkrale vërehet një zhvillim i ritualeve të varrimit, që shkon nga varrimi kolektiv me tuma, duke filluar që nga Periudha e Bronzit të Hershëm deri në varrimet më individuale me varre mbi tokë, të cilat fitojnë herë-herë një trajtim më monumental, siç i gjejmë p.sh. në varret e Selcës së Poshtme.

Po kështu, dhe në arkitekturën e kultit, që përfaqësohet kryesisht me tempujt, qytetërimi ilir nuk mbeti prapa arkitekturës së botës mesdhetare në përgjithësi dhe asaj greko-romake në veçanti. Shembuj shprehës në këtë gjini na shërbejnë tempujt e Dodonës, Buthrotit (Butrintit), Dimalit, Amantias apo Foinikes (Finiqit).

Të dhëna me interes na jepen në fushën e urbanistikës së qytetit ilir, fushë kjo pak e studiuar, ku megjithatë kemi një zhvillim dhe arritje të dukshme. Autori numëron 321 qytete e kështjella të ngritura në lartësi dhe me mbrojtje të fuqishme natyrore. Por, terreni ku ngrihen këto qytete e kështjella ka ndikuar dhe në tipologjinë urbanistike të tyre. Në bazë të tipareve urbanistike autori bën një klasifikim tipologjik, duke dalluar 1. Qytetet kupolë me nënvariantet radiocentrike (Nikaia, Klosi, Oriku, Persqopi) dhe kurrizore (Antipatria (Berati), 2. Qytetet shpati me nënvariantet të trashëguara (Zgërdheshi, Lissi, Lezha) dhe të reja ose pa vazhdimësi (Çuka e Ajtoit), 3. Qytetet rrafshi (ku analizohen qytetet e Kassopesë, Bylisit, Antigonesë etj., ku pati mundësi zbatimi i sistemeve të përparuara urbanistike, siç ishte sistemi ortogonal apo Hipodam, që i jepte mundësi zhvillimit të planifikuar të qytetit, 4. Qytete të paklasifikueshme (Darsi, Dimali, Butrinti).

Teatri, është një element tepër i rëndësishëm në formulimin urbanistik të qytetit dhe me funksionim të dendur shoqëror, me përhapje shumë të gjerë, thuajse në çdo qytet. Edhe këtu autori dallon tipin skenë e thjeshtë me rampa (Kassopea), tipin skenë me paraskenia dhe thiromata (Dodona, Bylisi, Foinike etj.). Për çdo teatër jepet kuadri historik dhe analizohen pjesët formuese, shkallarja, skena, korridoret e hyrjes, herë-herë dhe rikonstruksioni hipotetik dhe mbyllet me datimin e tyre.

Një element tjetër i rëndësishëm i kompozimit urbanistik ishte shëtitorja, e pranishme në çdo qytet. Arritje të larta arkitektonike ato arritën në shëtitoret e Apolonisë, Butrintit, Dimalit etj.

Ushtrimi i sporteve dhe garave sportive

DO NOT COPY

ishte pjesë e jetës shoqërore të qyteteve. Për zhvillimin e tyre u ngritën dhe instalimet e tyre, si stadiumet. Stadiumi i Amanties është një shembull shumë instruktiv për të kuptuar tipologjinë dhe madhësinë e kërkuar të tyre.
Ndërtimet inxhinierike, rrjeti rrugor dhe urat, skelat, instalimet për furnizimin me ujë, kanalizimet, deri dhe guroret, janë gjinitë që analizohen në këtë kapitull.
Për çdo prej njërës prej gjinive arkitektonike, sidomos për ndërtimet shoqërore, analizohet vendi që ato zënë në strukturën urbanistike të vendbanimit.
Gjinitë arkitektonike dhe shembujt e sjellë janë parë në lidhje të ngushtë me simotrat e tyre në viset e ndryshme të Botës Mesdhetare, për të zbuluar ngjashmëritë dhe tiparet specifike e të veçanta, të kushtëzuara nga veçoritë e shoqërisë ilire të së njëjtës periudhë.
Së treti, falë shfrytëzimit të një literature tepër të gjerë. Pa këtë literaturë nuk mund të kishte bazë argumentuese komponentja tepër e rëndësishme e veprës, aspekti krahasues ndërmjet shfaqjeve të ndryshme të dukurive arkitektonike. Por jo vetëm në aspektin arkitektonik. Baza e gjerë bibliografike i ka dhënë një forcë bindëse dhe shtjellimit të karakterit të etnosit ilir, të pohuar nga autorët antikë, si dhe nga studiues në zë të botës antike.
Së fundi, falë një materiali të shkëlqyer ilustrativ, grafik dhe fotografik. Pa këtë material analiza e shembujve të sjellë do të mbetej disi abstrakte. Është pikërisht ilustrimi që e materializon analizën dhe i jep një bazë argumentuese konkluzioneve të nxjerra nga shtjellimi i materialit përshkrimor. Ka rëndësi dhe fakti se materiali ilustrativ nuk është i thatë dhe skematik, por është përpunuar në një mënyrë të tillë që ai të jetë i konceptueshën nga çdo lexues, pavarësisht nga formimi i tij profesional.
Fjalori i termave, dhe ky i ilustruar, do t'i shërbejë lexuesit për t'i kuptuar më qartë përshkrimet dhe analizën e shembujve të sjellë.
Duke pasur parasysh këtë ngjizje të gjithanshme të materialit, me sfondin historik, me paraqitjen e shkathët të materialit të kombinuar me analizat tipologjike, zhvillimet historike, bazën krahasimore dhe konkretizimin ilustrativ, shpreh bindjen se çdo lexues e përfundon leximin me kënaqësinë se tashmë e fitoi njohjen e trashëgimisë arkitektonike të etnosit ilir. Nga ana tjetër, kjo vepër do të shërbejë si burim i saktë informacioni jo vetëm për specialistët e fushës së arkeologjisë, por dhe për një gamë shumë të gjerë lexuesish, që përfshin restauratorë, për të njohur objektet e trashëgimisë antike dhe për të përcaktuar metodologjinë e ndërhyrjeve në to, arkitektë e inxhinierë, studentë, për plotësimin e formimit të tyre kulturor e profesional, punonjës të kulturës e të turizmit, për të hartuar guida e tabela informimi të sakta shkencërisht, ndonëse me gjuhë të thjeshtëzuar, si dhe për lexuesit e interesuar për njohjen e kulturës të të parëve tanë.
Duke përgëzuar Prof. Apollon Baçen që na dhuroi këtë vepër të vlefshme, i uroj autorit suksese dhe prodhimtari të vijueshme për botime të tjera të kësaj natyre.

DO NOT COPY

DO NOT COPY